Klubi i Poezisë
Tiranë

FLORI BRUQI

S H T Ë P I A E V E R D H Ë

Klubi i Poezisë
Tiranë

FLORI BRUQI

SHTËPIA E VERDHË

DICK MARTY U "SPONSORIZUA" NGA BEOGRADI

Klubi i Poezisë
Tiranë

Tiranë, 2018

Titulli : Shtëpia e verdhë
Autori: Flori Bruqi
Redaktor: Izet Duraku
Recenzent: Rexhep Shahu
Ballina & arti grafik: BoV Desing
Përgatiti: Klubi i Poezisë, Tiranë
© Të gjitha të drejtat janë të Flori Bruqit
ISBN 978-9928-271-03-7
Fast print
Shtypshkronja Vision Print Prishtinë

Tiranë, 2018

FLORI BRUQI

SHTËPIA E VERDHË

DICK MARTY U "SPONSORIZUA" NGA BEOGRADI

Klubi i Poezisë
Tiranë

Tiranë, 2018

Esat Mekuli

SI KE MUNDUR?

(Duke lexuar tekstin e një dokumenti nga viti 1939,
i cili u publikua tash vonë, e shkruar nga I. A.)

Fjalë pas fjale – faqe të tëra ke shkruar –
faqe dhune, robërie e smire?…
Ëndërrues i dikurshëm, në burgje i sprovuar,
t'i robërosh të tjerët? Të ndjellish ditë errësire?!

Si t'i marr sot, në këto ditë lirie,
fjalët e tua farmak?

Po shkrimet tua të tjera, që aq të patën hije?!
Syve si t'u besoj?… Ti, që nderimin e pate hak, vallë,
lirinë e tjetrit ta vësh në darë e lak?!

(Jeta e re, nr. 4, fq. 390, Prishtinë, 1979)

NOBELISTI IVO ANDRIQ SI ANTISHQIPTAR

Që nga Naçertanije (drafti sekret 1844) e ministrit të Brendshëm, Ilia Garashanin, përmes elaboratit të Akademikut serb Ivo Andriqit të porositur nga kryeministri Milan Stojadinoviq, pastaj elaboratit të Akademikut Prof. Dr. Vasa Çubriloviqit, e pjesërisht të realizuar nga ministri i Brendshëm jugosllav Aleksandar Rankoviq, derisa ai u hoq nga Marshalli jugosllav Josip Broz Tito prej pushtetit në Plenumin e ashtuquajtur të Brioneve më 1966, nga "Marrëveshja xhentëlmene" me Turqinë, "Otkupi" e deri te Memorandumi 1 dhe 2, iniciuar nga Akademik Dobrica Qosiqi & SANU për zgjidhje ushtarake (i pari) dhe "përkufizimi paqësor me shqiptarët" (i dyti), Serbia e ka ngritur në doktrinë shtetërore zhdukjen e popullit shqiptar.

Në bazë të kërkesës së ish– kryeministrit dhe ministrit të Jashtëm të Jugosllavisë së parë Milan Stojadinoviq, shkrimtari serb Ivica Andriq që më vonë mori çmimin Nobel për Letërsi, kishte bërë një program për ndarjen e Shqipërisë.

Programi ishte hartuar në vitet 1937- 1939 derisa Andriq kishte qenë përfaqësues i MPJ-së së asaj kohe. Pas rënies së Stojadinoviqit, Andriq u bë ministër i Punëve të Jashtme i Jugosllavisë.

Editimi kritik sipas metodave bashkëkohore i burimeve dokumentare duke u mbështetur në origjinal e jo në botimin e botimit ose në përkthimin e përkthimit është një çështje delikate, serioze dhe mjaft me përgjegjësi. Duke pasur një botim të transilteruar e nga ai edhe të paktën një përkthim, edituesi i burimit arkivor iu shmanget qëllimshëm përsëritjeve por, edhe lëshimeve e gabimeve të mëparshme duke ruajtur autoritetin e botuesit të parë dhe të përkthyesit të parë, njëkohësisht duke sjellur një editim të ri, me saktësime, plotësime e korrigjime të domosdoshme.

Burimi arkivor, shkruante vjet në gazetën Shqiptarja Dr. Musa Ahmeti, që kemi në dorë ka njohur dy botime në origjinal sllavisht (B. Krizman, 1977, Zagreb dhe te revista “Sveske” 1988 Beograd, ky botimi i dytë është mbështetur te botimi i parë e nuk ka autorë. Redaktor i revistës “Sveske” më 1988 ishte

Slobodan Zubanoviq (L. Radoviq, 2008). Për këtë dorëshkrim është shkruar e debatuar edhe nga autorë shqiptar në shqip e sllavisht. Është përkthyer në shqip në mënyrë fragmetare a të plotë që nga viti 1981, J. Grvalla, (Zvicër), më 1990 në revistën Fjala, (Prishtinë), në vitin 2003 H. Islami, (V. Shita) dhe 2005 R. Qosja (V. Shita).

Debatet për këtë dokument arkivor që njihet me titull: "Elaborati i Ivo Andriqit për Shqipërinë i vitit 1939" titull ky i vënë nga botuesi i parë B. Krizman, që në origjinal nuk ka titull, janë jashtëzakonisht të shumta si nga shqiptarët (J. Grvalla, E. Mekuli, H. Islami, R. Qosja…, etj) ashtu edhe nga kroatët (B. Krizman, I. Jeliq, A. Stipçeviq, B. Horvat, etj), malazezët (V. Kaleziq), boshnjak (Bećir Macić), etj., ndërsa u mbrojt nga pothuajse të gjithë autorët serbë.

Me këtë rast dëshirojmë të theksojmë se dispojmë tërë polemikën e zhvilluar në mes të kryeredaktorit të revistës kroate: "Časopis za suvremene povijest" I. Jelić, B. Krizmanit dhe R. Čolakoviqit, V. Kaleziqit, E. Koshit, I. Tartaljes, R. Cvjetiqaninit e cila ruhet në dorëshkrim në Beograd në: "Centar za dokumentaciju Zadužbine Ive Andrića, nr. 1156-1164, f. 243-261". Këto dokumente pasi të përkthehen shpresojmë ti botojmë, sepse mendojmë se përmbajnë qëndrime shumë intersante rreth "Elaboratit" të Andriqit, duke

hedhur dritë në disa aspekte pak ose fare të panjohura nga veprimatria e I. Andriqit.
Kur është fjala te debatet me këtë rast dëshirojmë të sjellim në vëmendje të lexuesve dhe studiuesve polemikën shumë origjinale të poetit të madh shqiptar Esat Mekulit, i cili përmes një poezie të botuar fillimisht në gjuhën shqipe në Prishtinë, në vitin 1979 në revistën "Jeta e Re", nr. 4, f. 390, pastaj edhe në kroatisht në revistën "Forum", të Akademisë së Shkencave Jugoslave në Zagreb (sot HAZU), më 1980, viti XIX, libri XL, nr. 9, f. 364, shpreh kundërshtimin e tij ndaj nobelistit Ivo Andriq në këtë formë:

Esat Mekuli

SI KE MUNDUR?

(Duke lexuar tekstin e një dokumenti nga viti 1939,
i cili u publikua tash vonë, e shkruar nga I. A.)

Fjalë pas fjale – faqe të tëra ke shkruar –
faqe dhune, robërie e smire?…
Ëndërrues i dikurshëm, në burgje i sprovuar,
t'i robërosh të tjerët? Të ndjellish ditë errësire?!

Si t'i marr sot, në këto ditë lirie,
fjalët e tua farmak?

Po shkrimet tua të tjera, që aq të patën hije?!
Syve si t'u besoj?… Ti, që nderimin e pate hak, vallë,
lirinë e tjetrit ta vësh në darë e lak?!

(Jeta e re, nr. 4, fq.390, Prishtinë, 1979

Ne kemi sjellë të dy variantet e poezisë së E. Mekulit, sepse ato dallojnë nga njëra tjetra. Ne kemi bërë përkthimin e variantit koratisht, por duke ditur se vetë autori ka botuar në shqip këtë poezi, ne nuk po e botojmë atë kësaj radhe. Ndryshimet që vërehen sigurisht që E. Mekuli i kishte parasysh, veçanërisht ai këto i bën për lexuesin e gjuhës "serbokrate" të kohës kur u botua poezia. Një tjetër reagim interesant është edhe ai që Ivo Andriq dhe veprat e tij të hiqen nga literatura (L. Radoviq, 2008) dhe librat e letërsisë shkollore në Kosovë (D. Kostiq, 2010). Një kërkesë e tillë u bë edhe nga dr. Ibrahim Rugova në vitin 1988 (V. Lalić, 2008; A. Paliq, 2013).

Përshkrimi fizik i dokumentit

Dokumenti i Ivo Andriqit sot ruhet në: "Arhiv Serbije, [Jugoslavije, m.a.] fondi i: Milan Stojadinoviqit, kutia 37, f. 1-13" dhe është i daktiloshkruar në dy kopje, e

para me ngjyrë blu ndërsa e dyta me ngjyrë të zezë. Është daktiloshkruar me grafema çirilike. Është i paginuar në fund në mes te faqeve me numra 1-13, dhe kopja e parë me laps plumbi me të njëjtit numra, ndërsa kopja e dytë është e papaginuar me laps plumbi. Faqja e parë ka përmbajtën e dokumentit, ku janë të shënuar dhjetë kapituj me numra romak. Në fund të faqes së parë, djathtas, poshtë është shkruar me stilograf me ngjyrë blu nga kryeministri dhe ministri i punëve të jashtme i Serbisë së asaj kohe, Milan M. Stojadinoviq: "Referat i z. Ivo Andriq, 30 janar 1939".

Dokumenti nuk ka titull autorial. Data e krijimit të tij, merret ajo që ka shënuar Stojadinoviqi me dorë në faqen e parë, po ne jemi të mendimit se dokumenti është hartuar të paktën disa ditë më herët (gjithashtu nuk jemi dakord se ky dokument u hartua me 1 janar të vitit 1939, siç mund të haset në ndonjë shkrim të autorëve shqiptarë). Fletët e dokumentit kanë dimensione: 28.8cm x 20,6cm. Nuk kanë shenja filigranes. Dokumenti nuk ka shënime të tjera.

Dokumenti lexohet lehtë. Është në gjendje shumë të mirë. Ruhet në një kuti kartoni së bashku me disa dokumente të tjera me përmbajtje të ngjashme, për të cilat do shkruajmë një herë tjetër. Dokumenti është i ndarë në dhjetë kapituj dhe ka edhe katërmbëdhjetë

nënkapituj, të parët të shkruar me grafema kapitale ndërsa të dytët me grafema normale.

Çfarë është "Elaborati i Ivo Andriqit për Shqipërinë i vitit 1939"?

Një ndër projektet e shumta për zhdukjen, shpërnguljen e asimilimin e shqiptarëve si dhe për përvetësimin e territoreve të tyre etnike dhe ndarjen e tyre në mes të fqinjëve si dhe zhbërjen e shtetit të tyre të cunguar, është edhe ai i nobelistit jugosllav, Ivo Andriqit. Ky projekt ka përmbajte raciste (A. Stipçeviq, 1992), dhe mbështet gjenocidin mbi shqiptarët (S. Çekiq, 2009), është punuar me përkushtim, (S. Keçmezi-Basha, 2014) vetëdije të plotë, qëllime të qarta dhe ide largëpamëse, nga Ivo Andriqi në janar të vitit 1939, për kryeministrin dhe ministrin e punëve të jashtme të Mbretërisë Serbe Kroate Sllovene,(MSKS) Milan M. Stojadinoviqin (M. M. Stojadinović, Ni rat ni pakt. 1963), i cili ka shënuar me dorën e tij në të djathtë, poshtë të faqes së parë të dokumentin datën 30 janar të vititi 1939 dhe emrin e autorit, Ivo Andriq.

Këtë "Elaborat" Andriqi e shkroi kur ishte me funksion ndihmës ministër i punëve të jashtme (A. Stipçeviq, 1992) në MSKS (D. Kostiq, 2010), që në fakt ishte persnoni me përgjegjësi më të madhe në ministrinë e punëve të jashtme të MSKS, pasi M.

Stojadinoviq ishte kryeministër, I. Andriqi kryente punët e ministrit të punëve të jashtme (R. Paviq, 2001). Më 25 mars të vitit 1941 në Vienë, Ivo Andriqi firmos paktin "Trepalësh" për bashkimin e MSKS me shtetet fashiste (L. Radoviq, 2008).

Leximi i kujdesshëm i tekstit të "Elaboratit" hedh dritë mbi disa ngjarje dhe personalitete historike shqiptare, psh. siç është "Republikën e Mirditës" si krijesë e ideuar, financuar dhe mbështetur nga serbët, (B. Horvat, 1988) etj, por edhe mbi pretendimet serbe për të pasur një baraspeshë në rajon ndaj pretendimeve greke e italiane.

Ne kemi bërë një përkthim ad literam të tërë "Elaboratit" duke ruajtur besnikërisht terminologjinë profesionale diplomatike, juridike, gjeopolitike, politike, ekonomike dhe toponiminë. Në ato vende ku në origjinal mungonte kuptimi i fjalës në fjali, ne në kllapa kemi vënë fjalën që mungon ose atë që duhej të ishte. Nuk kemi bërë asnjë lloj ndërhyrje në tekst sikurse është bërë në botimet sllavish ose në përkthimet shqip.

"ELABORATI I IVO ANDRIQIT PËR SHQIPËRINË I VITIT 1939"

KUSH ËSHTË IVO ANDRIQI ?

Ivo Andriqit lindi në Dolac, Travnik, në Bosnje, me 9 tetor 1892 e vdiq, mbas nji hiktusi cerebral, me 13 marc 1975 në Beograd. . Kur ishte i vogël, familja e tij u shpërngul në Vishegrad. Përfundon shkollën e mesme në Sarajevë e në 1912 regjistrohet në Universitetin e Zagrebit e mandej vazhdon studimet edhe në Vjenë.

Debutoi në letersi në nji libër me titull «Poezia e re kroate» ku u paraqitën edhe poetë të tjerë. Mw vonë wshtw shkrimtari Cërnjanski ai qw e drejton poetin e ri serb drejt problemeve të letersisë e të politikës. Bwhet antar i grupit «Mlada Bosna» (Bosnja e re) qw organizon dhe kryen atentatin ndaj Arqidukës Franc Ferdinand në Sarajevë. Në vjetin 1914 arrestohet për propagandë politike kundra Perandorisë Austro-hungareze. Dërgohet në Split e prej aty në Shibenik e në nwntor të atij viti në Maribor ku dënohet me arrest shtëpie. Kësaj periudhe i përkasin edhe dy poezitë «Shëtitja« e «1914» të Andriqit 22 vjeçar. E para i kushtohet dy vajzave, Eugenija Gojmeracit prej Zagrebit e Halina Irzkowskit prej Krakovjes, qw lanë

gjurmë në jetën e rrëfimtarit të ardhshëm, i cili në 1961 do të nderohej me çmimin Nobel.

Prej 1920-1921 punon si sekretar ambasadet në Romë. Ndërkaq mbron doktoratin pranë Universtitetit të Gracit e vazhdon karrierën diplomatike në ambasadat jugosllave në Bukuresht, Grac, Madrid, Zhenevë. Mbas pushtimit të Beogradit prej gjermanëve në 1941, jep dorëheqjen prej ambasadës në Berlin e kthehet në Jugosllaví.

Në poezinë e Andriqit ndihet nji dhimbje qi me kalimin e kohës bâhet gjithmonë e mâ e fortë. Humbja për te wsht nji shkak për me u ringjallë e me shkue drejt fitores. Ndërsa melankonija e vetmia janë vetëm shprehje të luftës së mbrendshme kundra kohës e njerzve. Ndër prozat mâ të mira të këtij auktori përmendim triologjinë «Ura mbi Drin», «Kronika e Travnikut», «Zonjusha» (1945) si edhe «Tregimet e Bosnjës».

I.

LUFTA BALLKANIKE DHE SHQIPËRIA

Dalja e ushtrisë serbe në Adriatik

Sipas aneksit të fshehtë të Marrëveshjes për Aleancën në mes të Bullgarisë dhe Serbisë, të datës 26 shkurt të vitit 1912, Serbisë i njihej e drejta në territoret e deriatëhershme turke në Veri dhe në Perëndim të malit të Sharrit. Lidhur me këtë dispozitë, duke

synuar ti siguronin vendit të tyre dalje në det, trupat serbe më 15 nëntor të vitit 1912, hynë në Lezhë dhe gradualisht pushtuan tërë Shqipërinë Veriore, deri në Tiranë e në Durrës. Në "Times" të Londrës më 25 nëntor [të vitit 1912, m.a.] u botua deklarata e Pashiqit që Serbia kërkon Durrësin me pjesën më të madhe të hinterlandit.

Krijimi i Shqipërisë autonome

Megjithatë Konferenca e Ambasadorëve në Londër, më 20 dhjetor të vitit 1912 mori vendim për krijimin e Shqipërisë autonome, duke i dhënë Serbisë vetëm të drejtën e daljes tregtare në detin Adriatik. Po kjo Konferencë, më 20 mars të vitit 1913 vendosi që Shkodra ti dorëzohej Shqipërisë. Mali i Zi refuzoi ta pranonte vendimin e fuqive të mëdha; për këtë e mbështeti Serbia, e cila dërgoi trupat e veta për ta forcuar rrethimin e Shkodrës. Fuqitë e Mëdha vendosën (më 21 mars [të vitit 1913, m.a.]) të bënin demonstrimin detar, nga i cili u përmbajt vetëm Rusia. Kryqëzorët austro-hungarezë, anglezë, francezë, gjermanë dhe italianë, të grumbulluar afër Tivarit, i detyruan trupat serbe të tërhiqeshin nga pozicionet afër Shkodrës.

Bllokada e bregdetit malazez

Fuqitë e Mëdha shpallën më 10 prill [të vitit 1913, m.a.] bllokadën e brigjeve të Malit të Zi, por qeveria malazeze vazhdoi rrethimin e Shkodrës, e cila kapitulloi më 20 prill [të vitit 1913, m.a.]. Mbreti Nikolla, megjithatë, u detyrua të lëshonte pe dhe, më 4 maj, [të vitit 1913, m.a.] me një telegram që i dërgon sër Eduard Greit (sir Edward Gray), e dorëzon fatin e Shkodrës në duar të Fuqive të Mëdha. Pushtimi ndërkombëtar i Shkodrës zgjati prej 5 majit të vitit 1913 deri në fillim të Luftës Botërore.

II.

NDARJA E SFERAVE TË INTERESIT NË SHQIPËRI NDËRMJET SERBISË E GREQISË

Edhe pse nën presionin e Fuqive të Mëdha, në radhë të parë të Austrisë, u detyrua të tërhiqet nga Adriatiku dhe Shqipëria Veriore, Serbia nuk pushon së humburi shpresën. Në deklaratën e cila ishte shtesë e fshehtë e Marrëveshjes së aleancës në mes Greqisë e Serbisë nga 19 maj i vitit 1913, u ndanë sferat e interesit në mes të Greqisë e Serbisë, në Shqipërinë e porsaformuar autonome. Territori që shtrihet në veri të grykës së lumit të Semanit në det, pastaj drejt rrjedhës së këtij lumi deri te Gryka e Devollit, pastaj përgjatë Devollit deri te Mali i Kamjes – bënte pjesë në sferën e ndikimit serb. Pjesa jugore e Shqipërisë, nga kjo vijë, bënte pjesë në sferën e

ndikimit grek. Në rast trazirash në Shqipëri, dy shtetet do të merreshin vesh për qëndrimin që do të mbanin. Këto janë kërkesat maksimale që në një dokument të shkruar i kemi parashtruar ndaj Shqipërisë.

III.
PAKTI I LONDRËS DHE SHQIPËRIA

Pakti i Londrës është lidhur më 26 prill të vitit 1915 në mes: Francës, Britanisë së Madhe, Rusisë dhe Italisë kishte dispozitat vijuese ndaj Shqipërisë:

Në vërejtjen e nenit 5 është thënë: "Katër fuqitë aleate do të ndajnë tokat e poshtëshënuara të Adriatikut Kroacisë, Serbisë e Malit të Zi: [...]. Në Adriatikun e poshtëm (në viset që ju interesojnë Serbisë e Malit të Zi) tërë bregdetin, nga Kepi Planca deri te Lumi Drin, me portet e rëndësishme të Splitit, Dubrovnikut, Kotorrit, Tivarit, Ulqinit, Shëngjinit [...]. Porti i Durrësit do ti ndahet shtetit të pavarur mysliman, Shqipërisë".

Ivo Andriq: Shqipëria duhet ndarë

Në nenin 6 thuhet: "Italia do ta marrë në zotërim të plotë Vlorën, ishullin Sazan, e pos kësaj edhe një territor mjaft të gjerë i domosdoshëm për mbrojtën e tyre, domethënë pjesën ndërmjet lumit të Vjosës në veri e në lindje, kurse në jug deri në Himarë".

Në nenin 7 thuhet: "Nëse do të vinte deri te formimi i një shteti të vogël autonom e neutral i Shqipërisë, Italia nuk do ti kundërvihej dëshirës së Francës, të Britanisë së Madhe dhe të Rusisë që viset veriore dhe ato jugore të Shqipërisë të ndaheshin në mes Malit të Zi, Serbisë e Greqisë".

Që në vitin 1915 Fuqitë e Mëdha, pra miratojnë parimin e ndarjes së Shqipërisë dhe pranojnë që në Shqipëri të kenë interesat e tyre Italia, Serbia e Greqia. Ndërsa këtyre dy vendeve ballkanike ju njihet e drejta në korrigjimin e kufijve, Italisë i dorëzohet Vlora si dhe protektorati mbi Shqipërinë e cunguar.

IV.
SHQIPËRIA NË KONFERENCËN E PAQES

Pikëpamjet e fuqive të mëdha

Në Konferencën e Paqes fuqitë aleate (Franca, Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës), propozuan më parë për Shqipërinë, në Veri e Lindje, ata kufij të cilët ishin përcaktuar në Konferencën e Londrës në vitin 1913; i njihnin sovranitetin e plotë Italisë mbi Vlorën dhe hinterlandin e nevojshëm dhe i jepnin Italisë mandatin për administrim të lirë të shtetit shqiptar nën kontrollin e Lidhjes së Kombeve (Memorandumi nga 9 dhjetori i vitit 1919).

Pikëpamja jonë

(Kundër mandatit të Italisë. Për Shqipërinë e pavarur. Argumentet për korrigjimin e kufijve dhe për marrjen e Shkodrës e të Shqipërisë Veriore).

Në përgjigjen tonë nga 8 janari i vitit 1920 ne e hodhëm poshtë propozimin, që Italisë ti jepej mandati mbi Shqipërinë, duke theksuar se kjo do të ishte përsëritje e rastit të Bosnjës e Hercegovinës. "Kjo zgjidhje, thuhet në përgjigjen tonë, do të krijonte në favor të Italisë kufij ofensivë kundër shtetit tonë, i cili do të privohej nga mjetet për t'u mbrojtur. Kjo do të thoshte në njëfarë dore përparësi ofensive, kurse në anën tjetër vartësi e përsosur strategjike".

Ne kemi kërkuar, për shkaqe ekonomike dhe strategjike, që të bëhet korrigjimi i kufijve ndaj nesh (në rrjedhën e mesme të Drinit, në Bunë dhe në shikim [drejtim, m.a.] të fiseve Kelmendi e Kastrati), që i përcaktoj Konferenca e Londrës nga viti 1913. Përveç këtij korrigjimi, delegacioni ynë kishte deklaruar se zgjidhja më e mirë është, nëse Shqipëria bëhet shtet i pavarur në kufijtë e vitit 1913, dhe me administrim autonom.

Në rast se kjo zgjidhje nuk do të pranohej, ose nëse pjesa Jugore e Shqipërisë do t'u jepej shteteve të tjera, delegacioni ynë kishte kërkuar për ne pjesën Veriore të Shqipërisë deri në Drin. "Shteti ynë ka të drejta të

lashta në këto treva, thuhet në memorandumin tonë. Shkodra është kryeqyteti i dikurshëm i sundimtarëve serbë.

Populli ynë ka derdhur lumenj gjaku për Shkodrën, sidomos në luftën e vitit 1913, i cili i ka kushtuar Serbisë disa mijëra ushtarë të saj, kurse Malit të Zi një të tretën e ushtrisë së tij. Për ti kënaqur dëshirat e Fuqive të Mëdha, trupat serbe dhe malazeze zbrazën në vitin 1913 Shkodrën dhe Shqipërinë Veriore. Austria duke e mobilizuar ushtrinë, kërcënoi me luftë. Shkodra mund ti takonte Malit të Zi, po të pranonte ky i fundit t'ia lëshonte Llovqenin Austrisë, ose të ishte neutral. Por Mali i Zi refuzoi t'ia lëshonte Austrisë këtë pozicion të rëndësishëm strategjik".

"Lugina e Drinit me Shkodrën përbëjnë një tersi gjeografike dhe ekonomike me Malin e Zi dhe trevat kufitare të Serbisë. Për Serbinë e Mesme dhe për Malin e Zi, Lugina e Drinit është e vetmja rrugë natyrore direkte dhe më e shkurtër për në Adriatik. Hekurudha e rëndësishme Danub – Adriatik duhet të kalojë nëpër Luginën e Drinit. Konferenca e Ambasadorëve në Londër e vitit 1913, ja ka njohur Serbisë të drejtën e daljes në det".

"Shkodra është në lidhje edhe me lumin Buna, i cili i hap udhë natyrore tregtisë së Malit të Zi në det.

Që nga Marrëveshja e Berlinit, Mali i Zi gëzonte të drejtën e lundrimit të lirë në Bunë. Liqeni i Shkodrës,

në pjesën më të madhe i takon Malit të Zi. Për shkak të pakujdesisë së turqve, tokat më të mira të Malit të Zi edhe më tutje janë të përmbytura nga uji i Liqenit të Shkodrës. Për këtë shkak shtetin tonë e intereson në masën më të madhe rregullimi i Bunës dhe i Drinit, jo vetëm për shkak të lundrimit në Bunë, por edhe për shkak se në këtë mënyrë do të thaheshin 12 deri në 20.000 hektarë të tokës më pjellore dhe po aq hektarë do të bonifikoheshin. Dy të tretat e kësaj toke i takojnë Malit të Zi".

Pikëpamjet italiane(Sipas Memorandumit të 10 janarit 1920)

Italia kërkon nga Lidhja e Kombeve mandatin që ta administrojë shtetin e pavarur shqiptar.

Kufijtë shqiptarë në Veri e në Lindje do të jenë ata që janë caktuar në Konferencën e Londrës. Kufiri Jugor do të jetë objekt shqyrtimi.

Qytet i Vlorës do ti jepet Italisë nën sovranitet të plotë, bashkë me hinterlandin e nevojshëm për mbrojtjen e saj dhe zhvillimin ekonomik.

Aleatët pranojnë që Shkodra dhe Shqipëria e Veriut ti bashkohen Jugosllavisë

Duke propozuar një zgjidhje të përgjithshme të çështjes së Adriatikut, Klemanso, në cilësinë e kryetarit të Konferencës së Paqes, në lidhje me lëshimin e Rijekës Italisë, deklaroi më sa vijon: "pra

sipas kësaj shteti i S. H. S. [Serbëve Kroatëve e Sllovenëve, m.a.] do të ngrihet në kulmin e fuqisë së vet, pasi ti ketë në zotërim Shkodrën, Drinin dhe Shëngjinin".
Niti kishte pranuar këtë, me kusht që Italia ta mbante Vlorën dhe ta fitonte mandatin mbi Shqipërinë.

Përgjigjja jonë e fundit Konferencës së Paqes

Në përgjigjen tonë të fundit Konferencës së Paqes (më 14 janar të vitit 1920), ne edhe më tutje kemi qëndruar në pikëpamjen, se zgjidhja më e mirë do të ishte që administrimi i Shqipërisë në kufijtë e caktuar më 1913 ti besohej qeverisë autonome lokale, pa kompetenca të cilësdo fuqi të huaj. Nëse kjo zgjidhje nuk pranohet, por vendoset që pjesë të territorit shqiptar t'u jepen shteteve të tjera, delegacioni ynë do të kërkoj pjesën e Shqipërisë Veriore (duke bashkëngjitur një hartë me kufirin e shënuar), për të cilën ishte premtuar regjim autonom.

Pikëpamja e Nikolla Pashiqit

Kur dukej e sigurt se aleatët do ti lejonin Italisë të përforcohej në Shqipërinë e Mesme, kryetari i delegacionit tonë, Pashiqi, në fund të vitit 1919 njoftoi qeverinë në Beograd se kishte ardhur koha, që të shtrënguar nga rrethanat, ta ndryshojmë politikën tonë ndaj Shqipërisë. Në atë letër thuhej: "Pasi në

Shqipëri nuk mund ta kthejmë gjendjen çfarë ka qenë para evakuimit të ushtrisë sonë dhe të shtetit të parë të Esad Pashës, për shkak të depërtimit të Italisë dhe të përkrahjes së Italisë nga ana e fuqive; pasi Fuqitë duan ta zbatojnë Marrëveshjen e Londrës dhe s'do të ketë Shqipëri çfarë ne kemi mbrojtur, aleatët do t'ia japin Italisë Vlorën me hinterlandin dhe protektoratin mbi një pjesë të Shqipërisë – në këto rrethana, ne duhet të kërkojmë kufij të tjerë më të mirë ndaj territoreve shqiptare, të cilat do të bien nën protektoratin italian".

"Minimumi që do të pranojmë nga aleatët është ky: kufiri përgjatë Drinit të Zi deri në grykëderdhejn e Drinit të Bardhë e nga aty Drinit të Madh (duhet të jetë të Bardhë, në origjinal është të Drinit të Madh, m.a) deri në det".

"Maksimumin duhet ta kërkojmë, në mënyrë që Italia të marrë sa më pak territore. Ky maksimum i pretendimeve tona do të ishte: Lumi i Matit deri në burimin e tij, e nga aty drejt nga lindja deri te Drini i Zi. Pra, Mati dhe Drini do të ishin kufijtë tonë me protektoratin italian".

PUSHTIMI ITALIAN I SHQIPËRISË PAS LUFTËS DHE TËRHEQJA PËRFUNDIMTARE PAS MOSSUKSESIT TE VLORA

Pas përfundimit të luftës, në bazë të një vendimi ushtarak ndërmjet aleatëve, trupat italiane pushtuan tërë territorin e Shqipërisë, madje edhe atë pjesën Veriore, të cilën ne, na e kishte njohur Pakti i Londrës. Vetëm Shkodra ishte nën pushtimin e përbashkët të trupave franceze dhe italiane.

Për shkak të qëndrimit armiqësor që Italia kishte asokohe ndaj shtetit SKS, ne këtë pushtim ushtarak italian të Shqipërisë e kemi konsideruar si rrezikun më të madh për ekzistencën tonë. Ne territorin shqiptar është zhvilluar një luftë e ashpër ndërmjet nesh dhe Italisë. Italianët atëherë iniciuan çështjen malazeze e maqedonase, si dhe idenë e Shqipërinë së Madhe deri në Kaçanik. Ne kundër tyre zhvilluam herë aksione të fshehta, herë të hapura, duke e bërë për vete me para, fisnikët (parinë, m.a.) shqiptarë dhe duke u shërbyer me idenë e "Shqipërisë së pavarur" dhe "Ballkanin popujve të Ballkanit".

Pakënaqësia e popullsisë shqiptare, të cilën e përkrahnim edhe ne, i detyroi italianët që në fillim të vitit 1920, ti tërhiqnin trupat e tyre nga viset e brendshme të Shqipërisë dhe të përqendroheshim vetëm rreth Vlorës, prej nga po ashtu në qershor të të të njëjtit vit do të detyrohen të tërhiqen, duke lidhur një marrëveshje me qeverinë e Tiranës për evakuimin e tyre nga tërë territori shqiptar, përveç ishullit të Sazanit.

Deri te evakuimi nga Shqipëria erdhi për shkak të rezistencës së organizuar të shqiptarëve, por nuk duhet harruar se në atë kohë Italia ishte shumë e dobët politikisht dhe ushtarakisht. Edhe sot ka shqiptarë të cilët mendojnë se mund ti përzënë italianët nga Shqipëria kur të dëshirojnë. Ky vetëbesim është fatal për ata, sepse nuk e shohin që Italia e sotme fashiste nuk është ajo që ishte në vitin 1920 nën qeveritë parlamentare të Nitit, të Gjolitit e të Faktës.

SHQIPËRIA PARA KONFERENCËS SË AMBASADORËVE

Pas evakuimit të trupave italiane nga Shqipëria, gjendja në terren ishte pastruar (qetësuar, m.a.), Konferenca e Ambasadorëve, mundi që në nëntor të vitit 1921 të merrte vendim për njohjen e Shqipërisë si shtet i pavarur e sovran. Në vend të premtimeve të mëparshme lidhur me Vlorën dhe me mandatin mbi Shqipërinë, Fuqitë e Mëdha ia njohën Italisë vetëm interesin e saj të posaçëm për ruajtjen e pavarësisë shqiptare. Shqipëria hyri në Lidhjen e Kombeve, me shpresë se kjo do ta siguronte edhe më tepër pavarësinë e saj.

Para Konferencës së Ambasadorëve, edhe një herë provuam, por pa sukses, që të realizonim korrigjimin e kufirit në drejtim të Shkodrës dhe të Drinit, duke

theksuar për Shkodrën shkaqet historike, kurse për Drinin shkaqet ekonomike dhe ato të trafikut. Eksperti francez në Konferencë, Larosh, na ngushëlloi kështu: "Qeveria mbretërore ka gabuar, që nuk e ka miratuar, në atë kohë, propozimin e Francës për ndarjen e Shqipërisë. Pashiqi qe pajtuar me këtë, por qeveria e Beogradit kishte refuzuar". Që mos të lejonim italianët në Vlorë, ne u detyruam të hiqnim dorë nga Shkodra dhe kufirit deri në Dri.

Meqenëse ne gjithmonë e kemi përfaqësuar idenë e pandashmërisë së territorit shqiptar, ashtu siç ishte caktuar ajo në vitin 1913, si dhe pavarësinë e Shqipërisë, do të mund të supozohej se ne, kjo zgjidhje e Konferencës së Ambasadorëve do të na kënaqte. Kjo megjithatë, nuk është e rastit. Vështirësitë në marrëdhëniet tona me Shqipërinë, si dhe në marrëdhëniet tona me Italinë për shkak të Shqipërisë, po rëndoheshin edhe më tutje, edhe përkundër shpalljes së Shqipërisë si shtet ti pavarur dhe anëtare e Lidhjes së Kombeve.

Republika e Mirditës

Derisa Konferenca e Ambasadorëve po zgjidhte çështjen e kufijve të Shqipërisë dhe organizimin e pavarësisë, ne, në gjysmën e vitit 1921 nënshkruam me të parët (fisnikët, bajraktarët, m.a.) e Mirditës marrëveshjen e bashkëpunimit. Ishte paraparë

formimi i shtetit të lirë të Mirditës, të cilin do ta mbronin forcat ushtarake të S.K.S. dhe interesat të cilit në botën e jashtme do ti përfaqësonte qeveria e Beogradit. Qeveria e Tiranës e shtypi këtë lëvizje, kurse ne qemë akuzuar dhe dënuar para Lidhjes së Kombeve.

VII.

PAKTI I ROMËS, PASHIQI, MUSOLINI DHE SHQIPËRIA

Pakti i Romës i janarit të vitit 1924, me frymën e tij, ua imponoi edhe Romës edhe Beogradit respektimin e pavarësisë dhe parimin e mospërzierjes në punët e brendshme të Shqipërisë, si dhe informimin e ndërsjellë rreth ngjarjeve në Shqipëri. Kjo, megjithatë nuk pengoi qeverinë italiane që të ndihmonte Fan Nolin, në qershor të vitit 1924, që të organizonte kryengritjen kundër Ahmet Zogut, dhe as qeverinë tonë, që në dhjetor të të njëjtit vit ti mundësoj Ahmet Zogut që nga territori ynë të futet në Shqipëri dhe të merrte pushtetin. As Roma, as Beogradi nuk mund t'u bënin ballë intrigave dhe kërkesave të "miqve" të shqiptarëve, të cilët kërkonin ndihmë për të ruajtur ose për të ardhur në pushtet dhe premtonin besnikëri e bashkëpunim, kurse në rastin e parë ndërronin orientimin.

VIII.
PAKTI I TIRANËS DHE GJENDJA QË KRIJOI AI

I ndjeri Pashiq duke i udhëzuar përfaqësuesit tonë për punë në Shqipëri, ju thoshte: ne dëshirojmë Shqipëri të pavarur, por edhe Shqipëri të dobët dhe të trazuar. Koha dëshmoi se kjo nuk ishte e mundur të mbahej. Shqipëria e dobët dhe e trazuar ishte e detyruar të kërkonte ndihmë dhe mbrojtje atje ku mund të gjente. Regjimi i cili ishte i rrezikuar nga Italia, na drejtohej neve, ndërsa ai të cilin ne dëshironim ta rrëzonim, kërkonte mbrojtje nga Italia.

Shqipëria e dobët dhe e trazuar, në vitin 1926 i kërkoi mbrojtje dhe ndihmë Italisë. Ahmet Zogu mori së pari garanci për regjimin e tij, dhe pastaj pranoi në vitin 1927 në lidhjen e një Alenace Ushtarake për 20 vjeçare, përfitoi qindra e qindra miliona lireta për punime botore, ekonomikisht dhe financiarisht e vuri Shqipërinë në zgjedhën italiane, pranoi shumë instruktorë italianë. U krijua, kështu, një raport që i ngjante shumë atij protektorati, kundër të cilit kishim luftuar në Konferencën e Paqes.

Ajo që viteve të fundit më së shumti na rrezikonte prej Shqipërie, ishte organizimi ushtarak fortifikimet ushtarake dhe aksionet irredentiste. Gjithandej e vërenimin rrezikun nga aksionet italiane dhe atë "kufirin ofensiv", kundër të cilit patëm luftuar para

aleatëve në Paris, kur patëm propozuar që Italisë ti jepej mandati në Shqipëri.
Në këtë vend është me interes të theksohet, që vetëm ne kishim protestuar dhe kishim luftuar kundër ndërhyrjes së Italisë në Shqipëri dhe në Ballkan. Asnjë vend tjetër i Ballkanit në kërë drejtim nuk na përkrahu. Dy fuqitë detare mesdhetare, Franca dhe Anglia, nuk kundërshtuan mbylljen e detit Adriatik. Për më tepër, Osten Çëmbërleni, në takimin me Musolinin në Livorno në vitin 1926, dha pëlqimin për Paktin e Tiranës. E të gjithë përfaqësuesit francezë në Tiranë vazhdimisht i jepnin këshilla mbretit Zog që të mos futej në konflikt me italianët.

PAKTI I MIQËSISË ITALO-JUGOSLLAVE I 27 MARSIT TË VITIT 1937

Italia e Jugosllavia duke ndjekur politikë miqësie njëra ndaj tjetrës, mund të merren vesh për Shqipërinë në këtë formë: Italia ka interesin e vet jetësor në Vlorë, kjo pjesë e bregdetit shqiptar nuk bën të rrezikohet prej nesh; ne këtë interes duhet ta kuptojmë dhe ta respektojmë. Interesi jetësor i Jugosllavisë është të mos jetë e rrezikuar në kufirin në drejtim të Serbisë Jugore, as nga Kosova (e populluar me shqiptarë), as nga Shkodra dhe Mali i Zi. Për këtë, pa dyshim është llogaritur, kur në protokollin e fshehtë së bashku me Paktin e Miqësisë

është parashikuar që të ndërpritet fortifikimi i mëtejmë në zonat e Librazhdit e të Milotit.
Për sa i përket aksionit ekonomiko-financiar në Shqipëri, ne për këtë nuk kemi, dhe nuk dëshirojmë të investojmë mjete të veçanta. Italianët, pra, mbeten pa konkurrencë dhe pa vërejtje nga ana jonë, kuptohet me kusht që të mbeten në kufijtë e obligimit tjetër të fshehtë, të cilin para dy vjetësh e kanë marrë ndaj nesh që në pikëpamje politike, ekonomike dhe financiare nuk do të kërkojnë kurrfarë përfitimesh të posaçme, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë do ta kompromotonin pavarësinë e shtetit shqiptar.
Në këtë mënyrë Pakti i Miqësisë i datës 25 mars 1937 krijoi një "modus vivendi" tolerant ndërmjet nesh dhe Italisë në territorin shqiptar, për të cilin vite më parë kemi pasur aq shumë konflikte e dyshime.
Është çështje tjetër, që ky qetësim, në Shqipëri, a do të mund të përballoj disa situata të rënda dhe të komplikuara në Detin Mesdhe ose në Ballkan.

RUAJTJA OSE NDRYSHIMI I STATUS QUO-së

Pavarësia e Shqipërisë është zvogëluar, por nuk është shkatërruar
Pavarësia e një shteti ndaj botës së jashtme gjithnjë është gjithnjë një koncept relativ. Duke pasur

parasysh rrethanat, kjo pavarësi është më e plotë ose është më e zvogëluar. Për Shqipërinë, sot nuk mund të thuhet që politika e brendshme dhe e jashtëm është e pavarur nga Italia.

E megjithatë, ajo në bashkësinë ndërkombëtare konsiderohet si shtet i pavarur. E drejta ndërkombëtare, bregdetin shqiptar e njeh si të pavarur e jo si italian, përkatësisht e konsideron se është nën suverenitetin e një shteti Ballkanik. Italia ende nuk ka shkelur në Ballkan. Ajo ka një pjesë të sovranitetit të territorit të Zarës, por ky nuk i ofron mundësi të zgjerohet më tutje. Në Shqipëri, Italia ka ndikim, por nuk ka lirinë e aksionit sikur në territorin e saj. Shqiptarët megjithatë e kundërshtojnë ndërhyrjen e saj, i shkaktojnë vështirësi dhe e ngadalësojnë.

"Ballkani – popujve të Ballkanit"

Politika tradicionale e Serbisë është "Ballkani – popujve të Ballkanit". Ky parim është përdorur në kohën e tij në luftë kundër Perandorisë Osmane dhe kundër Monarkisë Austro-Hungareze. Jugosllavia e përdori me sukses këtë kundër dispozitave të Paktit të Londrës, i cili e futi Italinë në Dalmaci dhe në Shqipëri. Në zbatimin e këtij parimi ne gjithmonë kemi shikuar garancinë më të mirë për paqe në Ballkan, për bashkëpunim ndërmjet popujve të

Ballkani dhe për zhvillim normal të popujve ballkanas. Prania e një Fuqie të Madhe në Ballkan, janë dyer të hapura të intrigave e pushtimeve.

Zgjerimi i Italisë

A është e mundur që Italia, duke u bërë zotëruese e sovrane e Shqipërisë Jugore dhe të Mesme, të mbetet vetëm në atë brez të ngushtë bregdetar? Ne këtë nuk e kemi besuar para 20 vjetësh, kur Fuqitë e Mëdha ia ofruan Italisë Vlorën me hinterlandin. Ne këtë e kemi edhe më të vështirë ta besojmë sot, kur Italia tregon aq shumë dinamizëm e guxim në politikën e saj të jashtme.

Një precedent i rrezikshëm

Marrja e një pjese të territorit të Ballkanit nga një Fuqi e Madhe joballkanike pa kurrfarë baze etnike, për tërë popujt e Ballkanit, pra edhe për ne, është një precedent i rrezikshëm. Të tjera Fuqi të Mëdha nga drejtime të tjera mund të paraqiten me pretendime të ngjashme. Rasti i veçantë i Italisë në Shqipëri për ne është i rrezikshëm, sepse me Paktin e Londrës, me të cilin për herë të parë ju njoh Italisë, Shqipëria Jugore, po kësaj Italie i ishte njohur edhe Dalmacia Veriore. Precedenti për gjallërimin e dispozitave të Paktit të Londrës në një sektor të Ballkanit hap dyert edhe për gjallërimin e dispozitave të tjera.

Ndarja e Shqipërisë

Me rastin e vlerësimit të tërë kësaj çështjeje, duhet t ë kemi parasysh që me çdo kusht duhet të shikojmë që ti shmangemi konfliktit të hapur ose të fshehtë me Italinë. Gjithashtu duhet ta shmangim pushtimin e tërë Shqipërisë nga Italia, ngase kjo do të na rrezikonte në vendet më të ndjeshme (nevralgjike, m.a.) si në Bokë të Kotorrit e në Kosovë.

Duke pasur parasysh gjithë ç'thamë më lart, për ne ndarja e Shqipërisë mund të vinte në konsideratë vetëm si një e keqe e domosdoshme, të cilën nuk mund ta evitojmë dhe si një dëm i madh nga i cili duhet të nxjerrim përfitime të atilla aq sa është e mundur, d.m.th. prej dy të këqijave ta zgjedhim më të voglën.

KOMPENSIMET TONA

Këto kompensime gjenden në materialin e përpunuar para 20 vjetësh, kur është shtruar çështja e ndarjes së Shqipërisë.

Maksimumi që e kemi kërkuar asokohe ishte kufiri që do të shkonte përgjatë lumit të Matit dhe Drinit të Zi dhe i cili do të na jepte garanci strategjike të Malit të Zi dhe Kosovës. Gjithashtu do të duhej të siguronim luginat e Liqenit të Ohrit dhe Prespës, duke përfshirë

edhe Pogradecin dhe fshatrat sllave të Malit të Thatë si dhe ato në mes të Prespës e Korçës.
Marrja e Shkodrës me këtë rast do të kishte rëndësi të madhe morale dhe ekonomike. Kjo do të na mundësonte që të bënim punime të mëdha hidroteknike dhe të përfitonim tokë pjellore për ushqimin e Malit të Zi. Shqipëria Veriore në kuadër të Jugosllavisë do të mundësonte krijimin e lidhjeve të reja të trafikut të Serbisë Veriore e Jugore me Adriatikun.
Me ndarjen e Shqipërisë do të zhdukej qendra tërheqëse për pakicën shqiptare të Kosovës, e cila në situatën e re lehtësisht do të asimilohej. Ne eventualisht do të fitonim 2-300.000 shqiptarë, por këta shumica janë katolikë, marrëdhëniet e të cilëve me shqiptarët myslimanë nuk kanë qenë asnjëherë të mira. Çështja e shpërnguljes së shqiptarëve myslimanë në Turqi do të bëhej gjithashtu në rrethana të reja, sepse nuk do të kishte kurrfarë aksionesh të forta për pengimin e tij.

PRANVERA E KOSOVËS - MARS – PRILL 1981

Në historinë më të re të Kosovës kujtohen me të drejtë ngjarjet e vitit 1968, 1981, 1997, 1998, 1999.

Por, tërësisht të lëna anash janë demonstratat e 28 marsit 1989.

Ata që harrojnë historinë, ajo mund tu përsëritet, thuhet jo rrallë.

Ka kohë, përkatësisht 28 vite që 28 marsi i vitit 1989 jo që po heshtet, por shumëkush (sidomos gjeneratat e reja) as që dinë se çka në fakt ka ndodhur në atë ditë.

Para lufte edhe pse institucionet nuk ishin si këto që kemi sot, kujtonin nëpër dhoma këtë datë Mars i Përflakur – kushtuar dëshmorit Ismet Avdi Qorraj (21. 01. 1968 - 28. 03. 1989) etj.

****

Ndoshta nga shumë njerëz kjo datë është e harruar dhe i takon vetëm të kaluarës, mirëpo nëse rikthehemi mbrapa do të shohim se kjo datë ka qenë ndër pikat kyqe të qëndresës shqiptare ndaj regjimit serbo-sllav, me protesta në mbrotje të shkollës shqipe, sovranitet të shtetit të Kosovës e deri tek çlirimi i saj.

Serbia pas protestave nëpër krejt ish Jugosllavinë "në mbrojtje të shtetësisë së saj" dhe jo rrallë edhe krijesës së Josip Broz Titos (Jugosllavisë), bëri çmos që të arrinte deri te suprimimi i Autonomisë së Kosovës.

Ajo po ndihmohej edhe nga vasalët, që nëpër tubime thoshin se: "Kosova nuk humb asgjë, derisa Serbia barazohet me republikat tjera"!

Për gjeneratat e reja që edhe s'mund t'i fajësojmë, po ua kujtoj se çfarë ndodhi në këtë ditë. Poashtu, edhe injorantëve të asaj kohe e që sot "harrojnë" këtë ngjarje me peshë po ua "freskoj" kujtesën.

Serbia thoshte se po kthente elementët shtetëror, që kishte humbur me Kushtetutën e Kosovës të vitit 1974.

Tubimi kryesor u mbajt në Gazimestan, kur kasapi i Ballkanit Sllobodan Millosheviq kishte mbledhur rreth një milion serbo-malazezë, ... duke u

premtuar se Serbia do t'u dalë zot serbëve e malazezëve në Kosovë.

Mbaheshin mbledhje që nga lagjet e deri më lart, ku haptas populli shqiptar dhe jo vetëm ai, kundërshtonte ndryshimet kushtetuese.

Kujtojmë protestat gjithëpopullore të nëntorit 1988 dhe grevën e minatorëve në muajin shkurt 1989, që kundërshtuan paqësisht heqjen e elementit (shtetëror) konstituiv që pati Kosova, me Kushtetutën e vitit 1974.

Mirëpo, më 28 mars 1989 Serbia me tanke e dhunë bëri që Kosovës t'i merrej elementi konstituiv, me ndryshimet e dhunshme kushtetuese.

Kosova, deri në këtë kohë ishte pjesë e barabartë e Federatës së atëhershme Jugosllave. Dhunshëm u ndërrua Kushtetuta e Kosovës.

Po të njëjtën ditë me 28 mars 1989 qytetarë të shumtë protestuan në shumë vendbanime të Kosovës.

Në Komunën e Prizrenit në mbrojtje të Kushtetutës ranë po atë ditë 5 dëshmorë (tre në Zhur e dy në Arbanë) dhe u plagosën dhjetëra të tjerë.

Në Komunën e Deçanit u vranë katër demostrues (Ismet Qorraj, Agim Kukleci, Mujë Mehmetaj dhe Sali Hadërgjonaj).

Populli i Kosovës duarthatë dhe paqësisht kishte dalë në mbrojtje të Kushtetutës.

Mirëpo, makineria serbe shkeli me dhunë gjithçka para vetes.
Vrau dhe shkatërroi gjithçka që i doli para.
Protestuesit si në Deçan, Zhur e në Arbanë i vunë gjokset e njoma tankeve dhe blindave serbe që bashkë me njësitet speciale qëllonin pamëshirshëm mbi ta.
Në Beograd okupatori bashkë me kolaboracionistët e kohës pinin shlivovicë të Shumadisë, ndërsa në Kosovë derdhej gjak shqiptari.
Kundërshtimet sa vinin e rriteshin.
Filloi dhe jeta e institucioneve të pavarura që organizuan mësimin, financat, kulturën e sportin, si mundësi e vetme e kundërshtimit e rezistencës aktive paqësore.
Kujtojmë edhe demonstratat e vitit 1990 dhe thirrjet për demokraci gjithandej nëpër Kosovë.
Durimit po i vinte fundi.
Shpërthimi i demonstratave të studentëve dhe mbështetja githëpopullore (1 tetor 1997) deri tek dalja publike e UÇK-sëdhe operacionet luftarake, ishin veprime se po vinin ditë më të mira dhe se okupimit po i vinte fundi.
Mbështetja e aleatëve dhe lufta e heroike e djemve dhe vashave çliruan vendin tonë të okupuar nga hordhitë sllavo-çetnike serbe.

Pa dashur të minimizoj rëndësinë e gjithë këtyre ngjarjeve që kaloi populli ynë, do ta rikujtojë 28 marsin e përgjakshëm të 1989-tës ,do ta kujtojë me po aq pietet si gjithë datat tjera.

Jemi dëshmitarë të asaj që po duan të na ndërrojnë apo rishkruajnë historinë.

Për të mos ndodhur një gjë e tillë, duhet që vetë ta shkruajmë atë.

Të paktën këtë që e jetuam dhe disa nga ne jemi dëshmitarë të saj.

Shoqëria dhe institucionet duhet të jenë më koshientë, që në historinë më të re të Kosovës, t'i kushtojnë rëndësi të veçantë kësaj date.

Assesi nuk bënë të harrojmë gjakun dhe veprën e: Ismet Qorrajt, Kuklecit, Sali Hadërgjonajt, Mujë Mehmetaj (nga Komuna e Deçanit) dhe Muhamet Kabashit e Afrim Bytyqit nga Arbana, të Xhimshit, Xhylbehar e Hajrim Badallaj nga Zhuri dhe gjithë të rënëve tjerë në gjithë Kosovën në këtë ditë.

Derisa popujt tjerë nga balta bëjnë heronj, ne heronjtë po i bëjmë baltë!

Prishtinë, 22 mars 2017.

DUART E PËRGJAKURA TË ALEKSANDËR VUÇIÇIT

Një nga betejat në një vargë të gjatë luftimesh juridike dhe diplomatike kohë më parë u kurorëzua me lirimin (pa kusht) të Ramush Haradinajt nga Gjykata Franceze e cila padrejtësisht si dhe për habi edhe të sërbëve, vendosi të zbatojë një urdhër të lëshuar nga Serbia në INTERPOL në vitin 2004 kundër tij.Reagimet shqiptare dhe ato serbe ishin natyrisht dhe diametrikisht krejtësisht të kundërta, por nga ana jonë ky vendim nuk duhet të sjellë kurrësesi eufori por një plan veprimi konkret për demaskimin e shpifjeve të palës serbe për krime imagjinare lufte kundër serbëve.

Nga të gjitha deklaratat pro dhe kundër lirimit të Haradinajt ajo që bëri më shumë bujë kontradiktore ishte deklarata e personit që pretendon të sjellë ndryshimin në Serbi, Kryeministrit Aleksandar Vuçiç i cili shprehu habinë dhe zhgënjimin e tij në lidhje me këtë vendim pasi sipas tij kriminelet e luftës duhet të gjykohen për krimet e tyre.

Në këtë pikë kulmore duhet të bëhët një portretizim i hollësishëm mbi profilin e montuar me moderim të Vuçiç i cili si për çudi harron të shkuarën e tij kriminale në mbështetje të gjenocideve kundër popujve në ish Jugosllavi.Si fillim, Vuçiç ishte një nga vullnetarët më aktiv dhe besnik të ultranacionalistit Vojislav Sheshelj gjatë luftës në Bosnjë por edhe Kosovë. Ishte partia që Vuçiç ishte Sekretar i Përgjightshëm (Partia Radikale Serbe) ajo që kishte përgatitur dhe firmosur nga ana e tij, Kryetarit Sheshelj dhe zv./Kryetar Nikoliç, për spastrimin etnik të Kosovës, platformë kjo e botuar në gazetën "Serbia e Madhe" (Velika Serbia), më 14 tetor 1995 në Beograd.

Urrejtja kundër popujve të ish Jugosllavisë dhe kryesisht shqiptarëve dhe myslimanëve arrinte deri aty sa Vuçiç me pathos deklaronte në 1995 që për çdo serb që do të vritet "ne do të vrasim qindra myslimanë". Ishte pikërisht kjo urrejtje e tij dhe mbështetje ndaj krimeve të luftës për të cilat ai sot flet, që i dhanë atij postin e Ministrit të Informacionit në Qeverinë e Millosheviçit (që ai pretedonte se protestonte kundër) gjatë 1998-99 më një qëllim të qartë: Censurimin e çdo lajmi që njolloste imazhin e përgjakur të kasapit të Ballkanit, Sllobodan Millosheviç. Lidhjet e Vuçiç me qendrimet radikale dhe lidhjet me Sheshelj vazhdojnë edhe pas lufte dhe

gjykimin e këtij të fundit nga Gjykata e Hagës për KRIME LUFTE!

Konkretisht, në vitin 2005, Vuçiç shprehej ende me fjalë të ngrohta për Sheshelj duke thonë se: "Ai na ka krijuar, ai është dikush me anë të se cilit jemi bërë dikush dhe diçka… Nuk ka asnjë dyshim se ai është një nga udhëheqësit e Serbisë, të cilët historia do të studiojë si një hero i popullit serb". Por duket se pikërisht gjykimi i Sheshelj dhe e shkuara i tij si bashkëpunëtor i tij e largonte nga synimi i tij për pushtet dhe kështu ai vendos të shkëputet de jure nga mentori i tij politik por asnjëherë de facto. Më specifikisht, kur Sheshelj u kthye në Serbi pas lirimit e tij me kusht nga Haga për shkak të sëmundjes së tij, Vuçiç ashtu si dhe Nikoliç nuk u treguan shumë të zellshëm për të mbajtur një qendrim të qartë kundër tij pikërisht sepse ishte Sheshelj ideologu i tyre dhe ai që u bë shkak i ngritjes së tyre në pushtet në kohë rekord duke fshirë kështu nga memorja e tyre personale gjithë ato fjalime plot pasion nacionalist dhe dedikimi emocional ndaj lidërit të tyre. Në fakt ky dyjëzim duket qartë dhe nga deklaratat e Vuçiç. Ai nga njëra anë shprehej se "Nuk ka asgjë në Serbinë e sotme që mund të lidhë qeverinë tonë me Vojislav Sheshelj". Por, nga ana tjetër ai shprehej për gazetarët serb se "Jam krenar që Qeveria e Serbisë ka

mbrojtur ligjet dhe dinjitetin e Serbisë, të qytetarëve të saj dhe të Sheshelj. Nuk kam asnjë antipati ndaj tij. Atij dhe familjes së tij u dëshiroj çdo të mirë". Gjithashtu, ajo që është më e frikshme dhe nxjerr fallço të gjithë teatrin e stisur nga Vuçiç, është fakti që Kryeministri serb jo vetëm që nuk ndaloi aktivitetit politik ultranacionalist të Sheshelj por, gjatë 2016 dakordsoi me të për zgjedhjet lokale të Nishit për të bërë koalicion! Duke marrë në konsideratë të shkuarën e tij të faktuar por edhe të tashmën e tij të lëkundur pikërisht për shkak të njollosjes së tij me gjakun e të pafajshëmve që partia e tij dhe ai si Sekretar i saj solli, Vuçiç jo vetëm që nuk mund flasë për gjykime të krimeve të luftës, por duhet të heshtë pasi ai vetë duhet të gjykohet i pari për nxitje të krimeve etnike dhe heshtjen e dhunshme dhe të përgjakur të civilëve shqiptar dhe jo vetëm. Nga ana tjetër, z. Haradinaj pati guximin që të dorëzoi mandatin e Kryeministrit dhe të shkoi vullnetarisht në Hagë dhe në këtë rast dhe për se dyti kur u thirr po në Hagë, dhe sërisht u dëshmua para botës lufta e tij e drejtë dhe e pastër në mbrojtje të kauzës për liri dhe vetvendosje. Po ju z. Vuçiç jeni të gatshëm për të bërë diçka të tillë? Si më poshtë një koleksion i pasur mbi të shkruarën "e ndritur" të Vuçiç.

-Sheshel ka një guxim të jashtëzakonshëm, gatismëri dhe konsistencë në mbrojtjen e nderit dhe dinjitetit të popullit serb (v. 2001)
-Gjithçka çfarë thotë Voja nga Haga, për ne do të jetë Letër e shenjtë (v. 2003)
-Vojisllav Sheshelin e kisha kumbar kur u martova, e më pas më pagëzoi djalin dhe vajzën. Për fëmijën tjetër, do të presim kur të kthehet nga Haga që ta pagëzoi, pavarësisht se sa do të zgjas (v. 2003)
-Kurrë nuk kam takuar njeri më trim se sa zoti Sheshel (2006)
-Shesheli më tradhtoi mua, familjen time dhe gjithë të tjerët (v. 2008)
-Nuk dua të them asnjë fjalë të keqe për Sheshelin (v. 2008)
-Vojisllav Sheshel është një gënjeshtar ordiner, mi i vogël dhe mostër (v. 2010)
Për Bosnjen dhe luftën në BiH
-Po, ju bombardoni. Vrani një serb, ne do të vrasim qindëra muslimanë (v. 1995)
-Me histerinë që po krijohet rreth Srebrenicës, po bëhet një persekutim antiserb, qëllimisht po heshten vuajtjet serbe, viktimat dhe fatkeqësitë (v. 2001)
-Është e papranueshme të gjykojmë vetëm krimin në Srebrenicë, pse a duhet të harrojmë Reublikën serbe të Kroacisë, Bratuncin, Sarajevën, Kleçkën (v. 2005)

-Dikur nuk kam folur se në Srebrenicë është kryer një krim i tmerrshëm, por tani neveritem nga njerëzit që e kanë bërë këtë gjë (v. 2010)

-Janë kryer krime ndaj serbëve, kjo nuk kontestohet, por asnjë krim kundër serbëve nuk mund të arsyetoj krimet që disa bashkëkombas tanë kanë kryer në Srebrenicë (v. 2010)

Për Mlladicin dhe Karaxhiçin

-Radovan Karaxhiç është simbol i luftës për liri të popullit serb (v. 2001)

-Karaxhiç dhe Mlladiç janë patriot të shquar serb dhe heronj të luftës atëdhetare (v. 2001)

-Nuk do të dorëzojmë as Radovan Karaxhiçin dhe as Ratko Mlladiçin. Nëse i takoj diku, do të pijë me ta kafe (v. 2003)

-Shtëpia ime, ashtu si edhe shtëpitë e gjithë familjes Vuçiq, do të jenë pikërisht "Shtëpi e sigurt e gjeneralit Ratko Mlladiç" (v. 2007)

-Tadiç është rrugaç sepse me formacionin e tij paramilitar ka arrestuar Karaxhiçin(v.2008)

-Kush e përmend Mlladiçin? Kujt i intereson më ky njeri? (v. 2009)

-Serbia ka detyrime ndërkombëtare të padiskutueshme dhe të qarta, këtu bën pjesë edhe arrestimi i Mlladiçit (v. 2011)

Për Kosovën

-Nëse NATO na sulmon, jam i sigurt se do të mbrohemi (v. 1998)
-Vetëm kur të khehet policia dhe ushtria serbe në Kosovë, mund të bisedojmë me të huajt dhe shqiptarët (v. 2003)
-Askush nuk ka të drejtë që në emër të Serbisë të heq dorë nga një arë ose livadh serb(v.2005)
-Shpresa e vetme që të mbrojmë Kosovën është që të na mbështes Rusia dhe Putin (v. 2005)
-Evropa dhe Amerika po na rrëmbejnë Kosovën. Serbia nuk duhet të mendoj për euro-integrimet (v. 2007)
-Kur shqiptarët shpallën pavarësinë isha i trishtuar, por kurrë më parë nuk kisha parë një guxim si tek çunat para ambasadës së djegur amerikane (v. 2008)
-Evropa dëshiron që Kosova të jetë e pavarur, por kjo nuk do të thotë se duhet themi: “Nuk duam në këtë Evropë” (v. 2011)
-Kosova është e rëndësishme për ne, por duhet të kujdesemi edhe për investime. SNS nuk do të heqë dotë nga rruga evropiane (v. 2011) shkruan në mes tjerash Lavdrim Lita në "Koha jonë".

KISHAT DHE MANASTIRET ORTODOKSE NË KOSOVË - TRASHËGIMI SHQIPTARE

1
KISHAT DHE MANASTIRET NË KOSOVË, HISTORIKISHT JANË MBROJTURA NGA VETË SHQIPTARËT.

Kishat dhe manastiret në Kosovë, të cilat me pakon e Ahtisarit janë përcaktuar si zona me status të veçantë mbrojtës, historikisht kanë qenë të mbrojtura nga vetë shqiptarët.
Mbështetje për qëndrimet tona që paraqiten gjatë gjithë këtij punimi, se kishat dhe manastiret ortodokse u rindërtuan ose më mirë të themi, u adaptuan me ndërhyrje gjatë ri-ndërtimeve për t'u transformuar nga stili katolik në at ortodoks, siç kuptohet nga shumica e rasteve të sipërtheksuara, do të gjejmë edhe tek disa studiues serbë që shquhen me punimet e tyre për këto çështje. Gj. Sljepçeviq, tregon se: nemanjidët, sundimtar të Rashkës nuk patën dije për ndërtime as të kishave e as të manastireve, ata vetëm i shfrytëzuan objektet dhe kulturën bizantine

duke qenë një herët kopjues dhe imitues të tyre. Kjo, sipas autorit, tregohet edhe me selit (rezidencat) e përkohshme të mbretërve të tyre që do të lëvizin gjatë gjithë periudhës së sundimit. Ata, nuk kishin një vend (qendër, qytet apo pallat) të përhershëm. Shefi i katedrës për arkeologji mesjetare në Beograd, Dr. Gj.Jankoviq, thekson se, sa është e ditur Kosova, Mali i Zi dhe Hercegovina janë territoret që më së shumti kanë kisha që shërbenin në vazhdimësi që prej njëmijë (1000) vjetësh. Nga këto, kemi objekte të ndërtuara qysh gjatë shek. të VI'të dhe të VII'të ose ato të shek. të IX'të dhe të XI'të, siç janë edhe kisha në Lipjan, Graçanicë dhe Zonja Prene (Ljevishka) në Prizren. Akademiku, D. Bogdanoviq, tregon se, dy qytete bizantine që i okupoi Stefan Nemanja, Prizreni dhe Lipjani, që aso kohe ishin qendra fetare. Kur arkimandriti Sava e organizoi kishën autoqefale "rashkase", atë e ndan në dhjetë ipeshkvi, e nga ato tri gjendeshin në territoret e sotme të Kosovës. Zhvillimi i territorit të sotëm të Kosovës, sipas autorit, si "qendër shpirtërore" e popullit "serb" gjatë mesjetës mbështetet me përqendrimin e madh të kishave dhe manastireve. Ai vazhdon, deri sot nuk mund të dihet se sa kisha kanë qenë ose janë ruajtur nga epoka para-nemanjide, sepse kërkime, hulumtime sistematike si dhe arkeologjike nuk janë kryer, duke shtuar, numër bukur i madh i kishave nemanjide

(rashkase) sigurt se janë ngritur në themelet e vjetër të tempujve bizantinë. Njohësi i mirë i këtyre çështjeve, V. Markoviq, na tregon se, historia e kishave dhe manastireve ortodokse siç shkruhet dhe përshkruhet nga tradita dhe historiografia serbe, nuk lënë tjetër, veç të kuptohet se, veprat-ndërtimet e fundit, ato nemanjide, të janë ngritur mbi llogarinë e të parave. Kështu, nemanjidëve i përshkruhen shumë manastire, të cilat janë shumë ma të vjetra se koha e tyre. V. Markoviq, tregon edhe se, mbreti Millutini (1282-1321) nuk ndërtoi asnjë manastir të ri, ai vetëm i rindërtoi manastiret e vjetra e të lëna. Për këtë, historiografia jonë e vjetër dhe e re e paraqesin Millutinin si themelues-ndërtues i shumë manastireve. Karakteristikë e kohës së tij është se, Millutini rindërtoi shumë manastire në territoret që okupoi nga Bizanti, më shumë se sa në territoret e vjetra "serbe". Historiani, St. Stanojeviq, thekson që edhe para Stefan Nemanjës, në kufijtë me Rashkën kishte bukur shumë manastire dhe udhëheqës fetarë dhe nuk fillon krejt me Nemanjën, siç donë ta paraqesin historiografët tanë… Autori, V. Petkoviq, vjen në përfundime se, fiset "serbe" (sllave, E. R.) që nga ardhja dhe vendosja e tyre në këto territore (ballkanike) e deri në shek. e XVIII'të, shënuan lëvizje të mëdha. U ndërtuan dhe rindërtuan kisha e manastire e për çka "nuk mundemi të pohojmë e

vërtetojmë se këto vepra janë ekskluzive serbe". Në këtë drejtim, siç potencuam edhe më sipër, kemi të bëjmë me propagandën pseudoshkencore serbe e cila tenton që territorin e Kosovës ta paraqet si "qendër shpirtërore të popullit serb" gjatë mesjetës, që sipas tyre, mbahet me numrin e madh të konceptuar të kishave serbe dhe manastireve në këtë territor. Duhet theksuar edhe tendencat e një pjese të madhe të autorëve të historiografisë serbe, që tentojnë me të dhëna të argumentojnë se, selia e kishës ortodokse e Rashkës do të bartet në Pejë gjatë gjysmës së shekullit të XIII'të, më konkretisht kinse që në vitin 1253, nga Zhiça, selia e arkipeshkvisë kalon në Pejë. Mirëpo, në këtë drejtim duke iu referuar po të dhënave të autorëve serbë, theksohet që Peja tek në decenien e fundit të shekullit të XIII'të bëhet qendër ose seli e arkipeshkvisë së Rashkës. Sipas tyre, selia e arkipeshkopatës pas sulmeve mongole dhe djegies së Zhiçës më 1284 bartet në Pejë. Sipas të tjerëve, selia e kishës kalon nga Zhiça në Pejë tek në decenien e fundit të shekullit të XIII'të kur sulmohet nga tatarët dhe kumanët që e plaçkitin dhe e djegin, të cilët i hakmerren Rashkës për një sulm që udhëhoqi ndaj tyre mbreti Millutin (V. Jankoviq). Po ashtu, edhe autorë të tjerë mbështesin faktin se tek në fund të shekullit të XIII'të, pas pësimit të Zhiçës, Peja bëhet seli e re e arkipeshkopatës rashkase (V.

Boshkoviq, S. Qirkoviq). Në këtë drejtim tendencat janë që pjesët e territorit të Kosovës së sotme, konkretisht treva e Drenicës paraqitet si "Drenica mali i dytë i shenjtë serb". Lidhur me këtë është interesant të përmendim se, autori thekson që në shekullin e XIV'të në trevën e Drenicës gjendeshin 13 manastire dhe 5 kisha (T. Vukanoviq). Po ky autor më pas, duke theksuar se kinse me rezultatet e tija hulumtuese të vendbanimeve, të cilat "bazohen në të vërtetën shkencore" nxjerr përfundime se: në trevën e Drenicës së sotme kanë ekzistuar gjithsej 9 manastire dhe 42 kisha, d.m.th. bie në konfuzion në librin e njëjtë. Po ashtu, vlen të theksojmë propagandën nacionaliste të kishës ortodokse serbe që gjithherë ishte veçuar dhe veçohet për kah falsifikimi dhe spekulimet lidhur me çështjen në fjalë. Sipas hartuesve të librit "Memorandumi për Kosovë e Metohi" i botuar nga kisha ortodokse serbe, theksohet se: "Kosova e Metohija", "Tokë e shenjtë" e "popullit serb", për ne paraqet atë, që për popullin "hebre paraqet Jerusalemi". Për këtë, më së miri dhe më së forti dëshmojnë më se 1300 kisha dhe manastire që gjenden atje. Po kështu edhe autorë të tjerë mbështesin këto qëndrime duke theksuar se: "Hapësira e krahinës jugore të Serbisë mbulohet me 1300 kisha dhe manastire me emrin zyrtar "Kosovo" (me Metohinë e cila që nga viti 1968, me dëshirën e

shqiptarëve kosovarë hiqet nga zyrtariteti, dhe më pastaj nga komunikimi politik ditor), që në gjuhën serbe është simbolike, fjala më me rëndësi e cila pas emrit të Zotit, emrit të Shën Savës (themeluesit të kishës ortodokse serbe në shekullin e XIII'të), shënon njëkohësisht edhe identitetin kulturor e nacional të të gjithë popullit serb" (D. Bogdanoviq). Propaganda në këtë drejtim vazhdohet: "… në territorin e Kosovë e Metohisë…, populli ortodoks serbë dhe kisha e saj kanë 1300 kisha e manastire nga shekulli i XII-të deri në atë të XX'të, të punuara gjatë tetë shekujve…" (Novosti, Beograd, 2004). Po ashtu theksohet se sipas evidencave në trevën e Kosovës duhet të ketë aty afër 200 objekte të ruajtura ose të shkatërruara, por në të vërtetë ka më shumë sikur të numëroheshin dhe hulumtoheshin lokalitetet arkeologjike të paidentifikuara (gërmadhat e kishave). Sipas A. Urosheviq, gjendja e të pamurit të kësaj treve (është fjala për Kosovën) në mesjetë flet për një numër të madh gërmadhash të kishave, mbetje të kishave të vjetra dhe sipas tij, shenja të tilla kishte pothuajse në të gjitha fshatrat, edhe serbe e shqiptare, ndërsa në disa fshatra janë edhe nga dy e më shumë gërmadha të kishave (A. Urosheviq). Edhe D. Bogdanoviq, shprehet se, sipas hulumtimeve arkeologjike vërtetohet se në territorin e Kosovës ishin 1300 kisha e manastire e monumente tjera serbe.

Të dhënat e tilla si më lart, të ndërtuara dhe të udhëhequra nga historiografia e edhe nga politika ditore e qeverisë serbe, pra, mundohen të mbështesin konceptin mbi monumentet e kultit të krishterë që ekzistojnë në Kosovë duke rritur numrin impozant që shihet, për çka dhe Kosova sipas tyre paraqet vlera të "jashtëzakonshme". Për të sqaruar më mirë çështjen lidhur me ndërtimin dhe rindërtimin e objekteve fetare në territorin e Kosovës në periudhën nemanjide, ofrojmë dhe të dhënat që tregojnë se, mbreti Millutin (1282-1321) rindërtoi afër 30 manastire, në mes të cilave në territorin e Kosovës vetëm tri, në Prizren, Bajskë dhe Graçanicë. Mbreti Stefan Deçani (1321-1332) ndërtoi vetëm Deçanin. Gjatë periudhës së Dushanit u ndërtua Manastiri i Shën Arkangjelit (M. Kashanin, revista "Pravoslavlje"). Gjatë periudhës Osmane, burimeve që dalin aso kohe, të cilat i paraqesim nga M.Kashanin, tregohet se, që nga periudha e patrikut Makarije në gjysmën e shek. të XVI'të, u ngritën nga gërmadhat dhe u rishkruan-vizatuan përsëri me qindra kisha në territoret e sunduara nga Osmanët (mendon në Kosovë, Serbi dhe Sanxhak). D. T. Batakoviq duke u thirrur në burime osmane (regjistrat osmanë) tregon se gjatë shek. të XV'të dhe XVI'të ekzistonin dhjetë deri katërmbëdhjetë tempuj ortodoksë që ishin aktiv. Udhëheqësit e kishës ortodokse të Pejës (1557-1766)

duke u mbështetur në traditën mesjetare të sundimtarëve nemanjid dhe shtetit të Rashkës, tani me një territor më të madh se i tyre, rindërtuan kultet e vjetra dhe vendosën edhe të reja. U bë jetësimi – funksionimi i kishave dhe manastireve, ku vetëm në Kosovë u ndërtuan njëzetë (20) kisha të reja, ndërsa shumë nga të vjetrat u aftësuan duke edhe u rishkruar-vizatuar (D. T. Batakoviq, R.Samargjiq, Gj.Sljepçeviq). Defterët osmanë për Sanxhakun e Vushtrrisë – Prishtinës (njësi administrativo-politike territoriale në Perandorinë Osmane), të viteve 1490-1491, 1525-1526, 1530-1531, 1544-1545 dhe 1561 tregojnë se ishin të evidentuar 42 manastire dhe 11 kisha, ndërsa në at të Prizrenit shënohen 2 manastire dhe 15 kisha (D. Batakoviq). Do të jetë interesante të paraqesim të dhënat që na ofron episkopi Artemije (Radosavljeviq) i Prizrenit, i cili në shkrimet e tija publikuar në "Raspeto Kosovo", kur flet për rrezikun dhe dëmet e kishave dhe manastireve që gjinden në Kosovë gjatë luftës së vitit 1999, paraqet edhe regjistrin mbi një numër të tyre. Nga ky regjistër del të jenë kisha dhe manastire të ndërtuara gjatë periudhave: nëntë të shek. të XIV'të; nëntë të shek. të XV'të dhe XVI'të; pesë të shek. të XIX'të dhe pesëdhjetë e tri (53) që janë ndërtuar në shek. e XX'të. Këto të dhëna nga ky regjistër i paraqitëm me qëllim që të tregojmë se një numër i kishave janë të

periudhës Osmane e çka është ma me rëndësi, këtu qartë shihen se pesëdhjetë e tri (53) kisha janë të evidentuara që janë ndërtuar në shek. e XX'të. Këtu, shohim që kishat e shekullit të XX'të, janë kisha thjesht "politike". Këto kisha politike do të ndërtohen nga Serbia me qëllimin për të arsyetuar para botës se, Kosova është "tokë e tyre". Por gjithë bota tani e dinë se, Kosova u pushtua nga Serbia në vitin 1912-1913 dhe Serbisë ju qel rruga për ndërtimin e numrit kaq të madh të kishave gjithnjë deri në vitin 1999, kur Kosova do të jetë jashtë saj.

Për të vërtetuar se me të vërtetë qëllimet, qëndrimet dhe të dhënat e historiografisë serbe, janë pretenduese, qëllim-këqija e nacionaliste, tregon numri i madh e i pa argumentuar i paraqitur për monumentet e krishtera ortodokse – kishave dhe manastireve që kinse kanë ekzistuar në Kosovë, që sipas tyre sillen prej 1300 e herë-herë deri në 1500 objekte. Për këtë mendojmë sigurt se, nuk ka as burime historike e as studime që mbështeten në fakte, se kishte aq shumë kisha në këtë trevë aso kohe e as sot, përveç konstruksioneve me prapavijë politike. Për këtë, lirisht vijmë në përfundime se, shkrimet e tilla janë falsifikim i qindpërqindtë i realitetit historik e shkencor.

Për fund, si bazë të fortë e argumentuese e gjithë qëndrimeve tona të paraqitura në këtë punim, ofrojmë dëshmitë mbi gjendjen reale të monumenteve të trashëgimisë kulturore, që tregojnë saktësisht se sa është numri i kishave dhe manastireve të krishtera në Kosovë që karakterizohen në radhën e monumenteve kulturore'historike. Po paraqesim të dhënat e sakta që ruhen në dokumentacionin e Entit Krahinor për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, Prishtinë, të vitit 1990 (sot, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës). Të dhënat nga arkiva e këtij institucioni, na tregojnë dhe vërtetojnë që: në territorin e Kosovës sot, janë të evidentuara 183 objekte (të tipave dhe gjinive të ndryshme), kisha të krishtera, kryesisht ortodokse, prej të cilave 126 sosh kanë tretman monumenti, ndërsa 57 objekte janë vetëm të evidentuara (të dhënat marrë nga Dr. Fejaz Drançolli). Objektet në fjalë janë të regjistruara në regjistrin qendror të monumenteve në këtë institucion dhe nga këto monumente, mund të themi se, një numër i tyre i takojnë stilit bizantino-kosovar, posbizantin si dhe të karakterit lokal.

Këto të dhëna të fundit i theksuam me qëllim, sepse tregojnë se treva e Kosovës gjatë mesjetës e më vonë, nuk ishte epiqendra e veprimtarisë së kishës ortodokse të Rashkës- "Serbisë" siç pretendohet nga

historiografia serbe, çështje që dëshmohet nga të dhënat e sipërpërmendura. Si përfundim, theksojmë se, kultura materiale e arbërve gjatë mesjetës e më pas shqiptarëve në territoret e Kosovës ishte pre e sundimeve të huaja, në rastin tonë atij më ekstrem – të Rashkës gjatë mesjetës. Theksuam se, në Kosovë gjatë kohës kanë bashkëjetuar shumë monumente të kultit, si katolike, ortodokse që shërbenin aso kohe si për arbërit-shqiptarët ashtu edhe për popullatën tjetër që asokohe dhe sot jeton në këtë vend. Nga të dhënat që theksuam shihet se kisha ortodokse rashkase-"serbe", përvetësoi shumë nga këto monumente të kulturës, kisha e manastire vendëse iliro-arbërore ku ndërtoi dhe rindërtoi mbi to, siç u pa sidomos gjatë shekullit të XIV'të, kisha të quajtura më vonë të veta, duke i shndërruar ato në kisha ortodokse. Këtej kultura materiale e Kosovës ndër shekuj u shkatërrua, u plaçkit duke vazhduar me tendencat (që nuk ndalën as në ditët e sotme) për t'u përvetësuar në forma të ndryshme siç i paraqitëm. Këto qëndrime i paraqesim, me qëllim të tregojmë se, Serbia dhe historiografia e saj pothuajse pa përjashtime, pretendon edhe sot të qëndrojë me këto parime: që Kosova është "Djep i serbizimit", "Tokë e shenjtë serbe", "selia e kishës ortodokse serbe" dhe qëndrime të tjera antishkencore e jo humane, që sipas argumenteve shkencore nuk qëndrojnë, e për

më tepër lënë pasoja të dëmshme në raportet e së ardhmes ndërmjet popujve. Sot numri i objekteve sakrale mesjetare, të kishave katolike, bizantine e ortodokse paraqesin gjurmë të kulturës materiale të dikurshme që e karakterizojnë kulturën materiale të popullit të Kosovës e më gjerë.

Duke i hedhur poshtë qëndrimet dhe tendencat që paraqiten prej historiografisë serbe, nga të dhënat e sipërshënuara, sot mund të themi se, në Kosovë kemi monumente të kultit të krishterë që janë ndërtuar nëpër kohë që nga antika e deri më sot, dhe jo vetëm ato të krishtera, katolike e ortodokse të mesjetës, por edhe duke vazhduar me monumentet kulturore islame që sot i kemi një numër të madh të tyre, sot i trajtojmë për trashëgimi të kulturës vendëse dhe ato i takojnë popullit dhe qytetarëve që jetojnë dhe veprojnë në Kosovë, pa bërë dallime të trashëgimisë kulturore në asnjë aspekt. Në këtë drejtim do të shtojmë edhe mendimin se, është obligim shoqëror, intelektual, institucional e shtetëror, që monumentet e trashëgimisë kulturore, çfarëdo qofshin ato, të mbrohen, konservohen, restaurohen etj., të mbahen në jetë, sepse i takojnë kulturës materiale dhe shpirtërore të njerëzimit, në rastin tonë popullatës vendëse të Kosovës dhe kulturës universale botërore.

Për fund, kishte me qenë mirë t'i tregojmë edhe

historishkruesve serbë, çështje për të cilën jam i bindur që e dinë por nuk e theksojnë dhe shkruajnë, se, të dhënat historike dëshmojnë që iliro'arbërit'shqiptarët, gjatë historisë jetuan dhe vepruan në këto treva dhe më gjerë që nga kohët e vjetra, dhe mundën të mbijetonin pushtuesit dhe sunduesit e ndryshëm, si ata romakë, bizantinë, sllavë, osmanë dhe serbë deri në kohën e sotme. Gjatë kësaj kohe, dëshmohet se, mbijetoi dhe një pjesë e monumenteve të trashëgimisë kulturore'historike e tyre (duke përfshirë në këtë kuadër edhe, kishat e krishtera, kishat dhe manastiret ortodokse si dhe objektet e kulturës islame – xhamitë, teqetë etj.) të cilat qenë ndërtuar nëpër kohë e që një pjesë mbijetuan deri më sot.

Po këta, iliro'arbërit'shqiptarët, gjatë kohës, kanë pranuar kulturën fetare të besimit të krishterë më se dhjetë shekuj (prej shek.të I'rë deri në shek. e X'të). Më pas, ata do të gjinden pjesërisht edhe nën ndikimin e krishterë ortodoks bizantin për afro tre shekuj (shek. i X'të dhe i XIII'të), afër dy shekuj nën trysninë e kishës ortodokse sllave'rashkase (XIII'të e XIV'të) e që vazhdon me pranimin e fesë islame që nga (shek. i XV'të dhe i XIX'të). Gjatë këtyre shekujve rrugëtimi, populli shqiptar përqafoi tri konfesione si, atë katolike, ortodokse dhe islame. Konfesionet që bashkëjetuan tek populli shqiptar e që i besojnë dhe

sot, i bëjnë që edhe monumentet fetare të trashëguara gjatë historisë t'i respektojnë, mirëmbajnë dhe vlerësojnë si pjesë e pa ndarë e kulturës së tyre.

2.
KLERIKU SERB SAVA JANJIQI E PRANON, PUBLIKON DËSHMI SE MANASTIRI I DEÇANIT ISHTE I SHQIPTARËVE

Manastiri i Deçanit, edhe sipas historianëve të tjerë jo vetëm shqiptarë, nuk konsiderohet pasuri e trashëgimisë serbe, por pasuri e trashëgimisë ortodokse. Kush më mirë se fotografitë e mëposhtme e dëshmon këtë?

Manastiri i Deçanit është një monument i trashëgimisë kulturore në Deçan, Kosovë.[1] Manastiri i Deçanit , i ndërtuar në shekullinXIV, është pjesë e listës së monumenteve të mbrojtura të UNESCOs.

Manastiri është ndërtuar afër lumit Bistrica , nën shpatet e mprehta të Bjekshëve të Nemuna , ndërsa e ka themeluar Shën Stafeni Uroshi III i Deçanit , dajli i mbretit Millutin dhe babai i mbretit Dushan.

Një pjesë e thesarit edhe sot janë karrocat për karrocat për fëmijë nga argjendi , të cilat manastirit ia kanë dhuruar çiftet që kanë pasur fëmijë. Vlera më e madhe e thesarit është koleksioni i ikonave të piktuara nga shekulli XIV deri në fund të shek. XVII , pastaj përmbledhja e dorëshkrimeve dhe librave të botuar , përmbledhja e dorëshkrimeve dhe librave të botuar, përmbledhja e sendeve nga metalet e çmuara etj.

Manastiri i Deçanit i rindërtuar mbi themelet e një kishe ilire nga gurskalitësi shqiptar Fra Vita Kuçi nga Kotorri

Dyndjet serbe apo dyndjet sllave siç njihen në histori, sipas informacioneve konkrete të histografisë shqiptare dhe asaj botërore, kanë sjellur serbët në Gadishullin Ballkanik në shekullin IX dhe jo siç pretendon histografia serbe, dy shekuj më herët, thotë Shkodran Imeraj duke rrëfyer se, me ardhjen e pushtuesve të ri, dinastisë serbe, ata kanë përvetësuar gjithçka çka ata pushtuan si territor dhe me këtë rast kanë përvetësuar prona dhe institucione fetare, duke përfshirë edhe manastirin.

“Manastiri i Deçanit është i rindërtuar mbi themelet e një kishe ilire, pasi që zona ku ndodhet Manastiri i Deçanit, disa metra në perëndim shtrihet lokaliteti i

vjetër arkeologjik i cili nuk është i hulumtuar në detaje dhe që quhet Kulla e Qelisë, ku është një lokalitet arkeologjik që dëshmon se kjo pjesë ka qenë e populluar para se të popullohet pjesa e Deçanit dhe Rrafshit të Dukagjinit. Aty i kemi informacionet e para të një qytetërimi ilir" thotë Prof. Dr.Shkodran Cenë Imeraj ,historian i njohur nga Isniqi i Deçanit dhe shton se informata e dhënë për emrin e mjeshtrit që e ka rindërtuar manastirin është e pasaktë.

"Manastiri i Deçanit është i rindërtuar që nga viti 1327 deri në vitin 1335 dhe ëshhtë rindërtu në themelet e një kishe ilire nga ana e Fra Vita Kuqit, në tokën e Hak Kuqit nga Deçani. Fra Vita Kuqi ka qenë një gurskalitës shqiptar me origjin nga Kotorri (Mali i Zi). Ai bashkë me 30 gurskalitës të tjerë fillon dhe e rindërtojnë Manastirin e Deçanit për t'i kryer rritet fetare popullsia vendase."

Duke e shpjeguar historinë e ndarjes së Perandorisë romake në dy pjesë, në atë të Lindjes, me qendër në Konstantinopoj (Stambollin e ardhshëm) dhe Perandorinë Romake të Perëndimit me qendër në Romë, historiani Imeraj shpjegon se tokat shqiptare që ndodheshin përtej Adriatikut dhe Detit Jon, kaluan nën sovranitetin e Perandorisë Bizantine ndërsa, më 1054, kur vjen deri tek ndarja e Kishës në dy rite, atë

ortodoks dhe katolik, shqiptarët i takuan ritit ortodoks dhe gjatë mesjetës, ruajtën fenë ortodokse si besimin e vet fetar.

Imeraj këtë e argumenton me Defterin e Regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485, dokumentacion turk i botuar në Tiranë , në vitin 1974 nga ana e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Shqipërisë, ku hasën emrat shqip si: Gjon, Gjin, Lekë, Kol, Gegë, Progron, Tole, Lesh apo Llesh, Bardo, Kolsh, Gectë, Tanush, Bushat, Lulo, Mazrek, Pal, Dukë, Kal, etj. Sipas tij, këta janë emra autokton ortodoks shqiptar dhe nuk kanë të bëjnë me pretendimet e histografisë serbe se kinse Kosova është ripopulluar me popullsi shqiptare.

Kristobula e Manastirit të Deçanit – fillim i sherrit

Manastiri i Deçanit kishte përfunduar së rindërtuari, në vitin 1335, ndërsa pesë vite më herët kemi Kartën e cila njihet si Kristobula e Manastirit të Deçanit.

“Sipas disa informacioneve , që ne i disponojmë dhe janë zbuluar tash në Francë, Karta e Deçanit apo Kristobula e Manastirit të Deçanit është një dokument i falsifikuar pasi që ndodhet në katër versione” thotë Imeraj duke shtuar se katër versionet sjellin katër informacione të ndryshme për popullsinë

vendase të Deçanit, ku njëra ndër to thotë se, kjo pjesë ka qenë e populluar me popullsi serbe dhe shqiptarët kanë qenë të ardhur, mirëpo këtë e përgënjeshtron Defteri i Regjistrimit të Sanxhakut së Shkodrës 1485.
"Kjo demantohet me anë të dokumenteve osmane, pasi që dokumentet apo Defteri i Regjistrimit të Sanxhakut së Shkodrës i jep në detaje të dhënat për gjithsecilin fshat dhe vendbanim , si dhe për Manastirin e Deçanit, për sa i përket ardhjes apo prejardhjes serbe në Deçan" thotë Imeraj duke demantuar edhe pohimet për etimologjinë e emrit Deçan, që sipas serbëve buron nga kupola e Manastirit dhe thotë "Po të rridhte emri Deçan në vitin 1330 apo 1335, po ta kishte marr emrin sipas kupolës së manastirit të Deçanit atëherë si është quajtur Deçani në lashtësi?"

Ai thotë se ky është një pretendim jo i bazuar në fakte sepse Deçani është i banuar që në kohën ilire dhe kjo dëshmohet me anë të lokaliteteve arkeologjike të cilat janë në terren dhe të cilat mund të shihen ndërsa emri Deçan rrjedh nga trajta e fjalës 'dash' apo 'desh' sepse Deçani në kohën ilire është shquar për prodhimtari blegtorale. Këtu ai i referohet punimeve të akademik Mark Krasniqit, si dhe studiuesi Muharrem Carrabregu në librin "Hartografia 2".

Manastiri i Deçanit kurrë nuk ka pasur 700 hektar tokë

Lidhur me madhësinë e pronës së Manastirit të Deçanit dhe pretendimeve të atit Sava Janjiq dhe fakteve të cilat i përdor Kisha Ortodokse Serbe se, manastiri ka pronë prej 700 hektarëve, Imeraj thotë se kjo e pavërtet mund të hidhet lehtë poshtë nëse studiohen me kujdes faktet se, me ardhjen e Perandorisë Osmane në Ballkan, Kisha Ortodokse dhe Kisha e Deçanit e pranojnë vasalitetin ndaj Perandorisë Osmane dhe se, ata që kanë pasur tokë kanë qenë edhe spahi, kalorës të zgjedhur të Perandorisë Osmane.

"Me që manastiri i Deçanit sipas një broshure që ata e kanë botuar, thuhet se kanë qenë spahi të Perandorisë Osmane, atëherë rrjedh pyetja: sa i kanë dhënë Perandorisë Osmane ushtar? – Që është një disbalancë i të vërtetës, sepse murgjit në atë kohë nuk kanë qenë kalorës të Perandorisë Osmane, siç potencojnë në broshurën që e kanë publikuar kohë më parë" shpjegon historiani Imeraj duke theksuar se Perandoria Osmane nuk ka lejuar që manastiret apo kishat të kenë prona aq të mëdha sepse Perandoria i ka marr taksat dhe ka caktuar një shumë vjetore të pagesës të cilën është dashur me e kryer, prandaj ai

pyet se "ku e mori burimin Manastiri që të paguaj për pronën që e ka poseduar?"
Duke e shpjeguar kopjen e fermanit të Sulltanatit, nga viti 1794, ku banorëve të fshatit Isniq ju dhurohet një pjesë e Bjeshkës nga Perandoria Osmane, historiani Shkodran Imeraj vërteton se Manastiri i Deçanit dhe kishat në kuadër të Perandorisë nuk kanë zotëruar shumë tokë dhe se kanë zotëruar vetëm me objektet përcjellëse.
"Se a ka pasur pronë të zgjeruar shumë apo jo, manastiri i Deçanit, flasin edhe faktet e mëvonshme, respektivisht flet një fotografi e vitit 1962 e cila e pasqyron qartë pronën e Manastirit të Deçanit. Këtë e argumentojmë me shemën e cila është një shemë që tregon rreth pronave dhe objekteve përcjellëse të Manastirit të Deçanit, sipas territorit nuk ka më shumë se 8 hektar tokë. Kjo është pronë që e ka trashëguar, sepse po të kishte 700 hektar tokë, që nga koha e Perandorisë Osmane , ai do t'i kishte edhe sot. Do të thotë, është një e pavërtetë" rrëfen Imeraj dhe e dokumenton këtë me një gravurë që daton nga vitit 1764, si dhe me një fotografi ku shihet se, në vitin 1962, ajo pjesë ishte ripyllëzuar me anë të mbjelljes së pishave.

Një fakt tjetër argumentues është regjistrimi i parë Osman në territorin e Deçanit, në vitin 1485, kur

jepen informacione për igumanët , priftërinjtë apo shërbëtorët që kanë shërbyer në kuadër të Manastirit të Deçanit dhe të cilët kishin emra të trajtës jo ortodokse. Sipas Imerajtë, kjo tregon se territori i komunës së Deçanit ka qenë i banuar nga popullsia edhe ortodokse edhe katolike shqiptare e cila gjithmonë ka qenë e lidhur me tempujt e tyre fetar dhe në histori njihet si respektuese e monumenteve fetare.

Apiko dhe Ilira s'mund të tjetërsohen nga Manastiri i Deçanit

Imeraj ka reaguar edhe në pretendimet e Manastirit për pronat e Apikos dhe Ilirisë, dy gjigantëve të mëdhenj ekonomik, jo vetëm të Deçanit por edhe të Kosovës, në kohën e Jugosllavisë dhe se, marrja e tyre do të shkaktonte bllokim ekonomik të komunës së Deçanit. Për më tepër, ai e kundërshton aktgjykimin e 28 Dhjetorit 2012, kur Gjykata Supreme e Kosovës, respektivisht Dhoma e Veçantë merr vendim duke u bazuar në dy dokumente, sipas tij të papranueshme: Masat e Dhunshme të vitit 1993 dhe 1997, sipas të cilëve , pronat në fjalë i bëhen dhuratë Manastirit të Deçanit, nga ana e institucioneve të Republikës së Serbisë.

Lidhur me këtë, Lidhja e Historianëve të Kosovës ka kërkuar në vitin 2012 dhe kërkon edhe sot, që Kuvendi i Kosovës t'i nxjerr urgjentisht tri ligje: Ligjin për distancimin ndaj Masave të Dhunshme, që do t'i hudhte poshtë gjitha vendimet nga 28 marsi 1989 kur suprimohet autonomia e Kosovës e deri më 12 qershor 1999 kur Kosova vendoset nën admisnitrimin e Kombeve të Bashkuara; Ligjin e Reformës Agrare, për të rishikuar historinë e tokave dhe Ligji i Lustracionit apo Ligji i Pastërtisë Publike

Ne e kemi respektuar dhe do ta respektojmë çdo herë Manastirin e Deçanit

Manastiri i Deçanit është respektuar dhe ruajtur , përherë, nga deçanasit sepse, kanë qenë popullsia vendase me gurskalitësit nga Kotorri ata që e kanë rindërtuar këtë manastir dhe deri në fillim të viteve të '90-ta, në Manastirin e Deçanit ka ekzistuar Vojvoda apo Rojtari, rrëfen historiani Imeraj dhe shton se, Vojvoda e fundit ka qenë familja e Sali Rrustës nga Deçani.

Me këtë, Imeraj bënë me dije se, shqiptarët e Deçanit, pa marr parasysh bindjet fetare, e kanë respektuar dhe e respektojnë Manastirin e Deçanit si një monument të rëndësishëm të kaluarës historike shqiptare dhe për këtë thirret edhe në vet

dokumentet serbe. “Arhimani i Manastirit të Deçanit, Serafin Ristiç, në vitin 1864 e boton librin e tij ‘Deçanski spomenici’, në Beograd, i cili përshkruan disa zakone të Kishës së Deçanit dhe ndër të tjera thekson që, murgeshat kur i kanë kryer lutjet dhe meshat në manastirin e Deçanit, kanë kënduar me këto fjalë: ‘O Patriarkan, manastir i famshëm, në trevën e Dardanisë, qëndron qysh moti. Domethënë, ky është një argument të cilin e pranojnë edhe vet ish drejtuesit e Manastirit të Deçanit se, ai i takon një të kaluarës historike Dardane” citon Imeraj burimet serbe që dëshmojnë se, ky manastir ishte i ndërtuar në Dardani, pjesën e Ilirisë antike, vendit të shqiptarëve dhe ishte kult fetar i popullsisë vendase shqiptare.

Gjatë luftës në Kosovë në Manastir ishin strehuar shqiptarë, kolaboracionista

Lidhur me deklaratat e Igumenit Janiq se, gjatë luftës në Kosovë në vitet 1998-1999, ai ka strehuar shqiptar, historiani Imeraj thotë se, ati Sava është duke i shtrembëruar faktet dhe se Manastiri i Deçanit ka qenë vend strehim i atyre shqiptarëve që kanë qenë kolaboracionist dhe i kanë shërbyer regjimit serb të asaj kohe dhe jo vetëm atyre.

"Ne e dimë që gjatë luftës fundit, në vitet 1998 dhe 1999, janë strehu edhe personel ushtarak i uniformuar, gjë e cila dëshmohet edhe me anën e kësaj fotografie ku shihen policët e uniformuar serb dhe në mesin e tyre shihet edhe një nga personeli i Manastirit të Deçanit" rrëfen Imeraj.

Njëherësh, ai ja rikujton atit Sava Janiq se gjatë viteve 1998-1999, në këtë manastir janë mbajtur edhe mesha kishtare duke u tymosur dhe lagur me ujë qindra policë e paramilitarë serb të cilët më pas kryen krimet më të rënda në territorin e Deçanit dhe më gjerë. Për këtë, Imeraj tha se, më së miri flasin faktet, incizimet dhe fotografitë e kohës dhe se nuk është mirë që Igumeni Sava Janiq po mundohet të shtrembërojë.

Manastiri i Deçanit të hapet edhe për historianët shqiptarë

"Unë personalisht e kam një mesazh për fund që, Manastiri i Deçanit gjithmonë ka qenë një monument i respektuar prej shqiptarëve dhe do të vazhdon të respektohet prej shqiptarëve sepse është ruajtur nga shqiptarët" përfundoi historiani Shkodran Imeraj i cili shprehi dëshirën që arkivi i Manastirit të hapet edhe për studiuesit shqiptarë, në mënyrë që edhe ata të kenë qasje në dokumentacionin të cilin e disponon

Manastiri. Si historian, ai është shumë i gatshëm ta vizitojë Manastirin pasi që, personalisht, në këtë moment e ka të pamundur me shkua dhe me e vizitua atë monument të historisë shqiptare.

***

Kohë më parë historiani i njohur shqiptar Shkodran Cenë Imeraj është kërcënuar me jetë nga një serb i quajtur Boris Simonoviq. Në mesazhin e dërguar në profilin e Imerajt në Facebook, ai shkruan : "Nož, žica, Srebrenica. Biće ti i na Kosovu. ", që do të thotë : "Thikat e Srebrenicës. Kanë me qenë edhe në Kosovë". Ky kërcenim vjen pas protestës se djeshëm në qendër të Deçanit, ku para protestueseve, Imeraj ka mbajtur një fjalë kundër pretendimeve pronësore të Manastirit të Deçanit ndaj pronave të Ndërmarrjeve "Apkio" dhe "Iliria", dhe me pas ka publikuar një fotografi të një njësie të policisë serbe në Manastirin e Deçanit gjatë kohës se luftës në Kosovës me 1998."Askush nuk do të mund të me ndalë për të thënë fjalët e vërteta. Askush nuk do të mund të falsifikoj të vërtetën historike të popullit shqiptarë", ka shkruar historiani Imeraj në rrjetin e saj në facebook

3.
PËRKATËSIA E KISHAVE DHE MANASTIREVE NË KOSOVË

Kujt i përkasin kishat dhe manastiret në Kosovë? Kjo është një çështje esenciale dhe ekzistenciale për identifikimin e lashtësisë së një etniteti dhe entiteti të një kombi, e kulturës dhe historisë së tij. Çështje e të vërtetës së lashtësisë dhe autoktonisë së kombit shqiptar, të Ilirisë dhe Shqipërisë Natyrale, qëndron para çfarëdo vendimi rreth statusit politik të Kosovës. Neglizhenca e trajtimit shkencor dhe historik të trashëgimisë historike-kulturore shqiptare të kishave dhe manastireve në Kosovë, paraqet turpin më të madh të qarqeve tona akademike shqiptare, sidomos në kohën kur kemi të bëjmë me ringjalljen e pansllavizmit, me pretendimet për përvetësimin e trashëgimisë shqiptare për interesa të hegjemonizmit serbomadh. Përgjegjësinë do ta bartin ata që në këto kohëra jetike për ardhmërinë e Kosovës, gjenden në ballë të këtyre proceseve politike, si dhe institucionet e heshtura akademike të Kosovës dhe e Shqipërisë. As politika e Kosovës, as edhe Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, nuk e kanë kryer obligimin që u takon, në të mirë të vërtetës shkencore e historike, përderisa kishat dhe manastiret e Kosovës po trajtohen si serbe nën kontroll të Kishës Ortodokse Serbe. Si mund të bëhet një politikë reale dhe e

qëndrueshme duke e heshtur dhe falsifikuar historinë? Çfarë politike për shtet bëjnë shqiptarët duke mohuar kulturën dhe trashëgiminë autoktone të popullit të vet? Si mund të heshtet uzurpimi dhe tjetërsimi i trashëgimisë historike dhe kulturore të shqiptarëve të Kosovës gjatë kohës së sundimit të regjimeve pansllave të Kosovës. Serbia dhe Kisha serbe nuk ka as të drejtë as legjitimitet të thirret e t'i uzurpojë ato, duke u sjellë si patron ndaj tyre; Serbo-jugosllavia ka qenë vetëm një pushtues i përkohshëm, falë pansllavizmit ruso-evropian. Ato nuk i takojnë Serbisë as serbëve, por janë pasuri e Kosovës, me themele të kohës së Perandorisë Bizantine, e cila, jo vetëm që nuk ka njohur Serbi në Kosovë, por në atë kohë as që ka ekzistuar, as kombi serb, as gjuha serbe. (këtë e kemi lexuar te postimet e Zues10). Krishtërimi në këto troje është autokton, me vendlindje dhe themele në Iliri, atë nuk e solli as Serbia nga stepet e Karpateve, as nga Rusia. Para se të arrinte në Evropë, krishtërimi ishte zhvilluar në trevat e Ilirisë, me qëllim dhe mision ta kultivonte shpirtëroren e mbronte njerëzoren dhe të mirat e përparimit e kulturës, nga sulmet dhe plaçkitjet e hordhive ardhacake të hunëve, gotëve, avarëve e fiseve tjera të egra, që asokohe ishin vërsulur drejt tokave të Ilirisë së begatshme me kulturë, dijeni dhe zhvillim. Dyndjet e hordhive sllave janë të kohës së

mëvonshme, të intensifuara vetëm në mesjetë, në kohën e dobësimit dhe rënjes së Perandorisë Bizantine, por sllavët nuk kanë qenë asnjëherë me supermacion etnik, si serbë, por si përzierje e shumë etnive. Pas rënjes së Perandorisë Osmane, Serbia me mbështetjen e fuqive të mëdha ka arritur të infiltrohet dhe pozicionohet në Ballkan, pikërisht nga shkaku i kësaj përzierje e madhe të përkatësive të ndryshme etnike, ku rol të madh kanë pasë vetë prijësat shqiptarë. Edhe emrat e serbëve janë emra shqiptare të deformuar në gjuhë sllave; si Boris (Bora), Mira (Mirë), Dhimitri (Dimitar), etj. Gjuha është themeli, shpjeguesi i të vërtetës, sado të çirren pansllavistat e botës. Historianët dhe shkencëtarët e kanë për detyrë t'i sjellin argumentet se kush ishin vërtet rindërtuesit e kishave dhe manastireve ortodokse në Kosovë, a ishin serbë apo shqiptarë ortodoksë. Ku i kanë rrënjët gjuhësore emërtimet "sllavizuara" ortodokse si të njërëzve edhe objekteve fetare?

Fatkeqësisht, sot për këto çështje më shumë flasin historiografët e botës dhe krijues shqiptarë jashtë vendit, se sa ata brenda. Kjo indeferencë dhe kjo heqje dorë nga kultura dhe historia, nga shpirti krijues dhe etnik, është tragjedia dhe turpi që po ndodhë në trojet e Ilirisë së stome - të Shqipërisë Natyrale! Ky është turpi i intelegjecës, turp i politikës,

turp i kombit. Për këtë qesh e po qesh bota me ne, përderisa mohojmë identitetin tonë, të kaluarën tonë, kulturën tonë! Nëse kështu vazhdon, vërtetohet teza e pushtuesve se, pa marrë parasysh lashtësinë e shqiptarëve, shqiptarët nuk dijnë të përcaktohen dhe mbrojnë të vërtetën, dhe, duke heqë dorë nga trashëgimia kulturore-historike e të parëve të tyre, nuk e meritojnë as ardhmërinë si komb e si shtet. Si duket, për këto shkaqe është krijuar (apo ka ndryshuar) edhe strategjia e bashkësisë ndërkombëtare ndaj çështjes shqiptare, edhe po të supozonim se një strategji e këtillë nuk ka qenë e kurdisur që nga fillimi. Harresa kaq e shpejtë e krimeve dhe gjenocidit serbomadh, tregon papjekurinë tonë më ekstreme dhe më të turpshme për shtet e sovranitet.

Historiografët e ndryshëm dëshmojnë me dokumente se shqiptarët kanë dhënë katër papë të Romës (shiko http://ëëë.frosina.org). Sa paska dhënë Serbia, e cila akoma guxon të sillet si zot shtëpie, në shtëpitë shpirtërore dhe kulturore të Kosovës? Serbia e di mirë këtë, prandaj zhvillon fushata anë e mbanë botës, për t'i mbrojtur pronat e uzurpuara dhe fshehë të kaluarën gjenocidale, për t'i mbuluar gjurmat e krimit me falsifikime të historiografisë dhe uzurpimin e kulturës iliro-shqiptare. Prandaj nuk thuhet kot "krimineli kthehet gjithmonë në vendin e krimit". Kjo

po ndodh në Kosovë, me klerikët e vendosur në kishat dhe manastiret e Kosovës, si drejtues të saj. Jo vetëm që i kanë uzurpuar ato, por brenda mureve të këtyre kishave serbet kanë bërë krime gjenocidi, jo vetëm në të kaluarën e largët por edhe në luftën e fundit. Ky ka qenë misioni i tyre kryesor në këto objekte fetare. Prandaj, edhepse në rrethana të reja, të prezencës ndërkombëtare, liderët serbe, si Koshtunica etj., gostiten nëpër festa në Kosovë, në Mitrovicë, Shtërpce e Graçanicë. Krimineli nuk e harron vendin e krimit, po kthehet gjithmonë sa herë që t'i mundësohet. Serbia i ka aktivizuar kollaboratorët shqifolës në interes të politikës së copëtimit të Kosovës, kontrollit të enkllavave me shumicë serbe, kishat dhe manastiret ortodokse të Kosovës, duke siguruar nyjet kryesore për kontrollin ndaj Kosovës në tërësi, dhe synimet e hegjemonizmit për të ardhmen. Faktori i sapoardhur ndërkombëtar nuk brengoset për luftën e supermacionit të njërës apo tjetrës palë, se do të jenë serbët apo shqiptarët prioritet i saj në Ballkan, meqë ka interesat dhe fuqinë globale. Ajo nuk shikon drejtësinë, por krahun e atij që është më i vendosur, që tregon fuqinë e organizimit dhe unitetit të brendshëm, si garanci për sigurinë e interesave strategjike në përmasa më të gjëra lindje-perëndim e veri-jug. Kosova u duhet vetëm si një vatër multietnike e koklavitur etnikisht,

nën kontroll, derisa të realizohen këto interesa, mëpastaj mbeten këtu popujt për t'ia filluar serish me konfliktet e luftrat e pambarim.

Kah po shkon Kosova, kah po shkon Shqipëria?

Shqiptarët i kanë bërë llogaritë gabim, (vet)mashtrimi i fundshekullit XX dhe fillimi i atij XXI do t'i kushtojë, me aventurat dhe proceset vetëshkatërruese në emër të demokracisë, vrapin marramendës për përfitime, duke ikur nga qenësorja, nga identiteti e nga bashkimi si komb e si shtet. Tashmë kemi hyrë në fazën përfundimtare të këtij procesi, me logjikën e pandryshuar të iluzioneve për integrime me BE përmes dezintegrimit kombëtar. Këtë e tregon pikërisht mospërfillja e vatrave të trashëgimisë së lashtë të kishave dhe manastireve në Kosovë, sikur këto të ishin diku në qiell e jo në tokën e Kosovës. E kujt pra është Kosova, nëse shpërfillet historia dhe kultura e saj nga vet shqiptarët?

4.
MANASTIRI "SHËN BIGURI" DIBËR, ËSHTË I SHQIPTARËVE

Branko Panov është historian i Maqedonisë i cili e ka shkruar Historinë Mesjetare të Maqedonisë dhe ai vetë duke u bazuar në dokummentet arkivale

vërteton se Blazhja dhe maqedonët e tij kur erdhën në Ballkan e pranuan krishterizmin nga shqiptarët (Arbërit) dhe më vonë, shqiptarëve ua uzurpuan edhe kishat, sepse këta erdhën nga Karpatet si egërsira, paganë dhe të pa fe.

Pasi është djegur e shkatërruar nga sllavët, Shën Biguri është rindërtruar në vitin 1018, përsëri nga arbërit në kohën kur Kisha e Krishterë ishte ndarë në ate të Perëndimit me qendër në Romë dhe të Lindjes më qendër në Konstantinopol. Ky ka qenë kapërcimi i sh.X-XI kur trevat shqiptare ishin nën juridiksionin kishtar të tri kryepeshkopatave: Naupaktit, Durrësit dhe Ohrit.

Kjo e fundit edhe e përmbëlidhte numrin më të madh të peshkopatave shqiptare dhe kishte nën vete edhe selitë peshkopale të Prizrenit,Shkupit, Dibrës, Kërçovës, Përlepit, Devollit, Kolonjës Manastiritt etj. Ndarja përfundimtare dhe zyrtare e kishës (1054) në Katolike dhe Ortodokse i detyroi shqiptarët të ndahen në mes të këtyre dy qendrave të mëdha të botës së krishterë. Duke u nisur nga kufinjtë e dioqezës së Tivarit, Kisha Katolike depërtoi në thellsi, në drejtim të Lindjes(Dardanisë) dhe të Jugut (Principata e Arbërit). Në vitin 1204 burimet historike flasin për ekzistencën e selive peshkopale katolike në Prizren, Shkup e Dibër. Shtrirja e ritit

katolik në viset e Dardanisë me kryeqytet Shkupin (kufiri I të cilës shtrihej deri në malin Bukovik mes Gostivarit e Kërçovës), toka të banuara këto kryesisht nga popullatë shqiptare, përkonë me kalimin e tyre nga sundimi bizantin nën sundimin e shtetit serb, politika e të cilit synonte që Kisha Ortodokse serbe, që prej vitit 1219, të zinte në këto hapsira vendin e kishës bizantine të Konstantinopojës.

Themelimi dhe kthimi i një sërë kishash e manastiresh në teritorin, Kosovë e Maqedoni e sotme, si dhe zhvendosja në Pejë e selisë së Patrikanës Serbe, i shërbenin pikërisht këtij qëllimi. Për të shmangur ballafaqimin me shqiptarët, që ishin në përgjithësi të ritit katolik, dhe me botën katolike përtej detit Adriatik, (Itali) mbretërit e parë serbë të dinastisë Nemanja, ua njohën për ca kohë shqiptarëve autonominë kishtare. Mirëpo kur serbet u shfaqën në viset e Kosovës, Pollogut e rrethinat e Dibrave, fillojnë edhe persekutimet e zhupanit të madh" (Veliki Zhupan)1173, si dhe ankthet dhe vuajtjet e shqiptarëve katolikë të robëruar nga sërbia 1199. Politika antishqiptare dhe antikatolike u kristalizua me ardhjen e Stevan Uroshoit II, (1282-1321), Uroshit III, (1322-1331) dhe Stevan Dushanit (1331-1355). Kjo është koha kur Sërbia arrin kulmin e fuqisë, dhe plotësisht i prish marëdhëniet edhe me

papatin po edhe me botën katolike si që ishte Hungaria dhe Anzhuinët fracez.

“Sveti Jovan” është emri i Gjon Kastriotit (i shënuar në dokumentet slave si Jovan Kastrioti) dhe ky emër ka filluar te përdoret në shënjë respekti, sepse i dhuroi pasuri të madhe këtij manastiri. Edhe te Kisha e Hilandarit në Atos (Greqi) një pirg e mban emrin e Gjon Kastriotit,poashtu për nderë të dhuratave që ai i dha kësajë kishe. Ky eshte llogaritur si “Ktitor” I ketyre kishave.

Se “Shën Biguri” ka qenë e ndertuar nga arbërit e vërteton edhe Teofilakti i Ohrit ku thotë se sllavët i shkatërruan deri në themel “Shtëpitë e Zotit” (Bozhjite Hramovi) dhe ilirikët, përsëri i rindërtuan.

5.
MANASTIRI I SHËN NAUMIT DHE LEGJENDA E TIJ

Vetëm 2 km larg doganës së Tushemishtit ndodhet një nga Manastiret më të medha të gjithë rajonit tëEuropës e të Ballkanit..Sapo i afrohesh një parku të madh buzë liqenit me lumin Drin i cili kalon mes perms parkut 20 ha me një gjelbërim te harlisur me drurë të dendur dhe përroska uji me drurë të ndryshëm dekorativë me qiparise të shumta dhe zogj të rrallë si psh palloj vijnë rrotull manastirit dhe të

duket sikur gjithçka këtu ka dale nga perrallat e Andërsenit. Afrohesh më pranë Manastirit dhe në hyrje ka një portë shekullore ku sipër portes është një mozaik ku paraqitet një bujk duke punuar token dhe në njërën anë është një ka dhe në anën tjetër një ari në pendën e qeve që bujku punon tokën ndërsa brenda shtrihet një oborr i madh dhe brenda tij shtrihet kompleksi i madh i kishës së Shën Naumit me piktura të shumta murale shenjtorësh ku vendin qëndror e ze ajo e Shën Naumit. Në një dhomë tjetër ndodhet varri i Shën Naumit ku njerëz të shumtë bëjnë pelegrinazhe pranë varrit të shenjtorit.

Legjenda e Shën Naumit

Legjendat, të mbetura te tilla në kujtesën e njerzve m egjithë ndonjë fantazi ruajnë të trashëguara vlera historike dhe kulturore të popujve. E tillë është edhe legjenda e Shën Naumit. Shen Naumi i ka hipur një kali dhe është nisur nga Ohri për në Voskopojë. Në krye të Qafës së Plloçës kali hingëllin dhe nuk pranon të eci më përpara. I ndodhur para këtij fakti që nuk i bindej kali Shën Naumi vendos të këthehet dhe atje ku kali vendosi këmbën mbi një pllakë guri ngeli i stampuar patkoj i këmbes së kalit të Shën Naumit (njerzit e dhe ditët e sotme tek vendi ku duket shenja e patkojt hedhin lekë). Shën Naumi i këthyer mbrapsh zbriti Qafën e Plloçës dhe kaloj nëpër

fshatin Zagorçan dhe i uroj "grurë mbjellshi dhe magjia ju qoftë gjithmon plot". Kur po hynte në fshatin Tushemisht një bari delesh e dhish i lëshoj qentë e tufës ndërkohë një tufë me lope që ishin aty pranë me brirët e tyre e shpëtuan Shën Naumin nga qentë. Shën Naumi bekoi lopët dhe mallkoi delet e dhitë që në këtë fshat mos paste kurrë. Gjatë gjithë rrugës shenjtori ndihmoi fukarenjtë dhe shëroi të sëmurët. Pasi eci më pak se 2 km nga Tushemishti qendroj në një pllajë buzë liqenit. Aty pranë ishte pronari i tokës. Shën Naumi iu lut pronarit të tokës ti jepte pak vend se donte të jetonte atje në atë vend të cilin ai do ta bekonte. Pronari i tokës i tha Shën Naumit se do tja falte të gjithë token e tij nëse ai do ti sheronte vajzën e vetme të cilen e kishte të sëmurë me të meta mendore edhe tullace. Shënjtori pasi mundi të realizonte dëshirën e pronarit duke ia shëruar vajzë duke e larë buzë Drinit dhe duke e bekuar ujin atje (ku sot aktualisht ndodhet një ndërtesë e vogël dhe njerzit mbushin ujë të bekuar dhe sherojnë të sëmurët me ujin e bekuar nga Shën Naumi) arriti të marri token e pronarit që i shëroj vajzën .Por Shën Naumit nuk i mjaftonte vetëm ajo tokë kështu që takoj një pronar tjetër që e kishte token ngjitur me atë që mori Shën Naumi. Pronari po e punonte token i mërzitur sepse ia kishte ngrënë njërin nga qetë ariu. Shën Naumi i thotë atij se do ta

detyronte ariun të mbrehej në pendën e qeve dhe ta punonte token në vend të kaut që ai kishte ngrënë. Kjo është e pamundur tha pronari por shenjtori e realizoj e dhe këtë mrekulli atëherë edhe pronari i dytë ia dha tokën e premtuar Shën Naumit ku sot ndodhet Manastiri i cili mban emrin e tij ndërsa mbi portën kryesore ndodhet mozaiku që ka ariu sëbashku me kaun duke punuar token dhe aty pranë edhe Shën Naumi.

Fakte historike mbi Shën Naumin

Shën Naumi ka qënë pjesë e kufirit shqiptar, kur vendimi i Konferencës së Londrësmë 1913 shprehej zyrtarisht se kufijtë e Shqipërisë tek liqeni i Ohrit do të jenë nga bregu perëndimor i liqenit nga fshati Lin dhe diagonalia e kufirit e futë manastirin e Shën Naumit brenda kufijve shqiptarë. Qeveria Sërbo Kroato Sllovene protestoi në gjykatën e Hagës më 31.12.1924 por edhe ky gjyq ia la Shqipërisë manastirin e Shën Naumit.

Manastiri i Deçanit, Patrikana e Pejës dhe kisha e manastire të tjera nëpër Kosovë, të pushtuara prej serbeve dhe “dorëzuara” prej shqiptarëve, nuk mund të jenë ato që ishin dikur. Manastiri i Deçanit është ndërtuar prej shqiptarëve në tokën e Haki Kuqit! Ka qenë kishë ilire. Ata që krenohen me Kosovën, që

bëjnë sikur janë patriotë të mëdhenj, duhet të luftojnë për të vërtetën historike të kishave ortodokse ("serbe"), duhet të përgenjështrojnë "të vertetat" e Rakiqit e Gjuriqit.

Çfarë kemi bërë ne qe 19 vjet për të dëshmuar se kishat e ndërtuara para dhe pas ardhjes së serbëve në Ballkan ishin të shqiptarëve, asokohe të krishterë të gjithe!?

Manastiri i Deçanit, Patrikana e Pejes etj. dhe kisha e manastire të tjera nëpër Kosovë të pushtuara prej serbeve dhe "dorëzuara" prej shqiptarëve nuk mund të jenë ato që ishin dikur, ashtu sikurse e di që janë trashëgimi kulturore e Kosovës, edhe e shqiptarëve të Kosoves.

Unë e di që liderët tanë, një pjesë injorantë dhe të pa guxim, nuk mund t'ua nxjerrë goja këto fjalë, ngase brengosen për vota dhe për budalleqet që nxjerrin gojët e hoxhallarëve "Elhamdululah që jam turk"!!

Kur të kryhet një punë, duhet mësuar prej saj, por assesi t'i kthehesh me të njejtën qasje! Kur nuk e njeh të kaluarën, ashtu siç ishte, e ardhmja është e zymtë.

Një pjesë tjetër e jona, gjithë ditën flasin për pellazgët, për ilirët, ca vjedhin miliona, dhe lëmë

qytetin antik të Ulpianës të shkatërrohet. Thuajse gjithë trashigiminë e kemi në çifteli!
Ata që krenohen me Kosovën, që bëjnë sikur janë patriotë të mëdhenj, duhet të luftojnë për të vertetën historike të kishave ortodokse ("serbe"), duhet të përgenjeshtrojnë "të vërtetat" e Rakiqit e Gjuriqit, të shikojnë me lupë punën e ministrit Rikallo, të nxjerrin në sipërfaqe Ulpianën, ta sjellin botën aty, me synim që të përfitojnë materialisht dhe kulturalisht, që të krenohen se janë shqiptarë, para së gjithash!

Tash 19 vjet pas çlirimit, Serbia nuk do të duhej të ishte prioritet i qeverisjes dhe as opozitarizmit në Kosovë. Por derisa të jetë kjo klasë politike duhet të turperohet! Jane të kota "broçkullat" për origjinën tonë, për të kaluarën!

DIALOGU SHQIPTARO - SERB NË QORRSOKAK

Marrëdhëniet e Kosovës me Serbinë, janë "duke i pritur ditët të vështira". Është e nevojshme një "mobilizim politik dhe qytetarë për kundërshtimin e aktiviteteve të tilla të Serbisë.

"Ne të gjithë duhet të mobilizohemi politikisht, por edhe në aspektin civil që të mos merren më presione që Serbia po i bënë në Kosovë, për shkak të planit të tyre që veriu i Kosovës të aneksohet nga Serbia. Kosovaret nuk do ta lejojnë këtë.

Kosova gjithë këto presione dhe provokime do t'i rezistoi duke i përdorur të gjitha mundësit ligjore dhe kushtetuese që i ka në dispozicion.

Kosovarët do të ua bëjmë të qartë edhe përfaqësuesve të Bashkimit Evropian se nuk do të lejojmë që të na rrezikojë integritetin territorial të Kosovës.

Ka qenë e nevojshme për të dy vendet të bëjnë marrëveshje për të normalizuar marrëdhëniet që nga viti 2013, disa marrëveshje janë arritur, ndërsa të tjerat janë në

rrugën e zbatimit, por duhet të shihet përpara dhe të bëhet gjithçka që është e mundshme për të normalizuar marrëdhëniet mes vendeve.

Serbia duhet të ndaloj provokimin e renda që po bënë kundër Kosovës, të tilla si urdhër-rresti, treni dhe muri në Mitrovicë.

Disa parti politike ishin pjesë e bisedimeve, si dhe disa përfaqësues kanë marrë pjesë në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, por thotë se edhe në Kuvendin e Kosovës e kanë votuar për marrëveshjen e parë në vitin 2013.

"Në kemi nevojë për mobilizim politik dhe qytetar ndaj presionit luftarak që po e bën Serbia. Ata janë duke pritur që ne të kemi ditë të vështira në marrëdhëniet me Serbinë.

***

Mendoj se është e domosdoshme që edhe Kosova e edhe Serbia të zbatojnë atë që janë marrë vesh në

Bruksel, ka deklaruar sot nënkryetarja e Parlamenti Europian. Ulrike Lunaçek, e cila ka qenë raportuese për Kosovën, transmeton Koha.net.

“Sinqerisht nuk dëshiroj të dëgjoj se çdo gjë duhet biseduar nga fillimi. Por, duhet zbatuar atë që është premtuar. Kjo vlen për të dy palët”, citon FoNet të ketë thënë Lunaçek për DW.

Në Parlamentin Europian krejtësisht qartë themi se kjo vlen edhe për Serbinë, pra nuk jemi të njëanshëm, por theksojmë se edhe Serba ka shumëçka për të plotësuar ka konstatuar Lunaçek.

Mendoj se edhe Kosova e edhe Serbia kanë humbur shumë kohë sepse nuk e kanë zbatuar atë për të cilën janë pajtuar.

“Pra, jo negociata të reja, por zbatim, zbatim, zbatim”, ka thënë Lunaçek.

Lidhur me zgjedhjet në Kosovë, Lunaçek ka shfaqur shpresën se shumica qeveritare në Kosovë do ta ratifikojë Marrëveshjen për kufi me Malin e Zi dhe se do ta luftojë korrupsionin.

***

Presidenti Hashim Thaçi mund të udhëheqë dialogun me Serbinë edhe para konstituimit të institucioneve, por nuk ka të drejtë kushtetuese të nënshkruajë asnjë marrëveshje pa pëlqimin paraprak të Kuvendit, vlerësojnë njohësit e Kushtetues.

Shoqëria Civile shkuarjen e tij në Bruksel e sheh si tentim për të qenë në qendër të vëmendjes dhe tentim shfrytëzimi të vakuumit institucional për të marrë në duar frenat e dialogut.
Sidoqoftë, dialogu që u zhvillua pas pavarësisë, fillimisht nisi për çështje teknike e më pas për normalizim marrëdhëniesh, u bazua në dy rezolutat e Kuvendit të Kosovës, e para e miratuar në marsin e 2011-ës dhe e dyta në tetorin e 2012-ës.
Që të dyja këto e obligojnë Qeverinë e Kosovës që të raportojë në mënyrë të rregullt për ecurinë e dialogut para Kuvendit.
Por në rastin e udhëheqjes së dialogut nga Presidenti, mbetet në vullnetin e tij nëse do të raportojë ose jo.

***

Ish presidenti Tadiq potencoi për mediat serbe se "kjo qeveri dha edhe atë që deri më tani nuk ishte e humbur, duke u arsyetuar në krijimin e një asociacioni që quhet 'Bashkësi e komunave me shumicë serbe', por që ajo bashkësi do të ketë rol të një OJQ-je, bile edhe më pak se ajo.
Në një intervistë dhënë mediave serbe, ish presidenti serb, Boris Tadiq theksoi se plani i tij, i shpalosur para pesë vitesh e që ishte i përbërë prej katër pikash, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit ai plan tanimë nuk ka vlerë, ngase disa çështje, që

atëherë ishin të mundshme për t'u realizuar, tanimë janë të pamundshme.

Ai, ndër të tjera, shtoi se Aleksandar Vuçiq dhe Tomisllav Nikoliq, kanë mashtruar qytetarët në zgjedhjet e 2012-ës, duke premtuar se të gjitha marrëveshjet e arritura më herët do të zhvlerësohen, njoftojnë mediat serbe, transmeton RTK.

"Me nënshkrimin e marrëveshjes së Brukselit kanë pamundësuar të luftojmë edhe për atë deri më atëherë ishte e mundur të fitohet, ndërkaq tanimë jemi para aktit të kryer dhe çdo marrëveshje për çështje të tilla shërben drejt ndarjes së përgjegjëve dhe mjegullim para syve të publikut për të thëne se bëjmë dialog", theksoi ish presidenti Tadiq. Tutje ai theksoi se dialogu mbi ato çështje kishte kuptim vetëm para nënshkrimit të marrëveshjes së Brukselit.

"Kjo qeveri lejoi të instalojë sistemin ligjor në gjithë territorin e Kosovë së pavarur, duke përfshirë edhe veriun. Ndërkohë që në mandatin tim si president nuk kemi pranuar dhe suksesshëm kemi arritur ta ruajmë atë që Serbia nuk kishte humbur gjatë luftës '98-'99", theksoi ish presidenti serb, Tadiq.

Ndër të tjera, ish presidenti Tadiq potencoi se "kjo qeveri dha edhe atë që deri më tani nuk ishte e humbur, duke u arsyetuar në krijimin e një asociacioni që quhet 'Bashkësi e komunave serbe' por

që ajo bashkësi do të ketë rol të një OJQ-je, bile edhe më pak se ajo, bile edhe më keq, kjo qeveri nuk do të jetë në gjendje të luftojë që edhe kjo të zbatohet".

***

Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë Marko Gjuriq sot në panelin e Forumit për Siguri të Beogradit është ankuar se Serbia nuk ka me kë të flasë për zbatimin e marrëveshjeve me Kosovën, transmeton Koha.net

"Ka muaj që nuk kemi partner për dialog dhe implementim. Tani jemi në ajër dhe varemi nga mëshira e tyre (Kosova) që të emërojnë dikë i cili do të merrej me këtë", ka thënë ai.

Ai, siç njofton rts, ka theksuar se është koha që gjatë kërkimit të zgjidhjes për Kosovën të fillohet me marrjen para sysh se çfarë duan shqiptarët dhe çfarë duan serbët në Kosovë.

"Nuk jam i sigurt nëse gjatë viteve të shkuara kjo zgjidhje qenë e njëjtë për serbët e për shqiptarët. Ai ka thënë se për serbët Kosova është krahinë autonome, për shqiptarët e për në pjesë të botës Kosova është shtet, ndërsa popullata atje nuk e është e kënaqur me këtë status pasi një pjesë e madhe e shqiptarëve e duan atë pjesë të Shqipërisë e ndërsa serbët e duan pjesë të Serbisë", ka thënë Gjuriq duke shtuar se pak kush është i kënaqur me këtë status.

Ai në vazhdim ka thënë se normaliteti në Kosovë do të thotë ekonomi më e mirë, më shumë vende pune dhe më pak papunës.

"Jemi të gatshëm të punojmë me Prishtinën në këto qëllime nga të cilat dobi kanë dy palët", tha Gjuriq duke përfunduar se "normaliteti nuk është marrja me statusin porse kushtet më të mira për njerëzit.

Zyrtari serb i për Kosovën ka thënë të mos jetë i sigurt shqiptarët do të ndalen me pavarësinë e Kosovës e si shembull ka marrë atë që Shqipëria ka emëruar shqiptarë nga Kosova, ndërsa Hashim Thaçi ka kërkuar për kosovarët pasaporta të Shqipërisë .

SHTËPIA E VERDHË

Duke folur për trafikimin me organe njerëzore, Prof. Dr. Zoran Stankoviq, specialist i mjekësisë ligjore nga Beogradi, thotë se në këtë punë duhet të marrin pjesë kirurgë të mirë, një ekip multidisiplinar me të paktën 50 njerëz. "Shtëpia e verdhë, (Shqipëri) sa kam parë, nuk ka pasur mundësi që në të dikush të bëjë transplantime, por është shumë e mundshme që ky objekt të jetë shfrytëzuar si burg në të cilin janë mbajtur të zënit robë", ka thënë Stankoviq për shtypin serb.

"Që transplantimi i organeve të jetë i suksesshëm, nevojiten kushte sterile për punë, pajisje dhe mjekë të stërvitur mirë. Para vetë ndërhyrjes duhet bërë tipizimi i organit". Sipas Dr. Stankoviqit kur të nxirren të gjitha organet që mund të transplantohen,

nevojitet një kohë për transportin e tyre. Kjo me siguri është kryer me avion, sepse tranpslantimi i organeve duhet të bëhe për disa orë. “Që organi të merret, trupi duhet të jetë në gjendje pa vetëdije duke dhënë sedativ, apo anestetikë’, thekson ai. “Janë iluzione se ata se pari janë vrarë, dhe të vdekur i kanë dërguar deri në vendin ku u janë marrë organet. Madje edhe kur bëhet fjalë për transplantime kadaverike, personi i tillë është në aparate. Ata me gjasë i kanë lënë njezëzit të vdesin”. Sipas Stankoviqit, nëse i gjejnë varret, me obduksion mund të shihet vetëm nëse është nxjerrë zemra apo disa eshtra të ekstremiteteve. “Për shkak të procesit të kalbjes nuk ka inde të buta dhe është e pamundur të verifikohet se a janë nxjerrë veshkat, mëlqia”. thotë Stankoviq për gazeten

***

Prokurori i Serbisë për krime lufte, Vladimir Vukçeviq, ka thënë se pa bashkëpunimin e Shqipërisë, Serbisë dhe EULEX-it, nuk do të ketë përparime në hetimet “mbi trafikimin e organeve”, për të cilat ka raportuar anëtari i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Dik Marti.

Duke pohuar se ka qenë në mesin e burimeve kryesore për Dik Martin, në Prokurorinë e Serbisë

pohojnë se gjërat kanë ndryshuar thelbësisht, pas ardhjes së EULEX-it në Kosovë.

***

Serbia nuk do ta akuzoj kryeministrin e Kosovës, Hashim Thaçi, lidhur me akuzat kundër tij të paraqitura nga raportin e Dik Martit.

"Nëse dikush nuk është i arritshëm për policinë tonë dhe autoritetet gjyqësore, nuk është e përshtatshme t'i fillojmë proceset e tilla, sepse duken shumë më tepër si procese politike", i tha gazetës beogradase Blic, zëvendës prokurori i Serbisë, Bruno Vekariq. Mëtutje ai theksoi se "meqë ne nuk dëshirojmë të jemi të involvuar në sferën politike, roli ynë më i rëndësishëm është ta ndihmojmë EULEKS-in dhe Prokurorinë në Shqipëri, në zhvillimin e hetimeve".

***

Zyrtarët serbë thanë se dëshirojnë një hetim ndërkombëtar në lidhje me raportin e raportuesit të Këshillit të Evropës Dick Martit.

Një zyrtar serb ka udhëtuar sot në Strasburg, në selinë e Këshillit të Evropës, për t'u takuar me senatorin Dick Martin, i cili javën e kaluar publikoi raportin mbi trafikimin ilegal të organeve, që siç pretendon raporti, është kryer nga disa pjsëtarë të UÇK-së.

Rasim Lajiq tha se “Serbia nuk po kërkon asgjë, përveçse të vërtetën në lidhje më këto akuza”.
Raporti i Martit përmend edhe kryeministrin Hashim Thaçin se qëndron pas rrjetit që është marrë “me trafikim narkotikësh, por edhe me trafikim të organeve njerëzore”.
Kryeministri Thaçi ka hedhur poshtë akzuat duke i quajtur shpifje dhe gënjeshtra.

***

Presidenti i Serbisë, Boris Tadiq vlerësoi se, pavarësisht të ekzistimit të supozimeve për pafajësi, pas publikimit të raportit të Dik Martit, në të ardhmen në komunitetin ndërkombëtar problemi i Kosovës do të shihet nga një prizm tjetër.
“Serbia ka pritur me vite para institucioneve ndërkombëtare për një raport të tillë. Kemi apeluar që të gjitha krimet të zbardhen, por këto apele në dekadën e kaluar nuk janë marrë seriozoisht. Tash, është një pamje tjetër dhe për këtë i falenderohem Dik Martit”, u ka thënë Tadiq gazetarëve në bazën e Njësive Speciale Anti-Terroristë në Batajnicë. Tadiqi ka vlerësuar se populli serb në vitet e kaluara në opinionin ndërkombëtar është paraqitur si fajtori i vetëm për të gjitha ngjarjet në ish RSFJ-në, por se pas raportit të Martit, një qëndrim i tillë “bie në ujë”.

Ai ka kërkuar hetim gjithëpërfshirës dhe të gjerë, që nënkupton konfirmimin e saktë nëse ka pasur krime të tilla në Kosovë dhe konfirmimi se kush është fajtor. Ai ka shfaqur shpresën hetimi i gjerë i këtij rasti do të ndriçojë dhe procesin e krijimit sic e ka quajtur të "të ashtuquajturit shtetit të Kosovës".

Duke u përgjigjur në pyetjen nëse pas raporti ka ndryshuar qëndrimin e tij ndaj kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçit, Tadiq ka thënë se ai përfaqëson interesat publike të Serbisë dhe nuk sillet në publik sipas simpative personale.

"Shumë herë jam takuar me njerëz me të cilët nuk kemi asgjë të përbashkët. Kjo është puna ime. Edhe mjekët shërojnë njerëz me të cilët nuk i lidh sistemi i njëjtë i vlerave", ka thënë Tadiq.

***

Ish-shefi i Zyrës së UNMIK-ut për persona të zhdukur dhe forenzikë, Jose Pablo Baraybar, ka deklaruar se dëshmitarët që jepnin informata rreth tregtisë me organe njerëzore në Kosovë, në kohën e tij, zhdukeshin.

Ai tha se informatat e para për tregti me organe njerëzore në Kosovë i kishte marrë nga 8 dëshmitarë, të cilët në ndërkohë thjesht ishin zhdukur.

E përditshmja e Beogradit, e njohur për pikëpamjet nacionaliste serbe, "Veçernje Novosti", citon

Baraybarin se informatat e para mbi tregtinë me organe njerëzish në Kosovë i kishte në fund të vitit 2002 dhe në fillim të vitit 2003. Baraybari sipas kësaj gazete më 2004 kishte marrë mostrat rreth Shtëpisë së verdhë famëkeqe dhe para dy vjetësh kishte paralajmëruar se hetimet e Dick Martyt do të jenë mënyra më e mirë se të zbulohet se çfarë kishte ndodhur në të vërtetë.

Ai ka pohuar se disa nga dëshmitarët kishin thënë se kanë qenë në "Shtëpinë e verdhë në veri të Shqipërisë, të tjerë kishin folur se kanë parë që nga kjo shtëpi nxirreshin trupat njerëzish dhe varroseshin në varrezën lokale, kurse disa të tjerë kishin thënë se kishin transportuar njerëz në Shqipëri".

"Nuk kemi biseduar me askënd që ka thënë se ka marrë pjesë në atë që gjoja ka ndodhur në Shtëpinë e verdhë ose, të themi, të ketë qenë i rrëmbyer", ka thënë Baraybar.

Baraybar ka theksuar se edhe gjatë vizitës së vendit potencial të krimit "ka pasur gjurmë që duhej të ndiqeshin", siç janë shishe ilaçesh ose kontejnerë kirurgjikë, duke vlerësuar se kishte mjaft informacione që hetimi të vazhdojë.

Po sipas fjalëve të tij, hetimi rreth krimeve ishte mbyllur pas shkuarjes së ekipit të UNMIK-ut në Burrel, nga shumë arsye, një nga to ishte se kishin

filluar hetimet kundër Fatmir Limajt e Ramush Haradinajt.

"Kur ndodhi kjo, të gjitha burimet të cilat do të mund të na çonin deri në varreza dhe të na tregonin se ku ishin varrosur saktësisht trupat, thjesht u zhdukën", i ka thënë kësaj gazeta Barebarin, dhe ka shtuar se dëshmitarët nisën të fshihen, nuk dëshironin të flisnin ose ikën.

"Raporti i UNMIK-ut që e ka nënshkruar Baraybar, dhe që është kompletuar kohë më parë dhe për të cilin ishte heshtur 4 vjet, zbulon se hetuesit dhe forenzikët më 4 shkurt të vitit 2004 gjurmët e krimit i kanë ndeshur 15 km në veri nga Burreli.

Në një mbeturinë është gjetur një kontejner i zbrazët plastik, përmbajtjen e pajisjeve për terapi intervenoze, shiringa, shishe të zbrazëta trankseni, që përdoret edhe për qetësim edhe për anestezion intravenoz, si dhe antibiotikë, ambalazh për hapa, copa materiali nga kombinezone kirurgjike, shishe hapash të ndryshëm, dhe këllëf për revole.

Të gjitha dëshmitë sipas Baraybarit i janë dorëzuar oficerit të Sigurimit të Tribunalit të Hagës, Han Koksi, dhe ato janë shkatërruar në vitin tjetër.

***

Serbia dhe aleati i saj, Rusia kanë reaguar ndaj raportit, i cili e implikon kryeministrin e Kosovës

Hashim Thaçi në trafikimin e organeve të serbëve të burgosur.

Ministri i Jashtëm serb. Vuk Jeremiç, i bëri komentet e tij pas takimit me homologun rus Sergei Lavrov në Moskë.

"*Ky raport është sinjal se ka ardhur koha që tërë bota e qytetëruar të pushojë së mbylluri sytë para realiteteve të tmerrshme në Kosovë. Ky raport tregon se si është Kosova sot, dhe kush janë liderët e saj. Ne të gjithë duhet të bëhemi bashkë që të kërkojmë zgjidhje për çështje*n" e Kosovës, tha Jeremiç.

Raporti i raportuesit të Këshillit të Evropës Dik Marti thotë se civilët e burgosur nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës janë vrarë në Shqipëri, dhe veshkat e tyre janë shitur në tregun e zi pas përfundimit të luftës në Kosovë në vitin 1999.

Raporti gjithashtu sugjeron se kryeministri Hashim Thaçi ka qenë një kohë "bosi" i nëntokës kriminale, e cila ka bërë tregtinë me organet.

Lavrov tha se informatat për trafikimin e organeve kanë dalë në sipërfaqe shumë kohë më parë, dhe se Moska është "shumë e alarmuar" nga raporti i ri.

Qeveria e Kosovës tha se raporti është përpjekje për ta njollosur imazhin e UÇK-së.

***

Projekt-raporti i Dick Martyt në Këshillin e Evropës, i cili përfshin kryeministrin në largim Hashim Thaçi në trafikimin e organeve, është mirëpritur nga ana e ish-kryeprokurores së Tribunalit të Hagës, Carla del Ponte.

Në një intervistë për agjencinë zvicerane Suissinfo, Del Ponte, autore e librit të diskutueshëm "Gjahu", aktualisht ambasadore në Argjentinë, ka thënë se ishte ndërmjet shqetësimit dhe kënaqësisë se këto "akte të urryera" së shpejti do të nxirren para drejtësisë.

"Informacionet e publikuara në librin 'Gjahu', çoi në këtë hetim. Jam e tronditur dhe thellësisht në gjendje të vështirë, nga gjetjet se kishte vrasje të të burgosurve me qëllim të heqjes së organeve të tyre dhe shitjen për fitim është kryer nga anëtarë të lartë të UÇK-së, duke përfshirë disa individë që mbajnë pozita të lartë në qeverinë aktuale të vendit", ka thënë Del Ponte në këtë intervistë, raporton Telegrafi.

Ajo tha se pretendimet në librin e saj mbështetën nga "prova të besueshme dhe të verifikueshme fizike" të marra nga studiuesit nga Tribunalit të Hagës dhe të UNMIK-it, gjatë një misioni në Shqipëri dhe në prani të një prokurori të qeverisë shqiptare.

"Unë e di që citimet nga libri im 'Gjuetia' kanë çuar në një hetim nga ana e Këshillit të Evropës, një draft i të cilit u botua në faqen e internetit në mars", ka thënë

ajo.
Tribunali i Hagës pati njoftuar, derisa ajo ishte kryeprokurore, se nuk kishte gjetur prova për të vërtetuar pretendimet e saj, dhe si Thaçi ashtu edhe kryeministri shqiptar Sali Berisha, hodhën poshtë ato publikisht.

***

Ish-kryeprokurorja për Krime Lufte në Hagë, Karla Del Ponte pasi ka mbështetur akuzat e Dick Marty, në një deklaratë ditën e sotme ka akuzuar Shqipërinë për pengesa në hetimet që janë zhvilluar ndaj Hashim Thaçit.
"Shqipëria, pengoi hetimet fillestare", i tha Del Ponte agjensise gjermane te lajmeve DPA. "Hetimet për këto çështje penale duhet te zhvillohen medoemos,- kembengul del Ponte, duke shtuar se – nuk duhet te kryhen nga autoritetet e Kosovës apo ato te Shqipërisë".
"Ata që tani thanë se të gjithë janë të pafajshëm", tha ish kryeprokurorja, aktualisht ambasadore e Zvicres ne Argjentinë. Sipas saj, vetem EULEX-i, mund te marre pjesë ne hetime, por edhe ai duhet pergatitur per kete pune.
"Pas perfundimit te punes ne krye te Gjykates se Krimeve te Luftes, mesova e tronditur se ishin zhdukur dëshmi për heqjen eventuale të organeve. Ka

pasur prova gjaku, shami, fotografi dhe gjëra të tilla të ngjashme nga shtëpia e verdhë në Rribe në veri te Shqiperise", thotë Del Ponte.
"Për ne ishte atëherë e qartë se në ate shtëpi kishte ndodhur diçka. Hetimet fillestare te gjykates mbeten ne vendnumero, per shkak se Shqipëria nderpreu bashkëpunimin. Veç kësaj dëshmitarë nuk kishin pranuar të dëshmonin. Ata kishin frikë", vazhdon Del Ponte.
Akuzat në fjalë ajo i ka publikuar për herë të parë në një libër të botuar në vitin 2008.

***

Ish-kryeprokurorja e Tribunalit të Hagës, Carla del Ponte ka thënë se NATO ishte aleate e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), ndërsa është shprehur mirënjohëse Këshillit të Evropës dhe Dick Martyt që kanë çuar më tej dyshimet rreth tregtisë me organe dhe kanë publikuar informacione për këtë çështje, për të cilën thotë se misioni i EULEX-it ka baza të shkojë përpara.
Në një intervistë për të përditshmen zvicerane Le Temps, ajo ka se Tribunali "kishte tregimin e personave që kanë transportuar të burgosurit nga një vend i mbajtjes rob në vendin tjetër dhe deri në një spital" dhe "se ato ishin dëshmi shumë të rënda". "Po ashtu e dinim se ka pasur gropa të përbashkëta të

Shqipëri, ku ndoshta do të mund të gjenim trupa, të cilave iu mungonin organet".

Carla del Ponte ka thënë se Tribunali i Hagës ka hetuar rastet e 400 të të zhdukurve dhe se kanë pasur shenja, sipas të cilave, një grup i vogël i atyre personave, nja 10 sish, të ketë qenë viktima të tregtisë me organe.

"Por, dëshmitarët kanë qenë të frikësuar dhe kanë refuzuar të përsërisin rrëfimet e tyre para Tribunalit të Hagës. Shenjat e krimit ndodheshin në Shqipëri dhe autoritetet shqiptare kanë refuzuar të bëhen hetime, duke thënë se këtë tashmë e kishin bërë, por pa sukses. Ato ngjarje kanë ndodhur gjatë verës së vitit 1999, pas luftës. Në këtë kohë, dyshohej në ekspertizën e Tribunalit të Hagës. UNMIK-u mund të merrej me hetime, por këtë nuk e bëri", ka thënë ish-kryeprokurorja e Tribunalit të Hagës.

Carla Del Ponte në librin e saj "Gjuetia" jep të dhëna mbi tregtinë me organe të civilëve serbë të vrarë pas përfundimit të luftës në Kosovë në vitin 1999.

***

Raportuesi i KE-së Dick Marty tha sot se ka prova dhe fakte për implikimin e kryeministrit të Kosovës Hashim Thaçi në trafikun e organeve, ndërsa ky i fundit mësohet se po shikon mundësinë për të çuar

para drejtësisë Martyn dhe britaniken "The Guardian".

Menjëherë pas rezolutës së miratuar sot nga Komiteti ku behet thirrje për një seri hetimesh në nivel kombëtar, mbi raportin e Dick Marty, ka reaguar ky i fundit. Gjatë një konference për shtyp raportuesi i KE-së Dick Marty e quajti veten zëdhënës të viktimave dhe e cilësoi raportin si shumë serioz.

"Të gjithë e dinin por askush nuk fliste", tha Marty, ndërsa shtoi se nuk janë bërë publike të gjitha detajet. Ai tha se ka prova dhe fakte nga persona të përfshirë në çështje.

Ai ka bërë thirrje që raporti i tij, i cili përfshin një periudhë dy vjeçare hetimesh të lexohet në mënyrë korrekte.

Ndërkaq kryeministri i Kosovës planifikon të hedhë në gjyq raportuesin e Këshillit të Evropës, Dick Marty. Agjencia e lajmeve Associated Press citon një zyrtar të lartë të Kosovës të ketë thënë se kryeministri Thaçi ka kontaktuar me një zyrë avokatie për tu këshilluar rreth çuarjes para drejtësisë të Dick Martyt. Zyrtari, të cilin AP-ja e citon në kushte anonimiteti, ka theksuar se Thaçi po shikon mundësinë edhe të hedhjes në gjyq gazetën britanike

***

Marty, një person lunatik, kundërshtoi fort pavarësinë në 2008, duke lëshuar që atëherë akuza ndaj UCK-së. Pak ditë nga shpallja e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008 ai tha se vendimi për shpalljen e saj nuk është marrë në Prishtinë.

Ai foli për "kutinë e pandorës" dhe pasojët e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Po shumëkush mund të thotë, pse ky raport erdhi pikërisht pas zgjedhjeve në Kosovë, ku PDK, forca politike e drejtuar nga Hashim Thaci, që është edhe i akuzuari i Marty-t, u quajt fituesja e zgjedhjeve?

Në intervistën e dy viteve më parë Dick Marty thotë shprehimisht kështu.

"Konstatoj se Kosova e administruar nga komuniteti ndërkombëtar pas 10 vjetësh ka një ekonomi që nuk ekziston, është kthyer në një qendër të krimit të organizuar e të trafikut të drogës, armëve dhe qënieve njerëzore. Konstatoj se nuk ka një shoqëri të vërtetë civile e cila të ngrejë themelet e një demokracie të vërtetë…".

***

"Nuk mund të ndërtohet e ardhmja e Kosovës pa u ballafaquar me të kaluarën. Me këtë raport unë veproj jo kundër Kosovës, por për Kosovën – dhe, mbi të gjitha, për ata kosovarë, të cilët, më në fund, duan të jetojnë në një shtet juridik", u shpreh anëtari i

Dhomës së Ulët të Parlamentit të Zvicrës, Dick Marty, në një intervistë dhënë gazetës zvicerane „NZZ am Sonntag“, të cilën e transmeton sot “Koha Ditore”, duke iu përgjigjur
kritikave ndaj raportit të tij mbi krimet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

I pyetur fillimisht nëse mund të lëvizte i lirë pas prezantimit të raportit mbi krimet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), derisa po udhëtonte në kantonin e Tiçinos, Dick Marty u përgjigj: “Marty: Mendoj se po”. Ai as e pohoi, as e demantoi se udhëton i pashoqëruar nga policia.”Ju siguroj se tani jam duke udhëtuar vetëm me një koleg të Parlamentit”, tha ai.

Marty shtoi se nuk e priste një jehonë të tillë të raportit të tij “Jo në këtë përmasë. Carla del Ponte, ish-kryeprokurore e Tribunalit të Krimeve të Luftës në Hagë, por edhe gazetarët më herët kanë tërhequr vëmendjen te këto krime. Por, raporti im ndoshta është më gjithëpërfshirës dhe më i detajuar”. Ndërkaq rreth akuzave ndaj ish-komandantit të UÇK-së dhe kryeministrit të tanishëm Hashim Thaçi për këto krime, tha se emri i tij përmendet në aq shumë raporte të shërbimeve sekrete dhe policore, prandaj ka qenë e pamundshme që ai të injorohet. Por, ka mohuar që emri i tij apostrofohet si pjesëmarrës në

krime. “Unë askund nuk shkruaj se ai personalisht ka qenë pjesëmarrës.”

Në pyetjen se pse e publikoi raportin tek pas zgjedhjeve, u përgjigj gjoja pse “ Nuk kemi dashur të ndikonim (në zgjedhje, v.j.)”. Sipas tij ndërkaq “në strukturat hierarkike të krimit të organizuar nuk bëhet gjë pa e ditur shefi”.

Marty në intervistën dhënë kësaj gazete zvicerane përpiqet të duket i paanshëm, parimor; “Unë s’e gjykoj askënd, por as nuk e amnistoj. Unë kam mbledhur fakte dhe kam konstatuar se kurrë nuk ka pasur një hetim të mirëfilltë. Por, unë nuk e paragjykoj epilogun e një hetimi të tillë”.

Reagimin e qeverisë ndaj akuzave të tij ai e konsideron gjë normale. ” Por, ne jemi konsultuar me ekspertë të tregtisë me organe. Kjo nuk është aq e komplikuar”, shpreht. Po ashtu shton se “E gjithë kjo s’ka ndodhur në Kosovë, por në një lokalitet në Shqipëri, afër Tiranës dhe aeroportit. Të transportosh atje një veshkë dhe ta futësh në një frigorifer është më pak e komplikuar se ç’po thuhet.”

Në vërejtjen se mungojnë dëshmitë për akuzat që bën, ai përgjigjet se kështu është thënë edhe kur e ka publikuar raportin për burgjet sekrete të CIA-s. “ Nuk më takon mua të them a është diçka dëshmi apo jo. Unë kam pasur mandat nga Këshilli i Evropës t’i hetoja ato që i ka thënë Del Ponte. Në bazë të shumë

burimeve – mes tjerash raporte të shërbimeve sekrete të vendeve të ndryshme dhe deklarata të dëshmitarëve, kryesisht kosovarë – unë kam mbledhur fakte. Unë përmendi vende, data, emra. Tani kjo duhet të hetohet nga një instancë juridike".

Sipas tij një problem fondamental ka qenë që NATO-ja atëbotë luftën në tokë ia kishte lënë UÇK-së, e cila më parë ishte klasifikuar si grup terrorist. NATO-ja, dhe veçanërisht SHBA-ja, pastaj vendosën të mbështeten te Thaçi për të formësuar të ardhmen e Kosovës. Marty nuk ngurron ta konsiderojë përgjegjëse për ato që kanë ndodhur në Kosovë. Përgjegjëse është "Gjithë bashkësia ndërkombëtare. Do të kishte mjaftuar sikur Evropa të kishte thënë jo", thotë ai. "Ajo ka pasur alternativë mes oportunizmit shkurtpamës politik dhe zbatimit të ligjit. Nuk mund të ndërtohet e ardhmja e Kosovës pa u ballafaquar me të kaluarën. Me këtë raport unë veproj jo kundër Kosovës, por për Kosovën – dhe, mbi të gjitha, për ata kosovarë, të cilët, më në fund, duan të jetojnë në një shtet juridik."

Marty pohon se gjatë një kohe të caktuar Zvicra me sa duket kishte vendosur një ndalimhyrje për Thaçin – dhe kjo nuk bëhet nëse kemi të bëjmë me njerëz absolutisht të ndershëm. Tani për tani nuk kam informata të tjera. Por, emri i Thaçit me siguri mund të gjendet në aktet policore.

Pohimin në gazetën „Le Temps“ në vitin 2008 se njohja e pavarësisë së Kosovës nga Zvicra ka qenë e hershme, Marty nuk e vë në dyshim. “Po. Por, është tërësisht e padobishme dhe absurde, që sot të vihet në dyshim kjo njohje”, shton.

Ndërkaq në pyetjen nëse është rastësi që pikërisht ai dhe Del Ponte – dy prokurorë të Tiçinos – eksponoheni në këtë çështje, Marty u përgjigj: Besoj se ne ndajmë një kulturë të ngjashme, vlera të njëjta.

***

Raportuesi i posaçëm i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (KE), Dick Marty, raporti i të cilit për trafikim ilegal me organe njerëzore në Kosovë është miratuar në Komitetin për çështje juridike dhe të drejta të njeriut, do të qëndrojë të hënën në Moskë, ku do të bisedojë me zyrtarët rusë rreth këtij raporti.

Siç mëson gazeta moskovite Komersant, nga zëvendësshefi i delegacionit rusë në Asamblenë Parlamentare të KE, Leonid Slutzky, temë kryesore e bisedimeve të Martyt në Moskë do të jenë marrëdhëniet ruso-gjeorgjiane.

Por, Slutzky ka thënë se gjatë qëndrimit të Martyt në Moskë, anëtarët e delegacionit rus do të marrin qëndrim rreth raportit të tij, ku akuzon kryeministrin e Kosovës në largim Hashim Thaçi për përfshirje në tregtinë me armë, drogë dhe organe njerëzore.

Sipas medieve serbe, pritet që Marty në Moskë të takohet me shefi i diplomacisë ruse, Sergey Lavrov, i cili javën e kaluar, pas takimit me shefin e diplomacisë serbe Vuk Jeremic, ka thënë se Rusia është e shqetësuar për informacionet rreth mundësisë së përfshirjes së udhëheqësve aktualë të Kosovës në krime kundër njerëzimit.

***

Raportuesi special i Këshillit të Evropës Dik Marti ka thënë se është në interes të udhëheqësisë kosovare zbulimi i së vërtetës në lidhje me raportin e tij mbi trafikimin e organeve në Kosovë.

"Është në interes të vetë kryeministrit Hashim Thaçi që të konfirmohet e vërteta", i ka thënë radios Eho Moska Dik Marti, i cili në kuadër të përgatitjes së raportit mbi konfliktin ruso-gjeorgjian ka biseduar me zyrtarët rusë.

Marti i pyetur se si do të zhvillohen ngjarjet në të ardhmen, ka thënë se "është vështirë të flitet për këtë".

Ai ka shpejguar se obligimi i tij ka qenë që të përgatisë një raport, ndërsa qeveritë sipas tij duhet të nxjerrin "përfundime të përshtatshme". Marti megjithatë, ka vlerësuar se nuk mund të ndërtohet e ardhmja pa hetimin e të gjitha rrethanave të së kaluarës dhe pa u konfirmuar e vërteta.

“Thaçi është lider i rëndësishëm i kriminalitetit kosovar, për të cilin ka pasur shumë informacione dhe ato gjenden në raporte të shumta ndërkombëtare”, citohet të ketë thënë Marti. I pyetur nëse ekzistojnë prova materiale për transplantimin e organeve, ai ka thënë se ekzistojnë prova për “vendet dhe rrethanat”.

***

Raportuesi i Këshillit të Evropës, Dik Marti ka thënë se padia e paralajmëruar ndaj tij nga ana e kryeministrit në dorëheqje Hashim Thaçi nuk do të prodhojë asgjë.

“Thaci e di mirë që raportuesit e Këshillit të Evropës kanë imunitet dhe ngritja e padisë në këtë rast nuk do të thotë asgjë”, ka thënë Marti në një intervistë për gazetën Veçernje Novosti.

“Është lehtë të padisësh dikë, është e domosdoshme para se gjitash, që të ndërmerren të gjitha hapat, për të parë se çka do të ndodhë”, ka thënë raportuesi i Këshillit i të Evropës, i cili javën e kaluar publikoi një raport në të cilëin akuzoi kryeministrin Thaçi se është “bos i mafias” dhe se ka qenë i përfshirë në një “rrjet të tregtimit të organeve njerëzore”. Ai ka thënë se këtë çështje duhet ta ndjekin organet përgjegjëse në Kosovë, Serbi si dhe ato ndërkombëtare.

“Drejtësia në Kosovë, instancat ndërkombëtare të drejtësisë, por edhe drejtësia serbe është kompetente”, ka thënë Marti, meqë sipas tij, ka pasur edhe viktima serbe. “Problemi është se dëshmitarët nuk janë të mbrojtur, për të cilën gjë, fatkeqësisht tashmë jemi vërtetuar. Ka pasur dëshmitarë që janë vrarë”, ka thënë Dik Marti.

Kosova dhe Shqipëria, e cila po ashtu është apostrofuar në raport, kanë kërkuar nga drejtësia ndërkombëtare, që të fillojë hetimet në të dy vendet, duke hedhur poshtë në të njëjtën kohë pretendimet se në territoret e tyre është zhvilluar tregti me organe njerëzore.

***

Raportuesi i Këshillit të Evropës, Dik Marti ka thënë se padia e paralajmëruar ndaj tij nga ana e kryeministrit në dorëheqje Hashim Thaçi nuk do të prodhojë asgjë.

“Thaci e di mirë që raportuesit e Këshillit të Evropës kanë imunitet dhe ngritja e padisë në këtë rast nuk do të thotë asgjë”, ka thënë Marti në një intervistë për gazetën Veçernje Novosti.

“Është lehtë të padisësh dikë, është e domosdoshme para se gjitash, që të ndërmerren të gjitha hapat, për të parë se çka do të ndodhë”, ka thënë raportuesi i Këshillit i të Evropës, i cili javën e kaluar publikoi një

raport në të cilëin akuzoi kryeministrin Thaçi se është "bos i mafias" dhe se ka qenë i përfshirë në një "rrjet të tregtimit të organeve njerëzore". Ai ka thënë se këtë çështje duhet ta ndjekin organet përgjegjëse në Kosovë, Serbi si dhe ato ndërkombëtare.

"Drejtësia në Kosovë, instancat ndërkombëtare të drejtësisë, por edhe drejtësia serbe është kompetente", ka thënë Marti, meqë sipas tij, ka pasur edhe viktima serbe.

"Problemi është se dëshmitarët nuk janë të mbrojtur, për të cilën gjë, fatkeqësisht tashmë jemi vërtetuar. Ka pasur dëshmitarë që janë vrarë", ka thënë Dik Marti.

Kosova dhe Shqipëria, e cila po ashtu është apostrofuar në raport, kanë kërkuar nga drejtësia ndërkombëtare, që të fillojë hetimet në të dy vendet, duke hedhur poshtë në të njëjtën kohë pretendimet se në territoret e tyre është zhvilluar tregti me organe njerëzore.

DICK MARTI U "SPONSORIZUA" NGA BEOGRADI

Në të përditshmen " The Guardian " u publikua kohë më parë një artikull i cili thirret në një raport të anëtarit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, Dik Marti, i cili është në vazhdën e raporteve të cilat janë publikuar në 12 vitet e fundit dhe që kanë pasur për qëllim njollosjen e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të udhëheqësve të saj. Pretendimet e botuara në "The Guardian" janë hetuar disa herë nga drejtësia vendore dhe ndërkombëtare, dhe në të gjitha rastet është konstatuar që deklarimet e tilla kanë qenë të pabazuara në fakte dhe të konstruktuara me qëllim të dëmtimit të imazhit të Kosovës dhe të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Për më tepër, është e papranueshme që shpifjet e nje anëtari të Asamblesë Parlamentare të Këshilit të Europës të paraqiten si opinione të vet institucionit, i cili nuk ka të bëjë me raportin e cituar.

Është e qartë se dikush dëshiron të pengoj Kryeministrin Hashim Thaçi pas zgjedhjeve parlamentare, në të cilat qytetarët e Kosovës, në mënyrë të qartë dhe masive i dhanë besimin për të vazhduar programin zhvillimor dhe qeverisjen e vendit tonë.

Veprimet e tilla të ulta dhe bizare, nga njerëz pa asnjë kredibilitet moral, mund të jenë në shërbim vetëm të qarqeve të caktura që nuk ia duan të mirën Kosovës dhe qytetarëve të saj.

Opinioni i gjërë vendor dhe ndërkombëtar tashmë e di fare mirë se Dik Marti që nga fillimi, pa u mbështetur në asnjë fakt dhe argument, ka qenë paragjykues dhe i vendosur që të raportojë në favor të qëndrimeve që ka shprehur bashkëpunëtorja dhe mikja e tij Karla Del Ponte dhe Qeveria e politikanët e Republikës së Serbisë.

Por, publikimi i qëndrimeve të tilla paragjykuese dhe denoncuese, pa u mbështetur në asnjë fakt dhe argument, nuk përkon me etikën profesionale që do të duhej ta kishte gazeta “The Guardian”.

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kryeministri Hashim Thaçi do të ndërmarrin të gjithë hapat dhe

veprimet e nevojshme për të kundërshtuar shpifjet e Dik Martit, duke përfshirë edhe rrugët ligjore dhe politike.
As qytetarët e Republikës së Kosovës dhe as opinioni i gjërë ndërkombëtar, nuk do të bijnë pre e shpifjeve qëllimkëqija të kundërshtarëve të pavarësisë dhe sovranitetit të vendit tonë dhe në asnjë mënyrë nuk do të lejojnë që matrapazët e porositur të njollosin luftën e pastër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe sakrificën e të gjithë qytetarëve të vendit tonë. Qeveria e Republikës së Kosovës i bën thirrje të gjitha shteteve anëtare të Këshillit të Evropës që të kundërshtojnë fuqishëm këtë raport shpifës dhe tendencioz dhe të mos rreshtohen në anën e atyre që me çdo kusht duan ta pengojnë stabilitetin, progresin dhe qeverisjen e mirë në Republikën e Kosovës.

***

Draft raporti nga raporteri i Këshillit të Evropës, Dick Marty që pretendon se kryeministri në largim Hashim Thaçi dikur ka drejtuar një rrjet të krimit të organizuar që trafikonte organe njerëzore të marra nga të burgosurit e vrarë dhe se kjo tregti ka filluar kur ai ishte udhëheqës politik në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës në fund të viteve 1990 vlerësohet si e pabazë edhe nga kundërshtarët politik të Thaçit.

Përveç Qeverisë së Kosovës që e ka vlerësuar si të pabazë draft raportin evropian, edhe zyrtarë të partive politike e denoncuan atë si një goditje kundër përpjekjeve për pavarësinë e Kosovës, e cila ka një popullsi kryesisht shqiptare.

Sekretari i përgjithshëm i AAK-së, Burim Ramadani ka vlerësuar se sa i përket luftës së UÇK-së, akuzat janë të papranueshme.

"Shqiptarët në Kosovë luftuan për liri dhe të mos përfitojnë nga unaza kriminale", ka thënë ai. Kreu i Social Demokratëve, Agim Çeku, njëherësh komandant i UÇK gjatë luftës 1998-1999,

fajësoi Beogradin për këto akuza.

"Çdo akuzë kundër UÇK-së vjen nga Serbia apo ndihmues të saj", tha Çeku për Reuters duke shtuar se raporti "është vetëm një përpjekje për të njollos luftën dhe fitoren e kosovarëve".

Ndryshe, akuzat e tilla bëhen në një raport nga reporteri i Këshillit të Evropës, Dick Marty. Thaçi akuzohet se dikur ka drejtuar një rrjet të krimit të organizuar që trafikonte organe njerëzore të marra nga të burgosurit e vrarë. Raporti pretendon se kjo tregti ka filluar kur zoti Thaçi ishte udhëheqës politik në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës në fund të viteve 1990.

Raporti i Dick Marty-t, që e quan Thaçin si kreun e një grupi shqiptarësh "në formë mafie" përgjegjës për

kontrabandën e armëve, drogës dhe organeve njerëzore nëpër Evropën Lindore. Thaçi është identifikuar si "bosi" i një rrjeti që ka filluar të vërë në veprim reketet e tij kriminale në prag të luftës së vitit 1999 në Kosovë, dhe i cili ka ruajtur ndikimin e tij të fuqishëm mbi qeverinë e vendit që nga atëherë".

Ky raport pritet të diskutohet në Komitetin e Ligjeve dhe të Drejtave të Njeriut në Paris ditën e enjte.

***

Ish Ushtruesi i Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi ka lëshuar sot një deklaratë lidhur me një projekt-raport të Raportuesit të Këshillit të Evropës, Dick Marty.

Në deklaratë thuhet:

Me këtë rast shpreh indinjatën e thellë për këtë projekt-raport absurd të mbushur me trillime të pastra, fakte dhe hamendësi të paqena dhe të pavërtetuara nga drejtësia ndërkombëtare.

Ky projekt-raport nuk është gjë tjetër, pos vazhdim i deklaratave shpifëse dhe të papërgjegjshme të librit të ish-Kryeprokurores së Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës për krime të Luftës në ish-Jugosllavi, zonjës Karla del Ponte. Këto shpifje janë hedhur poshtë nga zëdhënësja e Gjykatës Ndërkombëtare për Krime të Luftës në ish-Jugosllavi, sipas së cilës hetuesit nuk kanë gjetur prova të bazuara për të vërtetuar këto

akuza, si dhe nga ish-zëdhënësja e kryeprokurores del Ponte, e cila i quan deklaratat e saj si të papërgjegjshme, si një inkurajim të ngatërrimit të fakteve me thashethemet dhe si një rrezik për revizionuar ato që kanë ndodhur me të vërtetë.

Shpreh indinjatën time të thellë me faktin që raportuesi i Këshillit të Evropës guxon të zëvendësojë Prokurorinë e cila është shumë më e specializuar dhe ka shumë më tepër mjete ligjore për të vlerësuar rëndësinë e provave të mbledhura.

Ky projekt-raport është qartësisht i njëanshëm dhe përmban edhe deklarata raciste, kur flet për "strukturën klanore" të shoqërisë shqiptare të Kosovës dhe për "mungesën e një shoqërie civile të vërtetë".

Ky projekt-raport përfaqëson përpjekjet e qarqeve të caktuara për të barazuar luftën e drejtë dhe heroike të popullit të Kosovës dhe të Ushtrisë së tij Çlirimtare me masakrat e regjimit serb të Milosheviqit. Tentativat për të ngatërruar viktimat me xhelatin hedhin hije dyshimi për të gjithë aktivitetin dhe paanshmërinë e raportuesit të Këshillit të Evropës. Së fundi, përshëndesim të gjithë nismat ligjore dhe politike të ndërmarra si brenda dhe jashtë Kosovës për të dënuar këto shpifje absurde dhe të padenja, të cilat nuk i kontribuojnë shndërrimit të Ballkanit në një rajon paqeje, stabiliteti dhe sigurie.

***

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës përmes raportuesit Dick Marty riaktualizon çështjen e "shtëpisë së verdhë" duke kërkuar hetime, ndonëse hetimet paraprake nuk kanë dhënë prova që do të mbështetnin akuzat e Karla del Pontes të bëra publike në librin aurobiografik të saj "Lufta ime"! Qëllimi prandaj është politik! KMDLNJ mendon se ky raportues i autorizuar nga Asambleja Parlamentare i Këshillit të Evropës po përpiqet që përmes këtij dokumenti në formë të raportit të atakojë në shumë adresa politike brenda dhe jashtë Kosovës duke i kompromettuar ato.

Në një komunikatë të KMDLNJ-së thuhet se "raporti është i mbushur me konstatime ofenduese, denigruese, linçuese dhe raciste për politikën e Kosovës dhe politikanët e saj". "Raporti është i drejtuar kryesisht kundër ish UÇK së dhe drejtuesve të saj, politik dhe ushtarak! Raporti në fjalë nuk amniston asnjë politikan kosovar, nuk amniston asnjë forcë politike dhe nuk amniston qytetarë të Kosovës dhe të Shqipërisë. Raporti i amniston kriminelët e vërtetë".

KMDLNJ mendon se drejtësia ndërkombëtare dhe sidomos sistemi kontinental Europian është vënë në lajthitje. Ky zyrtar, prokuror me profesion (nëse ka

fakte) duhet të ofrojë prova para Prokurorisë Speciale të Kosovës. Gjithashtu, nëse provat e tij kundër ish UÇK së dhe drejtuesve të saj tregohen të qëndrueshme atëherë duhet të paditet edhe ish kryeprokurorja e Tribunalit të Hagës, znj. Karla del Ponte për shkak të mëshehjes së veprave kriminale.

KMDLNJ ka kërkuar dhe kërkon që të hetohen të gjithë ata që janë përgjegjës për krime lufte dhe krime kundër civilëve si dhe ata që janë përgjegjës për zhdukjen e civilëve. Aktualisht llogariten si të pagjetur 1823 persona të të gjitha nacionaliteteve ndërsa pjesa dërmuese e tyre janë shqiptarë.

Zbardhja e fatit për personat e pagjetur nuk duhet të politizohet apo të ngjyroset me përkatësi etnike por duhet të trajtohet ekskluzivisht nga pozitat e të drejtave të njeriut, thuhet në komunikatë.

***

Organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, shprehin indinjatën e thellë për raportin absurd, të trilluar e me deklarata raciste, nga raportuesi i Këshillit të Evropës Dik Marti-antishqiptar i përbetuar. Ky raport, është vazhdimësi e deklaratave antishqiptare të ish Kryeprokurores së Tribunalit të Hagës Karla Del Ponte e cila po ashtu me shpifje ordinere u mundua që ta paraqes Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës si organizatë kriminale. Këto shpifje i ka

kundërshtuar edhe ish zëdhënësja e saj si dhe zëdhënësja e tribunalit për krime lufte në ish Jugosllavi, me arsyetimin se hetuesit nuk gjetën asnjë provë të bazuar për vërtetësinë e këtyre akuzave.

Të gjitha këto shpifje, bëhen nga qarqe të caktuara e që kanë për qëllim ta barazojnë krimin e gjenocidin e ushtrisë jugosllave me luftën e lavdishme për liri të popullit e cila udhëhiqej nga UÇK-ja. E tërë kjo luftë e tmerrshme kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është në bashkërendim me politikën Serbo-Ruse e cila po përdoret në dëm të Kosovës, procesit shtetndërtues dhe popullit shqiptar në përgjithësi.

Organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, 'Raportuesit të Këshillit të Evropës' dhe të gjithë atyre që merren me shpifje të ndryshme, ia bëjnë të ditur se:

- UÇK-ja është krenaria jonë kombëtare dhe nuk do të lejojmë kurrë që të shkelet dhe nëpërkëmbet;
- Serbia si shtet okupues ka bërë krime, masakra dhe gjenocid ndaj popullit të shumëvuajtur shqiptar të Kosovës;
- Vendi ynë ka qenë i robëruar dhe për këtë qëllim është bërë luftë çlirimtare ku nga radhët e saj kanë rënë mijëra dëshmorë, kanë mbetur mijëra invalidë dhe janë vrarë mijëra civilë ndërsa nga radhët e pushtuesit janë vrarë me mijëra policë, ushtarë dhe mercenarë;

- UÇK, si ushtri çlirimtare është njohur nga bota demokratike që nga 28 qershori 1998;
- OVL të UÇK-së, si përfaqësuese e luftëtarëve, është anëtare në Konfederatën Evropiane të Veteranëve të Luftës dhe në Federatën Botërore të Veteranëve.

Ne kërkojmë që, të gjithë pjesëtarët e këtij grupi kriminal i cili sponsorohet nga Serbia, për shpifjet e tyre të ndjekjen penalisht nga drejtësia ndërkombëtare si dhe t'iu ndalohet përjetë hyrja në territorin e Republikës së Kosovës. Shpresojmë në reagime sa më konkrete të organeve përgjegjëse në të kundërtën Organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, do të iniciojnë procese që këta kriminelë të gjinden në bankën e të akuzuarve ashtu siç edhe e meritojnë, thuhet ne reagimin organizatave të dala nga lufta e UÇK-së.

***

Ish Raportuesi zviceran i Asamblesë së Këshillit të Evropës, Dick Marty ka paraqitur raportin e tij lidhur me pretendimet se pjesëtarët e UÇK-së paskan keqtrajtuar njerëz dhe paskan trafikuar organe njerëzore. Këto pretendime po shpalosen në vazhdën e dyshimeve dhe përbaltjeve të ngritura nga ish kryeprokurorja e Gjyqit të Hagës, Carla del Ponte. Në mesin e atyre që apostrofohen si protagonistë të veprimeve të tilla çnjerëzore dhe të lidhur me krimin

e organizuar përmendet edhe ish kryeministri i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi.

Lëvizja VETËVENDOSJE! konsideron se pretendimi për ta njollosur UÇK-në, kësaj radhe nëpërmjet Hashim Thaçit, është tendencë e turpshme dhe e papranueshme, që synon ta degradojë në aktivitet të ulët e kriminal luftën çlirimtare të popullit të Kosovës. UÇK-në nuk mund ta njollosë kush përmes Hashim Thaçit, apo cilitdo individ. Pavarësisht faktit që persona të caktuar mund ta kenë keqpërdor luftën fisnike çlirimtare me qëllime të pastra për përfitime personale, kjo nuk mund të përzihet me përpjekjen e popullit tonë për liri, një përpjekje fisnike për të dalë nga prangat e dhunës e për t'i shpëtuar shtypjes e spastrimit etnik.

UÇK-ja i përket sublimimit të luftës dhe sakrificës historike të shqiptarëve për çlirim, 2,500 dëshmorëve të luftës së fundit, familjeve të dëshmorëve, veteranëve e invalidëve të luftës. Kushdo që mund ta ketë keqpërdorur UÇK-në, nuk mund të fshihet pas UÇK-së.

Në anën tjetër, nëse KE-ja dhe BE-ja dyshojnë në Hashim Thaçin, le të mos e shfrytëzojnë atë vetëm sa për ta njollosur UÇK-në. Dhe në vend që ta trajtojnë atë si partnerin e tyre kryesor strategjik në mbajtjen e stabilitetit në kurriz të popullit të Kosovës, le ta vendosin para drejtësisë. Ne druhemi se këto

pretendime të Këshillit të Evropës nuk janë në funksion të drejtësisë, por gjithnjë drejt rritjes së trysnisë ndaj Hashim Thaçit për negociata dhe koncesione të reja me Serbinë për hyrjen e saj sa më të përshpejtuar në BE. Populli i Kosovës nuk ka pse ta paguajë çmimin e makinacioneve të stabilitetit rajonal nëpërmjet figurave politike të lidhura me krimin e organizuar ballkanik. Edhe bastisjet e EULEX-it nëpër ministri dhe shtëpitë luksoze të politikanëve, kurrë nuk u pasuan me drejtësi, por vetëm me presion politik në shkëmbim të dëgjueshmërisë.

Të gjitha këto akuza, të cilat po mbesin vetëm akuza, po bëhen vetëm tash para negociatave me Serbinë. Boris Tadiqi tha se do të bisedojë me Thaçin përderisa nuk janë vërtetuar akuzat e KE-së. Gjithçka po tregon se Tadiqi po ia kthen Hashim Thaçit dashurinë, thuhet në komunikatën për medie të Lëvizjes "Vetëvendosje".

***

Hashim Thaçi, deklaroi se akuzat e raportuesit të Këshillit të Evropës, Dik Marti janë të drejtuara kundër Kosovës, kundër luftës së UÇK-së dhe kundër tij personalisht.

Thaçi kërkoi që populli i Kosovës t'i marrë me qetësi këto raporte, ndërsa u shpreh i gatshëm për të bashkëpunuar për zbardhjen e së vërtetës.
Thaçi tha se do t'i ndjekë mjetet legale dhe politike për të hedhur poshtë përmbajtjen e raportit, duke përfunduar se në fund do të triumfojnë drejtësia dhe e vërteta

***

Hetuesi i Këshillit të Evropës, Dick Marty ka lëshuar sot një raport që është jashtëzakonisht kritikues ndaj lidershipit të Republikës së Kosovës dhe përfshinë akuza për veprimtari kriminale të llojit më të tmerrshëm.
Në vitet e fundit, ka pasur disa raporte të llojit të këtillë nëpër media lidhur me akuza për aktivitete të tilla. Opinioni publik dhe liderët politikë në Kosovë kanë qëndruar pothuajse njëzëshëm mbi kritikat e këtyre raporteve dhe kanë mohuar të ketë pasur aktivitete të tilla", thuhet në një letër Komisionit për të drejtat e njeriut të Asamblesë parlamentare të Këshillit të Evropës, e cila edhe është lexuar, njofton me një komunikatë zyrtari i lartë i PDK-së, Xhavit Haliti. Raporti i Këshillit Evropian, megjithatë, është një çështje plotësisht e ndryshme.
Ka qenë një investigim i plotë nga institute kompetente evropiane, shkruan Haliti dhe shton

se PDK-ja e merr shumë seriozisht raportin e z. Marty. “Ne mohojmë akuzat dhe pretendimet e paraqitura në raport.

Megjithatë, ne mbështesim Kosovën si shtet evropian dhe e shohim të ardhmen e Kosovës, askund tjetër përveç si anëtare e BE-së. Kjo nënkupton që Kosova duhet të jetë e rrënjosur në sundimin e ligjit. Duhet të jetë një shtet me agjenci kompetente ligjore dhe penale. Për këtë arsye, ne në PDK i bashkohemi Dick Martyt në thirrjen për një hetim kompetent ndërkombëtar mbi pretendimet dhe akuzat e bëra në raportin e Këshillit të Evropës. Ne kërkojmë bashkëpunim të plotë të autoriteteve kosovare në një hetim të tillë. Ne kërkojmë mbështetjen nga BE-ja, SHBA-ja dhe shtetet tjera në këtë përpjekje.

Kërkojmë që, në këtë kohë kritike të zhvillimit të Kosovës si shtet i pavarur, bota të mbajë dhe ndalojë paragjykimin dhe vlerësimin mbi Kosovën dhe udhëheqësit e saj, përderisa një hetim i plotë, i besueshëm dhe i mbështetur ndërkombëtarisht të përfundojë”, thuhet në deklaratën e Xhavit Halitit.

Raporti i cili u publikua këto ditë me akuza dhe shpifje të rënda kundër UÇK-së dhe kryeministrit të Kosovës Hashim Thaqit , është i pa vërtet dhe pa baza faktike. Në këtë raport Dick Marty tregon qartë antipatinë e tij kosovare dhe keqdashjen për popullin shqiptarë në përgjithësi dhe atë kosovarë në veçanti.

Ky raport sipas PSHDK-së është vazhdimësi e "pjellës" së deklaratave skandaloze të ish Kryeprokurores së Hagës, mikës së ngushtë të Dick Martyt, zonjës Carla Del Ponte e cila ndonëse për vite të tëra u mundua që të paraqes Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës si organizatë kriminelë, megjithatë nuk ia arriti.

PSHDK pohon se UÇK-ja dhe prijësit e saj kanë bërë luftë të drejtë, të lavdishme dhe të pastër ku bashkë me ndihmën e miqve ndërkombëtarë, kanë çliruar popullin e Kosovës nga robëria, maltretimet, burgosjet, vrasjet dhe masakrimet e pushtuesit serbë. "Ushtria Çlirimtare e Kosovës, doli në mbrojtje të popullit të saj, në kohën kur makineria serbe tentonte të shfaroste popullin e Kosovës. Askush nuk mundët të njollos luftën fisnike të UÇK-së dhe as të nëpërkëmbë gjakun e shumë të rinjve e të rejave, pleq e fëmijëve të pafajshëm që u vranë për lirinë e këtij vendi", thuhet në reagimin e PSHDK-së.

Partia Shqiptare Demokristiane si mike aleate e shumë shteteve ndërkombëtare kërkon që të ndaloj shpifjet dhe trillimet e pa argumentuara nga persona të cilët nuk ia dëshirojnë të mirën Kosovës dhe popullit të saj.

***

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, me

vëmendje ka shqyrtuar Projekt-Rezolutën e Komisionit të Çështjeve Ligjore dhe të Drejtave të Njeriut të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës të përgatitur nga raportuesi, Dik Marti. Pas shqyrtimit të gjithanshëm, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës del me këtë DEKLARATË:

Raportin e përgatitur nga raportuesi Dik Marti, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës e konsideron pamflet të konstruktuar dhe tendencioz me qëllime të qarta anti-shqiptare ku në fokus është përbaltja, degradimi e kriminalizimi i luftës çlirimtare të popullit shqiptar për liri e pavarësi.

Dik Marti që prej kohësh njihet për qëndrimet e tija kundër pavarësisë së Kosovës dhe me paraqitjet e deklarimet e tij të shprehura në raport me Kosovën, ka qenë një zë i artikuluar i regjimit të Milloshevqit në perëndim.

Dik Marti, në raportin e tij të gatuar me thashetheme, me insinuata, me trillime e të pavërteta, i ka dhënë për detyrë vetes që para opinionit ndërkombëtar, ish-udhëheqësit e UÇK-së t'i paraqes edhe si tregtarë të organeve njerëzore.

Të gjitha këto akuza për ne nuk janë ta pa njohura, ngase që herët i ka lansuar politika zyrtare e Beogradit që nga koha e regjimit kriminal të Millosheviqit, që qe munduar ta njolloste luftën tonë për liri.

Mirëpo, për ne është e habitshme që një qytetar i një vendi të lirë e demokratik të bie pre e qarqeve shoviniste serbe, të cilat siç dihet, bën gjenocid të organizuar në Bosnjë e Hercegovinë, në Kroaci e në Kosovë.

Dik Marti me raportin e tij në mënyrë të paskrupull mundohet që të barazoj xhelatin me viktimën, mirëpo një gjë të tillë jemi më së të bindur që nuk do e arrij, ngase dihet se populli shqiptar, UÇK-ja dhe udhëheqësit e saj bënë luftë çlirimtare përse gjeten edhe përkrahjen e faktorin relevant ndërkombëtarë.

Për akuzuat e Dik Martit, për të ashtuquajturën shtëpia e verdh, janë bërë hetime nga hetuesit e UNMIK-ut dhe të Tribunalit të Hagës, dhe në të dy rastet, në mungesë provash, ato janë ndërpre. Andaj, kokëfortësinë e Dik Martit për të vazhduar misionin e tij antishqiptar, duhet kuptuar si një qëllim të keq ndaj Kosovës dhe pavarësisë së saj, ndaj Shqipërisë dhe ndaj Kombit Shqiptar në tërësi. Një raport i mbushur me shpifje e gënjeshtra, të cilat janë riciklim i propagandës së vazhdueshme të qarqeve të caktuara që nuk ia duan të mirën Kosovës dhe qytetarëve të saj dhe që tenton të njollos të gjithë shqiptarët në rajon, nuk mund të jetë tjetër veçse edhe një dështim i radhës. Mirëpo, si të tillë, institucionet tona duhet ti qasen me plot seriozitet e përgjegjësi, ngase, përpos efektit propagandistik, s'ka

dyshim se tenton të dëmtoj kredibilitetin e Kosovës dhe të lidershpit të saj në arenën ndërkombëtar. Andaj, Kryesia e BIK kërkon nga të gjitha institucione e vendit që në bashkëpunim me ekspert të fushave përkatëse, sa më parë në mënyrë profesionale e të argumentuar para opinionit kombëtarë e ndërkombëtar të hidhen poshtë akuzat e Dik Martit, dhe në asnjë mënyrë mos të lejojnë tentativat të tilla me qëllim degradimin e luftës çlirimtare të popullit tonë.

***

"E kuptojmë së çdo individ mund të ketë mendime të pavarura, por kur përfaqëson institucione me karakter vlerësues çdo kush duhet të lirohet nga konceptet dhe mendimet individuale që mund të ndikojnë në përmbajtjen e vlerësimit që ai vlerësim të jetë i paanshëm dhe i drejt", thuhet në reagimin e Komisionit Qeveritar për Persona të Pagjetur-Zhdukur.

Më tutje, ky komision thotë se Marti si moto dhe mbështetje kryesore ka pas librin-pamflet të ish kryeprokurores së Tribunalit të Hagës për Krime Lufte në ish- Jugosllavi, Karla del Ponte. "Në librin e Del Pontes bëhet një përshkrim i pabazuar pa asnjë argument për luftën e UÇK-së me etiketime për trafikim të organeve njerëzore, ku

citohet 'shtëpia e verdhë' në Shqipëri. Ato përshkrime të pabazuara kanë për qëllim denigrimin, etiketimin për gjëja "keqpërdorimin e UÇK-së, luftës çlirimtare të popullit shqiptar në Kosovë, si dhe inkriminim e një shteti të pavarur – Shqipërisë", i cili shtet i hapi dyert për të shpëtuar popullin shqiptar nga terrori dhe ndjekjen që bëri policia dhe ushtria serbe". Në këtë kontekst, Komisioni Qeveritar për Persona të Pagjetur-Zhdukur i Republikës së Kosovës ka shtruar pyetjen se ku ishte zonja Del Ponte kur kishte detyrën e kryeprokurores dhe pse nuk ndërmori ndonjë hap për të ndriçuar këto ndryshime, por gjeti formën përmes një libri anal të denigrojë, të etiketojë një popull, një ushtri çlirimtare që iu imponua dhe u detyrua të mbrojë qenien e vet.

"Në librin e Del Pontes, përmenden masakrat, përmenden të zhdukurit, por harrohet se kush mban përgjegjësi për masakra dhe për zhdukjet që bënë ushtria dhe policia serbe, si dhe forcat paramilitare serbe që vepronin me bekimin e institucioneve serbe".

Më tutje, sqarohet se edhe pse në raport përmenden personat e zhdukur, të cilët janë 1823 persona, që aktualisht nuk dihet së paku për eshtrat e tyre, nuk kërkohen rrugët që zgjedhin çështjen e ndriçimit të fatit të tyre.

Komisioni Qeveritar për Persona të Pagjetur-Zhdukur i Republikës së Kosovës thotë se nuk pretendon që krimet të fshihen, por kërkon që të ndriçohen masakrat si Reçaku, Meja, Krusha e Madhe, Krusha e Vogël, Kralani, Qyshku, Rrezalla, Shavarinat e Qirezit, Studime, Lubeniqi, e të tjera, ku me dhjetëra e qindra civilë të pambrojtur janë masakruar dhe trupat e tyre janë bartur në varrezat masive anekënd Serbisë, për t'u fshehur dhe për t'u zhdukur gjurmët e krimeve.

"Bartësit e aktiviteteve kriminale kanë qenë strukturat institucionale të organizuara në pushtet, ushtri dhe polici. Shumë kriminel lirshëm enden në Serbi, mbase edhe ushtrojnë funksione ne hierarkinë shtetërore dhe çmohen si heronj të popullit. Z. Marti ka pasur mundësinë që të pyes, se a kemi shënime për bartësit e aktiviteteve kriminale, se a kemi dosje, ku janë dëshmitarët të cilët i kanë para me sytë e vet duke u masakruar civilë të paarmatosur, duke iu masakruar të afërmit e tyre", ka theksuar Komisioni Qeveritar për Persona të Pagjetur-Zhdukur.

Ky institucion thotë se Marti gjen kohë të etiketojë, të akuzojë, luftëtarët që u detyruan t'i rrokin armët për ta mbrojtur popullin e vet, për të mbrojtur shtëpitë e veta, për ta mbrojtur Kosovën që u gjakos nga nacionalfashizmi serb, ndërsa nuk pyet se kush e mban dhe ku gjendet krimineli Mladiç, i cili para syve të ndërkombëtarëve urdhëroi masakrimin e mbi 7

mijë personave në Srebenicë, me kriterin e vetëm që të jenë meshkuj.

Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur, me mbështetjen edhe të Shoqatave të Familjeve të Personave të Zhdukur, kërkon dhe pret nga faktori ndërkombëtar dhe nga individë që përfaqësojnë institucionet ndërkombëtare që të bëhet trysni në Beogradin zyrtar që të tregojë se ku gjenden trupat e të masakruarve në Kosovë. Madje t'i kushtëzohet Serbisë çdo hapje për integrim me hapjen e arkivave ushtarake dhe policore, dhe të nxjerrë para organeve të drejtësisë përgjegjësit e krimeve dhe ata të dënohen në vendin ku kanë kryer krimet, që do të ishte një satisfaksion për ata që pësuan dhe pasardhësit e tyre.

Përderisa ne shqiptarët, menjëherë pas përfundimit të luftës në Kosovë, nuk ngritëm padi kundër Serbisë për gjenocid dhe krime lufte në Kosovë, tani një gjë të tillë e bëjnë serbët kundër ne shqiptarëve, edhe përmes lobit të tyre shumë të fuqishëm në Zvicër, fillimisht përmes librit të ish Kryeprokurores së Tribunalit të Hagës, Zonjës Karla Del Ponte, dhe tani edhe përmes Raportit të Zotit Dik Marti në Këshillin e Evropës.

Publikisht kemi deklaruar se, Fronti Demokratik i Bashkimit Kombëtar (FDBK) ka arritur që të fusë në dorë një hartë origjinale të një varreze masive me

shqiptarë të vrarë gjatë luftës së Kosovës dhe se në këtë varrezë, vendndodhjen e së cilës edhe e kemi zbuluar, janë të varrosur mbi 150 shqiptarë të Kosovës.

Gjithashtu kemi deklaruar se FDBK e ka mundësinë që, përmes atyre djemve e vashave shqiptare të ish Sigurimit Kombëtar Shqiptar (SKSH) të ish FBKSH-së, të cilët na e kanë dhënë këtë hartë origjinale, të sigurojë edhe 9 (nëntë) harta të tjera origjinale. Përmes kësaj deklarate publike, të publikuar në korrik 2010, kemi pritur edhe përkrahjen financiare të Qeverisë së Prishtinës dhe pse jo edhe të Qeverisë së Tiranës, si dhe edhe të biznesmenëve shqiptarë, gjë kjo që jo vetëm që nuk ndodhi por përkundrazi… Konsiderojmë se, edhe tani nuk jemi vonë që ta realizojmë këtë projekt kombëtar dhe botë demokratike t'i tregojmë se kush ka qenë xhelati dhe kush ka qenë viktima, si dhe të kërkojmë që të mos barazohet xhelati me viktimën.

Fronti Demokratik i Bashkimit Kombëtar (FDBK) konsideron që, përderisa kundër Zotit Hashim Thaçi dhe grupit të tij shumë shpejt do të fillojnë hetimet nga ndërkombëtarët, jo vetëm që nuk duhet të jetë Kryeministër i Republikës së Kosovës, por do të duhet që ai dhe të tjerët si ai, që akuzohen, të mos jenë as deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në situatat e krijuara në Republikën e Kosovës, FDBK gjithashtu konsideron që, në Republikën e Kosovës duhet të krijohet vetëm një Qeveri Teknike, e cila do të duhej të përgatisë gjithë infrastrukturën ligjore për zhvillimin e zgjedhjeve të lira e demokratike, zgjedhje këto që do të duhej të mbaheshin më së voni gjatë nëntorit të vitit të ardhshëm.

***

Radio Televizioni i Kosovës sjell rrëfimin ekskluziv të dëshmitarit të cilit i ishin ofruar shuma të mëdha parash në këmbim të deklaratës për të ashtuquajturën "Shtëpi e Verdhë". E dëgjuar vetëm në prokurori, dëshmia e tij sjell detaje të takimeve me Igor Jucinacin, i dyshuar dhe i arrestuar në qershor të 2009-tës, dhe i liruar në shkurt të këtij viti nga një gjyqtar ndërkombëtar.

Një dëshmitar ka thënë për RTK se Igor Juçinac, i ka ofruar shuma të mëdha të parave që të deklarojë rrejshëm ndaj rastit "shtëpia e verdhë", të cilën ofertë nuk e ka pranuar dhe se e ka paraqitur në polici. Dëshmitari ka thënë se dëshmia e tij kurrë nuk është marrë parasysh nga prokuroria.

Policia e Kosovës kishte arrestuar vitin e kaluar Igor Juçinac dhe dy serbë tjerë, nën dyshimin se kanë kryer vepra kriminale, duke ofruar shuma të mëdha parash, më shumë se 100 mijë euro për të gjithë ata

që bëhen dëshmitarë të aferës rreth marrjes dhe trafikimit të organeve njerëzore nga ushtarët e UÇK-së gjatë luftës në Kosovë. Por të arrestuarit, janë liruar gjatë vitit 2010 nga një gjykatës ndërkombëtar, me arsyetimin se nuk ka prova të mjaftueshme në akuzën ndaj të dyshuarve.

Dëshmitari i RTK-së deklaroi se në takim Igori i ka thënë se ”kanë të bëjnë me një biznes që do të përfitojnë shumë, dhe e ka pyetur se për çfarë biznesi bëhet fjalë, Igori i është përgjigjur se vinë disa persona nga Beogradi, që të kërkojnë një deklaratë nga ai, dhe duhet të thotë atë që të thonë ata, pamarre parasysh nëse di diçka apo nuk di, dhe i ka përmendur “shtëpinë e verdhë”, të cilën fjalë thotë se e ka dëgjua për herë të parë nga ai”.

Dëshmitari pohoi se së pari i ka ofruar 30 mijë euro për deklaratën e rrejshme, herën e dytë 70 mijë dhe herën e tretë 100 mijë euro, të cilat para nuk i ka pranuar.

Dëshmitari i RTK-së dhe disa dëshmitarë të tjerë, nga të cilët u munduan të blejnë deklarata të rrejshme, nuk u morën kurrë parasysh nga prokurorët dhe gjykatësit që u morën më lëndën e serbëve të akuzuar për këtë krim.

***

Edhe organizatat joqeveritare në vend kanë reaguar ndaj raportit të raportuesit të Këshillit të Evropës, Dick Marty, duke pohuar se është i ndërtuar në hamendje, paragjykime dhe në të pavërteta, që kanë për qëllim degradimin e vlerave të Ushtrisë Çlirimtare, si dhe të ndikojnë në rrjedhat politike nëpër të cilat po kalon Kosova.
Përmes një deklarate për media 200 organizata joqeveritare, me rreth 2000 anëtar të bashkuara në 'koalicionin për demokraci' i kanë bërë thirrje çdo instance vendore dhe ndërkombëtare që ndaj rastit në fjalë të zhvillohen hetime të menjëhershme dhe të pavarura.
Shoqëria civile thuhet se mbetet e përkushtuar në mbrojtje të se vërtetës, pavarësisht cila është ajo.
Kjo deklaratë u tha se do t'i dërgohet edhe Këshillit të Evropës.

***

Presidenti në detyrë, Jakup Krasniqi, ka vlerësuar të martën se akuzat për trafikim të organeve njerëzore, me trafikim të drogës dhe me kontrabandim të armëve nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, janë të pabaza dhe të padëshmuara, kurse vetë raporti është politikisht i njëanshëm, tendencioz, qëllimkeq dhe me përmbajtje tmerrësisht raciste dhe antishqiptare. Në një shkrim të publikuar të martën Krasniqi thotë

se ky raport është vazhdim i deklaratave shpifëse dhe të papërgjegjshme të ish-kryeprokurores së Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës për Krime të Luftës në ish Jugosllavi, zonjës Del Ponte, në librin e saj, për të cilat hetuesit nuk kanë gjetur prova të bazuara për t'i vërtetuar këto akuza, njofton Zyra e presidencës.

Ai thotë se ky raport përfaqëson përpjekjet e qarqeve të caktuara antishqiptare për ta barazuar luftën e drejtë dhe heroike të popullit të Kosovës dhe të Ushtrisë së tij Çlirimtare me masakrat e regjimit serb të Milosheviçit. Sipas tij, tentativat për t'i ngatërruar viktimat me xhelatin hedhin hije dyshimi për të gjithë aktivitetin dhe paanshmërinë e raportuesit të Këshillit të Evropës.

"Populli i Kosovës dhe luftëtarët e tij janë ndier tepër të fyer dhe të indinjuar nga spektaklet e ulëta, të luajtura turpshëm, kësaj radhe jo në librushka të zonjës Ponte, por në foltoren e një institucioni të lartë dhe shumë të nderuar evropian, në Këshillin e Evropës. Anëtari i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, zoti Dick Marty, një njeri me ndjenja të pakontrolluara urrejtjeje ndaj Kosovës së lirë dhe pavarësisë së saj, që na asocionon në disa qarqe të pakta antikosovare në botë, po luan një dramë të rrezikshme dhe të pandershme mbi kurrizin e një populli liridashës, paqësor dhe të shumëvuajtur. Populli i Kosovës asnjëherë nuk ka bërë luftëra

pushtuese, asnjëherë nuk i ka rënë në qafë kujt. Popullsia serbe, gjithmonë ka qenë komunitet pakicë në Kosovë, por kurrë nuk është dëmtuar nga shumica shqiptare dhe aq më pak nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, e cila ka kontrolluar gjatë luftës territore të tëra me popullsi serbe, por civilët nuk kanë pësuar asnjë dëm të vetëm. Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk do t'i bënte kurrë veprimet që i përshkruhen në raport, sepse ishte betuar në pastërtinë e luftës së saj çlirimtare, sepse lufta e saj kishte për qëllim idealet e popullit që e lindi, çlirimin e Kosovës, vendosjen e paqes, ndërtimin e rendit demokratik dhe jo ambiciet profitere, sepse ajo respektonte ligjet humane të luftës, sepse mishëronte traditën dhe kulturën e popullit të vet që nga antika, sepse ashtu do ta dënonte veten e saj dhe aspiratat që i përfaqësonte. Së fundi duhet thënë se Ushtria Çlirimtare e Kosovës as mund t'i kishte kushtet teknike për ta realizuar një veprim të tillë të shëmtuar. Në emër të drejtësisë së luftës së shenjtë të Kosovës, të ish-ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare dhe të institucioneve dhe të qytetarëve që përfaqësoj, në emër të së drejtës dhe të së vërtetës, them me bindje dhe përgjegjësi se pandehmat e zotit Dick Marty, për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, në Raportin e tij të fabrikuar pa asnjë fakt, kurrë nuk do të mund të argumentohen, sepse nuk janë të vërteta. Njerëzit që apostrofohen në

raportin famoz dhe denigrues, të zotit Dick Marty, janë në krye të shtetit modern dhe demokratik të Kosovës, i cili komuniteteve pakicë, duke e përfshirë në radhë të parë komunitetin serb, u ka siguruar me Kushtetutë, me ligj dhe në praktikë mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive civile dhe njerëzore, demokratike e kombëtare, përtej standardeve më të avancuara ndërkombëtare", tha Krasniqi.

Sipas tij, Kosova, deri në qershorin e vitit 1999, ka kërkuar nga vendet e Demokracisë Perëndimore ta shpëtonin nga politika shfarosëse serbe e Milosheviçit, e cila asnjëherë nuk u dënua nga Dick Marty, përkundrazi u mbështet, kurse tani është e detyruar të kërkojë ta mbrojnë nga njeriu i veshur me petkun e anëtarit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

***

Ish Ministri i Integrimit Europian, Besim Beqaj në deklaratë për Televizionit e Zvicrës, TSR ka deklaruar se akuzat e raportuesit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës Dik Marti janë akuza të pavërteta dhe se janë të orkestruara nga Serbia.

"Është shume e pikëllueshme te dëgjosh se një diplomat i larte si Z. Marty lanson ne emër të një institucioni zyrtare këso lloj akuzash te pavërteta. Ne jemi shume te vetëdijshëm se këto thashetheme janë

te orkestruara nga Serbia. Nuk janë fakte nëse dikush pohon se ka dëgjuar diçka. Faktet duhen të përmbajnë elemente konkrete. Nganjëherë në politikë zgjedhja e momentit për të lansuar një atak është shume e rëndësishme, kurse për neve ky moment është krucial për shkak se Kosova është në proces të krijimit të qeverisë pas zgjedhjeve të porsa përfunduara. Ky raport është planifikuar pikërisht ne kohen e zgjedhjeve për ta prishur imazhin e Kosovës. Në mirëpresim çfarëdo lloj hetimesh me një kusht që ato të jene të mbështetura në fakte, kurse ata qe ofrojnë pretendime te rrejshme duhet të përgjigjen përpara ligjit “, ka thënë ministri Beqaj.

***

Aleanca Kosovare e Biznesit (AKB) dhe anëtarësia e saj kanë reaguar ndaj raportit të Dik Martit, si sulm ndaj investimeve të huaja në Kosovë dhe raport që ka fyer gjithë kombin shqiptar, NATO-n dhe botën demokratike që ishin në mbështetje të luftës sonë çlirimtare dhe pavarësisë së Kosovës.

Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, gjatë një konference të mërkurën, ka thënë se akuzat e Martit janë një mesazh të keq për investitorët, duke i frikuar ata që mos të vijnë të investojnë në Kosovë.

Ai ka theksuar se raporti i Martit, ka fyer gjithë kombin shqiptar, NATO-n dhe botën demokratike që

ishin në mbështetje të luftës sonë çlirimtare dhe pavarësisë së Kosovës.
I pyetur nga mediat se AKB-ja a ka pas kontakte me organizatat biznesore nëpër vende të ndryshme për të sqaruar këtë situatë, Shahini ka thënë se janë zhvilluar biseda me disa vende për të sqaruar këtë situatë.
Shahini ka theksuar se AKB-ja do të dërgojë edhe një notë proteste në Ambasadën zvicerane.

***

Analisti Shkelzen Maliqi dhe drejtori i KIPRED Krenar Gashi pohuan se raporti i z. Marti nuk do të ndikojë në bisedime pasi ai është spekulativ, ndërsa analisti serb Nenad Radosavleviç, u shpreh skeptik nëse bisedimet e paralajmëruara do të mund të sjellin diçka të mirë për serbët e Kosovës. Këto komente ata i bënë, të premten, në një debat publik me titullin ”Deri në cilën masë do të ndikojë raporti i Dik Martit në dialogun e ardhshëm të Beogradit dhe Prishtinës”, në Qendrën Mediale në Çagllavic.
Analisti Maliqi, tha se krejt kjo është propagandë serbe që ka për qëllim njollosjen e luftës së UÇK-së.
Ndërsa, Krenar Gashi drejtor i KIPRED, tha se raporti i Dik Martit nuk e dëmton pozicionin e Kosovës në bisedat me Beogradin, pasi ato janë përmbledhje akuzash që po dëgjohen tash e dhjetë vite. Megjithatë,

Gashi tha se raporti e ka dëmtuar imazhin e Kosovës në rrafshin ndërkombëtar, sidomos te miqtë e Kosovës në BE.

Në anën tjetër, analisti serb Nenad Radosavleviç, u shpreh skeptik nëse bisedimet e paralajmëruara do të mund të sjellin diçka të mirë për serbët e Kosovës. Ish këshilltari i PSSP-së, kritikoi deklarimet e zv-amabsadorit amerikan në Kosovë, Majk Marfi se raporti i Martit nuk do të ndikojë në raportet Kosovë-SHBA.

"Nuk pajtohem me pohimet e Majkell Marfit se ky raport nuk i dëmton marëdhëniet Kosovë SHBA. Dik Marti nuk është njeri i thjeshtë, ai megjithatë është raportues special i KE-së", ka thënë Radosavleviç.

Ndërkaq, Zhivojin Rakoçeviq, gazetar dhe analist politik u shpreh i dëshpëruar pse analistët shqiptarë dhe mediat po e mbrojnë, apriori, Kryeministrin Thaçi nga akuzat.

***

Ylli Hoxha, ish drejtor ekzekutiv i Klubit për Politikë të Jashtme, ka thënë se është e paqëndrueshme deklarata e kryeministrit në largim, HashimThaçi, se Dick Marty është i ftuar nga ky klub për ta prezantuar raportin e tij në Kosovë.

"Absolutisht është e pavërtetë. Ne jemi të befasuar me këtë deklaratë të kryeministrit, e cila nuk

qëndron” ka thënë Hoxha. “Klubi nuk i ka bërë ndonjë ftesë Martyt që të vijë në Kosovë”.

***

Prokuroria e Shtetit ka kompetencë dhe detyrë kushtetuese dhe ligjore ndjekjen e kryesve të veprave penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare. Në kuadër të saj është themeluar Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, kompetente për të ndjekur edhe kryesit e veprave penale të krimeve të luftës. Kjo prokurori udhëhiqet nga një prokuror i Eulex-it, ndërsa përbëhet nga prokuror vendës dhe prokuror ndërkombëtar, kryesisht nga shtetet e Bashkimit Evropian dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Prokurorët e kësaj prokurorie janë të përzgjedhur nga vendet me sistemet më të mira dhe më kredibile prokuroriale dhe të dyshohet në paanshmërinë, kapacitet dhe profesionalizmin e tyre për të zgjidhur edhe rastet e krimeve të luftës, duke përfshirë edhe rastin lidhur me pohimet në Raportin e Dik Martit është në radhë të parë fyerje për prokuroritë e atyre shteteve.

Prokuroria e Shtetit shpreh kundërshtimin kundër krijimit të opinionit publik për të prezumuar fajësinë e kujtdoqoftë dhe vlerëson se ky është ndikim në organet e drejtësisë dhe shkelje e të drejtave të njeriut. Mund dhe duhet të prezumohet vetëm

pafajësia.

Tribunali Hagës, i themeluar për të gjykuar krimet e luftës në ish Jugosllavi, në praktikën e deritashme, ka liruar persona të akuzuar për këto krime dhe asnjë prokuror dhe as ish prokurorët që kanë vepruar pranë këtij tribunali nuk kanë të drejtë që mossukseset e tyre për t'i dëshmuar akuzat e ngritura, t`ia atribuojnë vendimeve të gjykatave. Aq më parë ata nuk kanë të drejtë të prejudikojnë se sistemet gjyqësore vendëse nuk kanë gatishmëri, kompetencë, profesionalizëm dhe se nuk janë të paanshme për të gjykuar krimet e luftës. Pohimet e këtilla të ish Kryeprokurores së Tribunalit të Hagës janë në kundërshtim me çdo etikë prokuroriale.

Prokuroria e Shtetit përkujton se, prokurorët e Tribunalit të Hagës në bashkëpunim me Prokurorinë e Përgjithshme të Shqipërisë, me ekspertët e tribunalit dhe me ata shqiptarë, kanë zhvilluar një hetim që ka rezultuar me mosgjetjen e provave për pohimet lidhur me trafikimin me organe njerëzore, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Prokuroria e Shtetit, gjithashtu përkujton se vetëm prokuroritë, si organe kompetente të një shteti apo ato të themeluara për të vepruar pran tribunaleve apo gjykatave janë kompetente për të akuzuar një person për kryerjen e një shkeljeje penale dhe se këtë kompetencë nuk e ka askush tjetër. Hetimet e

raportuesve të parlamenteve, Prokuroria e Shtetit i vlerëson si informata që duhet dërguar organeve kompetente për ndjekje penale.

Prokuroria e Shtetit kërkon nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, që të gjitha materialet e siguruara nga deputeti i saj Dik Marti t`ia dërgojë në kompetencë Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

Prokuroria e Shtetit siguron Asamblenë se pohimet nga Raporti i raportuesit të saj, do të vlerësohen si informata shumë serioze, të mbledhura nga një parlamentar i saj dhe se do të bashkëpunoj ngushtë me të gjithë faktorët relevant për hetimin e drejtë dhe të paanshëm të informatave dhe të të gjitha pohimeve të prezantuara në raport.

Ish Kryeministri në largim i Kosovës, Hashim Thaçi është duke planifikuar ta padis të dërguarin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme të këshillit të Evropës, Dick Marty, i cili në raportin e tij ka shkruar se të burgosur civilë janë vrarë pasi u janë marrë veshkat e tyre nga ish-UÇK-së.

Lajmin për përgatitjen e padisë e ka konfirmuar për agjencinë e Associated Press një zyrtar i lartë i Kosovës, të enjten, duke dashur të mbetet të mos identifikohet për shkak të ndjeshmërisë së çështjes.

Sipas këtij zyrtari, Thaçi ka kontaktuar avokatët për të ndjekur me padi për shpifje Martyn.

Raporti i Marty tronditi Kosovën sipas të cilit të paraburgosurve civilë të UÇK-së u janë shitur organet e tyre në tregun e zi dhe dokumenti sugjeron se Thaçi ishte dikur "boss"-i një i krimit dhe qëndronte pas tregtisë së frikshme.

Thaçi ishte kreu politik i UÇK-së e cila luftoi në vitet 1998-1999 për pavarësi nga Serbia. Partia e tij fitoi zgjedhjet në Kosovë, të parat që nga koha kur vendi shpalli pavarësinë nga Serbia në vitin 2008. Thaçi deri më tash nuk është paraqitur në publik, për ta komentuar raportin.

Hetuesi i BE-së pretendon se organet u hoqën të zënëve rob në Shqipërinë e veriut. Por, misioni i BE-së në Kosovë, EULEX bëri thirrje të mërkurën që të dilet me prova konkrete për këtë rast.

***

Ish Kryeministri i Kosovës ne doreheqje, Hashim Thaci ka reaguar sërish ndaj akuzave të raportuesit Dick Marty, duke i cilësuar ato si të motivuara politikisht.

Në një intervistë për agjencinë e lajmeve "Reuters", Thaci është shprehur se akuzat në fjalë kanë si qëllim dëmtimin e procesit të shtetformimit të Kosovës.

"Qëllimet e këtij raporti janë dëmtimi i imazhit të Kosovës dhe shqiptarëve në rajon, ngadalësimi i njohjeve të pavarësisë, pengimi i rinisjes së dialogut

Kosovë-Serbi dhe dëmtimi i procesit të zgjedhjeve të 12 dhjetorit", ka deklaruar Thaci.
Ai ka paralajmëruar raportuesin e KiE se do ta padisë për shpifjet që ka publikuar në dëm të tij dhe gjithë Kosovës.
"Marty të përgatitet të gjejë avokatë të mirë për t'i shpëtuar poshtërsive të tij", ka shtuar Thaci, i cili ka kujtuar se akuza të tilla janë hetuar edhe më parë nga OKB.

***

Ish Kryeministri i Kosovës në largim, Hashim Thaçi ka thënë se akuzat se është mafioz dhe trafikant me organe njerëzore janë "propagandë naziste".
Në një intervistë për gazetën londineze The Times, Thaçi ka thënë se në jetën e tij ka pasur tri dëshira. "Dy të parat – çlirimi dhe pavarësia e Kosovës më janë plotësuar. Dëshira e tretë është që shteti të jetë anëtare e NATO-s dhe BE-së, dëshirë të cilën njerëzit si Dick Marty, autori i raportit në Këshillin e Evropës, nuk mund të ma ndalojnë", ka thënë Thaçi.
Sipas tij, zvicerani Marty është një "apologjet i rëndom serb", i cili patjetër do të ballafaqohet me drejtësinë për atë që ka bërë.
"Ndoshta Marty është shtetas i një vendi neutral, por nuk besoj se drejtësia do të jetë neutrale ndaj tij", ka thënë Thaçi në intervistën për The Times.

***

Ish Raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian (PE), Ulrike Lunacek ka thënë të martën se situata është bërë më e komplikuar për kryeministrin Hashim Thaçi, tash pas publikimit të raportit të Dick Martyt, por, sipas saj, i mbetet vetë Thaçit të merr vendime.

Në një deklaratë për Radio Dukagjinin ajo ka thënë se Dick Marty duhet që ato fakte, të cilat i përmend, t'ia dërgojë EULEX-it. Ajo pranon se ky raport ka gjasa të ndikojë në imazhin e Kosovës.

Luancek ka bërë thirrje që ky raport mos të ketë ndikim tek procesi i liberalizimit të vizave, duke pohuar se ky proces është teknik dhe do të angazhohet që të mbetet i tillë.

"Do të ishte shumë gabim nëse që në çfarëdo mënyre të ndëshkohej populli i Kosovës vetëm e vetëm për dyshime të supozuara për veprime të politikanëve. Dhe po e potencoj që janë vetëm dyshime dhe të tilla do të mbesin derisa të mos vërtetohen", ka thënë Lunacek për Radio Dukagjinin.

Eurodeputetja austriake po ashtu ka bërë ftesë që të bëhen të gjitha përpjekjet e mundshme që të hetohet çdo keqpërdorim i mundshëm i votës gjatë zgjedhjeve të 12 dhjetorit.

***

Kryeministri në dorëheqje i Kosovës, Hashim Thaçi tha se ai dëshiron një hetim të pavarur për "të larguar mjegullën" rreth akuzave se ai ka udhëhequr një bandë që ka vrarë të burgosurit dhe ka shitur veshkat e tyre.

Thaçi në një intervistë për Associated Press tha se nuk ka "asgjë për të fshehur" dhe u zotua se autoritetet e Kosovës do të jenë "shumë bashkëpunuese" në lidhje me akuzat e bëra në raportin e Këshillit të Evropës të raportuesit Dik Martit se UÇK-ja e udhëhequr nga Hashim Thaçi ka vrarë të burgosurit shqiptarë dhe serbë për t'ua shitur veshkat e tyre në vitin 1999.

"Është një mjegull dhe unë duhet dhe unë do të punoj ta largoj atë", ka thënë Thaçi.

Ai ka thënë se akuzat kanë për qëllim që të minojnë shpalljen e pavarësisë së Kosovës nga Serbia në vitin 2008.

Ai paralajmëroi se dosja do të publikohet se shpejti dhe do të jenë më shokues se raporti i zviceranit. Edhe pse nuk tha se kur do ta bëjë publik këtë dokument, ai tha kur kjo të ndodhë, në të do të figurojnë emrat e njerëzve nga disa subjekte politike kosovare që kanë bashkëpunuar më të.

Pa lakuar asnjë emër, Thaçi tha se këta individ do të skuqen nga ky publikim, ndërsa theksoi se janë po ata që ndihmuan përpilimin e raportit të David Philips.
Në një intervistë për emisionin "Opinion" në TV Klan, të enjten mbrëma, Thaçi tha se zvicerani Marty, vazhdimisht ka qenë një anti-shqiptar dhe pretendimet e tij janë hetuar tre herë nga Tribunali i Hagës, UNIMK-u dhe e EULEX-i, por që nuk është gjetur gjë. Ai tha se për këto raporte, është takuar me hetues të të Tribunalit të Hagës në vitin 2004, nga të cilët është intervistuar, por se nuk është pyetur për trafikimin e organeve.
Nëse, Marty, mendon se duke pas imunitet mund t'i ikë dënimit nga padia, Thaçi ka thënë se do ta pres raportuesin zviceran, derisa ai nuk do të ketë mundësi të fshihet pas imunitetit që ia jep fakti i të qenurit anëtar i Këshillit të Evropës.
Kryeministri në largim tha se raporti kishte për qellim ta godiste gjatë fushatës zgjedhore, por gazeta The Gardian nuk e publikoi atë.

***

Marti gjithashtu ka sugjeruar se Thaçi një kohë ka qenë 'bosi' i nëntokës kriminale në Kosovë.
Zëdhënësja e policisë së EULEX-it, Karim Limdal, tha se "prokuroria i bazon hetimet dhe aktakuzën mbi fakte dhe prova të forta".

Limdal ka thënë se hetimet e Bashkimit Evropian mbi pretendimet se është bërë trafikim i organeve në veri të Shqipërisë, nuk kanë rezultuar me asnjë provë, transmetoi AP.
Po sot, Maja Kocijançiq zëdhënëse e kryediplomates së BE-së, Ketrin Eshton, tha se Brukseli i merr akuzat seriozisht, por e ftoi z. Marti që të dalë me prova.

***

Raporti i fundit i raportuesit për Këshillin e Evropës, Dik Marti, i cili u prezantua sot në Paris, akuzon kryeministrin në dorëheqje të Kosovës, Hashim Thaçi, për udhëheqjen e një mafie që, sipas raportit, është e përfshirë në trafikimin e drogës, organeve njerëzore dhe armëve. A ka EULEX-i informata që mund t'i mbështesin këto akuza?

KRISTINA HERODES

Ne jemi duke shikuar raportin në hollësi dhe nuk duam të bëjmë ndonjë ndërlidhje me askënd. Nëse dikush ka dëshmi konkrete që do t'i mbështesnin akuzat e përmendura në raport, duhet t'iu drejtohet autoriteteve adekuate.

RADIO EVROPA E LIRË

Raporti përmend edhe rastin e Medicus-it. A ka ndonjë ndërlidhje të akuzave ndaj Thaçit dhe ish-

udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me rastin Medicus?

KRISTINA HERODES

Seanca e konfirmimit për rastin e ashtuquajtur "Medicus" nisi të martën në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Gjatë seancës, prokuroria lexoi akuzat dhe faktet e padisë. Pesë nga të pandehurit u deklaruan të pafajshëm; dy të tjerët heshtën, që, sipas ligjit, nënkupton deklarim i pafajësisë.

Seanca e konfirmimit do të vazhdojë më 6 janar të 2011-ës, për shkak të disa mosmarrëveshjeve ligjore që duhet të zgjidhen brenda kësaj kohe.

Janë shtatë të pandehur, të cilët akuzohen për përfshirjen në një rrjet të trafikimit me njerëz, duke rekrutuar, transportuar dhe shfrytëzuar njerëz për zhvendosjen dhe transportimin e pjesëve të trupit; pastaj për keqpërdorim të detyrës nga zyrtarë të lartë, veprime të paligjshme mjekësore dhe procedura të tjera mjekësore, përfshirë zhvendosjen e organeve njerëzore dhe transportimin e tyre.

Ky rast filloi në vitin 2008 dhe në fillim hetohej nga Policia e Kosovës dhe ajo e UNMIK-ut.

RADIO EVROPA E LIRË

Zonja Herodes, EULEX-i ka shqyrtuar çështjen e krimeve të luftës me të ashtuquajturën "Shtëpinë e

Verdhë", që përmendet gjithashtu në raport. A ka dëshmi që flasin për krime të bëra në atë kohë në këtë lokacion?

KRISTINA HERODES

Duhet t'i ndajmë dy hetime: njëri ishte kryer nga Gjykata Ndërkombëtare për Krime të Luftës dhe nuk ka ndërlidhje me padinë lidhur me rastin 'Medicus'. Këto raste janë të ndara.

Hetuesit dhe prokurorët për krime të luftës në EULEX kanë hetuar rastin e ashtuquajtur "Shtëpia e Verdhë", por nuk kanë gjetur dëshmi apo të dhëna që do të na bënin të besojmë se në atë lokacion ka pasur transplantim dhe operime me organe njerëzore. Por, nëse kanë ndodhur lloje të tjera të aktiviteteve kriminale në atë shtëpi, nuk kemi të dhëna për momentin.

RADIO EVROPA E LIRË

Raporti flet gjithashtu për trafikimin me drogë dhe armë. Zyrtarë të lartë të EULEX-it kanë theksuar, ditë më parë, se hetimet lidhur me këtë janë duke vazhduar dhe së shpejti do të ketë rezultate. Kur mund të priten rezultatet?

KRISTINA HERODES

Ka shumë raste lidhur me krimet e luftës që janë duke vazhduar. Është për shembull një rast që ndërlidhet me Shqipërinë e veriut dhe objektet e UÇK-së atje. Është në pritje të gjykimit kryesor dhe ndërlidhet me dy persona që akuzohen të jenë të përfshirë në dy incidente, të cilat kanë ndodhur në objektet e Kuksit dhe të Koha-s në Shqipëri. Rasti ndërlidhet me keqtrajtimet eventuale të personave që janë mbajtur në objektet e UÇK-së në veri të Shqipërisë, gjatë konfliktit të 1999-ës. Mirëpo, as ky rast, deri më sot, nuk ka treguar ndonjë ndërlidhje me rastin e "Shtëpisë së Verdhë".

***

Komandanti i KFOR-it, Erhard Byhler ka thënë se raporti i Dik Martit, i cili akuzon kryeministrin Thaçi për përfshirje në "trafikim me drogë dhe me organet njerëzore", i ka shkaktuar imazh të keq Kosovës.

"Përderisa nuk ka dëshmi mbi tavolinë, për ne është gjithsecili i pafajshëm. Kështu që, në bashkëpunimin tonë nuk ka ndryshuar asgjë. Më vjen keq për dëmet që u janë bërë njerëzve nga ai raport, pasi nga perceptimi që kemi përfituar nga shtypi ndërkombëtar, raporti nuk i kontribuon imazhit të Kosovës", ka theksuar Byhler.

Byhler, gjatë një vizite në Skënderaj, ka thënë se të thënat në raportin e Martit janë thashetheme që dihen vite me radhë.
"Dua të them një gjë, se ne bashkëpunojmë ngushtë me Policinë e Kosovës dhe me EULEX-in, dhe nëse do të kemi dëshmi, ne do t'ua dorëzojmë policisë ato. Mirëpo, derisa nuk ka dëshmi, atëherë vlen pafajshmëria", theksoi Buhler, duke sqaruar se raporti ose është i vërtetë, ose nuk është, dhe "nëse është i vërtetë, atëherë duhet të ketë dëshmi".

***

Misioni i EULEX-it në Kosovë ka kërkuar nga raportuesi i Këshillit të Evropës, Dik Marti që t'ia dërgojë të gjitha të dhënat prokurorëve të BE-së në Prishtinë.
Marti ka hartuar një raport, ku akuzon kryeministrin Thaçi për përfshirje në „trafikimin e drogës dhe të organeve njerëzore", akuza këto të hedhura poshtë nga Thaçi.
"EULEX-i i ka dërguar një letër Martit ku e inkurajon që t'ia ofrojë autoriteteve prokuroriale brenda EULEX-it informacionet ose të dhënat që mund të vënë dritë mbi dyshimet e bëra në raport", i ka thënë agjencisë së lajmeve Reuters, zëdhënësi i EULEX-it, Blerim Krasniqi.

***

Ish Komandanti i KFOR-it, gjermani Erhad Buhler, ka thënë se Dick Marty, raportuesi i Këshillit të Evropës, duhet të paraqet dëshmi rreth raportit të tij skandaloz për Kosovën, ose në të kundërtëai ka thënë se ato janë shpifje, dhe se individët që akuzohen janë të pa fajshëm.

Buhler ka thënë se raporti nuk ka kurrfarë ndikimi në Kosovë, duke e vlerësuar situatën tejet të qetë, dhe ka mohuar se do të ndikoj negativisht në raportet mes Gjermanisë dhe Kosovës.

"Ky raport nuk ka kurrfarë ndikimi në gjendjen në Kosovë, jo vetëm pjesërisht, por mund të them për gjithë territorin e Kosovës. Kosova është e qetë pas zgjedhjeve si kurrë më parë. Sa i përket raportit të Dick Martit unë kam qëndrim dhe kam thënë edhe më herët se duhet të paraqiten dëshmi. Përderisa nuk kemi dëshmi, atëherë të gjitha ato janë shpifje dhe individët të cilët akuzohen janë të pafajshëm deri në atë moment kur nuk kemi dëshmi", ka theksuar Buhler të martën në një vizitë që i ka bërë Gjimnazit "Loyola" në Prizren.

Por komandanti i KFOR ka përsëritur se ky raport i ka bërë dëm imazhit të Kosovës. "Sigurisht që i ka shkaktuar dëm imazhit të Kosovës, por edhe ne sot këtu e pamë se Kosova është ndryshe. Vërtet duhet të punojmë edhe më tepër që të përmirësojmë imazhin

e Kosovës se Kosova nuk është vend i kriminelëve dhe i krimit. Nëse janë bërë krime për këtë duhet të merren institucionet përkatëse. Unë kam besim të plotë se kjo do të ndodh dhe në atë rast duhet të merren vendime të prera dhe të shpejta", ka theksuar Buhler. Për më tepër Buhler ka thënë se ky raport nuk do të ndikoj në raportet mes Gjermanisë dhe Kosovës.

"Nuk do të ketë kurrfarë ndikimi në raportin e Gjermanisë dhe Kosovës. Ajo çfarë duhet të pranojmë është se vërtet po dëmtohet imazhi i Kosovës, para së gjithash tek ata që lexojnë gazeta dhe nuk e njohin Kosovën. Mirëpo në aspektin afatgjatë nuk do të thotë asgjë, sepse Kosova ka përjetuar shumëçka tjetër, shumë gjëra më të këqija, pra kjo është e tejkaluar", ka spikatur Buhler.

Ai ka thënë se gjendje në Kosovë në sferën e sigurisë është stabile dhe se për këtë KFOR po bënë reduktimin e trupave. "Mund të thuhet se vërtet gjendja është stabile dhe për këtë arsye kjo gjendje na mundëson reduktimin e trupave të KFOR-it që jemi duke bërë.

Mirëpo edhe pse gjendja është stabile nuk do të thotë që kjo gjendje është e pakthyeshme dhe për këtë arsye qëndrojmë edhe më tej të gatshëm edhe me forcat mobile. Sinjali është i qartë se situata është e

qetë, mund t'i reduktojmë forcat dhe kjo na bënë të jemi të lumtur", ka shtuar ai.

***

Ish Presidenti i Shqipërisë, Bamir Topi, ka reaguar sot ndaj Projekt-Rezolutës së djeshme të Komisionit të Çështjeve Ligjore dhe të Drejtave të Njeriut të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës të përpirluar nga deputeti Dik Marti.

Në një komunikatë për media, Topi ka "dënuar ashpër të gjitha akuzat e pabazuara në prova konkrete".

Ai i ka quajtur ato "pandehma të endura me një rrjetë thashethemesh, të cilat duken sikur janë të gatuara në kuzhinën e dalëmode të qarqeve të caktuara ultra-nacionaliste, që për fat të keq vazhdojnë të ekzistojnë në Ballkan – në një territor ku kohë pas kohe zbulohen varreza masive të genocidit të pashembullt të forcave serbe të Millosheviçit dhe ku ende strehohen kriminelë lufte të kërkuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Hagës".

"Këto akuza fantazmagorike, shumë herë të ngritura edhe më parë e të hetuara, por asnjëherë të vërtetuara, nuk bëjnë gjë tjetër veçse hedhin baltë mbi Shqipërinë, kombin shqiptar si dhe shtetin e ri shumë-etnik dhe demokratik të Kosovës dhe drejtuesit e tij legjitimë, të certifikuar jo vetëm nga

qytetarët kosovarë, por edhe nga bashkësia ndërkombëtare", ka thënë Topi për të shtua se "akuzat dhe tymnaja e rrezikshme që ato po ngrenë, dëmtojnë e kërcënojnë seriozisht jo vetëm imazhin dhe vlerat e vërteta të kombit shqiptar, por edhe paqen e qëndrueshmërinë afatgjatë të rajonit tonë".

Në deklaratën e presidentit Topi thuhet se institucionet e Shqipërisë kanë qenë gjithmonë bashkëpunuese me institucionet e specializuara ndërkombëtare për të hetuar rreth dyshimeve që ringrihen në Projekt-Rezolutën e përpiluar nga Dik Marti, "i cili e ka bërë të njohur botërisht, prej kohësh, pozicionimin e tij kundër pavarësisë së Kosovës". "Rruga më e mirë për të mbyllur përfundimisht një kapitull të mbushur me akuza të pabazuara, shpifje dhe dashakeqësi, është që të bashkëpunojmë sërish me organet e specializuara të drejtësisë kombëtare dhe ndërkombëtare, edhe pse Gjykata Ndërkombëtare e Krimeve të Luftës, UNMIKU-u, EULEX-i si dhe prokuroritë e vendeve të ndryshme, sado që kanë hetuar me imtësi në të kaluarën, nuk kanë arritur të gjejnë prova bindëse e të mjaftueshme për të vënë ndokënd para drejtësisë", ka thënë Topi. "Duhet patjetër që e vërteta e kulluar të dalë e tëra në dritë ashtu siç ka ndodhur në Kosovën e martirizuar, ku shqiptarët Kosovës kanë ditur të falin, por jo të harrojnë. Kjo në mënyrë që mbi askënd të mos

rishfaqen më hijet e dyshimit, si makthe që na rikujtonë periudhën e trazuar të konflikteve dhe genocideve etnike dhe fetare – të cilat rajoni ynë, i projektuar i gjithi drejt botës euro-atlantike, i ka lënë pas një herë e mire", thuhet në deklaratën e presidentit Topi.

***

Kryeministri i Shqipërisë Sali Berisha tha se akuzat e raportuesit të Këshillit të Evropës, Dik Marti, ndaj kryeministrit të Kosovës dhe UÇK-së, janë të pabazuar në fakte.

"Është një raport tërësisht i pabazuar në asnjë fakt, evidencë apo realitet, çka dëshmon për një anësim politik të qartë të autorit, duke përbërë një abuzim flagrant me autoritetin e Këshillit të Europës", deklaroi Berisha.

Deklarata e Berishës është reagim i parë i qeverisë shqiptare në lidhje me raportin e anëtarit të Këshillit të Europës, Dick Marty ku kryeministri Kosovës, Hashim Thaçi identifikohet si bosi i drogës si dhe trafikant armësh dhe organesh.

***

Ministri i brendshëm, Lulzim Basha, ka sqaruar akuzat e Dik Marti për trafik organesh në Shqipëri, duk i vlerësuar si pretendime që nuk janë vërtetuar

kurrë dhe nuk ka prova për to. Basha ka thënë se Raporti i Dik Martin bën një riciklim të pretendimeve të pabazuara të Karla Del Pontes.

Lidhur me pretendimet se Basha ka qenë përkthyes gjatë hetimeve në "Shtëpinë e Verdhë" në Burrel ku dyshohet se janë trafikuar organe, ministri i Brendshëm ka sqaruar se ai nuk kishte qenë asnjëherë në atë shtëpi.

"Unë asnjëherë në jetën time nuk kam qenë në asnjë shtëpi të verdhë siç pretendohet e aq më pak të kem përkthyer për zotërinë në fjalë. Në vitin 2004 unë nuk kam punuar për Tribunalin. Kam qenë në UNMIK përgjegjës për krijimin e Ministrisë së Drejtësisë në Kosovë dhe transferimin e kompetencave të UNMIK kësaj ministrie. Mbaj mend që zotëria është marrë në punë për të ndihmuar procesin e identifikimit dhe ekzaminimit të eshtrave të personave të zhdukur gjatë luftës në Kosovë dhe se fatkeqësisht në këtë kontekst akoma figurojnë 1800 qytetarë shqiptarë të cilëve nuk u janë gjetur akoma trupat", ka thënë ai. Basha ka sqaruar edhe pozicionin e tij në vitin 2004 në Kosovë, duke deklaruar se në atë vit përgjegjësia e tij ka qenë përgatitja e tranzicionit të Departamentit të Drejtësisë tek sistemi kosovar i drejtësisë. Më tej, Lulzim Basha shprehet se eksperti mjeko-ligjor i OKB-së, i cili ka hedhur akuza, ka patur për detyrë të

gjejë dhe analizojë 1800 trupave ende të pa gjetur nga Kosova.

"Zotëria në fjalë ka patur një detyrë krejt tjetër ku rezulton se ka 1800 trupa ende të pagjetur, dhe ky është problemi kryesor dhe kjo është edhe arsyeja kryesore për të cilën ngrihen këto akuza. Heqjen e mendjes nga një çështje kaq e ligjshme, siç është asnjë e dhënë për fatin e 1800 viktimave të luftës me gjasë në territor serb dhe zhvendosja e vëmendjes në akuza, pretendime false të pavërtetuara asnjëherë dhe pa u shënuar nga asnjë fakt apo provë e vetme", thotë ai.

Në fund të intervistës, ministri shqiptar i Punëve të Brendshme, ka thanë se këto akuza dëmtojnë kredibilitetin e Këshillit të Evropës i cili nuk mund të tolerojë që të hartohen raporte të tilla absurde të pabazuara në fakte dhe prova dhe të heshtë mbi fatin e 1800 të zhdukurve.

***

Kryetari i grupit parlamentar socialist, Gramoz Ruçi deklaroi para pak minutash se Parlamenti shqiptar duhet të miratojë një rezolutë kundër akuzave të anëtarit të Këshillit të Evropës Dick Marty. Sipas tij, Rezoluta duhet të dënojë ashpër akuzat.

"Raporti nuk janë akuza thjesht ndaj Thaçit, por ato akuza dëmtojnë shtetin tonë", theksoi ai, duke shtuar

se rezoluta nga Parlamenti shqiptar duhet të ishte bërë më parë.
Më tej, ai foli edhe për ngritjen e komisionit hetimor, duke vlerësuar se mazhoranca nuk ka më arsye për ta shtyrë atë.

***

Prokuroria e Përgjithshme e Shqipërisë ka reaguar për raportin e Dikk Martit, në lidhje me trafikun e organeve të kryera sipas tij në një shtëpi në rrethin e Matit, që Karla Del Ponte në librin e saj e etiketon si "shtëpia e verdhë".
Sipas këshilltarit për Mediat në Prokurorinë e Përgjithshme, Plator Nesturi, për këto akuza të vjetra është hetuar që në vitin 2004 pa gjetur asnjë provë, prandaj Prokuroria e Shqipërisë nuk ka gjetur bazë për nisjen e çështjes penale.
"Deklarimeve të ish prokurores Karla del Ponte në librin e saj për një bazë në fshatrat e Burrelit ku pretendohej se kryhej heqja e organeve të ushtarëve serbë për qëllime tregtimi, i ka paraprirë në vitin 2004, një verifikim i një grupi të Prokurorisë së Hagës në bashkëpunim me prokurorë shqiptarë, që ka marrë në evidencë këto të dhëna në shtëpinë e supozuar si bazë për këtë qëllim".
"Në bazë të verifikimit të përbashkët të ekspertëve të Hagës dhe atyre shqiptarë, nuk ka rezultuar se të

dhënat e parashtruara të kenë ndonjë bazë vërtetësie, ndaj Prokuroria e Shqipërisë nuk ka gjetur bazë për nisjen e çështjes penale", ka theksuar Nesturi.

Në reagimin e Prokurorisë së Përgjithshme theksohet se institucionet shqiptare nuk kanë dijeni për të dhënat që jep Dik Marti në raport, ndërsa shtohet se asnjëherë këto institucione nuk kanë penguar hetime të tilla, por janë të hapura për cdo bashkëpunim me hetues ndërkomëtarë.

"Pretendimet e paraqitura së fundmi në raportin e anëtarit të Asamblesë Parlamentare të KiE-së, Dik Marti, mbi ekzistencën e bazave të tilla ku presupozohet se janë kryer transplante, si në Fushë Krujë a diku gjetkë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, janë të dhëna për të cilat Prokuroria e Shqipërisë nuk ka pasur asnjë dijeni dhe për të cilat nuk është njoftuar apo paraqitur kërkesë për hetim nga asnjë organ hetimor ndërkombëtar". "Prokuroria e Shqipërisë e deklaron të pabazë çdo insinuatë se institucionet shqiptare janë bërë pengesë për hetimin e kësaj çështjeje. Njëkohësisht, Prokuroria e Përgjithshme, në respekt të legjislacionit dhe konventave ndërkombëtare ku Shqipëria është palë, shpreh gatishmërinë për të vijuar bashkëpunimin me institucionet e specializuara nderkombetare", theksohet në deklaratën e Prokurorisë.

***

Lulzim Basha është thirrur nga Komisioni i Sigurisë për dosjet e UÇK-së. Komisioni do të kërkojë nga ministri i Brendshëm që të dëshmojë në lidhje me raportin e Dik Martit dhe ato që ai di për këtë çështje. Basha ka bashkëpunuar me Tribunalin e Hagës për mbledhjen e fakteve kundër UÇK-së në vitin 2003. Ai ka grumbulluar të dhëna në Shqipëri për këtë çështje. Vet ministri e ka mohuar këtë gjë deri më tani. Në Komision do të pyeten gjithashtu dhe drejtori i Shërbimit Informativ, Bahri Shaqiri dhe ministri i Jashtëm, Edmond Haxhinasto.

***

Duke folur në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, Berisha theksoi se Shqipëria mbështet hetimin, edhe pse të gjitha akuzat e ngritura janë të pabazuara në fakte.

"Pavarësisht se raporti i Dik Marti flet për akte makabre duke mosparaqitur as edhe një fakt të vetëm… ne ftojmë EULEX-in të ndërmarrë hetimin dhe garantojmë të gjitha lehtësirat dhe bashkëpunimin e plotë të autoriteteve shqiptare. Pavarësisht se EULEX-i ka një mandat për shtetin e pavarur të Kosovës, ne mbështesim hetimin e tij", theksoi Berisha.

"Ministri i Drejtësisë do i drejtohet kryetarit të Gjykatës së Hagës që në Shqipëri nuk do të ketë asnjë pengim të vogël për çdo lloj hetimi", theksoi kreu i qeverisë.
Duke folur për mendimin e tij personal për Dik Marti, kryeministri Berisha e cilësoi atë si një avokat të papërmbajtur të krimeve të shëmtuara mbi shqiptarët.
"Kam pasur rastin që kam qenë anëtar i delegacionit të KE-së. Marti ka qenë një avokat i papërmbajtur i krimeve të shëmtuara mbi shqiptarët. Teza e tij kryesore ka qenë kjo: në Kosovë nuk ka ekzekutorë dhe viktima, nuk mund të pranohet që serbët të jenë ekzekutorët dhe shqiptarët viktima", është shprehur Berisha.

***

Amnesty International i ka bërë thirrje misionit të EULEX-it që të hapë hetime lidhur me pretendimet për përzierjen e kryeministrit Hashim Thaçi në rrëmbimin e shqiptarëve dhe serbëve pas luftës në Kosovë.
Thirrja nga organizata për të drejtat e njeriut i pasoi pretendimet e raportuesit të Këshillit të Evropës, Dik Marti, sipas të cilit, Thaçi një kohë ka qenë 'bosi' i bandës kriminale, e cila ka shitur organe të trupit, ka

kryer vrasje dhe është marrë me drogë gjatë dhe pas konfliktit në Kosovë.
Amnesty International i mbështet thirrjet e Martit që BE t'i japë EULEX-it të gjitha resurset e nevojshme për të kryer hetime të plota dhe të paanshme mbi këto pretendime, përfshirë programin për mbrojtjen e dëshmitarëve.
"Familjet e serbëve, shqiptarëve dhe romëve të rrëmbyer pas luftës, kanë pritur tepër gjatë për drejtësinë. Ato meritojnë t'a dinë fatin e të afërmve të vet", thuhet në njoftim.

***

Organizata Humans Right Watch u bëri thirrje SHBA-ve dhe BE-së të kërkojnë hetime të hollësishme dhe të paanshme në Kosovë dhe në Shqipëri lidhur me akuzat për krime të kryera nga ish pjesëtarët e UÇK-së.
Hetimet në Shqipëri duhet t'i zhvillojnë organet e drejtësisë, ndërsa në Kosovë misioni i Bashkimit Evropian, thotë HRW.
Njoftimi i organizatës për të drejtat e njeriut pasoi pretendimet e raportuesit të Këshillit të Evropës, Dik Marti, i cili ka ngritur akuza për rrjete kriminale në periudhën e pas luftës në Kosovë.

***

Në librin e vet, të botuar me 2008, Karla del Ponte evokonte ekzistimin e një "shtëpie të verdhë", e cila gjendej në afërsi të Burrelit, në pjesën qëndrore të vendit, e zbuluar nga një ekip i gazetarëve hulumtues. Sipas tyre, në këtë shtëpi paskëshin qenë praktikuar tortura dhe heqja e organeve. Me 2008, këto akuza kanë pas nxitur pokështu pyetje. Përse prokuroja e Tribunalit penal ndërkombëtar , e ngarkuar që të ndjek krimet e luftës, nuk i ka vërë në pah këto fakte të supozuara ? Jacques Rupnick, specialist i Ballkanit në CERI, prerazi thot se, është fjala këtu për një zhurmë mediale : "Si të shpjegohet ndryshe fakti se prokuroja e rangut të saj bën akuza të tilla pa ofruar asnjë provë, përderisa pikërisht ajo duhej të ishte në gjendje t'i argumentoj ato ?"

"Madje edhe zëdhënsja e saj e dikurshme, Florence Hartmann, e kishte akuzuar se po bën akuza « pa ofrruar as një grimë prove". I pyetur lidhur me këtë çështje, gjatë qëndrimit të tij në Kosovë, Bernard Kouchner, i dërguari special i OKB-së, nuk e kishte fshehur skepticizmin e vet karshi tezës për njëfarë "shtëpie të verdhë".

Mirëpo, raporti i Dick Martyt, ndonëse i autorizuar që të orvatet të nxjerr prova, është pikërisht pa prova. Këtë madje nuk e fsheh vet deputeti zviceran : ai është mbështetur kryesisht mbi dëshmitë dhe raportet e shërbimeve sekrete perëndimore. Në

mungesë të mjeteve , ai nuk ka patur mundësi të vizitojë gjashtë vendet të cilat ai i ka identifikuar si burgje të UÇK-së në Shqipëri. Për shkaqe të sigurisë, ai nuk jap emrin e asnjë dëshmitari, disa prej të cilëve nuk kanë qenë të intervistuar nga ai por nga" përfaqësuese të shërbimeve policore të vendeve të ndryshme, nga hulumtues dhe universitarë e gazetarë hulumtues të një reputacioni dhe të një besueshmërie të pranuar".

"Ka dëshmitarë të këtyre ngjarjeve që kanë qenë të eliminuar, të tjerë të frikësuar nga vet fakti pse i kanë pyetur lidhur me këto ngjarje", arsyetohet ai. Rrjetet shqiptare të krimit të organizuar duket se është më vështirë të infiltrohen se sa Mafia italiane". Një lajtmotiv që përsëritet rregullisht . Kështu UÇK-ja është përshkruar kështu si një organizatë kriminale që përdorë "një imazh të bukur (…) të një armate guerile" për t'i maskuar aktivitetet e veta ilegale." (…) Me 2004, një mision i Gjyqit penal Ndërkombëtar të Hagës si dhe të UNMIKUT, i dërguar për të hetuar lidhur me këtë "shtëpi të verdhë", kishte gjetur inxheksione, disa gjurmë të gjakut dhe epruveta të zbrazëta, por këto nuk kishin mjaftuar për të sajuar prova.

(…) Sipas senatorit zviceran, gjithsesi, vrasjet me plumb në kokë – e menjëherë pastaj është bërë nxjerrja e organeve – nuk janë bërë në "shtëpinë e

verdhë ». Ky vend ishte shumë larg nga aeroporti i Tiranës, kryeqytet i Shqipërisë, për të lejuar dërgimin e shpejt të organeve kah klinikat private perëndimore. Dick Marty pohon se heqja e organeve është bërë në Fushë Krujë, një qytet shumë më afër Tiranës dhe i pajisur me një klinikë.

Përveç akuzave, është kalendari i publikimt të këtij raporti që zgjon dyshimin. Paraqitja e akuzave të tilla kundër Hashim Thaçit, të nesërmen e fitores në zgjedhjet legjislative e çuditë Jacques Rupnick-un : "Me një raport të tillë, bëhet një ndërhyrje e drejtpërdrejtë në lojën politike të Kosovës, duke e delegjitimuar atë që ka dalë i pari dhe që tani duhet të organizojë negociata për koalicionin."

Profesori Rupnik mendon pokështu se me këto akuza është goditur edhe dialogu midis Kosovës dhe Sërbisë, ngase s'mund të merret me mend një politikan serb i cili do të paranonte të hap me bisedimet me një lider të cilin Këshilli i Evropës do ta cilësonte si "kriminel".

***

Organizata për Bashkëpunim Rajonal dhe Integrime Evropiane me seli në Maqedoni reagon ashpër ndaj raportit të Dick Marty.

Sipas tyre, propozim raporti për Kosovën i përgatitur nga raportuesi i Këshillit të Evropës, deputeti

zviceran, Dick Marty është skandaloz, i njëanshëm dhe i pabazë.

"Ky raport dëmton rëndë marrëdhëniet dhe raportet mes vendeve të Ballkanit duke rrezikuar kështu paqen dhe stabilitetin në këtë rajon", thuhet në reagimin e OBRIE.

Kjo organizatë sugjeron Martyn që të hetoj krimet serbe, afër 300 mijë të vrarë e masakruar në Bosnjë Hercegovinë, afër 15 mijë të vrarë mizorisht në Kosovë, 800 mijë të dëbuar dhe terrorizuar dhunshëm nga trojet e tyre, shtëpi të djegura etj.

OBRIE, gjithashtu sugjeron Martyn të hetoj varret masive të shkaktuara nga Serbia, gjatë luftërave të përgjakshme të viteve të 90-ta, në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe vende tjera të rajonit.

"Është turp për Evropën dhe institucionet e saj të heshtë për krimet monstruoze serbe, ndërsa të akuzoj viktimat e luftës, njerëzit të cilët luftuat për lirinë e popullit të vetë. Raportet si ky i Marty rrezikojnë të humbin kredibilitetin e institucioneve më relevante të Evropës, si dhe të shkelin parimet e lirisë, drejtësisë dhe demokracisë", thuhet në reagim.

Sipas OBRIE, shqiptarët aktualisht, në kushte normale e kanë të vështirë të kryejnë operacione të tilla për transplantim organesh, e lërë më në vitet e 90-ta, në gjendje lufte e të jashtëzakonshme.

***

Në mes të periudhës së ËikiLeaks-it, një tregim tjetër eksplodoi në faqet e para në mbarë botën, e që pretendon se kryeministri aktual i Kosovës, Hashim Thaçi, ishte krimineli kryesor i involvuar në vrasjen e njerëzve, për nxjerrjen e organeve të tyre për shitje. Prej kohës së Pol Potit nuk janë bërë deklarata të tilla për një lider aktual në detyrë në vendin e tij. Thaçi ishte zgjedhur në dhjetor me vetëm 34% të votuesve kosovarë që e mbështetën atë, që është pak më pak se Dejvid Kameruni dhe shumë më tepër se Xhorxh Bushi në vitin 2000.

Asnjë zgjedhje në Ballkan nuk është pa akuza për parregullsi në votime. Partitë politike në Kosovë janë klanore, të lidhura me interesa të dyshimta biznesi dhe të financuara pjesërisht nga diaspora kosovare.

Liderët politikë kosovarë, sikur ata kroatë, malazezë, shqiptarë dhe maqedonas, rregullisht janë të akuzuar (shpeshherë edhe me drejtësi) për shmangien e parave për vete ose për nevoja të partisë politike.

Prandaj, prejse "biznesi" në Ballkanin Perëndimor është më tepër i bazuar në kontrabandë të cigareve dhe trafikimin seksual skllav, sesa në aktivitetin legal ekonomik, politikani që nuk mund të akuzohet se e mban një kompani të keqe, me të vërtetë është një "shtazë e rrallë".

Thaçi nuk dallon. Por Thaçi, i cili ishte në dhe jashtë pushtetit për një dekadë, operon si politikan që për së afërmi është i mbikëqyrur nga një asortiment i trupave të Kombeve të Bashkuara dhe të Bashkimit Evropian, si dhe nga vëzhguesit e jashtëm dhe vizitorët.

Raporti që ka shkaktuar tronditje, ende nuk është miratuar nga Këshilli i Evropës, me përjashtim të një nënkomiteti të panumërt të tij.

Është shkruar nga politikani i fortë dhe avokati prokuror zvicerano-italian, i quajtur Dik Marti. Ai është i afërt me bashkëvendësen e tij italiane, avokate politike, Karla Del Ponte – libri i së cilës në Itali kishte bërë akuza identike me raportin e Martit.

Raporti i zotit Marti nuk është dokument preciz juridik. Ai përmban teori të trazuara të politikës perëndimore, derisa ajo shpalosej në krizën e Kosovës në fund të viteve '90.

Në këtë, zoti Marti reflekton politizimin e Këshillit të Evropës, i cili prejse e pranoi Rusinë si anëtare në vitin 1995, ishte përdorur me mjeshtri nga Kremlini për t'i avancuar interesat diplomatike të Rusisë.

Atje Rusia kishte kultivuar aleatë në blloqe të ndryshme politike. Në Britani, anëtari liberal – demokrat i Parlamentit dhe anëtar i Këshillit të Evropës, Majk Hankok, ishte akuzuar nga kryesuesi i Grupit të të gjitha partive britanike parlamentare për

Rusinë, se në mënyrë flagrante ishte pro Rusisë në debatet në Këshillin e Evropës.

Anëtarët konservatorë britanikë të Parlamentit në Këshillin e Evropës ulen në të njëjtin grup me delegacionin e zgjedhur nga Vlladimir Putini.

Rusët, me mbështetjen e anëtarëve britanikë konservatorë të Parlamentit, kishin synuar ta vendosnin ish-anëtarin e stafit të KGB-së si president të Këshillit të Evropës, në vitin 2008. Shkurtimisht, Këshilli i Evropës nuk është ndonjë tubim pa interes i parlamentarëve të Amnesty International ose të Human Rights Watch, por është thellësisht trup i politizuar konfliktuoz, ku shtetet mobilizohen për promovimin e mbështetjes për çështjet e tyre aktuale.

Prioritet i lartë për Kremlinin ishte që ta maksimalizojë mbështetjen për qëndrimin anti-SHBA dhe anti-NATO në Këshillin e Evropës. Rusia ka synuar kultivimin e aleatëve për ta mbrojtur Serbinë dhe shtetet e tjera sllave ose ortodokse nga kritikat.

Përpjekjet nga demokratët socialë të qendrës nga Suedia për promovimin e pajtimit ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve, janë kundërshtuar.

Gjëra të tmerrshme ishin bërë nga ushtarët serbë dhe paramilitarët në Kosovë, pasi diplomacia e fuqishme e Riçard Hollbrukut në Dejton, para 15 vjetësh, i ndali

pasionet nacionaliste serbe të Millosheviqit për më tutje në veri.

Fshatrat e vizituara të Kosovës dhe varrezat myslimane kanë shumë gurrë varresh me njerëzit e lindur në data të ndryshme, por të gjithë të vrarë në të njëjtën ditë, kur skuadrat serbe të ekzekutimit ishin tërbuar.

Njëjtë, gjëra të tmerrshme ishin bërë derisa disa kosovarë kaluan nga rezistenca paqësore dhe pasive e gjatë dy dekada nën Ibrahim Rugovën, në një rezistencë të armatosur, të shkurtër por intensive, 15-18-muajshe, përfshirë edhe vrasje dhe trajtim brutal të bashkëpunëtorëve të regjimit, në stilin e rezistencës franceze në vitin 1944.

Në vend që të synohet paqe dhe pajtim, kanë ekzistuar përpjekje të vazhdueshme nga akset serbo-ruse në Këshillin e Evropës për të pretenduar se Kosova është provincë kriminale separatiste e Beogradit, që një ditë do të kthehet nën pushtetin serb.

Diskreditimi i liderëve të ndryshëm kosovarë, të cilët, pothuajse të gjithë, në një ose mënyrë tjetër, morën pjesë në betejën rezistuese kundër Millosheviqit, që përfundoi me intervenimin Bler-Klinton të NATO-s, në verë të vitit 1999, ishte prioritet i lartë për serbët dhe rusët.

Zoti Marti, së bashku me të tjerët me qëndrim armiqësor ndaj Shteteve të Bashkuara në Këshillin e Evropës, asnjëherë nuk e ka fshehur kundërshtimin e tij ndaj pavarësisë së Kosovës. Ai i ka kundërshtuar thirrjet që Kosovës t'i jepet status i anëtarit ose i vëzhguesit në Këshillin e Evropës.

Senatori Marti është njeri në vete dhe sinqeriteti i tij nuk vjen në pikëpyetje. Ai beson në atë që beson. Por, duke e lexuar raportin e tij me 19 mijë fjalë, paraqitet një problem. Atje nuk ekziston as një emër i vetëm ose një dëshmitar i vetëm i akuzave se Thaçi ishte i involvuar në trafikim të organeve njerëzore nga viktimat e vrara.

Senatori Marti i bën të gjitha për ta nxirë emrin e Thaçit, duke e akuzuar atë se është pak më tepër se kriminel, i cili e ka shfrytëzuar krizën në Kosovë për krijimin e operacionit të stilit mafioz.

Se këto praktika të padëshiruara kanë ndodhur dhe do të ndodhin çdo kund në botë, nuk ka dyshim. Por, zoti Marti ka dështuar ta lidhë Thaçin direkt me trafikun e organeve, megjithëse titulli shokues: "Trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë", ishte paraparë për t'i maksimalizuar titujt.

***

Këshilli i Evropës nuk ka konfirmuar e as ka hedhur

poshtë shkrimin në gazetën britanike Guardian, i cili bazohet ne raportin e Dik Martit, raportuesit te KE-së. Zëdhënësi i këtij institucioni Francesko Ferrer saktësoi për Radion Evropa e Lirë se raportit i Dik Martit do të diskutohet dhe pritet të miratohet në Komitetin e Ligjeve dhe të Drejtave të Njeriut paraditen e së enjtes.

Pas miratimit nga ky Komitet raporti do të bëhet publik derisa do të diskutohet në Asamblenë e Parlamentare të KE-së më 25 janar.

***

Shtetet e Bashkuara kanë reaguar me kujdes ndaj raportit të Dik Martit nga Këshilli i Evropës, që kryeministrin e Kosovës në dorëheqje, Hashim Thaçin, e ndërlidhë me grupin e trafikimit të organeve njerëzore, dhe kërkojnë që të paraqiten provat lidhur me këtë rast.

"Ky është propozim raport dhe ne jemi të vetëdijshëm për të", u tha reporterëve zëdhënësi i Departamentit amerikan të shtetit, Philip Croëley, mbrëmë vonë në Uashington.

Mëtutje ai theksoi se "i marrim të gjitha akuzat kredibile për aktivitet kriminal shumë seriozisht, dhe çfarëdo dëshmie dhe burime të cituara në këtë raport, duhet të ndahen me autoritetet kompetente, për udhëheqjen e hetimit përkatës dhe të plotë".

Zëdhënësi Crowly tha se “sundimi i ligjit është çështja kryesore për stabilitet dhe progres në Ballkan”.

***

Komiteti për Çështje Ligjore i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës ka bërë thirrje për një seri hetimesh në nivel kombëtar e ndërkombëtar lidhur me provat për zhdukje, trafikim, korrupsion dhe për lidhje mes grupeve të krimit të organizuar dhe rretheve politike, të paraqitura në raportin e Dik Martit.

Në një rezolutë të miratuar njëzëri nga Komiteti thuhet se “ka indikacione të numërta dhe që përputhen”, të cilat konfirmojnë se shqiptarë dhe serbë të Kosovës janë mbajtur në mënyrë të fshehtë si të burgosur nën kontrollin e UÇK-së në veri të Shqipërisë. Këta kanë qenë objekt i trajtimit jo njerëzor dhe fyes, përpara zhdukjes.

Komiteti ka kërkuar nga EULEX-i të hetojë këto krime dhe kërkon nga vendet e BE-së që t’i japin misionit burimet dhe mbështetjen e nevojshme politike.

Asambleja Parlamentare do ta diskutojë raportin në 25 janar.

***

Zvicra i ka bërë thirrje Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare, përfshirë Bashkimit Evropian, që të

ndërmarrin hetime mbi pretendimet për trafikim të organeve, njofton AFP.

"Ministria e Jashtme e Zvicrës u bën thirrje vendeve të apostrofuara dhe veçanërisht Kosovës për t'i qartësuar akuzat e këtilla. Autoritetet e duhura ndërkombëtare duhet t'u prijnë hapave ligjorë për t'i grumbulluar provat e mundshme", thuhet në njoftim. Ministria gjithashtu i bën thirrje EULEX-it, që t'i drejtojë hetimet.

Raportuesi i Këshillit të Evropës Dik Marti e implikoi kryeministrin në largim Hashim Thaçi në trafikimin e organeve.

Ministria tha se raporti i Martit përmban "akuza të rënda të bëra mbi bazë të dëshmive dhe provave të shumta".

Ndërkohë, ministria tha se presidentja Doris Leuthard dhe ministreja e Jashtme, Mishel Kalmi-Rej, të cilët duhej të merrnin javën e ardhshme një çmim nga diaspora kosovare në Zvicër, kanë vendosur që për momentin të mos e marrin çmimin.

"Nisur nga publikimi i raportit të Martit, nuk është koha e duhur për ta pranuar çmimin", njoftoi ministria.

***

– SHBA-ja do ta vazhdojë bashkëpunimin me kryeministrin e Kosovës, Hashim Thaçi, megjithë

konstatimet e raportuesit të Këshillit të Evropës që atë e lidhin me krimet, deklaroi zëdhënësi i Departamentit të Shtetit, Philip Crowley, dhe vlerësoi se këto pohime nuk do t'i ndryshojnë fundamentalisht marrëdhëniet amerikane me Kosovën, transmeton gazeta serbe Blic.

"Në këtë moment dhe duke marrë parasysh parimin se çdokush është i pafajshëm derisa të mos dëshmohet e kundërta, ai është kryeministër aktualt dhe do të vazhdojmë të bashkëpunojmë me të", ka deklaruar Crowley në konferencë me gazetarë. "Nuk mendoj se kjo do të ndryshojë në mënyrë fundamentale marrëdhëniet amerikano-kosovare. Ato janë të bazuara në interesin e dyanshëm, e jo në ndonjë personalitet për veçantë", ka shtuar Crowley.

Ai ka përsëritur se administrata në Washington mbështet çdo hetim të "organeve kompetente" lidhur me akuzat e paraqitura në raport.

Crowley tha se disa akuza janë hetuar më herët, por për aq sa ky raport hedh dritë të re, hetimi duhet të vazhdohet. Sipas tij, nëse ekziston informatë përkatëse e zbuluar në raport atëherë ajo duhet plotësisht të hetohet.

***

Zëvendësambasadori amerikan në Prishtinë, Majkëll Mërfi, ka thënë sot se marrëdhëniet dhe partneriteti i

SHBA-ve me Kosovën nuk janë dëmtuar nga raporti i Dik Martit, i cili akuzon disa ish-udhëheqës të UÇK-së dhe kryeministrin Thaçi për veprimtari kriminale. "Departamenti amerikan i shtetit e ka bërë shumë të qartë kur ka thënë se nuk ka ndikime në marrëdhëniet midis Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës", ka thënë zëvendësambasadori amerikan, duke kërkuar nga Dik Marti që nëse ka prova, t'i paraqesë ato.

Raporti i Dik Martit nuk do të ndikojë në marrëdhëniet e mira dhe partneritetin që Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë tashmë me Kosovën, ka deklaruar zëvendësambasadori amerikan në Prishtinë, Majkëll Mërfi.

Këto komente, ai i ka bërë gjatë një vizite në Graçanicë, në ceremoninë e diplomimit të Ekipit për Veprim në Mbrojtje të Komuniteteve.

Mërfi ka thënë se Departamenti i Shtetit tashmë e ka bërë të njohur qëndrimin amerikan në lidhje me raportin e raportuesit special të Këshillit të Evropës, Dik Marti, i cili akuzon disa nga ish-udhëheqësit e UÇK-së dhe vetë kryeministrin Hashim Thaçi për aktivitete kriminale dhe trafik organesh në Kosovë.

"Departamenti amerikan i shtetit e ka bërë shumë të qartë kur ka thënë se nuk ka ndikime në marrëdhëniet midis Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës. SHBA-të janë partnere të fuqishme të

Kosovës", ka thënë zëvendësambasadori Majkëll Mërfi.

"Gjithashtu mendoj se e kemi bërë të qartë se, nëse ka ndonjë provë kredibile, ashtu siç ka thënë edhe EULEX-i dhe të tjerët, zoti Marti duhet t'ua paraqesë ato prova autoriteteve përgjegjëse për hetime të mëtutjeshme", ka thënë zëvendësambasadori amerikan.

"Unë kam qenë shumë i kënaqur kur kam dëgjuar kryeministrin të thotë se qeveria e tij dhe populli i Kosovës do të bashkëpunojnë me hetimet e këtilla", ka thënë ai.

Zëvendësambasadori amerikan e ka përjashtuar mundësinë që raporti i Martit të ndikojë në imazhin dhe raportet e Kosovës e të popullit të saj me Shtetet e Bashkuara.

"Marrëdhëniet tona me qeverinë dhe popullin e Kosovës janë po aq të fuqishme sa kanë qenë gjithmonë dhe ne do të vazhdojmë të qëndrojmë fuqishëm në ecjen përpara. Kemi synimet e njëjta për Kosovën, sikur që kanë edhe populli dhe Qeveria e Kosovës – e ato janë të shohim një Kosovë prosperuese, demokratike dhe shumëkombëshe, të integruar në familjen euroatlantike. Dhe, kjo nuk ka ndryshuar", ka thënë zëvendësambasadori amerikan në Prishtinë, Majkëll Mërfi.

Raporti i Dik Martit vazhdon të kritikohet ashpër nga lidershipi kosovar dhe shoqëria civile. Ushtruesi i detyrës së presidentit, Jakup Krasniqi, përmes një editoriali të botuar në media, ka vlerësuar se raporti i Martit dhe akuzat për trafikim të organeve njerëzore nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, janë të pabaza dhe të padëshmuara.

Vetë raporti, sipas Krasniqit, është politikisht i njëanshëm, tendencioz, qëllimkeq dhe me përmbajtje tmerrësisht raciste dhe antishqiptare.

Ndërkaq, kryeministri në largim, Hashim Thaçi, ka thënë se akuzat se është mafioz dhe trafikant me organe njerëzore, janë "propagandë naziste".

Ndaj raportit të Martit ka reaguar koalicioni i 200 organizatave joqeveritare "Demokracia e Bashkuar". Sejdi Demiri, drejtori këtij koalicioni, ka thënë se raportet e tilla pa fakte, por që mbështeten në paragjykime, nuk mund të njollosin luftën e drejtë të UÇK-së dhe Kosovës për liri e pavarësi.

"UÇK-ja ka qenë, është dhe do të mbetet personifikim qytetar i luftës për liri, dinjitet dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut. Andaj, konsiderojmë se raporti i mbështetur në paragjykime, hamendje dhe i motivuar politikisht, është fyerje për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe për të gjithë miqtë e saj", është shprehur Demiri.

Shoqëria civile thuhet se mbetet e përkushtuar në mbrojtje të së vërtetës, pavarësisht se cila është ajo. Këto organizata joqeveritare kanë aprovuar edhe një deklaratë, të cilën kanë thënë se do t'ia dërgojnë edhe Këshillit të Evropës.

***

Komisioni Evropian ka refuzuar të komentojë akuzat në llogari të kryeministrit Hashim Thaçit se ka qenë i përfshirë në tregtinë me organe njerëzore në Kosoëv, të cilat janë bërë nga raportuesi i Këshillit të Evropës, Dik Marti.

"Është fjala për një raport të Këshillit të Evropës. Nuk di asgjë më tepër. Nuk kam biseduar me qeverinë kosovare dhe nuk dëshiroj të komentoj", u ka thënë gazetarëve eurokomisionerja për punët e brendshme, Sesilja Mastrom.

***

Ministrja e Punëve të Jashtme të Zvicrës, Micheline Calmy-Rey, mbron vendimin e vendit të saj për të njohur pavarësinë e Kosovës, duke e quajtur atë një veprim të matur mirë. Gjatë një interviste për gazetën zvicerane "Tages Anzeiger", Calmy-Rey kërkon që akuzat e Dik Martit ndaj Hashim Thaçit të hetohen urgjentisht. Kryediplomatja zvicerane shton se

udhëheqja e Republikës së Kosovës është zgjedhur nga vetë populli i saj.
Më tej, Micheline Calmy-Rey thekson se duhet pasur parasysh, se për propozimin për pavarësinë e Kosovës, ndërmjetësi i OKB-së Marti Ahtisari është shpërblyer edhe me Çmimin Nobel për Paqe.
"Zvicra nuk ka qenë shteti i parë, por i 30-ti ose i 31-ti që e njohu Kosovën. Para nesh ka qenë Austria, nëse kjo ju qetëson juve. Ne s'kemi vepruar me ngut. Por, sigurisht ne kemi qenë të parët që atëbotë që në OKB kemi thënë se duhet të flitet për pavarësinë e Kosovës. Atëherë qëllimi ishte të stabilizohet rajoni", deklaroi Calmy-Rey.
Sipas saj, autoritetet përgjegjëse, përfshirë edhe ato ndërkombëtare, duhet të nisin hapat juridikë. "Edhe vendet përkatëse, dhe sidomos Kosova, duhet të ndihmojnë në sqarimin e këtyre akuzave. Në Kosovë duhet të ndërtohet një shtet i sundimit të ligjit, dhe kjo nënkupton edhe ballafaqimin me të kaluarën".

***

Brukseli ka reaguar ndaj pretendimeve të raportuesit të Këshillit të Evropës, Dik Marti, sipas të cilit kryeministri Hashim Thaçi identifikohet si 'bosi' i mafias në Kosovë.

"Ne i marrim akuzat seriozisht, por e ftojmë z. Marti që të dalë me prova", tha Maja Kocijançiq, zëdhënëse e kryediplomates së BE-së, Ketrin Eshton.
Ndërkohë, misioni i EULEX-it tha se do t'i shqyrtojë raportin me kujdes.
"Nëse ka përmbajtje të këtij lloji, do të donim të dëgjojmë prej tyre më formalisht", tha zëvendës shefi i EULEX-it, Endrju Sparks për agjencinë Reuters**.**

***

Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim, Ali Ahmeti e ka quajtur tendencioz propozim-raportin për Kosovën të përgatitur nga raportuesi i Këshillit të Evropës, deputeti zvicerian Dik Marti.
"Raporti bart në vete tendencën e rrezikshme për të barazuar viktimat me përdhunuesit në njërin nga konfliktet më të ashpra në territorin e Evropës, i cili ka përfshirë vrasje të organizuara, pastrim etnik sistematik të vendbanimeve dhe fushata gjenocidale të sponsorizuara nga zyrtarët e regjimit famëkeq të Sllobodan Millosheviqit", thuhet në reagimin e Ahmetit. Sipas tij, raporti është plotësisht i njëanshëm dhe aspak i balancuar.
" Për fat të keq, ky propozim- raport, në vend të fakteve, portretizon një të vërtetë të ndikuar politikisht. Si i tillë, ky dokument nuk e meriton miratimin nga ana e Asamblesë Parlamentare të

Këshillit të Evropës", vlerëson kreu i BDI-së, Ali Ahmeti.

***

Komiteti për Çështje Ligjore i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës ka bërë thirrje për nje seri hetimesh në nivel kombëtar e ndërkombëtar lidhur me provat për zhdukje, trafikim, korrupsion dhe për lidhje mes grupeve të krimit të organizuar dhe rretheve politike, të paraqitura në raportin e Dik Martit. Këshilli i Evropës njofton se në një rezolutë të miratuar njëzëri nga Komiteti thuhet se "ka indikacione të numërta dhe që përputhen", të cilat konfirmojnë se shqiptarë dhe serbë të Kosovës janë mbajtur në mënyrë të fshehtë si të burgosur nën kontrollin e UÇK-së në veri të Shqipërisë. Këta kanë qenë objekt i trajtimit jo njerëzor dhe fyes, përpara zhdukjes. Komiteti ka kërkuar nga EULEX-i të hetojë këto krime dhe kërkon nga vendet e BE-së që t'i japin misionit burimet dhe mbështetjen e nevojshme politike.

Autori i raportit, zvicerani Dik Marti, gjatë një konference të mbajtur në Paris tha se ka bazë të mjaftueshme për një hetim të pavarur.

"Mendoj se kam ofruar materiale të mjaftueshme për të justifikuar ndërmarrjen më në fund të një hetimi të pavarur, të thellë e serioz. Mbi të gjitha duhet të

krijojmë kushtet që t'i lejojmë dëshmitarët të flasin hapur. Ky është problemi. Në kushtet aktuale dëshmitarët nuk do të flasin pasi jetët e tyre nuk janë të mbrojtura", tha Marti.

Ai shtoi se organet kompetente duhet të bëjnë detyrën.

"Tani varet nga autoritetet që janë në pushtet të vazhdojnë punën drejt së vërtetës. Ne besojmë se drejtësia nuk mund të jetë një kahëshe. Nuk besojmë se ka një drejtësi për fituesit dhe një tjetër për të mundurit. Ka një drejtësi për të gjithë", tha Marti para mediave në Paris.

Kreu i Këshillit të Evropës, Tjobjorn Jagland ka kërkuar që akuzat e bëra në raport të mos mbeten pa përgjigje. "Ato duhet ose të konfirmohen apo hidhen poshtë përmes një hetimi kriminal", tha Jagland. Ai ka kërkuar në veçanti nga autoritetet ndërkombëtare të bëjnë çfarë munden për të vendosur të vërtetën rreth asaj që ka ndodhur.

Në debatin e sotëm morri pjesë dhe një delegacion i Kuvendit të Kosovës në përbërje të të cilit ishin Xhavit Haliti nga PDK-ja dhe Ibrahim Gashi nga AKR-ja.

Në fjalën e tij Haliti ka hedhur poshtë të gjitha akuzat e raportit, duke theksuar se raqportin e marrin shumë seriozisht. "Ne në PDK i bashkohemi Dik martit në thirrjen për një hetim kompetent

ndërkombëtar mbi pretendimet dhe akuzat e bëra në raportin e Këshillit të Evropës", ka theksuar Haliti në Komitetin e Çështjeve Ligjore.

***

"Jam shumë skeptik në lidhje me realitetin e akuzave për trafikim të organeve". Kështu është shprehur ish-shefi i misionit të OKB-së në Kosovë (UNMIK), Bernard Kouchner, në një intervistë për BBC-në.

Ai ka theksuar se misioni i BE-së në Kosovë, EULEX, kishte mjetet dhe mandatin për të hetuar provat që mund të ekzistonin në lidhje me këtë çështje.

"Reagimi im i parë dhe unë e lexova atë me shumë kujdes, është se jam shumë skeptik në lidhje me realitetin e këtyre akuzave për trafikim të organeve, por reagimi im i dytë është le t'i hetojnë ato", tha Kouchner.

"Krim i organizuar, trafik, sigurisht, makina dhe drogë, sigurisht që ishim të vetëdijshëm, por për trafik organesh, ne nuk ishim aspak në dijeni, dhe duket se është e vështirë të besohet, prandaj jam skeptik", shtoi ai.

Kouchner, i cili ka qenë shef i UNMIK-ut menjëherë pas luftës në Kosovë në vitin 1999, ka hedhur poshtë pretendimet në raportin e Marty ku thuhet se zyrtarët perëndimorë "kanë bërë një sy qorr" në lidhje to.

***

Deputeti evropian, Bernd Posselt ka reaguar pas projekt-rezolutës të së enjtes të Komisionit të Çështjeve Ligjore dhe të Drejtave të Njeriut të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

Në një intervistë dhënë programit shqip të Deutsche Welles, deputeti i Partisë Popullore në Parlamentin Evropian, Bernd Posselt e quajti Dick Martyn një demagog, që keqpërdor pozitën e tij.

"Natyrisht që unë jam për atë që këto akuza të hetohen në mënyrë faktike, si në aspektin e së drejtës penale ashtu dhe në aspektin moral. Por jo ashtu thjesht si zotëri Marty, i cili është i njohur për tendencën e tij për sensacione, për të ngritur diçka nëse nuk ka prova.

Për aq kohë sa nuk dëshmohet fajësia, Marty nuk mund të veprojë kështu. Prandaj unë e konsideroj Martyn absolutisht një demagog, i cili keqpërdor funksionin e tij", përfundoi eurodeputeti Posselt.

***

Një analist i çështjeve të Ballkanit thotë se raporti i Këshillit të Evropës me akuza kundër UÇK-së dhe kryeministrit Hashim Thaçi, nuk sjell argumenta për të mbështetur këto akuza. Daniel Serëer, studiues në Fakultetin e Studimeve të Avancuara Ndërkombëtare

të Universitetit Johns Hopkins, e kritikon tonin e raportit, por ai shton se një komision hetimesh penale duhet të qartësojë se çfarë ndodhi në të vërtetë. Serwer thotë se qytetarët e Kosovës nuk e meritojnë një komplikim të tillë tani që duhet qartësuar situata pas zgjedhjeve. Serwer thotë se raporti e bën të qartë që nuk është kryer ndonjë hetim që të mund të përcaktojë fajësinë ose pafajësinë. Ai nuk sheh argumenta që të mbështesin akuzat, për të cilat thotë se kanë qarkulluar që prej 10 vjetësh.

"Ajo që unë nuk di, është a janë gjetur të dhëna të reja nga ato të para 10 vjetësh që të mbështesin këto akuza, pasi raporti nuk i përmend burimet e veta, i radhit përpjekjet e veta, por nuk është një hetim serioz penal. Me duket se kjo është ajo që nevojitet. Ne duhet të qartësojmë se çfarë ndodhi në të vërtetë dhe kjo do të kërkojë bashkëpunimin e qeverisë së Kosovës, të Shqipërisë, do të kërkojë angazhimin e EULEX-it dhe besoj se është diçka që duhet bërë, duhet të gjejmë a ka ndonjë gjë të vërtetë në këto akuza".

Analisti Serwer,, siç raporton Radio Zëri i Amerikës, thotë se në një shoqëri të hapur publikimi i raporteve të tilla, është normal por ai ka rezerva për mënyrën e prezantimit të tyre.

“Mendoj se është për të ardhur keq që ato janë botuar sikur të jenë prova dhe jo akuza. Mendoj se toni i raportit është i gabuar. Por kjo nuk e ndryshon faktin që dikush duhet t’i shkojë deri në fund kësaj çështjeje dhe të zbulojë se çfarë ndodhi, nëse kanë ndodhur gjëra të tilla dhe se cilët ishin përgjegjësit”.

Serwer, i cili është marrë me çështjet e Ballkanit, edhe si zyrtar i Departamentit të Shtetit, edhe në role të tjera në organizata amerikane, thotë se ai vetë kishte dëgjuar për akuza për trafikimin e organeve njerëzore para shumë vjetësh nga një gazetar i cili i pati thënë që nuk kishte qenë në gjendje të gjente prova.

“Unë akoma nuk shoh prova mbështetëse, të qarta. Shumë nga ato që thuhen në raport, janë fjalë që kanë qarkulluar. Veçanërisht për akuzat se zyrtarë të lartë qeveritarë kanë qenë të përfshirë, nuk paraqiten prova në raport. Për këtë arsye duhet një hetim serioz penal”.

Serëer thotë se akuzat kundër kryeministrit Thaçi e vështirësojnë edhe më shumë situatën paszgjedhore në Kosovë, mes ndërlikimeve dhe akuzave për mashtrime me votat që duhen sqaruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Bordi i Apeleve. Ai thotë se këto vonesa dhe akuzat që shtrohen në raportin e hartuar nga anëtarët e KE-së nën kryesinë e Dick

Martyt, e bëjnë të vështirë për zotin Thaçi që të gjejë partnerë koalicioni për qeverisje.
"Edhe për Kosovën do të jetë e vështirë në përgjithësi. Mund ta merrni me mend se si mund të ndjehen vendet që nuk e njohin Kosovën lidhur me këto akuza. Ata nuk dinë çfarë të mendojnë dhe do të shkaktojë probleme të vërteta për Kosovën".
Dhe për më tepër, thotë zoti Serwer, qytetarët e Kosovës nuk e meritojnë një gjë të tillë.
"Ata votuan, votat e tyre duhet të numërohen saktë dhe qeveria duhet të formohet dhe këto akuza për fat të keq e komplikojnë më shumë atë process.

***

Një gazetare amerikane që ka mbuluar periudhën e luftës dhe pas luftës në Kosovë, thotë se akuzat e raportit të Këshillit të Evropës për UÇK-në dhe Hashim Thaçin janë shokuese. Stacy Sullivan, autore e librit "Nënë mos ki frikë, se ke djemtë në Amerikë", thotë në një intervistë për Zërin e Amerikës se UÇK-ja ishte një organizatë shumë hermetike dhe kishte elementë kriminalë. Kur sheh pas ajo mendon që disa shenja në Burrel ishin shqetësuese. Por megjithëse zonja Sullivan kishte qenë në gjendje të konfirmonte vrasjen e serbëve nga UÇK-ja, ajo nuk kishte dëgjuar as nga serbët dhe as nga kontaktet e saj brenda UÇK-së, që organet e tyre të ishin trafikuar. Stacy Sullivan

iu përgjigj pyetjeve të koleges Keida Kostreci nga Jeruzalemi ku jeton aktualisht. Zëri i Amerikës: Stacy, si gazetare juve mbuluat luftën në Kosovë në fund të viteve 1990. Cili është mendimi juaj mbi akuzat e përfshira në raportin e anëtarit të Këshillit të Evropës, Dik Marti?

Stacy Sullivan: Këto akuza janë shokuese. Nuk ka diskutim që situata ishte jashtëzakonisht kaotike në Kosovë, që nuk kishte një kufi real mes Shqipërisë dhe Kosovës, që UÇK-ja kishte elementë kriminalë, por nga çfarëdo standardi, ideja e vrasjes së njerëzve, dhe marrjes së organeve për t'i shitur është shokuese.

Zëri i Amerikës: Ju mbuluat luftën dhe shkruat edhe një libër më pas për UÇK-në. Gjatë udhëtimeve tuaja atje, a mendoni se po të kishte ndodhur një gjë e tillë, do të kishit qenë në gjendje të vinit re, të shihnit diçka?

Stacy Sullivan: Do të më pëlqente të mendoja se do ta kisha vënë re, por UÇK-ja ishte një organizatë shumë hermetike. Unë kisha mbuluar luftën në Bosnje para luftës së Kosovës dhe atje ushtria boshnjake thoshte: "hajde me ne, shiko se çfarë po ndodh, ne po masakrohemi nga forcat serbe" dhe na ftonte të shihnim se çfarë po ndodhte. Me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës ishte krejt ndryshe. Të gjithë ne gazetarët që mbulonim luftën në Kosovë, i shihnim shqiptarët si viktima dhe unë ende besoj se ata ishin viktimat.

Ne përpiqeshim t'i thoshim UÇK-së se ne donim të njoftonim për atë që po ndodhte, të tregonim mizoritë që po kryheshin, por ata e bënë pothuajse të pamundur për ne. Ata ishin krejtësisht të mbyllur, rrallë na linin që të intervistonim ushtarë, ishin shumë dyshues ndaj anëtarëve të huaj të medias, pra ishte shumë e vështirë. Prandaj nuk më befason. Dukej sikur gjithmonë po fshihnin diçka. Ne nuk kishim gjithmonë mundësinë që t'u afroheshim dhe nuk do më habiste që ata të ishin të përfshirë në aktivitete kriminale. Por nuk do më kishte shkuar mendja kurrë që mund të ishin duke bërë heqje dhe trafikim organesh.

Zëri i Amerikës: A mendoni se ndoshta fakti që media perëndimore vinte me një ide të formuar se cilët ishin viktimat dhe cilët shkaktarët, mund t'i pengonte ata që të kishin një qëndrim më dyshues?

Stacy Sullivan: Unë edhe sot besoj se shqiptarët ishin viktimat. Ata ishin nën pushtimin serb për vite me radhë, iu ishin mohuar të drejtat civile dhe njerëzore. Ata trajtoheshin si qytetarë të dorës së dytë dhe unë akoma mendoj se në thelb lufta e UÇK-së për pavarësi nga Serbia ishte fisnike. Vetëm se mendoj që nuk mund të mohohet që kishte elementë kriminalë në UÇK. Nuk besoj që ata anëtarë të UÇK-së për të cilët unë shkrova librin ishin të përfshirë në gjëra të tilla. Unë mendoj që ata ishin imigrantë që kishin punuar

për të ndërtuar një jetë në Shtetet e Bashkuara, por besoj se është dokumentuar që prapa UÇK-së kishte elementë kriminalë, që kishte kontrabandë armësh dhe drogoe, dhe trafikim grash, por nuk do ta kisha menduar se bëhej fjalë edhe për trafik organesh.
Zëri i Amerikës: A kishit në atë kohë kontakte me Hashim Thaçin, apo me njerëz të tjerë që akuzohen se kanë qenë të përfshirë në këtë lloj aktiviteti?
Stacy Sullivan: Jo. Dhe në fakt isha përpjekur vazhdimisht që të kisha kontakt me Hashim Thaçin dhe grupin e Drenicës dhe çdo herë që isha përpjekur, nuk isha lejuar. Në Nju Jork isha takuar me Florin Krasniqin që ishte një nga personat kryesorë që mblidhte fonde dhe ai ishte i lidhur me grupin e Pejës, që nuk është akuzuar. Unë nuk pata kontakte me Hashim Thaçin deri pas luftës, kur ishte kryeministër dhe unë e intervistova. Ishte një bisedë formale por unë nuk pata asnjë shenjë se mund të kishte qenë i përfshirë në ndonjë gjë.
Zëri i Amerikës: A kishit parë, apo dëgjuar gjëra në atë kohë që tani mund t'ju bëjnë tani të mendoni se diçka po ndodhte?
Stacy Sullivan: Një gjë që kisha parë më shqetëson sot. Në Burrel, ku ishte një bazë e UÇK-së, ishte një grup shqiptaro-amerikanësh, që kishin shkuar atje për t'u sërvitur para se të bashkoheshin me luftën, me brigadën e Atlantikut. Unë u përpoqa për disa ditë në

Burrel, në përpjekje për t'u futur në këtë kamp, për të intervistuar disa nga ushtarët e rinj amerikanë. Mbaj mend që pashë shiringa dhe artikuj të tjerë mjekësorë në territorin e kampit. Po ashtu, të rinjtë shqiptaro-amerikanë që do të shkonin të luftonin me UÇK-në, më treguan për këto shiringa dhe artikuj mjekësorë. Atëherë mendova – dhe mund të jetë e vërtetë – që ishin artikuj të vjetër mjekësorë që ishin ruajtur në një magazinë. Sot më trondit ideja që mund edhe të kishin qenë mjetet e para të atij që mund të ishte operacioni i trafikimit të organeve. Megjithatë unë nuk e di se për çfarë u përdorën ato që pashë unë.

Zëri i Amerikës: Dhe gjatë asaj periudhe a patët kontakte me serbë që mund të kishin shprehur shqetësimet për një gjë të tillë?

Stacy Sullivan: Unë pata kontakte me serbë, anëtarë të familjes së të cilëve ishin zhdukur. Ata ishin të dëshpëruar të merrnin vesh se ç'kishte ndodhur me ta. Unë isha në gjendje të konfirmoja që UÇK-ja ishte e përfshirë në zhdukjen dhe vrasjen e tyre, por asnjëherë ndonjë nga serbët nuk shprehu akuza për heqje organesh. Nga ana tjetër unë kisha kontakte të brendshme në UÇK që më ndihmonin të zbuloja se ç'kishte ndodhur, por askush kurrë nuk me la të kuptoja që këta njerëz u vranë për t'iu marrë organet.

***

Nëse ndonjëherë dëshmohet se kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, të cilin e ka përkrahur ish-kryeministri britanik, Tony Blair, se është bos mafioz, vrasës dhe tregtar me organe njerëzore, historia e luftës për pavarësinë e Kosovës duhet të shkruhet sërish, ndërsa shkëlqimi, të cilin në atë luftë e ka vendosur Blair duhet të shlyhet, shkruan gazetari dhe publicisti i njohur britanik, Tim Judah, shkruajnë mediet serbe.

Judah në një shkrim autorial për botimin e së dielës të "Daily Telegraph", vlerëson se raporti i raportuesit special të KE-së, Dick Marty, në të cilin kundër Thaçit bëhen këto akuza, paraqet "dokumentin, i cili i ka dhënë goditje fatale shtetit më të ri të Evropës". Akuzat nga ky raport "minojnë kredibilitetin" e Kosovës, "dhe rrëzojnë akuzat se partia e Thaçit është e përfshirë në manipulimet flagrante të zgjedhjeve", thotë autori, duke përkujtuar se Kosova ishte një nga intervenimet e para të planifikuara ushtarake të Blairit, dhe pas intervenimit të NATO-s "situata ka ndryshuar".

Judah thekson se refugjatët e përndjekur shqiptarë, të cilët janë kthyer në shtëpi u janë hakmarrë serbëve që kanë mbetur në Kosovë, ndërsa rolin kryesor në

këtë e ka pasur UÇK-ja, derisa "forcat e NATO-s kanë mbyllur sytë në atë që ka ndodhur".

Akuzat nga raporti i Martyt "flasin se në Ballkanin e dhunshëm, qeveritë perëndimore kanë vendosur se paqja dhe stabiliteti në Kosovë është me rëndësi parësore dhe për këtë shkak ka mbyllur sytë në krimet e liderëve të ri të Kosovës, dhe kanë toleruar pjesëmarrjen e tyre në krimin e organizuar", shkruan Judah.

Ai thekson se në Kosovë edhe më tutje janë prezente varfëria, papunësia dhe veçmas korrupsioni në përmasa të mëdha, i cili është pengesë për prosperitetin e saj dhe ajo është "i vetmi vend në Ballkan, i cili në asnjë mënyrë nuk po prosperon, por stagnon krahasuar me të tjerët në rajon".

"Rreziku për Kosovën fshihet në atë se ajo ende nuk ka realizuar të gjitha elementet e shtetësisë e plotë, që nga koha kur është ndarë nga Serbia… Problemi është në atë se këtu, sipas të gjitha gjasave, asnjëherë asgjë nuk mund të dështmohet, dhe për këtë shkak populli i Kosovës do të jetë i dënuar me varfëri dhe izolim", vlerëson Judah në "Daily Telegraph".

***

Raportuesi i Parlamentit Evropian, Jelko Kacin, deklaroi sot se thëniet nga raporti i Dik Martit, për

tregti me organe në Kosovë, janë akuzë e rëndë për të cilën duhet të zhvillohen hetime.
Zoti Kacin u tha gazetarëve në Beograd, se hetimi për raportin e raportuesit special të Këshillit të Evropës, DikMarti, është sfidë e madhe për drejtësinë në Shqipëri dhe Kosovë, dhe se atyre u duhet ndihma ndërkombëtare.
"Duhet të aktivizohen edhe institucionet
ndërkombëtare dhe kjo duhet sa më parë të hetohet. Nëse aty ka faktografi, atëherë kjo çështje duhet të mbyllet sa më parë, ndërsa nëse nuk ka, atëherë kjo duhet të spastrohet, sepse po e helmon atmosferën politike në Kosovë, Shqipëri, Sërbi dhe rajon", tha zoti Kacin.
Kacin ka theksuar se ai raport ende nuk është miratuar, por është në formë të propozimit dhe se ajo që është publikuar deri tash, nuk jep të dhëna konkrete të mjaftueshme, në të cilat hetimi do të mund të koncentrohej.

***

Sociologia Ana di Lelio ka komentuar për rrjetin informativ shqiptar Top Media raportin e Dick Marty, duke e vlerësuar atë si një dokument të pabazë.Sipas Di Lelio, raporti që flet për trafik droge, armësh dhe organesh njerëzore nuk përmban asnjë provë. "Raporti nuk paraqet prova, por bazohet thjesht në

gojëdhëna. Është e sigurt që asnjë akuzë nga raporti i Dick Marty nuk ka për t'u vërtetuar", ka deklaruar Di Lelio.
Ajo më tej ka komentuar edhe librin e ish-kryeprokurores së Hagës, Carla del Ponte, që përmban akuza të tilla, duke u shprehur se ai libër synon vetëm diskriminimin e UCK-së dhe luftës së saj.

***

Shefi i diplomacisë hungareze Janosh Martoni ka shfaqur "brengosjen që po vonohet dialogu Prishtinë-Beograd" dhe ka thënë se në nisjen e këtij dialogu nuk duhet të ndikojë hetimi i mundshëm kundër kryeministrit Hashim Thaçit.
Duke paraqitur programin hungarez për kryesimin e radhës së presidencës së BE-së, Martonji ka thënë se bisedimet Prishtinë-Beograd duhet të fillojnë me çështjet neutrale dhe teknike.
Ai ka theksuar se akuzat e Këshillit të Evropës për përfshirje të kryeministrit Thaçi në krime lufte janë shqetësusese.
"Është çështje e drejtësisë që të sjellë provat, e vetëm atëherë mund të nxjerrim përfundimet politike", ka thënë Martonji.

***

SHBA-të e kanë marr seriozisht raportin e raportuesit të posaçëm të Këshillit të Evropës, Dick Marty për trafikim me organe në Kosovë dhe pretendimet se në të ka gisht edhe kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi.
"EULEX-i tashmë ka hetuar akuzat e mëparshme. Nëse ekzistojnë prova të reja në këtë raport apo dëshmitarë të rinj, kjo duhet t'i përcillet EULEX-it dhe autoriteteve kompetente për hetime", ka thënë zëvendësndihmëssekretari amerikan i Shtetit, Thomas Countryman në një intervistë ekskluzive për Zërin e Amerikës, i lutur që të komentojë raportin e Martyt.
Countryman ka thënë se SHBA-të presin dhe do të përshëndesnin njoftimet e qeverive në Prishtinë dhe Tiranë se do të bashkëpunojnë me çdo hetim eventual.
"Disa herë kemi theksuar se asgjë nuk është më e rëndësishme se sa vendosja e sundimit të ligjit në tërë Evropën Juglindore. Mjerisht edhe sot ka krim të tepërt të organizuar jo vetëm në Kosovë, në jug dhe në veri të Kosovës, por në çdo vend të rajonit". Countryman ka porositur qeveritë e vendeve të rajonit që të bashkëpunojnë në mënyrë më efikase me autoritetet lokale lidhur me këtë çështje.
"Në rastin konkret nuk kam parë raportin e zotit Martyt dhe prandaj nuk mund ta komentoj, por përgjithësisht tërë qëllimi i hetimit të tillë është që të

vendoset përgjegjësia individuale për krime të individuale, sepse nuk mund të kemi përgjegjësi kolektive dhe të themi se të gjithë serbët ose të gjithë shqiptarët apo kroatët janë fajtorë për aksionet e disa individëve. Prandaj mbështesim provat e reja dhe presim që të gjitha shtetet dhe individët në rajon të bashkëpunojnë me hetimet", ka thënë Countryman në një intervistë për Zërin e Amerikën.

***

Raportuesi i Parlamentit Evropian për Serbinë, Jelko Kacin konsideron se raporti i Dik Marti për tregtinë me organet njerëzore në Kosovë, nuk mund të jetë justifikim për të mos filluar dialogun Prishtinë-Beograd.

Kacin u ka thënë mediave serbe se ai dialog nuk do të nisë në nivel të presidentëve, as të kryeministrave apo ministrave, por në nivele më të ulta.

"Për këtë arsye, kjo nuk mund të jetë argument, apo justifikim që dialogu të mos fillojë, sepse ai do të meret me përmirësimin e kualitetit të jetës se njërëzve të rëndomtë, dhe kërkimin e zgjidhjeve të cilat do të ishin në interes të të dy palëve", ka thënë Kacin.

Ai ka theksuar se për të ka qenë shokuese jo vetëm përmbajtja e raportit të Dik Martit, por edhe fakti se "aty nuk ka elemente konkrete të provave".

Kacin ka thënë se pret nga njeriu që ka qenë prokuror që të ofrojë diçka më shumë, ndonjë provë shtesë.

***

Ambasadori austriak Volfgang Petriç, e cilësoi raportin e Dick Marty të pabazuar në fakte. Ai ka thënë se e ka pritur me skepticizëm raportin, pasi të tilla akuza ishin ngritur edhe më parë nga Beogradi apo Moska.

Sipas tij këto akuza prej 10 vjetësh qarkullojnë lart e poshtë, në Beograd e Moskë e për çudi edhe nga një senator zviceran. Ai ka shtuar se akuzat mbeten shumë misterioze, aç më tepër që këto vitet e fundit në rajon vepron NATO, EULEX-i dhe Kombet e Bashkuara.

Petriç tha se vendet e BE-së janë përgjegjëse për këtë raport dhe duhet të merren seriozisht me këto akuza për të zbardhur se ku qëndron e vërteta dhe kush mund të fshihet pas akuzave ndaj qeverisë së një shteti të pavarur.

***

Ambasadori Frank Wisner, përfaqësuesi amerikan i treshes, e cila i ndërmjetësoi bisedimet Prishtinë-Beograd para pavarësisë së Kosovës, i ka quajtur të çmendura akuzat e Dik Martit për kryeministrin e Kosovës dhe UÇK-në.

"Unë jam thellësisht skeptik ndaj këtij raporti. Ajo që është thënë duhet të argumentohet, dhe po që se ka fakte dhe argumente, ato t'i dorëzohen autoriteteve në Kosovë. Kosova është vend i rendit dhe ligjit, ka sistemin juridik, ka prokurorinë dhe jam i sigurt se po qe se është kryer vepër apo krim, autoritetet në Kosovë do ta hetojnë në tërësi", ka thënë Wisner. Në pyetjen nëse kjo do ta dobësojë pozitën e Kosovës në procesin e bisedimeve me Beogradin, Wisner vlerësoi se kjo nuk do ta dobësojë pozitën e Prishtinës.

***

Ish-emisari i posaçëm amerikan për Ballkanin Robert Gelbard, duke folur rreth fillimit të dialogut mes Beogradit dhe Prishtinës, pas raportit të Dik Martit për trafikim me organe njerëzore, tha se akuzat ndaj Hashim Thaçit "janë jashtëzakonisht të rëndësishme dhe po aq serioze sa që për to duhet patjetër zbatuar hetime".

Ndërkaq për Dik Martin, Gelbard tha se "është i prirur për senzacionalizëm, por ai ka paraqitur akuza serioze të cilat duhet të hetohen". "Mirëpo akuzat në lidhje me Thaçin nuk kanë ndikim në çështjet e pavarësisë së Kosovës", theksoi Gelbard.

Ai i shpreh mirënjohje qeverisë së Thaçit, për të cilën tha se ka vënë në dukje se ekzistojnë çështje praktike

midis dy vendeve fqinje që duhet zgjidhur. “Rasti i Thaçit nuk duhet të jetë pengesë në rrugën drejt zgjidhjes së çështjeve të tilla të cilat janë në interes të ndërsjellë të Beogradit dhe Prishtinës”, tha Gelbard në një intervistë për “Zërin e Amerikës” në serbisht. Ndërkaq, duke folur për rreth marrëdhënieve të mëtejshme të SHBA-ve me Beogradin, Gelbard raportet mes SHBA-ve dhe Serbisë i vlerëson të mira, ndonëse siç tha, mund të jenë më të mira. Ai tha se vizita e nënpresidentit Bajden dhe e sekretares së Shtetit Klinton kanë shënuar përparim në marrëdhënie dhe bashkëpunim. “Tani gjithashtu kemi edhe ndihmës sekretarin e shtetit shumë të aftë, Tom Kantrimen, i cili është i martuar me një serbe”. “Në Beograd kemi një ambasadore të jashtëzakonshme – Meri Uorlik”, tha Gelbard, dhe shtoi se administrata e Obamës është e angazhuar dhe po punon, megjithëse “ekzistojnë disa komplikime, para së gjithash preokupimet e Beogradit me Kosovën”.

VETËVRASJET DHE VRASJET NË KOSOVË

Numri i vetëvrasjeve në Kosovë po rritet vazhdimisht. Pas luftës mbi 800 vetëvrasje kanë ndodhur në Kosovë. Nga disa raste të izoluara vetëvrasjet tani janë shndërruar në dukuri, sidomos tek gjinia femërore. Sipas të dhënave të Policisë nga 1 janari 2016 deri më 02.11.2016 janë evidentuar 19 raste të vetëvrasjeve, ku të vetëvrarat janë të gjinisë femërore. Mosha mesatare e femrave që kanë kryer vetëvrasje është 39 vjet.

Vetëm gjatë 11 muajve të vitit 2014 afro 50 persona i kanë dhënë fund jetës së tyre. Sipas Policisë së Kosovës "Nga janari e deri në nëntor të këtij viti, në Kosovë janë regjistruar 48 vetëvrasje, një shtytje në vetëvrasje dhe ndihmë në vetëvrasje".

Mosha e personave që kryejnë një akt të tillë është e ndryshme, por numri më i madhe i tyre janë të

moshës 18-40 vjeçare. Sipas Policisë, faktorët që ndikojnë në këto rrethana janë të ndryshme.
Psikologët thonë se përveç gjendjes së rëndë ekonomike, janë edhe faktorët e tjerë që ndërlidhen me vetëvrasjen.
80 për qind të rasteve të vetëvrasjeve, personat që kanë kryer këtë akt kishin probleme të shëndetit mendor.

***

Në Kosovë vitin e kaluar janë regjistruar afër 10 mijë vdekje bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave. Prej tyre 188 raste janë të vdekjes së dhunshme mes së cilave 41 vetëvrasje dhe 19 vrasje. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar raportin me "Statistikat e Vdekjeve në Kosovë 2016".Gjatë vitit të kaluar janë regjistruar 9246 vdekje, prej tyre në Kosovë 8495, kurse jashtë Kosovës janë regjistruar gjithsej 751. Sipas ASK-së 4796 nga vdekjet janë meshkuj (apo 56.5 %) dhe 3699 femra (apo 43.5 %). Gjithashtu ASK ka nxjerrë edh numrin e vdekjeve të dhunshme në vitin 2016, gjatë së cilit ishin raportuan 188 raste nga të cilat fatkeqësi 128, vetëvrasje 41 dhe vrasje 19. Foshnje të vdekura sipas ASK-së vitin e kaluar kanë qenë 199, nga të cilat 116 meshkuj dhe 83 femra. Nga numri i përgjithshëm i vdekjeve 46.3 % e rasteve kanë

ndodhur në institucione shëndetësore, 52.5 % në shtëpi dhe 1.2 % në vend tjetër.

Fenomeni i vetëvrasjes në Kosovë, si duket është tentuar të minimizohet në shkallë jashtëzakonisht të madhe për shkak të shumë faktorëve. Në Kosovën para vitit 99', duke ditur rrjedhat edhe politike, sociale dhe ekonomike, pak është folur për një fenomen të tillë.

Edhe sot lirshëm mund të themi se pak I kushtohet rëndësi një fenomeni të tillë, porse ndryshimet në këtë drejtim kanë rrjedhë me vetë ndryshimet brenda për brenda shoqërisë, në përgjithësi.

Ballafaqimi me një situatë të cilën e ka kaluar shoqëria jonë, padyshim se në vete ngërthen edhe shumë sfida me të cilat do të atakohet drejtpërdrejt shoqëria, pas tejkalimit të një situate të tmerrshme për çdo individ që në një formë ose në një tjetër është ballafaquar me luftë.

Dalja nga një situatë, krejtësisht destabilizuese, dezorientuese për individin nuk premton që ai shpejt do ta marrë veten, madje e kundërta e kësaj, ai për një kohë të gjatë nuk do të arrijë të stabilizohet dhe të nis jetën nga e para.

Në Kosovë, të gjithë qytetarët e saj kanë qenë të dëbuar nga shtëpitë e tyre, kanë pasur të vrarë, të masakruar, të dhunuar, e të dëbuar pa dallime, gra, pleq, fëmijë, të rinj e të moshuar. Shumë nga ne me

sytë tanë kemi parë, e edhe përjetuar tmerre nga më të ndryshmet që për njerëzimin janë jo të lehta. Dhe normalisht, që gjithë këto të përmendura vetëm në pika të shkurtra janë një tregues real, I gjendjes psikologjike, emocionale, shpirtërore me të cilën është atakuar kjo shoqëri dhe që normalisht edhe individët të cilët nuk kanë mundur t'i bëjnë ballë qoftë edhe përjetimit të dhembjes, pas kësaj ndodhie, kanë kryer edhe aktin e vetëvrasjes.

Vetëvrasja është një akt personal, pra vetë individi vendos nëse donë ta kryej një akt të tillë apo jo. Edhe përkundër faktit që ai nuk është vetëkrijues i jetës së tij, ai merr vendim që t'ia marr vetes atë të drejtë për jetë.

Në vende dhe shoqëri të caktuara një akt i tillë konsiderohet i drejtë dhe pokështu edhe i guximshëm, madje në disa kultura konsiderohet si një akt i glorifikuar, si "një zgjidhje krenare e problemeve të pazgjidhura".

Në kultura dhe shoqëri të ndryshme, konsiderohet si një akt qyqar, madje shkohet deri në përfundime të tilla saqë individët të cilët kryejnë një akt të tillë, konsiderohen si të çmendur fare dhe si i paaftë për t'u ballafaquar me situata të cilat në momente të caktuara mund të konsiderohen të pazgjidhshme.

Për të analizuar një fenomen të tillë normalisht që duhet ndërlidhur fuqishëm teoria me kërkimin. Pa

një ndërlidhmëri të tillë, sociologu në asnjë mënyrë nuk do t'ia dalë në krye të një analize të mirëfilltë sociologjike, mbi fenomenin e vetëvrasjes.
Konsideroj që edhe në vendin tonë, edhe në shoqërinë tonë ka të dhëna të mjaftueshme mbi këtë fenomen, për t'i bërë një analizë sociologjike, dhe për të arritur në përfundime se cilët janë shkaktarët kryesorë që sot shtyjnë një individ brenda për brenda shoqërisë sonë, që të marrë një vendim të tillë.

Gjatë vitit 2001, janë bërë gjithsejtë 74 vetëvrasje dhe 41 tentimvetvrasje.
Gjatë vitit 2002, janë bërë gjithsejtë 51 vetëvrasje dhe 51 tentimvetvrasje.
Gjatë vitit 2003, janë bërë gjithsejtë 66 vetëvrasje dhe 72 tentimvetvrasje.
Gjatë vitit 2004, janë bërë gjithsejtë 64 vetëvrasje dhe 202 tentimvetvrasje.
Gjatë vitit 2005, janë bërë gjithsejtë 56 vetëvrasje dhe 137 tentimvetvrasje.
Gjatë vitit 2006, janë bërë gjithsejtë 58 vetëvrasje dhe 203 tentimvetvrasje.
Gjatë vitit 2007, janë bërë gjithsejtë 54 vetëvrasje dhe 221 tentimvetvrasje.
Gjatë vitit 2008, janë bërë gjithsejtë 58 vetëvrasje dhe 224 tentimvetvrasje.
Gjatë vitit 2009, janë bërë gjithsejtë 73 vetëvrasje dhe

293 tentimvetvrasje.
Gjatë vitit 2010, janë bërë gjithsejtë 67 vetëvrasje dhe 372 tentimvetvrasje.
Gjatë vitit 2011, janë bërë gjithsejtë 52 vetëvrasje dhe 306 tentimvetvrasje.
Gjatë vitit 2012, janë bërë gjithsejtë 58 vetëvrasje dhe 343 tentimvetvrasje.
Gjatë vitit 2013, janë bërë gjithsejtë 45 vetëvrasje dhe 236 tentimvetvrasje.

Këto janë të dhëna të përgjithshme, në gjithë vendin tonë, lidhur me aktin e kryer të vetëvrasjes dhe tentimvetvrasjes, duke i përfshirë të gjitha moshat, dhe të dyja gjinitë.
Normalisht, që nuk përjashtohet mundësia e mosraportimit të ndonjë akti të tillë. Shkaqet, që realisht nuk raportohet apo nuk publikohet si i tillë janë nga më të ndryshmet, si :

Ajo që lë pas hutesë/ shqetësim, fajësi, turp dhe me arsyetimin e ruajtjes së familjes, për faktin se akti i vetëvrasjes mund të godas në tërësi një familje dhe të sjellë çrregullime të mëdha përbrenda saj.
Ajo që bie në sy nga këto të dhëna që i posedojmë fillimisht është fakti se kemi ngritje të jashtëzakonshme të numrit të tentimvetvrasjeve, gjë që është mjaftë shqetësuese dhe se padyshim duhej

ndërmarrë masat e duhura për parandalimin dhe evitimin e tërësishëm të kësaj dukurie.

Në bazë të të dhënave statistikore, arrijmë në një përfundim se numri i tëvetëvrarëve në vendin tonë ka dallime të vogla me plus – minus nga viti në vit, porse shtimi i numrit të tentimvetëvrasjeve është një tregues shqetësues se në rast të realizimit të këtyre tentativave numri i tëvetëvrarëve do të shënojë ngritje jashtëzakonisht të madhe.

Për këtë, ka rëndësi të veçantë, ndarja gjinore që u bëhet atyre që kryejnë tentimvetvrasje, për faktin se mendohet se femrat kryesisht përdorin mjete tjera si medikamente dhe konsumim i tepruar i tyre, gjë që shpijnë edhe në dështimin e kryerjes së një akti të tillë.

Ndërkaq, meshkujt kryesisht mendohet se kryejnë këtë akt përmes mjeteve të forta, si armët, dhe realizimi i një qëllimi të tillë është dukshëm më i lehtë dhe më i sigurt në raport me ato mjetë që përdorin femrat.

Në bazë të të dhënave të cilat ekzistojnë për numrin e atyre që kanë kryer një akt të tillë, del se ky fenomen është mjaft shqetësues në shoqërinë tonë, dhe se duhet marrë më seriozisht.

Është e rëndësisë së veçantë të analizohen mundësitë për parandalimin e këtij fenomeni, në mënyrë që individët mos të ndjehen të lënë anash nga zhvillimet

brenda vetë shoqërisë, dhe pokështu edhe të përfshihen në procese të ndryshme.
Në këtë rrafsh, rol të veçantë ka institucioni kryesor, pra familja. E cila duhet, të ketë nën vëzhgimin e saj të përhershëm individin i cili në një mënyrë apo në një tjetër, mendohet po shkon drejt realizimit të një akti të tillë.

Faktorët që shtyjnë drejt një akti të tillë:

Në shoqërinë tonë mund të merren në konsideratë një mori faktorësh, që shtyjnë individin drejt vetëvrasjes dhe se nuk janë të paktë.
Nëse kemi parasysh studimin e Durkheim-it, për vetëvrasjen dhe pokështu edhe ndarjen në katër grupe që ai i ka bërë vetëvrasjes, padyshim se në shoqërinë tonë ndeshemi me tipin e vetëvrasjes Egoiste.
Mosmundësia e integrimit të individit brenda për brenda shoqërisë, e shtyjnë drejt një akti të tillë. Ngase, ai e sheh veten të ndarë në raport me proceset të cilat zhvillohen në shoqëri në përgjithësi dhe po kështu ndeshet edhe me zbehjen e vlerave në shoqëri, dhe me vetë mosrëndësinë e tij, e si pasojë e krejt kësaj, normalisht rrjedh vetëvrasja.
Çrregullimet mentale, humbja e besimit, kushtet e rënda ekonomike e sociale, stresi, depresioni, dukuritë si droga, alkooli, prostitucioni dhe dukuri të

tjera negative, kanë të gjitha mundësitë në një përfundim të tillë, pra përfundim në vetëvrasje.

Ndryshimet në jetën sociale, ekonomike të cilat kanë prekur gatise të gjitha shoqëritë, por me theks të veçantë ato shoqëri të cilat janë më pak të zhvilluara dhe në tranzicion, normalisht që gjen evoluim më të shpejtë dukuria e vetëvrasjes.

Sot ndeshemi edhe me një zhvillim kaq të hovshëm, të prekur nga procesi i globalizimit, dhe nga zhvillime kaq të shpejta, të cilat për individin në një formë ose në një tjetër janë të papërballueshme për integrim të shpejtë, normalisht e shtyjnë atë në një hamendësim për vetë rolin dhe rëndësinë e tij në shoqëri, dhe po kështu e shtyjnë atë drejt një përfundimi jo të kënaqëshëm për të, zbehjen e rolit të tij në shoqëri.

Padyshim se në këtë rrafsh, rëndësi të veçantë në shoqërinë tonë ka efekti që ka pasur familja tradicionale (familja e tipit të gjerë), e cila ka pasur ndikim të veçantë në formimin dhe zhvillimin e individit. Ndërkaq, sot kur shoqëria jonë ndeshet me individualizimin sikurse edhe shumë shoqëri tjera, individi ka dëshmuar se është dukshëm më i dobët t'i përballojë sfidat me të cilat atakohet në situata të caktuara.

Kujdesi i shtuar nga institucioni I familjes për individin dhe brenda një periudhe kaq të shpejt zhvillimi I hovshëm i individualizmit, ka ngjallur

mëdyshje dhe hamendësime të mëdha në të sotmen dhe të ardhmen e individit në veçanti dhe të shoqërisë në përgjithësi.

Prandaj, edhe situatat e tilla ngjallin padyshim dilema të mëdha në vetë individin, krijojnë një lloj ndjenje të pasigurisë dhe pafuqishmërisë së tij, gjë që e shtyn atë në një rrugë të tillë.

Por, për të arritur në një përfundim final për këtë fenomen, duhet pasur parasysh edhe të dhëna të tjera si : Sa është numri i vetëvrasjeve meshkuj sa femra, cili numri i tentimvetvrasjeve meshkuj e cili është numri i femrave, vetëvrasjet dhe tentimvetvrasjet të analizohen edhe në bazë të moshës së atyre që kryejnë këtë akt, në bazë të vendbanimit dhe kushteve se si jetojnë, si dhe të analizohet një aspekt tjetër i cili është mjaftë i rëndësishëm, se në çfarë periudhash kohore janë kryer këto vetëvrasje dhe tentimvetvrasje, për faktin se duhet pasur parasysh se sa lidhen me gjendjen emocionale shpirtërore, apo ndoshta edhe nuk ka fare ndikim një gjë e tillë.

Prandaj, për të arritur në një përfundim të tillë, është e nevojshme realizimi i një projekti madhor, që do të mblidhte gjithë këta faktorë, dhe më pas mbi plotfuqishmërinë e tyre të ndërtohet edhe një strategji për parandalimin e vetëvrasjes (Florent Rrahmani)

Raportet e Policisë së Kosovës flasin për rritje të ndjeshme të numrit të tentim vetëvrasjeve dhe vetëvrasjeve në Kosovë.

Kjo rritje, sipas psikiatërve dhe sociologëve, po vjen si pasojë traumave të luftës së fundit, por ka raste edhe për shkak të mungesës së kujdesit shpirtëror në planin individual dhe në atë institucional.

Përderisa në vitin 2001 statistikat flisnin për 74 vetëvrasje dhe 41 tentim vetëvrasje, në vitin 2014 numri vetëvrasjeve arrin 79, ndërsa 246 raste janë regjistruar si tentim vrasje. Ndërsa prej vitit 2001 deri në vitin 2014 janë evidentuar 855 raste të vetëvrasjeve dhe 2967 vetëvrasje në tentativë. Ky fenomen, sipas Policisë së Kosovës, po merr përmasa të gjera nga viti në vit. Psikologët dhe sociologët sugjerojnë se kjo dukuri nuk ka qenë pjesë e traditës kosovare.

Policia është duke i hetuar të gjitha rastet e raportuara të vetëvrasjeve dhe tentim vetëvrasjeve.

Vetëvrasja si fenomen nuk kursen asnjë shoqëri. Ai thotë se përveç mungesës së përkujdesjes së kosovarëve ndaj aspektit shpirtëror, si një ndër shkaqet kryesore që po ndikon në rritjen e numrit të vetëvrasjeve sipas tij është edhe pasojat e luftës, si dhe kushtet e rënda ekonomike.

Këto akte po rriten si pasojë e mos-trajtimit institucional. Për këtë arsye institucionet

përkatëse duhet të merren në mënyrë serioze me këto raste.
Sipas hulumtimeve shkencore, është vërtetuar se të rinjtë deri në moshën 35-vjeçare më së shpeshti bëjnë tentim vetëvrasje, ndërsa të moshuarit nga 50 vjeç e tutje, më shpesh bëjnë vetëvrasje.

***

Prishtina është bërë "vatër" e vetëvrasjeve. Vetëm brenda dy ditëve të fundit, dy persona u hodhën nga ndërtesat.
Dje në lagjen "Mati 1" një person u hodh nga kati i gjashtë i një ndërtese, ku fatmirësisht pësoi vetëm lëndime trupore.
Ndërkaq sot një vajzë rreth të 34-ve u hodh nga ndërtesa në lagjen "Dardania"e cila fatkeqësisht ndërroi jetë në vend të ngjarjes.
E lidhur me këtë fenomen, sociologu Fadil Maloku fajin i ja lë ndryshimeve të mëdha sociale dhe situatave në vend.
Ai në një prononcim ka thënë se ndryshimet e mëdha sociale, situatat e reja brenda një kohe të shkurtër kanë bërë që qytetarët të përjetojë stres dhe të arrijnë te kjo situatë, e pazgjidhshme dhe pa rrugëdalje.
"Vetëvrasja, në të shumtën e rasteve bazohet në humbjen e shpresës për jetë e në disa raste në vet

kënaqësinë perverse të shkaktimit të dhimbjeve ndaj vetvetes. Ka raste, kur këndvështrohet edhe si akt i pakuptimit dhe paradoksal që mund të përshkruhet si sjellje devijante dhe patologjike. Ky fenomen, zakonisht paraqitet si pasojë e bashkëveprimit të disa faktorëve që mund ta nxisin atë", ka thënë Maloku.

Maloku më tej ka theksuar se fare qartë mund të dallojmë faktorët që ndërlidhen me vetëvrasjen. "Në mesin e këtyre faktorëve mund të identifikojmë disa që u përshtaten rrethanave dhe ambientit tonë social e ato janë zakonisht: mungesa e kohezionit në familje, depresioni dhe historia familjare, pakënaqësia me statusin shoqëror, pamundësia e arritjes së ndonjë qëllimi qoftë në sferën emotive, apo atë sociale, pa perspektivë në jetë, pamundësia e gjetjes së vetes në situatë transformuese etj", u shpreh sociologu i mirënjohur Prof. Dr. Fadil Maloku.

Sociologu më tej ka shtuar se mjerisht në shoqërinë kosovare akoma nuk ka studime kredibile lidhur me shkaqet, por edhe pasojat që mund të sjellë ky fenomen.

"Në vendet tjera bëhen hulumtime në nivel kombëtar, ngase rritja e numrit të këtij fenomeni, vetvetiu i mobilizon institucionet shtetërore të deshifrojnë si shkaqet ashtu edhe pasojat. Unë jam shumë i bindur që Kosova ka specifikat e veta kur është në pyetje ky

fenomen vetëm se ato duhet të identifikohen, të interpretohen dhe të shpjegohen", u shpreh Maloku.
Prishtinë, 20. 02. 2018

Vetrasjet ne emer te "Jehovait"

Dëshmitarët e Jehovait është një sekt fetar i cili u përhap në Shqipëri pas viteve '90 me rilindjen e feve të tjera, pas rënies së sistemit komunist i cili pengonte me ligj zhvillimin dhe predikimin e besimeve fetare gjatë 45 viteve të ushtrimit të pushtetit në vendin tonë. Ky sekt zhvillon aktivitetin e tij fetar dhe në shumë vende të tjera të botës, por në disa shtete është e ndaluar të predikohet ky besim fetar, për shkak të riteve dhe parimeve të dyshimta fetare që shpesh kanë shtyrë në vetvrasje shumë persona mes të cilëve dhe fëmijë. Fenomeni i vetvrasjeve nga persona të cilët kishin përqafuar parimet morale dhe fetare të këtij sekti regjistroi shumë raste gjatë vitit 2005 në Shqipëri, duke lënë dyshime të thella mbi sektin fetar Jehovaian, duke ngritur pikëpyetje të shumta mbi predikimet dhe normat e tyre. Janë më dhjetra dëshmi të pasqyruara në median vizive dhe atë të shkruar gjatë vitit 2005 që tronditën të gjithë opinionin publik, akuza të drejtpërdrejta ndaj Dëshmitarët e Jehovait të ngritura nga familjarët e viktimave, zotime nga krerët e policisë në qytetet përkatëse ku ndodhën ngjarjet

tronditëse se vetvrasjet do ti nënështrohen një hetimi të plotë, por me keqardhje duhet të themi se tashmë kanë kaluar 5-vjet nga ato vetvrasje tragjike që u morën jetën dhe të miturve dhe gjithçka është lënë në harresë, në media nuk është ngritur më ky problem dhe nga shteti shqiptar nuk kami patur as edhe njëherë të vetme një operacion hetimor të plotë ndaj këtij sekti që dyshohet se nxiti në vetvrasje të paktën 10 persona gjatë vitit 2005, nga mosha 8 deri në 25 vjeç. Ajo çka të bënë më shumë përshtypje për këtë sekt fetar dhe që ngjall dyshime të thella lidhet me faktin se drejtuesit e Dëshmitarët e Jehovait predikojnë dhe frymëzojnë tek besimtarët ringjalljen. Një tjetër aspect që duhet analizuar me vëmëndje është dhe mospranimi i transfuzionit të gjakut, që siç do ta shohim më poshtë ka çuar në vdekjen e një pjesëtareje të organizatës, e cila kishte nevojë prej disa ditësh për ndërrimin e gjakut, përpara se të ndahej nga jeta.

Termi Jehova apo JHËH, në hebraisht është një nga emrat e Zotit, për hebrejtë dhe të krishterët dhe në shqip do të përkthehej si shpëtimtari. Sekti është krijuar nga mesi i shekullit të 19 dhe nuk ka lidhje me krishterimin edhe pse propagandon biblën (në disa variante të tjera). Bibla e tyre për të krishterët quhet e deformuar. Numri i ndjekësve të tyre në të gjithë botën është rreth 6.7 milion (sipas statistikave që

pohon faqja zyrtare). Emrin e sotshëm e morën nën presidencën e Zhozef Franklin Rutherford, ndërsa si themelues i tyre njihet Çarles Taze Rusell . Jehova është një emër përshkrues, që tregon se japin dëshmi për Jehovain, Hyjninë dhe qëllimet e tij. Jehova është një emër personal dhe i referohet Perëndisë së plotfuqishëm dhe Krijuesit të universit. Kjo tregohet në Psalmin 83:18, sipas versionit të Biblës së përkthyer nga Kristoforidhi: "Edhe le të njohënë, se vetëm ti, që ke emërin JEHOVAH, je i lartë mbi gjithë dhenë."

Emri Jehova ose Jahveh, sipas përkthimit Filipaj, një botim katolik romak dhe e përdorur nga disa studiues shfaqet rreth 7.000 herë në Shkrimet origjinale Hebraike. Shumica e Biblave nuk e tregojnë atë, por e zëvendësojnë me fjalët «Perëndi» ose «Zot». Megjithatë, edhe në këto Bibla, një person zakonisht mund të dallojë se ku tekstet origjinale hebraike përdorin emrin Jehova, sepse në ato vende fjalët që zëvendësojnë atë emër janë shkruar me shkronja të mëdha, si PERËNDI dhe ZOT. Disa përkthime moderne përdorin ose emrin Jehova, ose emrin Jahveh.

Po sipas faqes zyrtare të organizatës fetare dëshira e Dëshmitarëve të Jehovait është që t'i njohim më mirë. Ata interesohen për ne dhe për mirëqenien tonë. Dëshirojnë të jenë miqtë tanë e të na tregojnë më

shumë për veten, besimin, organizatën e tyre dhe se ç'mendojnë për njerëzit dhe për botën në të cilën jetojmë të gjithë. Dëshmitarët e Jehovait I janë dedikuar perëndisë për të zbatuar vullnetin e tij në tokë. Ata besojnë se bibla është fjala e perëndisë. Të 66 librat e sa0j ata i konsiderojnë të frymëzuar dhe historikisht të saktë. Asaj që zakonisht njihet si Dhiata e Re ata i referohen si Shkrimet e Krishtere Greke, dhe Dhiatën e Vjetër e quajnë Shkrimet Hebraike. Mbështeten te të dyja këto, si te Shkrimet Greke, ashtu edhe tek ato Hebraike, dhe i pranojnë ato në kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës, me përjashtim të rasteve ku shprehjet ose sfondi tregojnë qartë se janë figurative a simbolike. Ata e kanë të qartë se shumë nga profecitë e Biblës janë përmbushur, të tjera janë duke u përmbushur dhe të tjera akoma pritet të përmbushen. Arsyeja biblike që nxjerrin Dëshmitarët e Jehovait për emrin e tyre gjendjet në kapitullin e 43-të të Isaisë. Emri I tyre shihet si një dramë që zhvillohet në një sallë gjyqi. Në këtë sallë gjyqi sipas mitologjisë Perënditë e kombeve ftohen të paraqesin dëshmitarët e tyre për të provuar pretendimet e tyre të drejtësisë, ose të dëgjojnë dëshmitë në favor të Jehovait dhe të pranojnë të vërtetën. Jehovai atje i deklaron popullit të tij: "Ju jeni dëshmitarët e mi,—thotë Jehovai,—dhe shërbëtori im që unë kam zgjedhur; në mënyrë që të mund të dini e

të më besoni, dhe të kuptoni që unë jam ai: para meje nuk ishte formuar asnjë Perëndi tjetër, as nuk do të ketë pas meje. Unë, pikërisht, unë jam Jehovai; dhe përveç meje nuk ka shpëtimtar" . Besimtarët e Jehovait besojnë se Perëndia e tyre pati dëshmitarë mbi tokë gjatë mijëra vjetëve, para lindjes së Krishtit. Kështu pra, rreth 6.000.000 persona sot, të cilët po shpallin lajmin e mirë të Mbretërisë së Jehovait të drejtuar nga Jezu Krishti, në më shumë se 230 vende, mendojnë se quhen me vend Dëshmitarë të Jehovait.

Dëshmitarët e Jehovait besojnë te Perëndia i plotfuqishëm, Jehova është krijuesi i qiellit dhe i tokës. Sipas tyre vet ekzistenca e mrekullive të projektuara në mënyrë të ndërlikuar, në universin që na rrethon, tregon në mënyrë të arsyeshme se çdo gjë është bërë nga një krijues i mençur dhe i fuqishëm. Ashtu si veprat e burrave dhe grave pasqyrojnë cilësitë e tyre, ashtu është edhe me ato të Perëndisë Jehova. Sipas tyre zoti Jehova bëri çdo gjë për të përmbushur qëllimet e tij. "Perëndia, formuesi i tokës…, nuk e krijoi thjesht për asgjë. Ai e formoi madje për të qenë e banuar. Nuk do të shkatërrohet sepse toka mbetet përjetë. Qëllimi i Jehovait për tokën do të realizohet: «Këshilla ime do të qëndrojë dhe do të bëj çdo gjë që është kënaqësia ime" . Kështu, pra, Dëshmitarët e Jehovait besojnë se toka do të mbetet përgjithmonë dhe se të gjithë njerëzit, të

gjallë e të vdekur, të cilët do të përshtaten me qëllimin e Jehovait për një tokë të bukur e të banuar, mund të jetojnë në të përgjithmonë. I gjithë njerëzimi trashëgoi papërsosmëri nga Adami dhe Eva e, në këtë mënyrë, të gjithë u bënë mëkatarë. Duke cituar Biblën del në pah mjaft qartë flijimi dhe ringjallja e të gjithë atyre që besojnë në perëndinë Jehova: "Paga që paguan mëkati është vdekja. Të gjallët në fakt e dinë se kanë për të vdekur, por të vdekurit nuk dinë asgjë. Shpirti që mëkaton do të vdesë". Atëherë, si mund të jetojnë përsëri njerëzit për të marrë bekimet tokësore?- ngrihet pyetja në faqen zyrtare të Dëshmitarëve të Jehovait. Sipa tyre vetëm nëpërmjet flijimit shpërblerës të Jezu Krishtit mund të arrihet kjo gjë, pasi ai tha: "Unë jam ringjallja dhe jeta. Ai që ushtron besim tek unë, edhe sikur të vdesë, do të vijë në jetë. Të gjithë ata që janë në varret përkujtimore do ta dëgjojnë zërin e tij dhe do të dalin" . Ngjarjet e vitit 2005 që tronditën të gjithë opinionin publik shqiptar inkriminojnë organizatën "Dëshmitarët e Jehovait" ndoshta jo drejtpërdrejtë, por si nxitëse përmes doktrinës së tyre fetare të paraqitur më sipër në frymëzimin e vetvrasjeve të ndërmarra me një guxim të tepruar nga disa të mitur e disa të rinj në fazat e para të asoleshencës. Ngjarjet tronditëse të atyij viti u pasqyruan në median shqiptare. Pothuajse në të gjitha edicionet

informative të televizioneve kryesore të kryeqytetit këto vetvrasje përbënin lajmin e parë. Gjithashtu tragjeditë që pasonin njëra tjetrën u trajtuan dhe në faqen e parë të shtypit të shkruar dhe në mënyrë të përsëritur u theksua lidhja e "Dëshmitarëve" me viktimat. Ja disa raste të paraqitura në gazetën "Shekulli" gjatë vitit 2005 në versionin online të gazetës:

10 janar, Marenglen Tarja, gjendet I vetvarur në Mushqetë të Tiranës. 16-vjeçari

rekuentonte prej pak kohësh godinën ku kryente aktivitetin sekti "Deshmitaret e Jehovait" në Mushqetë. Marenglen Taraj u vetvar me litar në një pemë pranë shtëpisë së tij. Ngjarja ndodhi ditën e dielë dhe sipas disa bashkëmoshatarëve të viktimës Marengleni kishte deklaruar më parë: "Tani e kam radhën unë…Po të vdesësh të dielën është mirë, se ringjallesh të hënën…" Xhaxhai I viktimës deklaroi në atë kohë se ditë më parë, Genin e kanë parë të zbresë nga një furgon i "Dëshmitarëve të Jehovait" me libra në dorë. Ai akuzoi në mënyrë të drejtpërdrejtë sektin dhe deklaroi se: "E kemi ngritur problem, por deri tani nuk është marrë asnjë masë. Familjarët e viktimës nuk kishin vënë re ndonjë problem që mund të shqetësonte 16-vjeçarin përpara vendimit tragjik.

Më 12 shkurt Alda Cena, nxënëse në klasën e pestë në qytetin e Fierit u gjet e vetëvarur në tualetin e

shtëpisë. Fillimisht u fol se vajza e mitur kishte përqafuar "Dëshmitarët e Jehovait" dhe kjo u bazua në disa fletushka që policia gjeti në shtëpinë e viktimës. Por ky version i policisë u hodh poshtë që në fillim nga të afërmit e viktimës. Edhe versioni zyrtar e përjashtoi një gjë të tillë.

17 shkurt, vetëm pesë ditë pas vetëvrasjes së Aldës, vetëvaret bashkëmoshatarja e saj nga Tirana, Joana Rajdho, me prindër të divorcuar. Joana u gjet e vetëvarur nga gjyshërit e saj (nga nëna) në banjën e shtëpisë. Fillimisht, si shkak i vetëvrasjes u cilësua një notë katër, që ajo kishte marrë në lëndën e matematikës, por më pas dhe problemet familjare. Por shokët dhe shoqet e Joanës deklaruan të kundërtën. Ata thanë se vajza e vetëvrarë ishte "Dëshmitare e Jehovait". Dëshmitë e bashkëmoshatarëve të viktimës janë hedhur poshtë nga nëna e Joanës.

20 shkurt, vetëvaret në kasollen e bagëtive 13-vjeçarja Eriola Elezi, nga fshati malor i Velçanit në Mokrën e Sipërme në Pogradec. Sipas hetimeve të policisë, vajza nuk kishte asnjë arsye familjare që t'i jepte fund jetës. Ndërsa policia nisi hetimet intensive për zbardhjen e motiveve të kësaj ngjarjeje, kryetari i komunës, Ramazan Rapçe, deklaroi se viktima prej 3 muajsh frekuetonte një shoqatë fetare të njohur si "Dëshmitarët e Jehovait".

27 prill, vetëvaret 13-vjeçari Viron Dhani. Adoleshenti nga fshati Ndërmënas i rrethit të Fierit u gjet i vetëvarur me citate të broshurave të Jehovait. Sipas familjarëve, prej një viti, Vironi vuante nga epilepsia. Ende deri sot nuk janë saktësuar rrethanat e kësaj vetëvrasjeje, por burime të policisë që shkuan në vendngjarje thanë se adoleshentit iu gjetën në xhep citate të sektit "Dëshmitarët e Jehovait". Adoleshenti kishte rezultate të mira në shkollë.

1 maj, gjendet e helmuar Athina Nunka, 13-vjeçe, nga fshati Dishnicë i rrethit të Korçës. Ngjarja ndodhi në ditën e Pashkës, dhe sipas policisë adoleshentja ishte vetëhelmuar. Por një gjë e tillë nuk u pranua kurrsesi nga prindërit e saj. Sipas të afërmve, prindërit dhe motrat e Athinasë ishin në kishë kur ndodhi ngjarja. Viktima donte të shkonte me ta në kishë, por prindërit i kanë thënë se dikush duhet të qëndronte në shtëpi. Familjarët thanë se kishin gjetur në shtëpi karamele të dyshimta, që sipas tyre duhej t'i kishte sjellë dikush.

21 maj 2005, Alfred Hasa 25-vjeç, gjendet I vetvarur me litarë në dhomën e tij në lagjen Kombinat të Tiranës. Hasa ishte anëtar i "Dëshmitarëve të Jehovait". Menjëherë në vendngjarje mbërritën uniformat blu të Komisariatit numër 6 dhe mjekët eksperto-ligjorë, të cilët shënuan në dosjet e tyre rastin tjetër të vetëvrasjeve të sektit të

"Dëshmitarëve të Jehovait". Si shkak i një akti të tillë, mendohet të ketë ndikuar edhe papunësia, pasi Hasa prej 2-muajsh ishte larguar nga puna. Sipas burimeve nga Komisariati numër 6 I kryeqytetit, viktima ishte frekuentues i rregullt i "Dëshmitarëve të Jehovait" dhe kjo ishte bërë e ditur pas marrjes në pyetje të familjarëve të tij, vëllait të vetëm e dy prindërve dhe dërgimit në Prokurori të disa fletushkave fetare, të gjetura te sendet e tij personale. Si shkak i vetvrasjes ka qenë fillimisht mërzia që i ka shkaktuar papunësia dhe ky trishtim është pasuar me "prehjen" që gjendet në botën e përtejme, një nga pasazhet e frekuentuesve të "Dëshmitarëve të Jehovait". Ngjarja ndodhet ende nën hetimin e policisë.

Fenomeni I vetvrasjeve në Shqipëri filloi të "lulzonte" kur e mitura 11 vjeçe nga Tirana, me mbiemrin Rajdho, u gjet e varur në shtëpinë e saj. Sipas dëshmive të mbledhura gjatë asaj kohe e mitura ishte frekuentuese e rregullt e sektit Dëshmitarët e Jehovait.

Më pas, në Fier, Esmeralda Cena, me të njëjtën moshë, ishte viktima e dytë e kësaj vale të gjatë. Sipas burimeve nga gazeta "Korrieri" duke cituar deklaratat e policisë fierake, 11-vjeçarja ishte varur në banjën e banesës ku ajo jetonte, me shallin e saj të cilin e kishte kapur tek varesja e peshqirëve.

Në Mokër të Pogradecit, një javë më vonë regjistrohet një tjetër rast dhe sërish e vetëvarura në kasollen e bagëtive u zbulua se ishte anëtare e "Dëshmitarëve të Jehovait". Rasti I vetvrasjes së 25 vjeçarit Hasa regjistrohet si ndër më të rrallat në moshë madhore. Me daten 13 Shkurt 2005 Silvana Hoxha vdiq pasi refuzoi te merrte gjak per te shpëtuar. Nje vajze tiranase 24 vjecare, e semurë rëndë dhe e shtruar në spitalin e Tiranës, vdiq rreth dy vjet përpara kësaj ngjarje, duke refuzuar sipas familjes së saj, të shkelë besimin Jehovaj. Silvana Hoxha, e lindur ne Burrel, ishte Dëshmitare e Jehovait dhe bënte pjesë në këtë mision prej të paktën 9 vjetesëh. Ajo nuk i lejoi bluzat e bardha t'i jepnin gjak, edhe pse ishte shumë rëndë. Veshkat i ishin shkatërruar dhe ndodhej në dializë. Sipas të atit të viktimës, ai ishte grindur disa herë me pjesëtarë të sektit, pasi vinin shpesh në spital duke I kërkuar të sëmurës që të refuzonte transfuzion gjaku. Pak javë më vonë, në maj të 2002, Silvana ndeërroi jetë në spitalin " Nënë Tereza".

Sipas citimeve të dëshmitarëve të Jehovait, në faqen e tyre në internet në gjuhën shqipe, "është gabim që gjaku të hahet". Këtu, duke u shtruar pyetja: "A është gabim të pranohet transfuzioni i gjakut", jepet kjo pergjigje: "Mos harro, Jehovai kërkon që të permbahemi nga gjaku. Kjo do te thotë që në asnjë mënyrë nuk duhet të fusim në trup gjakun e një

personi tjetër, madje edhe gjakun tonë që është ruajtur mënjane. Për këtë arsye, të krishteret e vërtetë nuk pranojnë transfuzion gjaku. Ata pranojnë mënyra të tjera trajtimi mjekësor, te tilla si transfuzionin e produkteve pa gjak. Të tilla dogma dhe parime fetare aspak njerëzore dhe paradoksale për një sekt që predikon mirëqënien e njeriut bazuar në parimet sipas faqes zyrtare "Ëatchtoëer", u morën jetën të paktën dy adoleshenteve.

Si përfundim mund të themi se pa dashur të luajmë rolin e hetuesit, shteti shqiptar duhet ti trajtonte me seriozitet vetvrasjet tragjike të vitit 2005. Sikurse shihet edhe më sipër janë me dhjetra ngjarje të rënda vetvrasjeje nga persona që predikojnë sektin fetar Jehovaian. Sot pas 5-vjetësh, shumë ngjarje në rastin më të keq kanë mbetur pa përgjigje, mister dhe në rastin më të mirë u është gjetur një arsye e paarsyeshme, pa I kushtuar vëmendje rrezikut dhe gjurmve të dyshimta e të thella që lë pas ky sekt fetar I "pafe". Llogjika më con drejt pyetjes: çfarë arsyesh madhore mund të gjejë brenda vetes një 11-vjeçare e cila në mënyrë të ndërgjegjshme merr guximin e jashtëzakonshëm që të lidh vet kollaren apo litarin që si qëllim final ka marrjen e jetës së saj? Si ka mundësi që një adoleshente të mos pranojë transfusion gjaku pavarësisht se është koshiente se do të vdesë po të mos e pranojë këtë masë? Si ka mundësi që viktimat e

vitit 2005 perveçse ishin Dëshmitarë të Jehovait, skenat e vetvrasjeve kishin lidhje me njëra tjetrën? Këto janë pyetje që duhet të ngrejë shteti shqiptar për ti shkur deri në fund motiveve të vërteta të dhjetra vetvrasjeve tronditëse të vitit 2005. me gjithë akuzat e ngruitura nga familjarët dhe të afërmit e viktimave, të pasqyruara në gazetat "Shekulli" dhe "Korrieri", deri më sot shumë çështje kanë mbetur pezull dhe nuk kemi asnjë hetim të plotë nga shteti shqiptar, nga institucionet e drejtësisë dhe policisë mbi këtë sekt fetar të dyshimtë, i cili jo më kot është I ndaluar në disa vende të botës, madje dhe asaj perëndimore, të cilat më shumë se Shqipëria predikojnë lirinë dhe të drejtën e fesë.

RAMUSH HARADINAJ, DËSHTIMI I AKUZAVE SERBE

Shumëkush që e njeh sadopak Kosovën u trishtua dhe u befasua vërtet keqas nga gjuha mjaft e ashpër, me tone dhe konotacione krejtësisht paragjykuese, që u përdorur nga Kryeprokurorja e Tribunalit të Hagës, Karla Del Ponte, menjëherë pas rifillimit të procesit gjyqësor kundër njërit prej simboleve të rezistencës kosovare: Kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe ish-kryeministrit, Ramush Haradinaj.

Ai, që ajo e cilësoi "Kriminel i veshur me pushtet" mbetet njeri prej personaliteteve më të spikatura, jo vetëm në vendin e tij dhe në hapësirën mbarëshqiptare, por në të gjithë Ballkanin. Bëhet fjalë për njërin prej simboleve të rezistencës, për pinjollin e njërës prej familjeve më patriotike të Kosovës

(ndoshta e dyta në renditje pas legjendarëve Jashari), për atë që filloi dhe drejtoi luftën në njërën prej zonave operative më delikate, për themeluesin e një partie politike që theu mitin e Partisë Demokratike dhe që e para hyri në aleancë me rivalin tjetër të spektrit politik, Lidhjen Demokratike. Por, jo vetëm kaq.

Bëhet fjalë edhe për Kryeministrin më të suksesshëm dhe më efikas të vendit, pas konfliktit të armatosur. Pra, kjo fjali u drejtua ndaj, as më shumë dhe as më pak, por Heroit real të Kosovës moderne.

Tribunali i Hagës e akuzon zotin Haradinajn për vrasjen e 40 personave në 1998, gjatë konfliktit të armatosur. Dy prej bashkëpunëtorëve të tij më të ngushtë ndodhen gjithashtu me `të në bankën e të akuzuarve. Për prokurorin e çështjes, ky është dhe mbetet njeri prej rasteve më komplekse. Sipas tij, vështirësia qëndron tek fakti se një pjesë e dështmitarëve potencialë janë vrarë gjatë viteve dhe shumica e atyre që kanë vendosur të dalin përpara gjykatës, kanë kërkuar që të ruhet dhe të fshihet tërësisht identiteti i tyre. Sipas autoriteteve të gjykatës, bëhet fjalë për më shumë se një të dhjetën e tyre, duke vendosur kështu rekord për të gjitha çështjet penale të trajtuara deri më sot nga Tribunali. Megjithatë, ky element përbën vetëm njërën pjesë të realitetit. Tjetra, ka të bëjë me qëndrimin që kanë

mbajtur dhe mbajnë ndaj këtij procesi protagonistët kryesorë. Më konkretisht, dallimet konceptuale në këndvështrime mes prokurorëve të Tribunalit të Hagës nga njëra anë dhe diplomatëve perëndimorë dhe atyre të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, nga ana tjetër, që pavarësisht se janë ndër përkrahësit kryesorë të tezës së nxjerrjes së kriminelëve përpara drejtësisë, e kundërshtojnë fort dhe me stoicizëm.

Për diplomatët e huaj, Ramush Haradinaj ishte ndër politikanët dhe partnerët më të rëndësishëm në përpjekjet e tyre për vendosjen dhe konsolidimin e paqes dhe të stabilitetit. Kjo është kaq e vërtetë, sa ata u përpoqën që çështja e tij të mos dalë përpara gjykatës. Ky tashmë është fakt i superkonfirmuar dhe jo vetëm hamendësi.

Menjëherë pasi u ngrit dhe u bë publike padia e tij, ishte vetë Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë që e mbrojti lirimin me kusht të ish-kryeministrit; dhe njëkohësisht kërkoi që ai të mund të vazhdonte të luante një rol në politikë, ndonëse disi më i tërhequr dhe pa dhënë intervista. Ky është rasti i vetëm në historinë e Tribunalit, që një i akuzuar për krime lufte të lejohet të kthehet në vendin e tij për një periudhë dyvjeçare dhe të mund të merret me politikë, cilado qoftë forma.

Kontrasti është mëse i plotë dhe mëse i qartë, po të njihesh me dy qëndrime vërtet të kundërta. Ish-përfaqësuesi i OKB- së në Kosovë, Soren Jesen Petersen, për protagonistin e kësaj çështjeje është shprehur se: "Ai e shtyu përpara procesin e demokratizimit të Kosovës më shumë se kushdo tjetër dhe në një mënyrë krejtësisht unikale. Ai ishte mendjehapur dhe mjaft i saktë dhe është një politikan me vlerë të pallogaritshme, që i duhet vendit të tij në këto situata që po kalon". Nga ana tjetër prokurorët në Kosovë dhe Hagë u shprehën se, si Misioni i Kombeve të Bashkuara në Prishtinë ashtu edhe qeveritë perëndimore, u përpoqën që ta pengonin dhe frenonin gjykimin e tij. Zonja Del Ponte duke folur për këtë rast, u shpreh se kjo ishte "një çështje të cilën nuk donin të ndodhte dhe ishin shumë të paktë ata që e mbështetën, si në nivel lokal ashtu edhe ndërkombëtar".

Në Kosovë ai vlerësohet ndoshta si lideri më karizmatik, por njëkohësisht edhe si kryeministri më i suksesshëm, që brenda një periudhe të shkurtër kohore i dha ritëm, dinamikë dhe nivel të jashtëzakonshëm ekzekutivit. Mjafton të bisedosh me qytetarët për ta kuptuar një fakt të tillë.

E, ndërsa qeveria serbe e cilësoi si terrorist, zyrtarë të lartë ndërkombëtarë theksojnë se ai është tepër i rëndësishëm; madje edhe jetik, për të nxitur

bashkëjetesën dhe mirëkuptimin e shpartalluar ndëretnik.

Pas zotit Veton Surroi ai ishte i pari që e kuptoi se serbët e Kosovës, në çfarëdolloj kombinacioni, do të ishin pjesë e Kosovës së re. Fjala e tij kishte peshë dhe vlerë të pallogaritshme, pasi askush, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, nuk mund ta akuzonte atë për mungesë patriotizmi apo se po e tradhtonte Kosovën. Kredencialet e tij ishin dhe mbeten të mrekullueshme dhe të pasfidueshme. Kontributi i tij është i jashtëzakonshëm, si përpara ashtu edhe pas mandatit të arrestimit.

Nuk duhet harruar për asnjë moment se, gjatë trazirave më të rënda etnike që përjetoi Kosova e paskonfliktit, pra ato të Marsit të 2004, sipas vetë Kishës Ortodokse Serbe ai ishte personi, që me reputacionin dhe largpamësinë e tij të paturbulluar nga epshet nacionaliste, që i frenoi grupet agresive shqiptare për djegien dhe vandalizimin e disa prej manastireve dhe objekteve më të njohura serbe.

Akuza është e rëndë. Në të thuhet mes të tjerash, se njerëzit që kapeshin nga njësitë ushtarake që drejtoheshin nga komandant Haradinaj, lidheshin me tela me gjemba dhe tërhiqeshin me makina nëpër rrugë. Përkrahësit e zotit Haradinaj i kanë hedhur poshtë ato, duke i cilësuar trillime të trishta dhe të padenja për një tribunal.

Ata shtojnë se nuk ka prova që e lidhin emrin e ish-komandantit, me krime monstruoze të kësaj natyre. Sipas tyre, ka një dhe vetëm një arsye se përse është arrestuar zoti Haradinaj: dhe kjo ka të bëjë me faktin se Tribunali duhet të duket në opinionin e gjerë, si shumë i balancuar në punën e tij, pra, se nuk merret vetëm me krimet e kryera nga serbët, siç pretendon kryeministri serb, Vojisllav Koshtunica, por edhe të shqiptarëve.
Vetë zoti Haradinaj, si gjithnjë i drejtpërdrejtë në deklaratat e tij, është shprehur se përballjen me Hagën e sheh si mundësi jo për të mbrojtur veten, por historinë e lavdishme të UÇK-së. Dhe, ku ka më mirë që Heroi të mbrojë heroizmin!(Flori Bruqi,Floart-Press,27 prill 2007).

Kush është Ramush Hilmi Haradinaj?

Ramush Haradinaj u lind më 3 korrik të vitit 1968, në fshatin Gllogjan të Deçanit. Është i martuar dhe ka dy fëmijë. Shkollimin fillore e kreu në vendlindje, kurse atë të mesëm në Gjakovë. Ishte dëshirë e tij të studiojë për astronomi. Por, zhvillimet politike të kohës, atë e vendosën në një sferë tjetër të interesimeve dhe angazhimeve.

Në vitet 1998-99, Ramush Haradinaj ishte komandant i Zonës Operative të Dukagjinit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Zonën Operative të Dukagjinit.
Ka diplomuar në fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës dhe aktualisht ndjek studimet për Master i shkencave.
Ramush Haradinaj është ish-kryeministër i Kosovës, që doli pas zgjedhjeve të fundit nacionale në Kosovës (2004). Këtë përgjegjësi e mori më 6 dhjetor 2004, pas marrëveshjes për koalicion me Lidhjen Demokratike të Kosovës.
Më 8 mars 2005 Ramush Haradianaj jep dorëheqje nga posti i kryeministrit të Kosovës, pas aktakuzës që padrejtësisht iu ngrit nga Tribunali Ndërkombëtar i Hagës.
Ai, veç pas tre muajsh të akuzimit mori të drejtën e mbrojtjes në liri. Që nga qershori i vitit 2005 Haradinaj, mbrohet në liri. Kryen përgjegjësitë organizative dhe administrative si kryetar i AAK-së.
Është vëlla i tre dëshmorëve të kombit: Luan Haradinaj, vëlla i Ramush Haradinajt, ra në një betejë të UÇK-së me forcat serbe, më 6 maj të vitit 1997. Në ditët e fundit të luftës çlirimtare të UÇK-së, heroikisht ra vëllai tjetër i tij, Shkëlzen Haradinaj, një nga eprorët më të famshëm të UÇK-së.

Më 15 prill të vitit 2005, ka rënë në një pritë të organizuar vëllai i tretë i Hardinajve, Enveri, invalid i luftës së UÇK-së.

Ramush Haradinaj është aktualisht kryetar i AAK-së dhe pret lirimin e tij nga TPI-ja.

keto info jan te huazuara nga faqja zyrtare e Aleances www.aleanca.info Hero në luftë-hero në paqë:Ramush Haradinaj

Ndonëse i popullarizuar si ish kryeministër, ish komandanti i UÇK-së duhet ti mohojmë informatat e gazetave slave ,si dhe shumë informative tjera të MUP-it Jugosllavë si informative të rreme nga informatorët dhe bashëpunëtoret e komandant Ramushit,që gjeja gjenerali më trim i Kosovës ,ka "patur" aktivitete kriminale në pjesëmarrjen e tij në vdekjen e civilëve.

Në Ballkan shpesh thuhet se heroi i një personi është kriminel për personin tjetër. Ky përshkrim nuk do të mund të ishte i saktë se në përshkrimin e ish kryeministrit të Kosovës Ramush Raradinaj, i cili në mënyrë dinjitoze dha dorëheqje me 8 mars 2005 pasiqë tribunali i Hagës lëshoi aktakuzën për krime të luftës kundër tij.

Për rrafshin e Dukagjinit,Ramush Haradinaj është hero i modelit klasik-djali i vrazhdë dhe trim nga fshati që bëri vepra të mira duke pasur guximin të luftojë për idealet e tij.

Por për popullatën serbe nëKosovë, Ramush Haradinaj është simbol i dhunës dhe padrejtësisë. Ai konsiderohet si bandit i paskrupullt- vrasës që mbizotëroi një regjim terrori në Dukaxhin, regjionin perëndimor të Republikës së Kosovës në vitet 1998-1999 duke lënë nga pas gjurmë të kufomave civile,sipas informacioneve të MUP-it Jugosllavë. Njeriu që do të arrinte të ushtrojë respekt në masë të madhe nga ana e shqiptarëve dhe të nxisë hidhërim nga ana e serbëve ka lindur në fshatin Gllogjan më 3 korrik, 1968, fëmija i dytë nga nëntë femijë në familjen e tij.

Sikur të gjithë shqiptarët e Kosovës të lindur në vitet e gjashtëdhjeta, Ramush Haradinaj vijoi mësimet në shkollë etnikisht të përzier, dhe mësoi të flasë serbo-kroatisht.

Pas përfundimit të shkollës së mesme në vitin 1987, ai e kreu shërbimin e detyrueshëm ushtarak në APJ, duke treguar talent të mjaftueshëm ushtarak, gjë që çoi në gradimin e tij si oficer komandant-gjë e rrallë kjo për shqiptarët.

Pas ushtrisë, Ramush Haradinaj fillimisht deshi të studionte astronomi në Univerzitetin e Prishtinës, në atë kohë të udhëhequr nga rektori serb Radivoje Papoviç. Por ai deklaroi se i ishte pamundësuar një gjë e tillë për shkak se disa nga anëtarët e familjes së tij kishin pasur probleme me autoritetet komuniste

në komunën e vogël Deçan,rrënzë Alpeve Shqiptare. Në vend të studimit, ai shkoi në Lucern, Zvicër, ku së bashku me xhaxhanë e tij e krijoi një biznes për ndërtim. Gjatë një vizite të tij në Kosovë në mars të vitit 1991, Ramush Haradinaj u zu në mes të një vale protestash dhe kryengritjesh që po ndodhnin në Kosovë si reagim ndaj një numri të ligjeve anti-shqiptare të implementuara nën urdhërat e liderit serb Slobodan Miloseviq.

Ramush Haradinaj ishte mbajtur në paraburgim për një natë dhe ishte marrë në pyetje nga policia serbe e MUP-it të Deçanit dhe të Pejës. Pas lirimit të tij, ai u kthye në Zvicër ku u paraqit dhe më vonë iu dha azili politik.

Nga ekzili, Ramush Haradinaj përcjellte gjersa Sllobodan Miloseviq vazhdonte ta dezintegronte Kosovën duke i larguar shqiptarët nga univerziteti dhe duke i përzënë ata nga pozitat shtetërore të punës.

Ai u inkuadrua në Lidhjen Popullore të Kosovës, LPK, grup radikal i shqiptarëve emigrantë me banim në Zvicër, të cilët që një kohë ishin duke thirrur shqiptarët të përdorin çdo mjet të mundshëm- përfshirë këtu kryengritjen e armatosur- për të siguruar pavarësinë e krahinës.

Gjatë kohës në ekzil, ai u dashurua me një femër finlandeze dhe filloi të jetonte me të. Nga koha në

kohë, ai kthehej në Kosovë ilegalisht duke kaluar nëpër male nga Shqipëria, nganjëherë duke sjellur edhe armë me vete.

Në mars të vitit 1997, një varg investimesh mashtruese piramidale u shembën në Shqipëri, duke e sjellur vendin në një gjendje anarkie. Gjersa popullata atje ndërrmori një aksion të gjerë shkatërrimi-duke zbrazur arsenalet e miliona kallashnikovëve, granatave, minave tokësore, minahedhësve dhe municionit-Ramush Haradinaj fluturoi për në aeroportin e Rinasit ,në Shqipëri dhe filloi grumbullimin e armëve. Ai e dinte se tragjedia në Shqipëri do të shërbente për pajisjet për ushtrinë çlirimtre të Kosovës, UÇK.

Ai mblodhi një grup të njerëzve, duke përfshirë këtu edhe vëllain e tij, Luanin, në aksion të bartjes së armëve përtej kufirit. Në maj të vitit 1997, grupi i Ramush dhe Luan Haradinaj i ngarkuan armët në shpinë dhe kaluan kufirin për në Kosovë. Mirëpo pak pasiqë kaluan kufirin, ata u zunë në pritë nga trupat serbe. Luani u vra heroikisht nga soldateska serbe , dhe një nga personat tjerë u plagos rëndë.

Grupi u tërhoq dhe Ramush Haradinaj e barti trupin e vëllaut të tij përtej kufirit për ta varrosur dhe pastaj u kthye në Zvicër. “Kam qenë i humbur pas asaj ngjarje,” i tha Ramush Haradinaj mediave më vonë.

"Ndjehesha përgjegjës për vdekjen e vëllait tim. Doja të vazhdoja, por nuk mundesha gjatë asaj kohe."

Dy muaj më vonë, Haradinajt iu kthye vullneti. Ai u kthye në Shqipëri, kapërceu Alpet Shqiptaro-Shqiptare prapë për të ardhur në Kosovë dhe e themeloi bazën e tij në fshatin e lindjes në Gllogjan. Ai e shëndrroi shtëpinë e familjes së tij në bazë të UÇK-së dhe ndihmoi në ndërtimin e ushtrisë guerile të rajonit të Dukagjinit, duke e transformuar një grup të paorganizuar të djemve të rinjë në një forcë që do ta trondiste regjimin serb.

Në mars të vitit 1998, gjatë përpjekjeve të tyre për ta eliminuar UÇK-në, trupat serbe ndërrmorën një sulm në bazën rebele në Gllogjan, duke përdorur helikopterë dhe makina të blinduara.

Duke iu falenderuar një vargu të rastësive fatlume dhe konfuzionit nga ana serbe, grupi e mbijetoi sulmin, edhepse Ramush Haradinaj u plagos disa herë.

Gjatë dy viteve të ardhshme,Ramush Haradinaj do ta humbte edhe vëlla tjetër dhe disa nga shokët e tij të ngushtë në luftime. Por gjersa UÇK shëndrrohej në një forcë guerrile, Ramush Haradinaj e fitoi reputacionin e një lufëtari që nuk i frikësohet asgjëje.

Së shpejti ai zhvilloi marrëdhënje me zyrtarët e SHBA-ve duke u bërë i vlefshëm për ta ushtarakisht dhe për intelegjencë.

Mirëpo, edhe pse ai respektohej në mesin e bashkëluftëtarëve të tij dhe konsiderohej i vlefshëm nga amerikanët, ai ngjallte frikë tek secili që guxonte ti vinte në dyshim veprimet e tij.

Sipas skenareve të MUP-it të Beogradit, gjegjsisht krerëve të MUP-it të Pejës, Deçanit, Prishtinës thuhet se "…njësiti i UÇK-së i Ramush Haradinaj ka kidnapuar dhe vrarë 40 civilë serbë të cilët konsideroheshin të zhdukur në vitin 1998 dhe 1999. Disa nga këto kufoma gjëja janë gjetur në faza të ndryshme të dekompozimit në kanale që derdhen në liqen afër Gllogjanit. Trupat e disa civilëve tjerë janë gjetur në fund të puseve".

Gjithashtu,poashtu sipas mediave të Beogradit "… supozohet se njësiti i Ramush Haradinaj ka vrarë shqiptarë". Në fund të dhjetorit të 2002, vëllau i Haradinaj, Dauti, u dënua nga gjykata e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (në Pejë) me pesë vjetë burgim për pjesëmarrjen e tij në kidnapimin, torturimin dhe vrasjen e katër anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës (FARK), të cilët ishin rivalë të UÇK-së gjatë konfliktit. Dauti, para 5 muajsh u lirua nga burgu i Dubravës dhe u prit nga bashkëvendasit e tij për here të dytë si hero i popullit, ngase edhe është hero!

Pas luftës, Ramush Haradinaj u zgjodh zv.komandant i Trupave për Mbrojtjen e Kosovës (TMK), forcë kjo e

krijuar sipas modelit të Gardës Kombëtare të SHBA-ve. Sidoqoftë, pas një kohe Haradinaj dha dorëheqje nga posti i tij dhe e themeloi partinë e tij politike, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, AAK.

I rrjedhshëm në gjuhën frënge dhe angleze, politikani i ri la përshtypje të mira tek zyrtarët e huaj dhe gazetarët, dhe gjersa partitë tjera politike përqëndroheshin kryesisht në çështjen e pavarsisë, Ramush Haradinaj mbështeste rëndësinë e ndërtimit të rrugëve dhe shkollave.

Edhepse shumica e respektonin të kaluarën luftarake të Ramush Haradinaj, partia e tij politike në fillim nuk gëzonte përkrahje të gjerë popullore, dhe mbetej e treta në distancë pas partisë së Akademik Ibrahim Rugovës Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dhe partisë së liderit të UÇK Hashim Thaçi, Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

"Ramushi nuk është njeri i politikës," I tha IWPR një nga bashkëluftëtarët e tij në vitin 2000 kur Ramush Haradinaj hyri në skenën politike për herë të parë. "Kur flas me të, mund ta bëj të qesh një minutë, dhe ta bëjë të më vrasë minutën tjetër. Nuk mund të jesh emotiv në politikë."

Në fakt, gjatë garës për zgjedhjet komunale në Kosovë në vitin 2000, temperamenti i Ramush Haradinaj shpesh dilte jashtë kontrollit.Ramush Haradinaj

përfundoi në një përleshje fizike me ushtarët rusë paqeruajtës në një kalim kontroll.

Disa muaj më vonë, ai ndërmorri një veprim politik të gabuar edhe më të madh. Pasi disa nga rivalët e tij nga koha e luftës-familja Musaj-e konfrontuan babanë e tij duke kërkuar të dijnë se ku ishin familjarët e tyre të zhdukur, Ramush Haradinaj u zemërua tej mase. Ai dhe disa nga përkrahësit e tij udhëtuan tek shtëpia e familjes Musa në fshatin Strellc në ora një të mëngjesit, u ngjitën mureve dhe e konfrontuan familjen. Një shkëmbim zjarri pasoi në vijim ku u përdorën edhe granata, dhe Ramush Haradinaj përfundoi i plagosur.

Pas incidentit, Ramush Haradinaj u bart me helikopter në bazën ushtarake amerikane në Kosovë, dhe më vonë u trajtua për plagë të shkaktuara nga granatat në një spital ushtarak amerikan në Gjermani. Më vonë, zyrtarët amerikanë në Kosovë do të akuzoheshin për ndërhyrjen e tyre në hetimet e OKB-së të incidentit.

Në vitet që pasuan, stili i jetës së Ramush Haradinaj shkaktonte ngritje të vetullave në Kosovë. Ai u nda nga partnerja e tij finlandeze, u martua për së dyti dhe u vendos në një shtëpi luksoze në lagjën Arbëria në Prishtinë. Edhepse shtëpia thuhej ti ishtë dhënë nga miqtë e tij, shume anmiqë të tijë politikë e

vështronin një gjë të tillë me zili,ngase vetë Ramushi më vëllëzër dhe baban e tijë e ndërtuan.

Ndërkohë, mediat e ndryshme si fjala vjen "Koha ditore" e Veton Surroit, shpifte më të madhe "se ai kishtë bërë krime lufte dhe ishte i përfshirë në tregëtinë e paligjshme të duhanit".

Përkundër komenteve kontraverze të Beogradit, kundërshtarëve të tij politikë, Ramush Haradinaj mbetej person më i popullarizuar në Rrafshin e Dukagjinit dhe në tërë Kosovë...

Biografia e tij në dy pjesë në formë të intervistës së zgjatur u publikua nga bashkëvendasi I tij ,publicisti I shquar shqiptar Bardh Hamza, në "Zëri" të Prishtinës (nga një ndër shtëpitë botuese më të famshme në Kosovë), dhe ishte ndër librat më të shitur. Në Rrafshin e Dukagjinit, ai gëzonte përkrahje besnike. "Ne kemi njerëz tjerë për politikë," thonin fshatarët e rajonit të Dukagjinit. "Por nëse serbët kthehen, ne e kemi Ramushin."

Pas zgjedhjeve, AAK hyri në koalicion me partinë në udhëheqje LDK dhe Ramush Haradinaj u zgjodh kryeministër i Kosovës.

Emërimi i tij i zemëroi si serbët, kundërshtarët politikë tjerë,poashtu edhe diplomatët perëndimorë, shumica prej të cilëve i bënë thirrje Misionit të OKB-së në Kosovë të pengojnë emërimin e tij. Gazeta "The New York Times" kritikoi ashpër emërimin e tij në një

editorial.
Mirëpo, Soren Jessen-Pettersen, shefi i Misionit të OKB-së në Kosovë, refuzoi të intervenojë, duke deklaruar se, "Nëse unë do ti thoja Jo këtij emërimi, unë do ti thoja Jo demokracisë."
Sipas të gjitha burimeve, pasiqë u emërua, Ramush Haradinaj dëshmoi të jetë një lider efektiv dhe dinamik, duke mbështetur një pilot projekt që i ofronte Kosovës një pavarësi (të kushtëzuar). Më 8 mars 2005, pasiqë gjykata për krime të luftës pranë OKB (Hagë) e konfirmoi aktakuzën kundër tij, Ramush Haradinaj e shpalli dorëheqjen e tij prej kryeministri dhe u betua se do të udhëtonte për në Hagë të ndeshej me akuzat e Karla Del Pontës, kundër tij.
Gjatë dorëheqjes, Ramush Haradinaj thirri popullin për qetësi dhe apeloi kundër protestave të dhunshme.
Por kur ai do të thirret të përgjigjet për të kaluarën e tij si komandant i forcave guerrile, shumë frikësohen se temperamenti i tij do të del në sipërfaqe, gjë që mund të sjellë trazira dhe mund ti japë fund paqes së brishtë në Kosovë.
"Ai mund të jetë në paraburgim nga tribunali, por përkrahësit e tij vetëm janë duke bërë plane," thoshin banorët e fshatit tim, Isniqit, në një tubim masiv kur u burgos Ramushi.

Ramushi gjatë vitit 2007 duhet edhe një herë të përballohet më akuzat e Tribunalit të Hagës, por gjithsesi ai do të lirohet nga aktakuza ngase gjenerali, guerili dhe heroi i Dukagjinit nuk ka bërë krime lufte, por ka mbrojtë popullin nga soldateska e satrapit dhe kriminelit Sllobodan Millosheviqit.

Ramush Haradinaj u kthye nga beteja e Hagës me 5 prill ku u shpall i pafajshëm nga të gjitha akuzat. Amerikanët e cilësojnë si një hero të gjallë sepse shkoi si kryeministër dhe u kthye si hero.

SHQIPËRIA NATYRORE SI REALITET

Shqipëria Natyrore e ka frikësuar Beogradin dhe Athinën. Serbia dhe Greqia po përpiqen të ndalojnë rritjen e rolit të shqiptarëve në rajon, fenomen i cili po mbështetet nga SHBA. Nga paniku i Shqipërisë së Madhe, Serbia dhe Greqia po përpiqen të ndalin këtë fenomen, duke kërkuar shpërbërjen e Maqedonisë. Disa ekspertë të rajonit janë shprehur për gazetën serbe "Novosti" se, Shqipëria e Madhe nuk është një projekt i parealizueshëm, praktikisht funksionon që tani. Ata madje thonë se më vonë gjithçka do të bëhet "çështje e mbyllur" dhe kjo do të ndodhë pa asnjë konflikt madhor mes shteteve të rajonit. Ndërsa politologia kroate Jadranka Poloviç, thotë se, Hillari Klinton vizitoi rajonin dimrin e kaluar ku vetëm në Maqedoni nuk vajti. Kjo sipas saj ishte "dënim me

vdekje" për këtë shtet dhe "Shqipëria e Madhe" do të nisë me shpërbërjen e Maqedonisë.

Analisti politik grek, Dimitris Panatojakis, thotë se shqiptarët presin që bashkimi i tyre në një shtet të ndodhë në vitin 2016. Sipas tij Uashingtoni dhe Brukseli kanë shpenzuar shumë për këtë qëllim. Ai thotë se ndoshta "Shqipëria e Madhe nuk do të jetë formale por legalisht dhe praktikisht ajo funksionon që tani sepse kufijtë mes Kosovës dhe Shqipërinë nuk ekzistojnë dhe mes Kosovës dhe Maqedonisë ato janë më shumë imagjinarë se sa real. Historiani dhe politologu serb, Dragan Petroviç thotë se ky projekt ka mbështetjen e SHBA-ve, Britanisë së Madhe dhe një pjesë të mirë të Gjermanisë. Por ai thotë se, nëse vendet e rajonit, si Serbia, Mali i Zi, Maqedonia dhe Greqia bashkëpunojnë atëherë faktori shqiptar nuk do të ketë shanse të realizojë këtë projekt. Vendet që sipas tij nuk e mbështesin këtë koncept janë Franca, Spanjë, Italia, Sllovakia dhe Rumania.

E përditshmja New York Times në një artikull, marrëveshja e nënshkruar mes Serbisë dhe Kosovës vleftëson agjendën e dhunshme nacionaliste të "Serbisë së Madhe" të promovuar nga Sllobodan Millosheviçi, i cili vdiq në burg në vitin 2006, ndërsa përballej me akuzat për krime lufte. Kjo gjithashtu, thuhet në artikull, inkurajon aspiratat për një "Shqipëri të Madhe" në mesin e shqiptarëve etnikë në

Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi. Por, gazeta thekson se marrëveshja nuk do t'i pajtojë dy kombet ballkanike, e as nuk do t'i ndihmojë ato që të fitojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian. "Për t'i bërë gjërat edhe më keq, të dy shtetet thanë në këtë javë se nuk mund të pajtohen për një afat kohor për zbatimin e marrëveshjes", shkruan David L. Phillips, drejtor i Programeve në Institutin për Studimin e të drejtave të Njeriut, në Universitetin Columbia, është edhe autor i "Çlirimi i Kosovës: Diplomacia Detyruese dhe Intervenimi i SHBA-së". "NYT" thekson se kjo pengesë nuk është asgjë krahasuar me shkallën e masakrave të Ballkanit në vitet e '90-ta, por përfaqëson një dështim të vazhdueshëm për ta lënë pas të kaluarën e trazuar dhe për të vazhduar drejt integrimit me pjesën tjetër të Evropës.

Marrëveshja, e nënshkruar më 19 prill, pranon se Serbia, e cila nuk e njeh pavarësinë e Kosovës të shpallur në vitin 2000, ka një rol të vazhdueshëm në mbrojtjen e interesave të serbëve në veri të Kosovës. Në fakt, ajo ndan Kosovën në zonë qendrore me shqiptarët dhe me një shtojcë serbe. Shumica e 1.7 milionë banorëve të Kosovës janë shqiptarë të përkatësisë myslimane, por një pjesë e konsiderueshme e serbëve dhe të pakicave ortodokse në veri kanë mbrojtjen e NATO-s dhe janë autonomë

nga qeveria kombëtare.

****

Ekspertët rusë kanë vlerësuar se në vitin 2035 do të formohet “Shqipëria Natyrale ”.

Sipas tyre, në Ballkan do të ketë ndryshime të mëdha kufijsh.Ekspertët besojnë se Shqipëria dhe Kosova do të bashkohen.

Ndryshimet sipas tyre do të fillojnë në Britani, kur Skocia do të shpallë pavarësinë dhe pastaj do të bashkohet me Irlandën.

Katalonjasit dhe baskët do të shpallin pavarësi për shkak të nivelit të lartë të papunësisë në Spanjë, kurse kjo do të ketë ndikimin e saj edhe në Francë, ku do të krijohet shtet islamik.

Gazeta ruse Ekspress, shkruan se në Ballkan Bosnja do të ndahet nga Kroacia dhe Serbia, ndërsa një pjesë e Maqedonisë do të jetë e bashkuar me Shqipërinë dhe me Kosovën.

***

Perëndimi duhet të heqë dorë nga fantazia se paqja afatgjate në Ballkan mund të arrihet me izolimin e Serbisë, por edhe Beogradi duhet të bëjë kompromis e ta njohë Kosovën shtet, ka vlerësuar në The Observer eksperti amerikan për siguri dhe ish -analisti i Agjencisë Kombëtare për Siguri (NSA) John

Schindler, transmeton Koha.net. Sipas Schindlerit, "Shqipëria e madhe gjithsesi po vjen dhe është më mirë që ajo të vijë në kushte paqësore".

Ai mendon se Kosova duhet t'i bashkohet Shqipërisë, ndërsa Serbisë duhet t'i takojë rajoni i Mitrovicës verore e Kosovës Lugina e Preshevës. Autori shton se objektet fetare serbe duhet të vihen nën mbrojtjeje të KB-së dhe të shpallen eksterritoriale.

Autori thotë se nga korrigjimi i hartës në Ballkan, humbëse e madhe do të jetë Maqedonia dhe se Shkupi, në këmbim për humbjen e pjesës veriperëndimore të vendit, që me shumicë popullohet nga shqiptarët, duhet që para të gjithë të tjerëve ta marrë ftesën për anëtarësim në BE e ndihma nga Perëndimi.

Sipas Schindlerit Putin po përpiqet të shkaktojë probleme në Ballkan, porse, thotë ai, nga Moska mund të pritet bashkëpunim në këmbim të territoreve nëse Kremlini trajtohet partner i barabartë.

Ai e përshkruan Be H-në si "pseudo-shtet që nuk është shëruar kurrë nga katastrofa e viteve 1992 – 1995" dhe ka shtuar "miliarda dollarë të ndihmës perëndimore janë humbur nga kriminaliteti e korrupsioni ".

"Le t'i bashkohet Republika Srpska Serbisë", ka shkruar Schindler, duke thënë se askush nuk mund të

shpjegojë në mënyrë racionale pse kufijtë e Serbisë nga koha e komunizmit mund të ndryshojnë e kufijtë e Bosnjës nuk munden.

Autori i tekstit thekson se "kroatëve etnikë nga Hercegovina perëndimore duhet lejuar t'i bashkohen Kroacisë dhe përkujton se shumica e kroatëve të atjeshëm tashmë kanë pasaporta kroate. Ai mendon se pjesës së mbetur të B e H-së duhet mundësuar që të shkojë rrugës së vet dhe me procedurë të përshpejtuar të pranohet në NATO dhe në BE "Vetëm pasi Perëndimi të pranojë se popujt e Europës Juglindore mund të arrijnë paqen pasi të jetojnë në kombet –shtete koherente, sikur Gjermania, Polonia ose Danimarka, mund të presim që Ballkani të qetësohet dhe të fillojë së zgjidhuri problemet serioze të varfërisë, kriminalitetit e korrupsionit", thotë Schindler .

Është koha që Perëndimi të pranojë dështimin e vet dhe që Europës Juglindore t'ia japë atë që vërtetë i duhet, shtetet-kombe normale me kufij koherentë duke përmirësuar kështu hartën e Titos, ka thënë Schinlder.

****

Kryetari i Këshillit Kombëtar të Luginës, Jonuz Musliu thotë se edhe vetë kryeministri i Serbisë, Aleksandar Vuçiq e di se do të ndodh Shqipëria Natyrore.

Këto komente Musliu i bëri në emisionin 'InfoBox' të RTV Dukagjinit, duke thënë se bashkimi i tokave bëhet kur të bashkohen kokat.

"Jo që besoj, por kjo do të bëhet realitet. Nuk kanë besuar që Kosova do të jetë e pavarur, por kjo është bërë, është realitet. Me këtë mund, me këtë gjak, me këta dëshmorë, me këto lëvizje që kanë ndodh në hapësirat shqiptare, edhe kjo do të ndodh. Por, duhet të kenë vullnet shqiptarët për bashkim, pastaj faktorët e tjerë", tha ai.

Por, Musliu shqetësohet për unitetin e shqiptarëve në përgjithësi, e veçanërisht në Luginë, duke thënë se po korruptohen lehtë.

"Neve na duhen zgjedhje kombëtare, nuk na duhen me lloj-lloj pisllëqesh të cilat po bëhen. Në politikën shqiptare investon edhe Serbia, në Luginë të Preshevës. Marrin para, i blejnë votat, ka plotë", tha ai.

Megjithatë, ai kërkon një angazhim më të mëdha nga ana e Prishtinës dhe Tiranës zyrtare, për të ndihmuar shqiptarët e Luginës. Madje, Musliu tregon faktin që Serbia për serbët e Kosovës ndan 400 herë buxhet më shumë se Kosova e Shqipëria bashkë për shqiptarët e Luginës.

"Kosova nuk ka investuar sa duhet. Shqipëria nuk ka investuar edhe përkundër kërkesave që kemi bërë në këtë drejtim. Së paku të jetë fondi special për Luginën

e Preshevës. Dhe këto mbledhje që bëhen, duhet të ndahet një fond. Kur Serbia ndanë diku rreth 40 milionë euro zyrtarisht për çdo vit për Serbët e Kosovës, ne kemi marrë njëqind mijë euro nga dy qeveritë", tha ai.
Kryetari i këtij këshilli, propozon që të ketë një zyrë koordinuese për shqiptarët e kësaj pjese, duke përmendur pretendimet e Serbisë për të okupuar territore dhe trysni të tjera që u bënë shteti serb.

***

Mediet serbe, edhe pas po thuaj tri javësh, vazhdojnë të shkruajnë me alarmim për takimin e Qeverisë së Kosovës me atë të Shqipërisë në Tiranë me ç'rast u nënshkruan disa marrëveshje bashkëpunimi.
Këtë takim, gazeta e Beogradit "Veçernje Novosti", e sheh si një parahyrje në krijimin që ajo e quan Shqipëria e madhe.
Në një tekst të vetin në on line gazeta shkruan se Shqipëria , ose siç e quan ajo, ëndrra për bashkimin e gjithë shqiptarëve, është bërë ankth i Serbisë, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Greqisë, territoret e të cilave do të duhej t'i përfshinte.
"Ka ëndërr që bëhet zhgjëndërr. E tillë është ajo për Shqipërinë e madhe, të cilës po i vjen realizimi, ka thënë për këtë gazetë historiani serb Lubodrag Dimiq. Që nga Lidhja e Prizrenit ku projekti po realizohet

edhe ushtarakisht e politikisht, edhe me ekonomi e me kulturë … E ëndrra do të realizohet në kuadër të hapësirës së përbashkët evropiane .

Projekti i Shqipërisë së madhe, sipas Dimiqit transmeton koha.net, përfshin katër vilajete: të Kosovës, të Manastirit, të Janinës dhe të Shkodrës dhe ky, thotë ai, rrezikon kufijtë e katër shteteve ballkanike.

Sipas historianit nga Mali i Zi, Budimir Aleksiq, hap i rëndësishëm në këtë drejtim është bërë kur u bombardua Serbia në vitin 1999 dhe kur, sipas tij, u rrëmbye Kosova.

"Në radhë tani është Maqedonia. Kërkesat për federalizim të Maqedonisë janë vazhdimi më serioz i procesit që përcaktohet si projekt shqiptaro- madh në jug të Ballkanit. Pastaj në radhë është Mali i Zi ku shqiptarët të vetat i konsiderojnë katër komuna: Ulqinin, Plavën, Rozhajën dhe Podgoricën, thekson Aleksiq..

Bashkëbiseduesit e kësaj gazete theksojnë se projekti Shqipëri e madhe "gjithmonë ka pasur sponsorët e vet në botë – gjatë Lidhjes së Prizrenit ishin anglezët, në Luftën e Dytë Botërore gjermanët e tani janë ShBA dhe BE.

NATO, në krye me Amerikën, shkallë- shkallë po e krijon Shqipërinë e madhe, pohona Aleksiq.

Ndryshe mendon Dushan Prorokoviq, drejtor i Qendrës për alternativave strategjik në Beograd. Ai konsideron se krijimi Shqipërisë së madhe është pak i mundshëm.

“Problemi se edhe vetë përpjekja e krijimit destabilizon gjithë Ballkanin, edhe pse disa fuqi perëndimore do të kenë interes që deri diku ta destabilizojnë këtë hapësirë në të ardhme”, ka thënë Prorokoviq.

Krijimi i Shqipërisë së madhe i përgjigjet vetëm shqiptarëve thotë Prorokoviq,dhe shton se fuqitë e mëdha nuk i kanë shikuar mirë projektet shtetmëdha të popujve të vegjël ballkanikë.

***

“Projekt i Shqipërisë së madhe mund të realizohet vetëm me luftë madhe ballkanike, kjo është e qartë për të gjithë, këtë duhet ta ketë të qartë Brukseli”, ka thënë Aleksandar Vulin duke reaguar ndaj deklaratave të Edi Ramës e Hashim Thaçiq se “nëse ngec anëtarësimi në BE, atëherë në opsion është bashkimi i Shqipërisë dhe Kosovës.

“Prishtina e Tirana kanë thënë qartë ç’qëllim kanë e ai është “Shqipëria e madhe dhe bashkimi i të gjithë shqiptarëve në një hapësirë etnike. Kjo mund të bëhet vetëm me luftë të madhe ballkanike dhe e gjitha kjo duhet t’i jetë e qartë për Brukselin, i cili nëse nuk

është në gjendje ta gjykojë, duhet 'ua bëjë me dije se kjo sjellje do të dënohet, se në rast të tillë gjithë përgjegjësinë për ngjarjet e ardhshme do të bien mbi të", citon tanjug të ketë thënë Aleksandar Vulin, ministër serb për çështje sociale e të luftës.

Ai ka thënës se "reagimet e tilla të buta nga Brukseli, në të cilat, sipas tij, pothuaj shprehet mirëkuptim për hidhërimin e Edi Ramës dhe kërcënimin me luftë ballkanike, atëherë ka qenë e pritur që të paraqitet edhe Thaçi.

"Përgjegjësia nuk është më as në Shqipëri e as në Kosovë, sepse ne e dimë se ato gjithmonë kanë ëndërruar Shqipërinë e madhe, se do ta ëndërrojnë gjithmonë, se do të bëjnë çmos që ta realizojnë, nëse nuk ndalen, nëse nuk dënohen para se t'ia fillojnë.

Edhe Prishtina e edha Tirana e thanë qartë ç'qëllim kanë. Qëllim e kanë Shqipërinë e madhe dhe bashkimin e të gjithë shqiptarëve kudo që janë në një hapësish etnike. Përgjegjësia tani është te Brukseli", ka thënë ai.

***

Vajza e ish liderit famëkeq të Jugosllavisë, Sllobodan Millosheviç, thotë se babai i saj nuk është përgjegjës për luftën dhe akuzon për këtë Tuxhmanin dhe Izetbegoviçin. "Ai nuk kishte asgjë të përbashkët me ata", thotë Marija duke shtuar se "babai im është

vrarë nga Rendi i Ri Botëror" dhe se kjo ishte parashikuar që në vitin 2000.

Marija në një intervistë për gazetën serbe "Novi Standard", Marija thotë për babain e saj se ai çdo punë që bënte, si student, si banakier, si president, si baba, i kryente me përsosmëri. Ajo cilëson "fatkeqësi" personalitetin e tij superior pasi kjo provokoi zili dhe urrejtje tek të tjerët.

Marija lidhur me luftën me ish-republikat e Jugosllavisë, thotë se ajo u nxit nga vetë ato dhe jo Serbia. "Kryetar i Presidiumit ishte Stjepan Mesiç, i cili si president i parlamentit kroat tha ne 5 dhjetor 1991: "Unë mendoj se e kam kryer detyrën, Jugosllavia nuk është më.".

Në të njëjtin vit, me 23 dhjetor, Gjermania njohu pavarësinë e Kroacisë dhe filloi një luftë civile. Disa muaj më vonë, Tuxhman në Zagreb ka thënë: "Lufta do të ketë nëse nuk e duan Kroacinë. Ndërkohë që po zhvilloheshin negociata, formuan njësitë e e armatosura. "Dhjetor 1991.

Alija Izetbegoviç, tha: "Bosnja dhe Hercegovina e pavarur, unë jam i gatshëm të sakrifikojë për paqe". Në Bosnje erdhën luftëtarëve të shenjtë nga shumë vende islamike për të krijuar shtetin e parë islamik në Evropë", shprehet vajza e Millosheviçit.

Marija nënvizon se lufta për shpërbërjen e Jugosllavisë nuk ka përfunduar ende, duke thënë se

janë Sanxhaku (Kosova) dhe Vojvodina. “Pas marrëveshjes së Dejtonit, ka pasur një takim të vendeve të Evropës Juglindore në Kretë në vitin 1997. Kryeministri shqiptar, Fatos Nano, tha publikisht se Kosova është një problem i brendshëm e Jugosllavisë. Pastaj babai nënshkroi një marrëveshje me Rugovën”, thotë ajo për “Novi Standard”.

Ajo thotë se “SHBA-të po përpiqeshin të gjenin gjuhën e përbashkët në favor të interesave të tyre ndërsa Millosheviçi u përpoq për të gjetur gjuhën e përbashkët me ta në favor të interesave serbe”.

Në fund ajo flet edhe për Shqipërinë e Madhe, gjë e cila thotë ajo po bëhet e arritshme. “Një hartë e Shqipërisë së Madhe po bëhet më e arritshme për të gjithë sllavët e jugut të Ballkanit. Të gjithë duhet ta kuptojnë se rregullat nuk janë për një Serbi të Madhe por po bëhet Shqipëria e Madhe”.

***

Ndërsa kryeministri shqiptar Edi Rama ,kohë më parë ka thënë : ” Shqipëria e madhe apo Shqipëria e natyrale nuk janë nocione që janë prodhuar nga ne. Shqipëria natyrale është një nocion që është prodhuar nga të tjerë, të cilët janë trembur apo e kanë krijuar atë për shkak të axhendave të ndryshme, por kjo është si të thuash t’u vësh fajin grekëve sot

për Megala Idea që ishte një ide e një kohe të caktuar që nuk ka të bëjë me vendet tona.

Shqipëria natyrore është Shqipëria europiane. Ne kemi një histori shumë interesante duke qenë se jemi një komb me dy shtete. Ka shqiptarë në Maqedoni, Mal të Zi…. si dhe :"Ka qenë një zonë që quhet Çamëri ku shqiptarët jetonin dhe për fat të keq nuk është ajo çka ju them fëmijëve.

Njerëzit as nuk mund të shkojnë atje ku kanë qenë shtëpitë e tyre dhe fëmijët e tyre, për shkak të çfarë?

Nuk kemi asnjë lloj pretendimi që të marrim territore për të marrë pjesë të Greqisë apo Serbisë, por ka ardhur koha t'i kalojmë këto pengesa dhe ti themi a është e mundur që ata 80-vjeçar gra dhe burra që janë detyruar të largohen me forcë nga shtëpitë e tyre dhe mos ti lënë të shkonin.

A është e mundur që personat të kalojnë kufijtë e Greqisë. Çfarë ka këtu? Meqë ra fjala do doja të thosha se duke u mbajtur peng i këtyre temave dhe duke i mbajtur peng të së shkuarës ne e ushqejmë nacionalizimin dhe u japim linjë për të ekzistuar.

Pse mos ta shohim me sy ketë se po këta njerëz janë çrrënjosur nga shtëpitë e tyre dhe shtëpitë e tyre kanë të drejtën të kthehen nëse dua dhe të pretendojnë nëse i duan pronat.

E ardhmja jonë duhet të përcaktohet nga një vullnet i përbashkët. Çfarë do bëjmë luftë? Do ndryshojmë

kufijtë? Ne nuk duam ta bëjmë Shqipërinë më të madhe gjeografikisht, por më të madhe sa i takon demokracisë së saj dhe begatisë.”,tha Edi Rama.

***

Ish-sekretari politik në ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar në Shkup, Timothy Less nuk heq dorë nga ndarja e shteteve. Ai, edhe një herë tërhoqi vëmendjen e opinionit, prej kur e publikoi analizën e tij në “Foregin Policy”, në të cilën kërkoi formimin e Serbisë, Kroacisë dhe Shqipërisë së Madhe.

Media maqedonase e citojnë atë të ketë mbrojtur sërish idenë se si zgjidhje për Ballkanin do ishte Shqipëria e Madhe, Serbia e Madhe dhe Kroacia e Madhe me ndarjen e Maqedonisë.

Ato i janë referuar një shkrim tjetër të tij të fundit, ku ai për Maqedoninë rekomandon recetën e pakicës shqiptare që të marrë një formë të pavarësisë apo federalizim dhe pastaj shqiptarët të bashkohen me atdheun e Shqipërisë.

Sipas tij, mbi vendosjen e kufijve ka pasur tre skenarë, ku më të mirën për Ballkanin do të mund ta zgjidhnin Britania e Madhe, Gjermania, Franca, Rusia dhe Turqia me ndihmë të SHBA-ve.

Ai më tej thotë se perëndimi nuk është në gjendje të ndalojë pakicat kombëtare të bashkohen me shtetet e tyre amë. Për këtë ai e përmend referendumin e

boshnjakëve të Serbisë me ndihmë të Rusisë, ndërsa perëndimi sipas tij, nuk reagoi fare.

***

Edhe pse krerët në Prishtinë dhe Tiranë mohojnë ambiciet pan-shqiptare, deklaratat e tyre të fundit kanë shkaktuar alarm në BE.

Nacionalistët nga shumë kombe të Ballkanit kanë akuzuar prej kohësh krerët shqiptarë për një përbetim djallëzor për krijimin e 'Shqipërisë së Madhe' duke shkëputur territore nga fqinjët. Në anën tjetër, shumica e politikanëve shqiptarë vazhdimisht kanë hedhur poshtë këtë ide si frikësuese.

Sidoqoftë, me zbehjen e ndikimit të BE-së në Ballkan dhe konfliktet e moçme që pluskojnë në sipërfaqe, krerët gjithandej rajonit po i mëshojnë miteve nacionaliste për të zhvatur vota. Në një intervistë dhënë për Politico më pak se dy javë më parë, kryeministri i moderuar shqiptar Edi Rama ka thënë se ai nuk mund të përjashtojë një 'bashkim të vogël' mes Shqipërisë dhe Kosovës nëse BE e heq nga tavolina anëtarësimin.

Ditën tjetër, presidenti i Kosovës Hashim Thaçi ka deklaruar se 'të gjithë shqiptarët në rajon do të jetojnë në një shtet të vetëm' nëse BE i mbyll dyert e saj. Kjo ishte mënyra për të vazhduar 'integrimin në familjen evropiane', ka sqaruar Thaçi.

Sidoqoftë, krerët e Kosovës mohuan se ai po shtynte Shqipërinë e Madhe kur u pyetën nga Deutsche Welle për të qartësuar deklaratat e tij. Duke folur në një konferencë shtypi në Prishtinë, ai e cilësoi konceptin si 'një sajesë të Beogradit, me qëllim të përligjjes së ambicieve për Serbinë e Madhe'.

Thaçi akuzoi BE-në se është 'naive dhe po mashtrohet nga propaganda serbe'.

Drejtuesi i Këshillit Nacional Shqiptar në Serbi, Jonuz Musliu, ka rritur kërkesat duke thënë se edhe qytetet me shumicë shqiptare në Serbi – Bujanoci, Presheva dhe Medvegja – duhet t'i bashkohen Kosovës dhe Shqipërisë.

'Serbia duhet të jetë mirënjohëse' që shqiptarët nuk po kërkojnë më shumë territore, ka thënë ai.

Ish komandanti Ramush Haradinaj, pas kthimit të tij nga Franca pasi ishte kërkuar të arrestohej nga Serbia, foli për t'i treguar Serbisë 'vendin e saj'.

Beogradi u përgjigj me shqetësim. Kryeministri serb Aleksandër Vuçiç bëri thirrje për qetësi, por komentoi se ai do të 'varej në shtizë në Bruksel' nëse do të bënte deklarata të tilla për bashkimin e të gjithë serbëve. Shumë serbë jetojnë ende në republikat e dikurshme të Jugosllavisë dhe kontrollojnë entitetin e tyre në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Ministri serb i Jashtëm Daçiç ka thënë se BE, Shtetet e Bashkuara dhe Britania 'do të jenë drejtpërdrejtë

përgjegjëse' nëse shqiptarët vazhdojnë të shtyjnë përpara ambiciet e tyre territoriale.

"Për fat e gjithë kjo është thjesht ëndërr. Por, përvoja na ka mësuar se rruga që çon prej ëndrrës në makth është e shkurtër", ka thënë Daçiç.

Përgjigjja nga Perëndimi në fillim nuk ishte tumirëse. Javën e kaluar, komisioneri për Zgjerim i BE-së Johannes Hahn ka folur kundër thirrjeve të krerëve shqiptarë.

"Do të doja të shpreh zhgënjimin tim dhe mund të them edhe hidhërimin për deklaratat nxitëse të krerëve të caktuar në rajon", ka thënë ai pas takimit me Daçiçin në Bruksel. Deklaratat që nënkuptojnë 'ndryshime kufijsh janë të papranueshme dhe të panevojshme e kundërproduktive'.

Vëzhguesit e huaj nuk besojnë se shqiptarët do të përpiqen t'i bashkojnë tokat e tyre as përmes dhunës dhe as përmes diplomacisë. Deklaratat provokative me gjasmë ishin premtime politike për zgjedhjen e këtij viti në Kosovë dhe Shqipëri.

Çështja për bashkim është një 'ëndërr në diell', thotë Frederik Wesslau, analist politik në Këshillin Evropian për Marrëdhënie me Jashtë. Sidoqoftë, kjo është mjaft e dobishme si për politikanët shqiptarë dhe ata jo-shqiptarë që kërkojnë vota.

'Gogoli i Shqipërisë së Madhe është diçka që shfaqet herëpashere -përdoret nga krerët shqiptarë, por edhe

politikanët e tjerë në Ballkanin Perëndimor', thotë Wesslau, që ka kaluar disa vite si punëtor i OSBE-së dhe Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

Deklaratat e fiundit të Ramës dhe Thaçit 'nuk duhet të merren seriozisht', pajtohet Erdoan Shipoli, ligjërues në Shkollën për Marrëdhënie Publike dhe Ndërkombëtare në Universitetin Ndërkombëtar të Virgjinas.

"Ajo çka duan të arrijnë politikanët shqiptarë me këto deklarata janë votat nga grupet më nacionaliste', ka thënë ai për DW. 'Shumë politikanë shqiptarë akuzohen se janë blerë nga SHBA, BE, nga ky vend apo ai grup, kështu që në këtë mënyrë ata duan të thonë se janë patriotë'.

'Shumica e shqiptarëve, me aq sa mundem të shoh, mendojnë se mënyra më e mirë për bashkim është nën çadrën e BE-së', ka thënë ai.

'Shqiptarët e dinë se do të ishte tejet e vështirë, për të mos thënë e pamundur, për të zgjedhur kryetarin e Shqipërisë së Madhe, e lërë më për ta bërë funksionale. Mbështetja për një nismë të tillë është minimale', ka shtuar ai.

Edhe kështu, diskutimi për Shqipërinë e Madhe mund të jetë i rrezikshëm, sipas ekspertëve. Njerëzit gjithandej rajonit janë të drobitur nga korrupsioni dhe papunësia, shqiptarët pro-perëndimorë ndjejnë se BE ka dështuar të mbrojë interesat e tyre në

Maqedoni dhe Serbi, dhe qytetarët e Kosovës janë të zemëruar në BE-në që nuk po i lejon të lëvizin pa viza. Në rrethana të tilla, është e natyrshme që sentimenti nacionalist të rritet', ka thënë Shipoli.
'Hëpërhë nuk ka mbështetje por nëse BE vazhdon t'i dështojë shqiptarët në përgjithësi dhe Kosovën në veçanti, ky mendim do të fitojë më shumë momentum dhe do të ketë më shumë pranueshmëri', ka thënë Shipoli .

***

Profesori i lëndës për punë të jashtme në Universitetin e Bardit, në një koment për "Wall Street Journal" ka shkruar për gjendjen në Ballkan. Ai ka thënë se situata në vendet e Ballkanit mund të kthehet në një problem serioz për Bashkimin Evropian.
Në një takim të mbyllur kohëve të fundit, një zyrtar i mirë-informuar gjerman u pyet se çfarë është problemi më i madh në Evropë.
Përgjigja e tij erdhi pa hezitim: Ballkani Perëndimor, ku po krijohet një krizë e re, kurse Turqia dhe Rusia po "ndezin tenxheren".
Në skenarin e tij më të keq, Rusia dhe Turqia do të inkurajojnë problemet në Ballkan, Serbi dhe Shqipëri, për t'i ndihmua ata që të riorganizojnë kufijtë e rajonit.

Qeveria serbe mori mbështetjen e Rusisë, që të mund të aneksonte pjesët më të mëdha të Bosnjes të populluara me serbë etnikë.

***

Shqipëria e katër vilajeteve apo Shqipëria e Madhe, Shqipëria Etnike, apo Natyrale, sot është Shqipëri e ndarë në pesë shtete të Ballkanit.

Po kështu nuk do të mbetet përgjithmonë përderisa shqiptarët janë i vetmi popull në Ballkan që po e rritë natalitetin, ndërsa fqinjët po i rrezikon Murtaja e Bardhë, e cila dashur pa dashur në të ardhmen do të vendos një tjetër element përfaqësues e dominues në hapësirat e Ballkanit.

Shqipëria ka qenë dhe po mbetet Shqipëri, të paktën e tillë është për të gjithë shqiptarët me përcaktim liridashës kombëtar. Pavarësisht se si pretendohet të quhet, Shqipëri quhen trevat ku jetojnë edhe sot shqiptarët, edhe pse të ndarë në pesë apo gjashtë shtete.

Në të kaluarën, vendi u quajt Arbëri, Albania, ndërsa shqiptarët arbër dhe epirotas.

Stërgjyshërit së bashku me grekët përbenin popullatën dominuese në Ballkan deri në shekujt VII dhe VIII kur sllavët e popujt e tjerë të Lindjes vërshuan drejt tokave të Ballkanit, duke shkatërruar kulturën arbërore e greke dhe duke iu dhënë zjarrin

qyteteve, meqë si fise nomade jetonin në një nivel të ulët të qytetërimit.
Në kohën e sundimit të Perandorisë Osmane, tokat shqiptare, sikur ato të krejt popujve të Ballkanit ranë nën sundimin shumë shekullor, por për dallim nga popujt e tjerë, shqiptarët me pranimin e islamit u joshën nga Stambolli dhe fituan disa të drejta që realisht nuk i kishin popujt e tjerë që konsideroheshin raja, robër me detyrime e obligime të caktuara.
Duke qenë edhe pjesë e bashkëqeverisjes dhe duke u shtrirë deri në nivelet më të larta të administratës, ushtrisë dhe tërë komponentës shtetërore, shqiptarët me të drejtë u quajtën edhe Skithët e Perandorisë dhe për disa shekuj rresht ishin bërë shtylla të fuqishme të shteti më të fuqishëm të botës.
Ka qenë dashur apo nuk ka qenë dashur të veprohet ashtu kjo është çështje për diskutimin komentim, por realiteti ishte i tillë dhe me gjuhën e fakteve e argumenteve vështirë se mund të kontestohet.

Shqiptarët në shekullin XIX jetonin në katër Vilajetet e Rumelisë, që përbënin rreth 110.000 km.2. Vetëm Vilajeti i Kosovës shtrihej në afër 60.000 Km.2, që ishte aq sa tri vilajetet e tjera, të Shkodrës, Manastirit dhe Janinës.

Sot shqiptarët në trevat e tyre autoktone, në shtetet e Ballkanit janë rrudhur në 50 për qind të territorit etnik, ndërsa një e treta e popullsisë jeton në vende të ndryshme të botës si në Turqi, Gjermani, Zvicër, Francë, Amerikë e vende të tjera.

Shqiptarët në Shqipëri dhe në Kosovë përbëjnë më shumë se 6 milionë banorë rezidentë. Në Maqedoni, në tri komunat e Kosovës Lindore dhe në Mal të Zi përbëjnë rreth 700.000 frymë. E dhëna se në Ballkan jetojnë rreth 7 milionë shqiptarë është plotësisht e vërtetë.

Shqipëria e Madhe, pjesë e së cilës do të jetë edhe Kosova, nuk është vetëm fantazi. Epoka e shqiptarëve në Ballkan ka filluar, ndërsa për popullin serb 25 vitet e ardhshme do të jenë të errëta, thotë në një intervistë për mediet serbe, Anja Filemonit, anëtare e Akademisë së Shkencave Ruse.

"Projekti i Shqipërisë së Madhe ka marrë një impuls të ri. Duket se Perëndimi e ka përmbyllur fazën e parë, dhe ajo ka përfunduar në vitin 2008 me shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Tani fillon faza tjetër, e cila shkon në nivele tjera, e që ka të bëjë me komunat me shumicë shqiptare në Serbi, siç janë Presheva, Bujanoci dhe Medvegja".

Anja Filemon thotë se Serbia duhet të shqetësohet për këtë realitet, pasi sistemi arsimor i Shqipërisë

dhe Kosovës po unifikohet, e ai po përfshinë edhe komunat jugore të Serbisë.

Por përveç kësaj thotë se Shqipëria dhe Kosova kanë filluar edhe projekte të përbashkëta ekonomike, siç është autostrada, tanimë e kryer.

"Kufijtë midis Shqipërisë dhe Kosovës nuk ekzistojnë. Është vetëm çështje kohe para se territorit të Shqipërisë t'i bashkohet edhe Republikë e Kosovës".

Në 25 vitet e ardhshme, sipas saj, Serbinë e pret një perspektivë e zymtë, jo vetëm shkaku i politikave të Perëndimit, por edhe për fajin e politikave të brendshme që po i aplikon shteti serb, veçanërisht me miratimin e ligjit për pakicat kombëtare, që sipas saj do të jetë vdekjeprurës.

Anja Filemon: "Pravda": Shqipëria po pretendon të jetë gati "gjysma" e Evropës

Ky artikull është shfaqur shtatë vjet më parë, në revistën e njohur ruse, "Pravda". Sipas autores, Anja Filemon, ajo "zbulon" një plan, sipas të cilit lobi shqiptar në Amerikë i përfaqësuar nga emra si ish-drejtori i CIA-s George Tenet, aktori James Belushi, ish-kongresmeni Joseph Diogardi dhe shqiptarët e tjerë brenda dhe jashtë trojeve të veta po punojnë për një Shqipëri të madhe.

Data 17 shkurt 2010, shënon dy vjetorin e shpalljes së pavarësisë nga qeveria shqiptare e Kosovës. Që

atëherë, Kosovën e kanë njohur vetëm 65 prej 192 vendeve anëtare të OKB-së, (prej asaj kohe e deri tani Kosovën e kanë njohur 113 shtete të botës). Por shumë shqiptarë, megjithatë, besojnë se pavarësia e rajonit është një përfundim i pashmangshëm, si dhe hapi i parë drejt krijimit të Shqipërisë së Madhe, e cila, me përjashtim të Shqipërisë dhe Kosovës duhet të hyjë në disa zona të Maqedonisë, Malit të Zi, Serbi dhe Greqi.

Ndarja e Rajonit

Përgatitja për ndarjen e rajonit ishte e gjatë. Në vitin 2006, i dërguari special i OKB-së për Kosovën, Marti Ahtisari paraqiti një plan ku morën vendimin "për të arritur pavarësinë, shqiptarët do të kufizojnë fuqinë e përfaqësuesve të misioneve të BE-së, OSBE-së dhe OKB-së. Një vit më vonë, u bënë zgjedhjet, të cilat nuk njihen nga Beogradi dhe nuk u pranuan nga serbët lokalë.

Kryeministri, Hashim Thaçi ishte një njeri i akuzuar nga ish-prokurorja e Gjykatës së Hagës, Karla Del Ponte… Në 17 shkurt 2008 parlamenti në mungesë të deputetëve serbë miratoi një deklaratë të pavarësisë.

Disa ditë më vonë, deklarata u pranua nga Shtetet e Bashkuara dhe shumica e shteteve të BE-së. Rusia, Kina, India, Brazili, si edhe Greqia, Spanja, Rumania dhe Sllovakia kanë refuzuar ta bëjnë këtë, duke

deklaruar veprimin e shqiptarëve të Kosovës si shkelje flagrante të së drejtës ndërkombëtare.
Sipas rregullave të OKB-së, të drejtën për vetëvendosje të popujve pa shtetësi e kanë vetë shtetasit. Ish kryeministri Vojislav Koshtunica është shprehur se : "Shqiptarët e Kosovës kanë shtetin e tyre kombëtar. Quhet Shqipëri."

Rishikimi i kufijve

Po, kjo është kështu. Shqipëria u krijua në 1912, por kjo nuk solli bashkë të gjithë shqiptarët. Dhe qysh atëherë autoritetet e këtij vendi kanë bërë thirrje për rishikimin e kufijve në Ballkan. Për shembull, Enver Hoxha ish-udhëheqës komunist i shkroi Stalinit në 1949: "Ne besojmë se Kosova dhe Metohija janë pjesë e kufirit me Shqipërinë, Maqedoninë, popullata shqiptare … i duhet bashkuar Shqipërinë." Autoritetet e Kosovës kanë mohuar se planet e tyre kanë të bëjnë me bashkimin e Shqipërisë. Por këtë duhet ta mohojnë edhe liderët në Tiranë.
Por në vitin 2008, në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë, u botua harta e një Shqipërie të Madhe hipotetike, e cila përfshin zona të gjera ngjitur me gjendjen aktuale të vendeve.
Por përkthimi i kësaj ideje në praktikë duhet të jetë i qëndrueshëm në numrin e minoritetit shqiptar. Në Maqedoni, në mbi gjysmë e një milion shqiptarë

(rreth 25 për qind të popullsisë), Mali i Zi – 45 mijë (shtatë deri në tetë për qind). Në tre komuniteteve në tri komunat e Serbisë jugore – 60 mijë. Në Greqi, në Epir – gati 500 mijë (pesë për qind të popullsisë).
Së fundi, në Kosovë, pas 10 viteve të fundit kanë lënë rajonin më shumë se 250 mijë serbë dhe tani jetojnë më pak se dy milionë shqiptarëve, që përbëjnë jo më pak se 90 për qind të Kosovës. Qindra mijëra shqiptarët jetojnë në Itali, Gjermani, Zvicër, Turqi, Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera. Shumë prej tyre kanë shumë ndikim.

Plani shqiptar

Për shembull, ish-drejtori i CIA-s George Tenet, ylli i kinematografisë hollivudiane James Belushi, dhe ish-kongresmeni nga Nju Jorku Joseph Diogardi, anëtarë të pasur të diasporës shqiptare po japin shuma të mëdha parash për të mbështetur një plan global të bashkëatdhetarëve të tyre në Ballkan për një Shqipëri të madhe.
Kjo është kërkesa e shqiptarëve në Kosovë bazuar në faktin se paraardhësit e tyre – ilirët – kanë jetuar në ato vende mijëra vjet. Por shkenca është një marrëdhënie që provohet. Por dihet se në Pejë një qytet i Kosovës për shekuj (deri 1767) ishte selia e metropolitanisë serbe.

Në provincë deri kohët e fundit, ishin vendosur më shumë se 1800 tempujt përfshi dhe manastiret e kishës ortodokse serbe. Kaq shumë tempuj në një fashë të vogël, ka vetëm në Jeruzalem dhe në malin Athos. Objekti i kërkesës së shqiptarëve është vendosur edhe në jug të Serbisë në Luginën e Preshevës.

Nacionalistët shqiptarë

Nacionalistët shqiptarë në Maqedoninë fqinje pretendojnë gjysmën e territorit, duke përfshirë edhe kryeqytetin Shkup, si edhe si një pikë kyçe e shenjtë në të njëjtën kohë e Bullgarisë dhe Serbisë – Manastiri i Ohrit. Në vitin 2001, shqiptarë të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK) filluan operacionet ushtarake kundër forcave maqedonase.

Me ndihmën e Perëndimit konflikti u zgjidh, gjuha shqipe ka status zyrtar në pjesën më të madhe të vendit – në zonat ku folësit e saj janë jo më pak se 20 për qind të popullsisë. Disa shqiptarë kanë qenë dhe ende janë pjesë e Qeverisë së Maqedonisë.

Në vitin 2005, në një numër vendesh u lejua ngritja e flamurit shqiptar. Në vitin 2008, nën presionin e autoriteteve lokale shqiptare, Maqedonia njohu pavarësinë e Kosovës. Megjithatë, ata vazhdojnë të kërkojnë koncesione gjithnjë e më shumë, dhe disa

prej organizatave të tyre bënë hapur thirrje për ndarjen e zonave perëndimore.

Qetësia vazhdon ende në Mal të Zi. Këtu, shqiptarët përbëjnë rreth tetë për qind të popullsisë. Por, duke pasur parasysh shkallën e lartë të lindjeve, pjesa e tyre, e shqiptarëve, është në rritje.

Pra, ndoshta nuk është e largët ora kur shqiptarët lokalë të marrin guximin të sulmojnë zonat e populluara jugore të vendit.

Sa për Greqinë, në vitin 1982, Ministri i jashtëm i Shqipërisë ngriti çështjen e identitetit në "zonat e lashta etnike shqiptare në veri-perëndim," dhe kërkoi diskutimin e problemit "të të drejtave të popullsisë shqiptare dhe qartësimin e kufijve të përbashkët.

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë refuzoi të miratojë marrëveshjen midis dy vendeve mbi kufirin detar. Në një takim në Kosovë shkruhej parulla: "Nuk ka Kosovë dhe Shqipëri pa Çamëri !". Çamëria – është pjesë e rajonit të Epirit, ku shqiptarët sot përbëjnë shumicën e popullsisë. (Posted 25th February 2010 by Botimet Shqiptare)

Pavarësisht se autorja e këtij shkrimi, pretendonte të frikësonte Serbinë dhe rajonin lidhur me sikur ajo thotë, ekspansionin e shqiptarëve, zonja Filemon nuk ishte shërbyer me asnjë të dhënë relevante historike lidhur me faktin se cila kishte qenë Shqipëria e para

vitit 1912, edhe pse e administruar nga Perandoria Osmane.

Me atë, që ajo dhe sllavet e quajnë të "drejtë historike" mbi trojet shqiptare, të cilat dikur në Mesjetën e hershme ishin pushtuar nga sllavët, pretendohet se ky vend i përket Serbisë, pa shkruar më tutje, pa shpjeguar se kush jetonte në këtë troje kur u dyndën hordat sllave.

Ajo merr për bazë pushtimin e trojeve shqiptare në vitin 1912, si fakt të qëndrueshëm historik të "rikthimit të pushtimit", me forcën e armëve dhe përkrahjen e Rusisë dhe të gjitha shteteve sllave. Nisur nga kjo logjikë, shqiptarët me forcën e armëve dhe me përkrahjen e NATO-s në vitin 1999 realizuan të drejtën e tyre, jo mbi territoret shumicë serbe, por mbi territoret e pastra etnike shqiptare, qysh prej kohës së Ilirisë e në vazhdim.

Po të kthehen shqiptarët në trojet e tyre të kohës së Perandorisë Osmane, ata kanë jetuar në tërë territorin e sotëm të Serbisë, madje pashallarët shqiptarë kanë qeverisur edhe në Beograd. Të gjitha faktet historike flasin për këtë të vërtetë.

Serbët nuk e fshehin faktin se pas humbjes së Perandorisë Osmane, në Plevle në vitet 1877-1978, në kohën kur turqit po tërhiqeshin nga rajoni i Bullgarisë dhe rajonet sllave, Serbia e asaj kohe kishte ushtruar gjenocid dhe etnocid, duke vrarë

masakruar e dëbuar shqiptarët, qerkezët, hebrenjtë dhe të gjithë popujt jo sllavë.

Asokohe ishte thyer edhe kompaktësia etnike shqiptare e viseve pre Prokupjes deri në Nish dhe kishte filluar dyndja e madhe shqiptare drejt Vilajetit të Kosovës, i cili asokohe kishte 60.000 km2.

Qindra mijëra shqiptarë të Kosovës e më gjerë që quhen "muhaxhirë" i përkasin asaj periudhe të dyndjes së madhe e cila zgjati deri te pushtimi i viseve shqiptare të Kosovës, Malit të Zi e Maqedonisë, me ç' rast serbët e rusët kishin përzënë për në Turqi qindra mijëra shqiptarë, çerkezë myslimanë të Bosnjës e Sanxhakut.

Këto fakte historike nuk kanë nevojë për ilustrime me të dhëna relevante sepse gjenden në të gjitha tekstet e historive të popujt të Ballkanit, në të gjitha enciklopeditë e Ballkanit, Evropës e botës. Kemi të bëjmë me një realitet faktik të cilin nuk e fshehin nacionalistët e shovinistët sllavë.

Shqipëria është dhe do të bëhet një dhe e tërë

Shqipëria dhe Kosova janë dy shtete shqiptare të pranuara ndërkombëtarisht, edhe pse Kosova ende nuk është pranuar në OKB dhe në disa organizata ndërkombëtare. Shqiptarët në Maqedoni po faktorizohen dhe tani po shihet qartë e kthjellët se pa ata nuk mund të formohet Qeveri, as mund të

ekzistojë ai shtet artificial i kohës së AVNJOJ-it jugosllav i pas Luftës së Dytë Botërore.

Shqiptarët në Mal të Zi jo vetëm njëherë me votat e tyre kanë vendosur se kush do të jetë në krye të Qeverisë së këtij vendi.

Shqiptarët në Kosovën Lindore do të kërkojnë për veten e tyre, po ato të drejta që i kanë serbët në Kosovë. Ky homogjenizim etnik i shqiptarëve në Ballkan doemos se në të ardhmen do të rezultojnë me një hap tjetër integrues, si rrjedhë e natyrshme dhe e njëjtë me kombet e tjera të Ballkanit, që në shumicën dërrmuese jetojnë në shtetet e tyre etnike.

Për më tepër shqiptarët në Kosovë, Maqedoni, Serbi dhe në Mal të Zi janë i vetmi popull në Ballkan që ka shtimin më të madh demografik.

Mbështetja turke, mund të ndihmojë Shqipërinë të marrë një manovër të ngjashme, dhe jo vetëm në Kosovë, por edhe në Maqedoni ku shqiptarët banojnë, dhe dëshirojnë të ribashkohen në një atdhe", shkruan Russel Mead.

Sipas tij, shkëmbimi i territoreve ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve duket i pamundur. "Ky kurs i ngjarjeve megjithatë nuk ka gjasë të ndodhë.

Meqenëse disa nga territoret e pretenduara për Shqipërinë e Madhe janë në Serbi, dhe do të ishte e vështirë që dy vendet të bien dakord për një hartë të re.

Ekziston një realitet i rëndë i cili bazohet në shqetësimet e Gjermanisë. Ballkani po zhbllokohet, edhe Perëndimi tani duhet të shqetësohet më shumë për ndërhyrje ruse.

Turqia po bëhet gjithnjë e më shumë pushtet në NATO dhe pavarësisht raporteve Turqi-Rusi, Erdogan po bashkëpunon ngushtë me presidentin rus, Vladimir Putin", thuhet në komentin e profesorit të punëve të jashtme.

"Turqia dhe Rusia janë bashkuar nga kundërshtimi i tyre ndaj Gjermanisë dhe Bashkimit Evropian. Rusët jo vetë që e urrejnë NATO-n, por e shohin BE-në si pengesë ndaj rolit historik të fuqisë së Rusisë në Evropë.

(Autori është drejtor për mardhënie me publikun pranë Akademisë së Shkencave dhe Arteve Shqiptaro-Amerikane New York,Tiranë, Prishtinë, Shkup).

Prishtinë, 03.12.2017.

HEROJTË E TREPÇËS

Para 29 viteve minatorët e Trepçës kishin filluar grevën e urisë për të mbrojtur Kosovën nga regjimi i Sllobodan Millosheviqit, duke shënuar kështu zhbërjen e Jugosllavisë së Titos!

Ishin rreth 1,300 minatorë që kishin hyrë në këtë grevë për të mbrojtur ekzistencën e Kosovës dhe autonominë e saj.Greva historike e minatorëve të "Trepçës" e vitit 1989 qe shndërruar në rezistencë gjithë popullore demokratike e paqësore kundër presioneve të Serbisë për ta ripushtuar Kosovën.

Me rastin e këtij përvjetori Ndërmarrja Trepça organizon manifestimin tashmë tradicional "Java e Minatorëve"

Kujtesa kolektive në Kosovë përbëhet nga mungesa e vëmendjes së marrëdhënieve klasore. Modelet ekzistuese të kujtesës institucionale në masë të madhe kanë shpërfillë bazat materiale të punës dhe marrëdhëniet e punës.

Si një qasje kritike ndaj kujtesës kolektive, kjo masterklasë përqendrohet në Grevën e Urisë së Minatorëve të Trepçës që filloi me 20 shkurt 1989

dhe vazhdoi për tetë ditë me radhë. Dhjetë kërkesat e minatorëve ishin kryesisht për të drejtat kushtetuese. Minatorët protestuan kundër heqjes së autonomisë së Kosovës si pjesë e Kushtetutës së vitit 1974 të Jugosllavisë Socialiste. Prandaj, lidhja e identitetit të minatorëve dhe vendit me momentin në kohë – Greva e Minatorëve të vitit 1989 – është e rëndësishme për të nxjerrë një kuptim më të mirë të kujtesës kolektive dhe memorializimit. Minatorët ishin figurë qendrore në ideologjinë e socializmit Jugosllav. Megjithatë, minatorët ishin subjekt i margjinalizuar shoqëror e politik.

Çfarë e bën grevën të rëndësishme është konteksti i shpërbërjes së Jugosllavisë socialiste dhe ngritja e nacionalizmit në Serbi. Masterklasa shqyrton mënyrën se si greva është reprezentuar, interpretuar dhe kujtuar. Leximi bazohet në të dhënat e shkruara dhe kujtimet personale që rrjedhin nga arkiva, raportimet në media dhe dëshmitë e pjesëmarrësve. Ndërtekstualiteti i vendosur këtu si strategji për ndërtim-kuptim, do të gjurmojë jo vetëm atë që ka mbetur më pak e njohur dhe e pa treguar, por edhe ambiguitetin e vetë grevës. Për më tepër, leximi i Grevës së Urisë së Minatorëve të Trepçës në vitin 1989 do të zbulojë gjithashtu kufizimet e së kaluarës historike dhe historinë e punëtorëve.

Kanë kaluar 29 vjet që kur minatorët shqiptarë të Trepçës në Stan Tërg, nisën një grevë të pazakontë në zgafellat e minierës, një akt që shënoi një erë të re për Kosovën, në luftën e saj për liri, të drejta e pavarësi nga Serbia. Ajo ngjarje pati shumë bujë; dhe më e bujshmja brenda saj, ishte dhurimi i një lope që një mitrovicar ua bëri minatorëve grevistë.

Musa Berani, dhuruesi i lopës, akt që zuri vend dhe në mediat e huaja, sot është 66 vjeç. Edhe ai thotë se greva 8-ditëshe e minatorëve të Trepçës në Stan Tërg ishte themeli i shtetësisë së Kosovës, i bashkimit të shqiptarëve, i krijimit të UÇK-së dhe shkatërrimit të tërësishëm të Jugosllavisë së Titos.

Por si e kujton Berani aktin e dhurimit të lopës, që për të është një ndër përjetimet më të rralla dhe më të bukura te jetës së tij sa është gjallë.

"Lopën që dhurova unë nuk ishte asgjë, por bëri një jehonë të madhe në opinion, pasi që me sytë e mi kam para edhe gra të cilat në hyrje të minierës së Trepçës në Stan Tërg, kanë hequr nga fyti varëse të arit e stoli të tjera duke i dhuruar për minatorë, apo dhe persona që dhuronin para, marka dollarë, franga zvicerane", thotë Berani.

Dhe vazhdon ai rrëfimin: "Nuk e di saktë datën, ka qenë 21 apo 22 shkurti i vitit 1989, por në atë mëngjes pasi që kisha mjelë lopët në ahurin tim, u ktheva në dhomë brenda ku babai qëndronte i shtrirë

pasi që ishte shumë i sëmurë. Ishim duke shikuar lajmet në televizor dhe për një moment babai po më thotë: 'lehtë është për ty është o Musoo, plotë ahurin e ke me lopë, po ata minatorët atje në Jamë (minierë), ata e kanë shumë të vështirë', duke ma bëri me shenjë se unë duhesha ta dhurojë një lopë për minatorët. Të nesërmen në mëngjes, ka qenë ditë e shtunë kam shkuar në ahur ku kam zgjedhur lopën më të mirë të cilën e kam marrë dhe e kam dërguar në Stan Tërg", tregon Berani.

Ai më pas sqaron se tërë rrugën, nga Mitrovica deri në Stan Tërg, rreth 7-8 km, e ka bërë në këmbë. "Kur mbërrita aty, lopën e kam lidhur për rrethojën e oborrit të minierës dhe rojës që ishte aty i thashë se këtë lopë e kam sjellë për minatorët. E di se lopën e kanë therur në minierë, porse mishin në vend që ta hanë jua kanë shpërndarë të varfërve", sqaron Berani, i cili pra zbulon dhe këtë detaj tjetër kaq interesant të asaj ngjarjeje.

"Unë nuk kam punuar kurrë në minierë, por u solidarizova me minatorët pasi që ata po na mbronin me jetën e tyre nga terrori që po ushtronte Serbia me Millosheviqin mbi shqiptarë e Kosovës. Ka kaluar shumë kohë, pra 27 vite, nuk i kam ra pishman asaj pune, por jam i revoltuar me qeverinë dhe institucionet e tjera të Kosovës që deri më tani nuk kanë bërë gjë për të pasur një të ardhme më të mirë",

qahet ai duke gjykuar kështu mbi realitetin në të cilin ndodhet Kosova.
Ai ka shtuar se ato 8 ditë të grevës së minatorëve të Trepçës i ka përjetuar shumë keq, por se dhe ka qenë krenar pasiqë populli shqiptar jo vetëm në Kosovë, por në tërë Jugosllavinë ku ka jetuar, për herë të parë është bërë i gjithi bashkë, në një gojë.
"Por me lopët nuk më eci mirë", thotë Berani duke qeshur, dhe shton se gjatë luftës policia dhe paramilitarët serbë ia kanë marrë 3 të tilla, ndërsa njërën ja kanë vrarë.

"Dhe kështu mbeta pa lopë", shton ai.
Rasti i dhurimit të lopës për minatorët atë botë, bëri aq bujë sa Musa Berani thotë se policia serbe nisi ta kërkonte për ta burgosur.
"Pas dy ditëve, shkova prapë në Stan Tërg për t'u interesuar për gjendjen shëndetësore të minatorëve. Aty, disa policë serbë me rroba civile tentuan të më arrestonin, por disa minatorë e punëtorë të Trepçës reaguan dhe më shpëtuan nga policia duke më futur në një makinë e sjellë në Mitrovicë. Që nga ajo ditë dhe rreth 4 muaj, nuk kam fjetur në shtëpinë time, por tërë kohën e kam kaluar tek dajat e mi në fshatin Zhabar, tek kushërinjtë në fshatin Klinë të Skënderajt, si dhe tek miku i im Ibrahim Vidishiqi, dhe kështu policia nuk mundi të më arrestojë për këtë punë."

Dhe merak të madh ka faktin se për atë ngjarje nuk ka asnjë fotografi, pra asnjë lloj kujtimi që sytë e brezave të mund ta shihnin.

"Nuk kam asnjë fotografi nga ajo ditë. Gjatë luftës e humba atë faqe të gazetës 'Rilindja', ku krahas një letre përkrahjeje që madhi Bekim Fehmiu iu kishte dërguar minatorëve, ka qenë edhe shkrimi për dhurimin e lopës nga ana ime", shprehet i pezmatuar Berani.

Musa Berani tani jeton me gruan dhe tre fëmijët e tij në qendër të Mitrovicës, në pension në kushte të vështira ekonomike. Por në zemër e ndërgjegje ka një pasuri të madhe, kujtimin e bukur të një akti njerëzor e kombëtar, dhurimin e një lope për minatorët grevistë në Stan Tërg.

AKADEMIK PROF. DR. SKENDER KODRA
KRYETARI I AKADEMISË SHQIPTARE-AMERIKANE TË SHKENCAVE

PADREJTËSIA HISTORIKE E EVROPËS NDAJ SHQIPTARËVE

Shpesh flitej për normalizimin e rajonit të Ballkanit dhe integrimin e shpejtë në BE, por një gjë e tillë është larg sepse nuk janë zgjidhur çështjet e popujve qe përbejnë shtetet e Ballkanit.

Siç shihet Padrejtësia historike e Evropës ndaj shqiptarëve është plagë që duhet të shërohet urgjentisht, në të kundërten pasojat do të jenë të papara edhe për vetë- Evropën.

Zgjidhja e çështjes se shqiptarëve përkundër kompromiseve të bëra nuk ofrojë zgjidhjen për stabilitet të qëndrueshëm në këtë Gadishull.

Fundja, stabilitet s'mund të ketë kur të gjithë janë kundër shqiptarëve dhe të drejtave të tyre në shtetet ku jetojnë?

Andaj situata destabilizuese e sponzorizuar nga faktori politik, përkatësisht Qeveria e Maqedonisë, kërkon reagim të menjëhershëm të faktorit ndëkombëtarë dhe dorëheqjën e parevokueshme të Gruevskit me të tjerë.

Akadamia Shqiptaro Amerikane, në kry me Akademik Prof. Dr. Skënder Kodra- kryetar, po ndjek me shqetësim të madh situatën e fundit në Shqipëri, Kosovë,Maqedoni,Malin e Zi, Preshevë, Medvegjë, Bujanoc, Çamëri ndaj kërkohet që partitë kombëtare shqiptare dhe spektri i gjerë i intelektualëve dhe personaliteteve të pastra publike në Shqipërinë Etnike , të bashkohen si kurrë më parë dhe të bisedojnë konkretisht për kërkesat legjitime me dekada të tëra të shqiptarëve, të cilat edhe pas marrëveshjeve të ndryshme , nuk u implementuan kurrë, por mbeten të mbyllura në sirtarë.

Shqiptarët janë me rrënjë të lashta dhe se as Mbretër e as Krajli s'kanë mund t'i'' zhdukin'', e lërë më Z. Janukollovska me bashkëpunëtorë e bashkëmendimtarë.

Ajo me të tillë ka sjell tragjedi, dhunë, tmerr, situatë të jashtëzakonshme dhe pasoja të paparashikueshme për vendin, për të cilat duhet të marrë dënimin e merituar.

Unifikimi dhe bashkërendimi i kërkesave të shqiptarëve është i dimosdoshëm, ndaj hapërimi drejt së ardhmes është i pandalshëm.

Prof. dr. Skender Kodra, kryetar i Akademisë Shqiptare – Amerikane të Shkencave (The Albanian American Academy of Science – AAAS) theksoi se ka reaguar edhe para ngjarjeve të fundit(ndodhur para

rastit Kumanova), lidhur me tensionimet e situatës në Maqedoni dhe gjendjen e shqiptarëve atje.

Kjo Akademi ishte dhe do të jetë përherë pjesë e protestave në Nju Jork dhe Çikago, për alarmimin e pozitës së rënduar të shqiptarëve në Maqedoni.

"Në çdo vend të botës, akademikët orientojnë vendin dhe udhën ku duhet të shkelë një komb i caktuar." – kështu përgjigjet me një zë të shtruar Akademik profesor doktor Skënder Kodra, një nga psikiatrët klinikë më të shquar shqiptare i cili jep mësim në tre Universitete në Shtetet e Bashkuara.

Një intelektual nuk ka për detyrë vetëm të rrisë veten por edhe ti kontribuojë kombit, vendit dhe rrënjëve të veta dhe ne fakt ai kohë më parë është kthyer nga një takim i rëndësishëm në Maqedoni me kryeministrin Zoran Zaev ku ka lobuar në favor të shqiptarëve për montimin e rastit Kumanova.

Me një kolanë librash në fushën e psikologjisë klinike ai që prej vitit 1995 themelon dhe drejton Akademinë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe Arteve me qendër në New York.

Një figure poliedrike që influencën e tij nuk e kufizon vetëm te gradat e tij shkencore por e shtrin edhe më tej në politike dhe në aktivitetin e tij patriotik.

Me akademinë Shqiptaro Amerikane ku ka personalitete amerikane dhe shqiptare ai ka ndikuar në lirimin e Ramush Haradinaj, në tërheqjen pas të

botimit të parë të Enciklopedisë maqedone denigruese ndaj shqiptarëve.

Personaliteti i Akademik Prof. Dr. Skënder Kodra është i njohur në SHBA, në vende të ndryshme të Evropës dhe në të gjitha trojet shqiptare.

Ai ka qenë këshilltar pranë Ministrisë së Shëndetësisë në Shtetin e New Yorkut, është anëtar i Shoqatës së Doktorëve në Shtetin e New Yorkut, Anëtar i Shoqatës të sëmundjeve psikike "Sigmund Frojd" të Austrisë, nënkryetar i Akademisë së Intelektualëve Shqiptarë të Shkencës dhe Artit në Kosovë, anëtar i Shoqatës së Psikiatërve në Shqipëri. etj.

Jam lindur në Istog të Kosovës më 13 maj 1946, sigurisht nga një familje patriotike atdhetare e të gjithë brezave.

Familja ime shpërngulet nga genocidi i kralit të kohës për në Shqipëri dhe vendoset në Mamurras, periudhë kjo që përkon me sundimin e mbretit Zog. Ç'është e vërteta populli e ka pritur mirë, por edhe qeveria i ka përkrahur dhe strehuar.

Në atë kohë, siç më ka treguar baba, Mamurrasi kishte shumë pyje dhe në to rriteshin kuaj të egjër, të cilët i zbutshin. Po kështu, duke prerë pyjet, i shndërruan në toka pjellore. Krahas këtyre punëve, babai ka punuar me rërë, ka mbledhë rërë nga ora 4 e mengjesit me buaj dhe krijuan një pasuri jashtëzakonisht të madhe.

Vitet iknin dhe babës po i kalonte mosha për të krijuar familjen e tij, ndaj në moshën 35 vjeçare kërkon nonën time, që ishte me origjinë nga Gjakova të stabilizuar në Shijak. Siç tregonte babai, ai kishte dhënë 25 lopë për ta marrë nonën time, që ishte atëherë 16 vjeçare.

Më vonë, kur okupatori gjerman premtoi që trojet shqiptare pas luftës aty ku i thonë bukës bukë e ujit ujë, do të ishin tonat, i gjithë populli u angazhua. Mirëpo prindërit e mi nuk u morën me asnjë aktivitet gjerman, por duke besuar se do të jemi më në fund një shtet shqiptar, u kthyen përsëri në Kosovë, afër Mitrovicës, ku kishin tri fshatra të vetat si pronë: Tucep, Veric, Osojan dhe kur kaluan nga Shqipëria atje e morëm përsëri pasurinë. Aty punonin si argat 100 shkie edhe shkina, burrat korrshin dhe gratë shkina mbledhshin duaj e grurit, misrit, ndërsa në shtëpi nuk i pranonim si shërbëtorë. Arësyeja e këtyre fatzinjve qe, se kishin frikë se mos i vrisnim dhe donin vetëm sigurinë e jetës.

Me kalimin e kohës, bisedohej në ato fshatra që ka filluar një lëvizje komunistash dhe kryetari i komunës së kohës, Zeqir Rexha, edhe vëllau i tij, Beqir Rexha, u kërkoi të gjithë fshatarëvet që të mobilizohen kundra komunistëve dhe të gjithë me kuaj shkuan në Pejë. Kur arritën në Pejë, zonjat thanë se cilët janë këta njerëz me kuaj të armatosur, a janë budallenj, apo si e

kanë hallin, kur komunizmi i ka marrë të gjitha trojet shqiptare e këta duan me na marrë në qafë e me na rrezikuar jetën.

Dhe kur e panë situatën se si ishte, u kthyen mbas pasi kishin takuar shumë komunistë, njerëz të veshur keq, të pistë, pa kulturë, morracakë dhe menduan që s'kanë për të fituar, se nuk ua mbushën syrin, që këta do jenë ndonjë rrezik për vatanin, për Atdheun dhe u kthyen nga erdhën.

Më vonë komunistët u forcuan, vranë, dhunuan dhe shkaktuan 12 mijë dëshmorë të kohës dhe dëmin më të madh e ka bërë brigada e pestë e Shefqet Peçit.

Në atë kohë kalamajtë e axhës, të Halil Kodrës i internuan në Beograd, kurse baba dhe nona erdhën në Istog, ku edhe kam lindur unë. Komunizmi kishte marrë çdo gjë, por ajo më e tmerrshmja ishte, se në lisa vendosnin kutia, ku çdo serb që kishte ndonjë pakënaqësi me shqiptarët, i shkruanin dhe i qitshin aty dhe i merrnin këto ankesa dhe vinte OZNA, sigurimi i asaj kohe dhe i dhunonte fizikisht dhe u grabiste pasurinë dhe pse doktrinën e kishin mos me i prekun. Shqiptarët nuk kishin të drejtë ta bënin këtë gjë për serbët.

Nga fëmijët, unë isha i pari, më pas lindi Zeqiri, Enveri dhe motra Aishja; tre djem dhe një gocë. Shpesh mendoj se cilët kanë qenë shtysit e mi për të ndjekur rrugën e dijes dhe nuk mendoja që dikush më

ka drejtuar andej, por sot e them me bindje që ka qenë nëna dhe babai im, të cilët pa shkuar asnjë ditë në shkollë dinin të shkruanin dhe të lexonin, bile nëna ime krijonte poezi, fabula, anektoda dhe si një aktore profesioniste interpretonte para nesh. Ata nuk e thoshin me fjalë, por me sy, me sjellje, me shpirt, me dëshirë, të pamundur ekonomikisht, por që sakrifikuan bukën e gojë për ne, gjashtë fëmijët për t'u shkolluar… mund të di, zoti Kodra cila ka qenë tradita familjare në fushën e arsimit dhe cili ka qenë shtysi kryesor i arsimimit tuaj?

- Baba im ishte shumë fisnik, por i pashkolluar, nuk e donte shkollën, donte armën, burrërinë, krenarinë, veshjen kombëtare, të cilën nuk e hoqi kurrë, bile ka vdekur me tesha kombëtare. Ndërsa nona ishte një grua gjakovare me një mendje të mprehte dhe një dashuri të jashtëzakonshme për shkollën.

Pasi linda unë, pra në moshë fëminore, baba më tregojke ngjarje të ndryshme për Kosovën dhe Shqipërinë, për të cilat kishte një dashuri të madhe e kjo dashuri bëri vend tek unë, ndoshta para kohe, që fëmijë.

Në kohën time, për në klasën e parë i merrshin shtatë vjeç, por, kur unë isha gjashtë vjeç, isha tuj lujt me ujë, vjen një shoku im, Muharrem Zeka, me të cilin më vonë kemi kaluar shumë peripeci bashkë nëpër burgjet e Serbisë, dhe më tha që të shkoja me të në

shkollë. Pa i treguar nonës, bashkë me shokun tim, shkova në shkollë. Mësuesi me një dashuri që s'mund ta përshkruaj, erdhi pranë dhe më pyeti sesa vjeç isha. Edhe pse i tregova të vërtetën, mësuesi më mbajti në shkollë.

Kur i thashë nonës se kam konë në shkollë, ajo më tha që s'munesh, se je gjashtë vjeç. Kur i tregova që isha pranuar në shkollë ajo nuk më pengoi, përkundrazi më përgëzoi duke më rrokur për qafe. Në fillim mësuesi nuk ma shkruajti emrin, por kur unë kalova klasën më regjistroi dhe mora klasën e parë.

Nuk mbaj mend asnjë mësues, apo profesor të ndryshëm që kam pasur gjithë jetën time ngado që kam mësuar e studjuar, por mbaj mend vetëm mësuesin e klasës së parë që e quanin Muhamet, babën e kishte hoxhë, se më solli kënaqësi të jashtëzakonshme, se doja të mësoja dhe të rrija me Muharremin.

Në shkollë shkojshim herët dhe lujshim me pesë gurësh, (guracak) me shokët derisa fillonte mësimi. Pas mësimit merrshim me bagëtinë, kujdeseshim për delet dhe për lopët. Sapo vinim nga shkolla, nona na priste me bukën në dorë, shumë bukë dhe pak djathë e unë i thosha: "Pse pak djathë e shumë bukë se s'mund ta haj", por ajo më thoshte: "E han e han, ti..." dhe më jepte një shpullë duke qeshur.

Mbarova tetë - vjeçaren shkëlqyeshëm dhe gjithmonë kam qenë i shkëlqyshëm në shkollë. Kur isha në Istog, kam kry shkollën bashkë me Rugovën. Ai vinte nga fshati Xerxë 7 km në këmbë, pra 14 km në ditë. Më pas shkova në Pejë në shkollën Normale për mësues. Si student në shkollën e mesme dështova, se e qëllova me shpullë një profesor serbë, (profesorin e frëngjishtes) dhe prej Peje shkova në Gjkovë dhe u regjistrova në normalen e Gjakovës. Tek dajot në Gjakove, (familja Rugova) u lidha me profesor Kadri Kusari, Ali Riza Boshnjaku, Kimet Gojani, Sabahat Shehu, Hysni Shala i Suharekës. Profesor Kadri Kusari ishte kordinatori kryesor, kundër makinerisë serbe. Adem Demaçi ishte kryetari, por ai ishte i burgosur (1963). Profesor Kadri Kusari na mblidhte vetëm pesë minuta dhe na ndajke detyrat: na pyetke se nga cili vend ishim dhe na porosiste të ngremë flamurin në orën 12, ditën e enjte. Kështu shpërndaheshim të gjithë dhe flamujtë kombëtarë ngriheshin përnjëherë në të gjithë Kosovën. Atëherë bëhej rrëmujë e madhe, se flamurin e Titos e lidhinim tek një qen pas bishtin me një kanaçe dhe për këtë arësye jam denu disa herë.

Krahas studentëve që ishin angazhuar me lëvizjen kombëtare, kishte ndonjë që spiunonte. Ishte një student, që nuk dua t'i përmend emrin, ua vinte studentëve flamurin në palë të librit dhe nuk vononte

shumë, vinte policia, i kontrollonin dhe i arrestonin, në një kohë që as vetë studentët nuk e dinin që kishin flamurin në çantë.

Duke e parë me këndvështrimin e sotën e quaj krejtësisht të gabuar, se pjesa më e mire e bijve të Kosovës u vranë apo mbushën burgjet me lulen e rinisë. E pse baba im më thoshte merru me punë, por çka ti bëjsha se edukimi ynë ishte shumë emocional dhe jo vetëm nga mësuesit po edhe nga nëna.

Si student në shkollën e mesme dështova për arësyen që thashë, se autoritetet qeveritare serbe më burgosnin herë pas here për motive patriotike nëpër burgjet e Prishtinës, Gjakovës, Ferizajt, Suharekës, deri në Ce Zene të Beogradit dhe vecanërisht në burgun e Pejës.

Duke provuar tmerre në burgjet e Serbisë, vendosa të arratisëm për në Shqipëri, ku na zunë në kufi dhe bëra përsëri një muaj burg. Mirë që na zuri policia serbe, se po të na kishte kapur policia e Enver Hoxhës, ose do na pushkatonte, ose do na dënonte 25 vjet burg. Vetëm nga ky fakt, e them me bindje; vërtet Titoja ishte i egër me shqiptarët e Kosovës, por Enver Hoxha ishte shumë herë më i keq se Tito.

Kur dola nga burgu, isha bashkë me tre çuna në kafene, mora një gotë raki edhe kur e shoh fotografinë e Titos, hipa në karrike e mora dhe e

theva. Atëherë një serbë më tha: "Çka po bën?" dhe i mblodhi copat dhe i fshehu.

Shkova në shtëpi gjeta babën me duart në kokë. Ngrita gruan nga gjumi dhe fëmijët i lashë aty dhe shkova në Itali në një kamp. Lashë dy vajzat dhe nuk e harroj natën kur ika, vajza që ishte në djep u zgjua dhe më nguli sytë e mua më dukej sikur sytë e saj më thoshin: "Ku po më lini mu!" Kur shkova pas shumë vitesh Melihati ishte në shkollë e nuk po e din që isha baba i saj. Nuk pranoi të vinte me mua, veç më tha: "Po erdhi gjyshja, do vij edhe unë!" e s'erdhi, por ndenji me nonën e babën tem.

Kjo ndodhi në vitin 1969 dhe pas një viti përfundova në SHBA, ku mora menjëherë "Statusin e emigrantit politik". Fillimisht punova si taksist, më pas kreva Akademinë e Policisë dhe në vitin 1986 përfundova shkëlqyeshëm studimet e larta në Universitetin "Mercy College". Pas një viti laurohem me titullin "Master degry" në studimin "Diferencimi i trurit të mashkullit dhe i femrës". Në vitin 1991 mbroj doktoraturën me temën "Shkaqet që çojnë në skizofreni" dhe marr titullin më të lartë shkencor në SHBA PH.D.

Më tej u specializua në një profil më të ngushtë në fushën e Psikologjisë Klinike, Doktorova në sëmundjen e Skizofrenisë.

3. I nderuar Prof. Dr. Kodra, jo më kot e nisa bisedën me ju që nga fëmijëria, që jo vetëm unë, por gjithë lexuesit të binden se po ndoqe rrugën e dijes, drita e saj do të dërgojë përtej imagjinatës fëminore, ajo të bën të shohësh përtej maleve, pa pasur nevojë t'i kalosh ato me këmbë, të bën që ëndrrat të realizojnë njëra - tjetrën dhe të krijojnë ëndrra tjera deri në pafundësi… ndaj do ishte me interes për lexuesin shqiptar të dinim rreth veprimtarisë suaj në SHBA…

- Veprimtaria ime është në tre pozicione: si psikolog, si profesor dhe si shkencëtar. Kam një veprimtari të gjatë në psikollogjinë klinike, të cilën e kam pasuruar me përvojën e gjatë, ku dhe ende punoj të spitalit Ushtarak në New York, ku në dhjetë vjet jam marrë me pacientë të Luftës së Dytë Botërore dhe të Luftës në Vjetnam.

Jap mësin në tre Universitete, ku përgatitim kuadro nga i gjithë rruzulli tokësor dhe tash e njëzet vjet, kam qenë këshilltar i Ministrisë së Shëndetësisë të Shtetit të New Yorkut. Dua të theksoj dhe të pranoj, se jam më shumë doktor sesa profesor, por puna në universitete më jep një kënaqësi të veçantë. Kjo punë është si shplodhje për mua, por mendoj që është fat për studentët, ngaqë e kryej mrekullisht lidhjen e teorisë me një mori shembush nga praktika ime shumëvjeçare. Kështu mësimi në këto universitete është një kordinim perfekt i teorisë me praktikën,

besoj kjo është shumë e rëndësishme për kuadrot e ardhshëm, të cilët do zëvëndësojnë ne.

Dhe pozicioni tjetër në jetën e përditshme është studimi shkencor, studime që për të mbetur brezave i kam pasqyruar nëpër disa nga librat e mi si: "Evoluimi i Trurit Dje, Sot dhe Nesër" Library of Congress (June 11. 2001), "Definition of Personality" Tiranë Library of Congress (2003), "Drugs and its Impact" Tiranë Library of Congress (June, 11. 2004), "Road Map Opportunities in Cilinical Psychology" Tiranë Library of Congress (June 12. 2006), Library of Congress 101 Independence Ave, S.E. Uashington D.C. 20559 – 6000.

Krahas punës individuale shkencore jap kontributin tim edhe në Shoqatën e Doktorëve në Shtetin e New Yorkut, jam gjithashtu Anëtar i Shoqatës të Sëmundjeve Psikike "Sigmund Frojd" të Austrisë, nënkryetar i Akademisë së Intelektualëve Shqiptarë të Shkencës dhe Artit në Kosovë, anëtar i Shoqatës së Psikiatërve në Shqipëri...

Një punë të vazhdueshme kam bërë në publikimet e ndryshme në revistën "Dituria", Organ i Akademisë Shqiptaro - Amerikane me qendër në New York, si dhe në shumë revista e gazeta prestigjoze në SHBA dhe Shqipëri.

Nga studimet e mia në lidhje me personalitete të larta të Kombit tonë, që fatkeqësisht u është dashur të lënë

Atdheun për të shpëtuar jetën, kam vënë re që krahas veprimtarisë së tyre në SHBA, apo gjetkë, kurrë nuk e kanë harruar mëmëdheun e jo vetëm kaq, po në një formë, apo tjetrër kanë dhënë një kontribut të çmuar… më thoni Prof. Dr. Kodra, si ka qenë kjo lidhje mes jush dhe atdheut?

- Para viteve '90, përveç dëshirës që na vlonte në gji, nuk kishim asnjë lloj mundësie të jepnim ndihmesën tonë, por me hapjen e kufijve dhe ndryshimeve demokratike në Shqipëri, shpreha dëshirën për të punuar dy vjet në Tiranë si klinicist pranë Klinikës Psikiatrike të Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Tiranës duke ligjëruar leksione të ndryshme dhe me dëshirë dhe kënaqësi i dhurova kësaj klinike një bibliotekë të pasur me literaturë të psikiatrisë klinike amerikane. Po kështu gjatë kësaj kohe, shërbeva në spitalin psiqiatrik numur 5 në mënyrë vullnetare.

Unë menaxhoj 150 doktorë nga mbarë bota, por kjo nuk më pengon mua që kur diçka nuk e shikoj në rregull në klinikë, ta sistemoj, apo dhe të pastroj, por në spitalin e Tiranës, edhe pse vlen të përmenden shumë mjekë të zotë, por më çudiste fakti se në mengjes ata që ishin demokratë merrnin gazetën "RD" dhe të majtët "Zëri i Popullit", në vend që të merrnin seriozisht detyrat nga mjeku i rojës së natës, kjo ishte për mendimin tim e tmerrshme. Pacientët nuk janë as të majtë, as të djathtë, ata kanë vetëm një

emër, pacientë dhe mjeku ka vetëm një emër, specialist. Kjo më shqetësonte dhe mendoj që kjo është katastrofa më e madhe në Shqipëri, politika është futur në çdo institucion dhe karrierën apo gradat shkencore i ngre dhe ul politika, gjë që për Amerikën janë absurde.

Nuk dua t'i përmend, po është e pafalshme që doktori të rrahë të sëmurin, apo të pijë raki me të sëmurin. Në atë kohë në spital ishte një aparat (elektroshot) që e kishte sjellë Franca, por ai është për policinë e jo për spitalet, ai është shumë i dëmshëm për pacientët, në vend që të shërohen, dëmtohen edhe më shumë. Truni ka fushat e veta dhe çdo gjë zhvillohet në atë fushë, kështu prish dhe fushat tjera, ndaj urdhërova dhe e hoqa nga përdorimi.

Duke pasur dëshirën e madhe për të kontribuar për qartësimin e masave të gjëra, isha i ftuar në Radio Tirana në një Rubrikë të përjavëshme me temë nga psikiatria.

Gjatë këtyre viteve, pra pas viteve '90 kam vizituar shpesh edhe Kosovën, sigurisht jo vetëm si turist, por kam zhvilluar një veprimtari të vazhdueshme shkencore dhe patriotike, ku klinikën e ktheva në instikam lufte. Për këtë arësye, serbët e bastisën disa herë dhe më detyruan të paisem me dokumenta serbe, gjë që nuk e pranova, ndaj u detyrova për herë të dytë të largohem nga vendlindja ime. Ika, por me

mend e shpirt isha në Kosovë, Shqipëri e kudo që jetojnë shqiptarë, jetoja me shqetësimet dhe mendoja për mënyrat se si të jepja kontributin tim.
Kështu gjatë Luftës së Kosovës shkova në kampet që u ngritën në Shqipëri me të dëbuarit nga Kosova, po kështu kam sherbyer edhe në spitalin Ushtarak. Krahas ndihmës sime, djali im ushtarak, Isai, lindur e rritur në SHBA, u bashkuar me radhët e UÇK - së në Kosovë, si disa të afërm të tjerë ta familjes sime. Kjo nuk është gjithshka, ndihma dhe përkushtimi im dhe i familjes sime nuk mbaron me kaq, gjithë jeta ime do jetë në shërbim të kombit.
Kam dërguar për botim një roman me titull "Rrjedha" dhe nga ç'po bisedojmë bashkë, njëri nga personazhet e librit më duket sikur jeni ju, sikur janë të gjithë ata shqiptarë intelektualë që egërsia e armiqve tanë të jashtëm e të brendshëm i detyroi të emigrojnë në vende të ndryshme të botës, veçanërisht në Amerikë, ku dhanë maksimimin e tyre intelektual dhe shkencor… ju më lart përmendën Akademinë e Shkencave dhe Arteve Shqiptaro - Amerikane, ku ju, i nderuar Prof. Dr. Kodra, jeni President i saj, mund të na thoni se si u lindi ideja e krijimit të saj, se për nga përbërja jam më se e sigurtë që ka anëtarë të denjë, të cilët me kontributin e tyre profesional dhe shkencor janë një "rrjedhë" e ndërsjelltë për ta pasuruar dhe freskuar Akademinë tonë të Shkencave këtu në

Tiranë.
Kjo ka qenë ideja e Profesor Martin Camajt, por nuk u realizua për arësye se ishin standartet Amerikane për me u plotësu me ligjet. Kur u krijuan kushtet e favorshme e krijuam Akademinë Shqiptaro - Amerikane të Shkencave dhe Arteve, ku filozofia e saj është "Çështja Kombëtare".
Vërtet aktiviteti i kësaj Akademie është i larmishëm, gjithpërfshirës të problemeve dhe arritjeve të kombit tonë, por dua të përqëndrohem pak në arësyen e ardhjes sime së fundmi në Maqedoni, Shqipëri dhe Kosovë, si përfaqësues i kësaj Akademie për problemin e mprehtë të shqiptarëve në Maqedoni e konkretisht mbi ngjarjet në Kumanovë, për të bashkëpunuar me Akademitë e këtyre tre shteteve, me Qeveritë dhe politikanë të ndryshëm që ngjarje të tilla tragjike të mos ndodhin më.
6. Po, i nderuar Prof. Dr. Kodra, ky fakt na mblodhi dhe më dha rastin të njihemi dhe komunikojmë së bashku, se çdo plagë e kombit dhemb tek të gjithë intelektualët e ndershëm shqiptarë, kudo që jetojnë e punojë.
Unë e kam theksuar edhe në një shkrim tjetër, që para se të trokasim nëpër dyert e botës, të trokasim në portat e qeverive tona, për të bashkuar mendimet dhe forcën për të drejtat dhe liritë e shqiptarëve kudo që jetojnë e punojnë në trojet e tyre dhe, më vjen

mirë që në bashkëpunim me Unionin Ndërkombëtar të Drejtave të Njeriut me seli në Kumanovë, keni bërë një kërkesë Kryeministrit shqiptar, zotit Edi Rama, me shpresë të realizohet për të mirën e shqiptarëve, më thoni ju lutem opinionet tuaja në lidhje me çka dini mbi këtë masakër dhe çfarë mendoni të bisedoni me kryeministrin Rama?

Kjo ngjarje tronditi botën e ne, shqiptarët, u drodhëm, u rrënqethëm. Akademia Shqiptaro - Amerikane e Shkencave dhe Arteve në New York, si institucion i lartë intelektual, ndjek me vemendje zhvillimet e ngjarjeve në mëmëdhe, ashtu si gjithë bashkësia shqiptare në Amerikë, por ngjarjet e fundit në Kumanovë jo vetëm na kanë tronditur, por na kanë mobilizuar që të kontribuojmë në zbardhjen e shkaqeve dhe nxjerrjen e përgjegjsve realë të kësaj gjakderdhjeje. Bilanci i kësaj masakre ku dhanë jetë 14 vetë, mbi 30 të arrestuar, 68 objekte të shkatërruara, prej të cilave 18 shtëpi shkatërruar plotësisht, na bën të mos reshtim gjer të vihet në vend drejtësia.

Kështu që lind detyrë imediatë që të bëhet një analizë e gjerë dhe të kërkohet më ngulmin zbatimi i Marrëveshjes së Ohrit me të gjitha kërkesat e saj, se me mbi 30% në Maqedoni janë shqiptarë, të cilët në çdo hap të jetës së tyre ndjehen të diskriminuar dhe të keqtrajtuar.

Ky është dhe qëllimi i bisedës sime me Kryeministrin Rama, se Shqipëria ka marrdhënie normale me Qeverinë Maqedonëse, sidomos në fushën ekonomike, por krahas tyre, duhet të ndikojë fuqishëm edhe në ruajtjen e dinjitetit të shqiptarëve në Maqedoni. Ne përshëndesim qëndrimin e qeverive të Tiranës dhe Kosovës për këtë problem, por mendoj që duhet qëndruar dhe insistuar që këto akte vandale të mos ndodhin më me shqiptarët.

Akademia Shqiptaro - Amrikane e Shkencave dhe Arteve kërkon zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit dhe shqiptarët të gëzojnë të gjitha të drejtat e tyre në Maqedoni. Akademia u kërkon liderëve politikë të shqiptarëve që të marrin përgjegjësi atdhetare e demokratike dhe të bashkëkohen midis tyre, pavarësisht nga nuancat politike që ka secila, ata duhet të tregojnë vendosmëri politike ne mbrotjen e të drejtave te popullit shqiptar në Maqedoni dhe kjo është dhe arësyeja që ne kemi kërkuar kontakt me Kryeministrin Edi Rama, që shpresojmë se do na realizohet, për të qenë qënë në krah të vëllezërve shqiptarë, ashtu si të gjithë bashkëkombasit kudo që ata punojnë e jetojnë.

Unë e kam deklaruar edhe herë tjetër, se qëllimi ynë është që t'i ofrojmë mbështetje familjeve të të paraburgosurve, por edhe avokatëve, përmes këshillave dhe logjistikës nga ana e ekspertëve dhe

avokatëve amerikan. Për rastin e Kumanovës kemi zhvilluar disa takime në Nju Jork dhe Uashington, ku kam kërkuar mbështetje për të pasur një proces transparent. Prej tani do të jemi në koordinim me Forumin për të Drejtat e Njeriut IGFM dhe kryetarin e saj Idriz Sinanin si dhe këshillin emergjent të Lagjes së Trimave. Do të bëjmë çmos që të zbardhet e vërteta.

2018-02-21

IMAZHI DHE JETA REALE E GJERGJ KASTRIOTIT - SKËNDERBEUT

Skënderbeu ose Skënderbej ,lindi në vitin 1405 dhe vdiq të vitit 1468. Është Heroi Kombëtar i shqiptarëve, figura më e shquar në historinë e shqiptarëve.

Gjergj Kastrioti ishte djali më i vogël i Gjon Kastriotit dhe i princeshës Vojsava, fëmija i fundit midis 4 djemve dhe 5 vajzave. Mendohet se lindi më 6 maj 1405 në Dibër. U mor peng si nizam pas thyerjes së të atit nga Sulltan Murati më 1421 dhe u dërgua në oborrin e Sulltanit në Adrianopojë. Atje, zgjuarsia dhe shkathtësia e quan Gjergjin në shkollën e sulltanit (içogllanëve) që përgatiste komandantë e nëpunës.

Natyra i kishte dhënë dhunti mendore e fizike. Atje mori emrin Iskënder (Aleksandër).

Pas mbarimit të shkollës, Skënderi "(Gjergj Kastrioti)" kreu detyra ushtarake në Ballkan e në Azinë e Vogël, duke u dalluar për trimëri dhe për këtë arsye iu dha titulli bej që do të thotë princ ose fisnik pra Skënderbeg do të thotë Aleksandri princ ose fisnik.

Ai nuk e harroi vendin e tij të dashur dhe priste me padurim rastin të kthehej në tokën që e lindi. Me vdekjen e të atit, ai shpresonte t'i zinte vendin, por në

fakt sulltani e emëroi sanxhakbej jashtë tokave shqiptare.

Skënderbeu nuk hoqi dorë nga ideja për t'u kthyer në Shqipëri në fronin e të atit, deri në vitin 1443 kur ai u nis kundër Janosh Huniadit nën komandën e bejlerbeut të Rumelisë.

Më 3 nëntor 1443 në afërsi të Nishit, u ndeshën dy ushtritë. Ushtria osmane u shpartallua dhe u tërhoq në panik.

Skënderbeu filloi të zbatonte planin e kryengritjes, së bashku me 300 kalorës shqiptarë e me të nipin Hamza Kastrioti, u kthye në Dibër, ku populli e priti si çlirimtar.

Mori masa për përforcimin e rrugëve nga mund të vinin osmanët, dhe prej andej iu drejtua Krujës. Me një ferman të rremë shtiu në dorë qytetin e garnizonin dhe kështu më 28 nëntor 1443 u shpall rimëkëmbja e principatës së Kastriotëve.

Mbi kështjellën e Krujës u ngrit flamuri me shkabën e zezë dykrenare i Kastriotëve.

Kryengritja u përhap shpejt në viset e tjera dhe feudalët e tjerë u ngritën gjithashtu.

Gjatë dhjetorit, Shqipëria e Mesme dhe e Veriut u spastruan nga forcat osmane, u çliruan njëra pas tjetrës kështjellat e kësaj zone.

Skënderbeu ishte organizatori i Kuvendit të Arbërit, në të cilin u zgjodh si prijës i Lidhjes Shqiptare të

Lezhës. Ai u martua me të bijën e Gjergj Arianitit me Donika Arianitin për të forcuar lidhjet e tij me principatat e tjera.

Në janar të vitit 1468 Skënderbeu u sëmur gjatë zhvillimit të një Kuvendi të thirrur nga ai, në të cilin ishin të ftuar të gjithë princat shqiptarë.

Vdiq me 17 janar 1468 në Lezhë. I mbuluar me lavdi, ai u varros në Lezhë. Shqiptarët humbën prijësin e lavdishëm që i udhëhoqi për 25 vjet rresht.

E shoqja me të birin emigruan, sikurse edhe një pjesë e parisë shqiptare, për në Itali.

Rreth përkrenares ekziston ideja se e ka mbajtur për nder të Pirros së Epirit, pasi edhe ai ka mbajtur po të njëjtën përkrenare.

Epoka e Skënderbeut e shekullit XV dhe vetë figura e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut ndikoi fuqishëm në jetën shpirtërore të shqiptarëve dhe për rritjen e vetëdijes kombëtare të tyre.

Të frymëzuar prej tyre, intelektualë të shquar shqiptarë, i pasqyruan e i përjetuan ato në vepra historike monumentale, në të cilat nisi jetën e vet historiografia shqiptare.

Në kulmin e pergatitjeve të kryqëzatës së vendeve europiane, kundër pushtuesve osmanë, vdiq më 14 Gusht 1464 ne menyre te papritur dhe te mistershme(thuhet qe u helmua), Papa Piu II, frymëzuesi dhe organizatori i saj.

Ai ishte papa i 210 i kishes katolike, Shërbeu si papë që nga zgjedhja e tij më 19 gusht 1458 dhe deri më 14 gusht 1464. Paraardhës i tij ishte papa Kalisti III ndërsa pasardhësi papa Pali II.

Ai e shpalli fillimin e kryqëzatës, në nëntor 1463 dhe ushtritë kryqëtare po grumbulloheshin në skelat e Italisë, për tu nisur kundër turqve.

Po atë vit midis Skënderbeut dhe Venedikut u përfundua Traktati i Miqësisë dhe aleanca në luftë kundër pushtuesve turq. Edhe Venediku me Hungarinë, përfunduan një lidhje ushtarake. Në Shqipëri Skënderbeu u pajtua me Dukagjinët dhe u bënë aleat të ngushtë.

Të gjitha këto si dhe nxitje e presionet e ushtruara nga Papa dhe nga Venediku e detyruan Gjergj Kastriotin të prishë marrëveshjen e Paqes me Mehmetin e II në Prill të vitit 1463 dhe të solidarizohet me kryqëzatën, duke kryer një varg aksionesh ushtarake në zotërimet turke.

Por shpresa e Skënderbeut për t'a lidhur rezistencën shqiptare, me luftën e popujve europianë, u fashit me vdekjen e Papës, që pruri në dështimin e kryqëzatës. Me dështimin e saj, shqiptarët mbetën përsëri të vetëm përballë furisë turke, barrikadë e vetme, në mbrojtje të civilizimit europian.

Ishte Dhimiter Frângu (dhe jo Dhimiter Frëngu) qe shkroi i pari jetën e Skënderbeut, realisht si u

zhvillua, sepse Frângu ishte bashkëshoqërues i gjithë jetës dhe luftërave të Skënderbeut, arkëtar e shoqërues në udhëtimet e Princit Shqiptar, ndrysh nga Marin Barleti ku ka edhe trillime.

Shkrimet latinisht të Frângut të vitit 1480, 12 vjet pas vdekjes së Skënderbeut, mjerisht u përvetësuan nga të tjerë, dhe përkthimi dhe botimi i saj italisht u bë më vonë, pas vdekjes së Frângut.

Patjetër se vepra e Barletit qe u botua latinisht ne fillim të shek të XVI (1504) kushtuar luftës heroike të arbërve për mbrojtjen e Shkodrës, (rrethimi i Shkodrës) pati jehonë të madhe.

Por vepra që e lartësoi figurën e tij si historian humanist është "Historia e jetës dhe e bëmave të Skënderbeut", të cilën e botoi italisht në Romë rreth viteve 1508-1510.

Kjo vepër voluminoze njohu shumë ribotime në gjuhë e në vende të ndryshme të Evropës.

Veprat e M. Barletit u bënë burimi më i rëndësishëm ku patriotët shqiptarë mësonin historinë e epopesë legjendare të shk. XV, kur nuk ishte zbuluar e njohur vepra e Dhimiter Frângut. Periudha e Skënderbeut u përjetësua edhe në vepra të tjera historike nga bashkëkohësit e heroit.

Siç e thame një nga bashkëpunëtorët e ngushtë të Skënderbeut, Dhimitër Frângu, shkroi latinisht, në

frymën e ideve humaniste të kohës një vepër për jetën e Skënderbeut.

Një vepër tjetër e rëndësishme për të njohur shoqërinë shqiptarë të shek. XV është "Historia dhe gjenealogjia e shtëpisë së Muzakajve", shkruar në italisht më 1510 nga bashkëluftëtari i Skënderbeut, Gjon Muzaka.

Ajo mbeti në dorëshkrim dhe, për vlerën që ka për historinë mesjetare shqiptare, botuesi i saj i shek. të XIX më të drejtë e ka cilësuar atë si një "margaritar".

Gjergj Kastrioti - Skënderbeu (6 maj 1405- 17 janar 1468) sintetizon një epokë të tërë historike që mori emrin e tij: luftën njëshekullore kundër pushtimit osman (fundi i shek. XIV - fundi i shek. XV).

Nën udhëheqjen e tij, lufta e shqiptarëve u ngrit në një shkallë më të lartë e më të organizuar dhe shënoi një kthesë vendimtare në zhvillimin politik të Shqipërisë.

Gjergj Kastrioti - Skënderbeu ishte përfaqësuesi më konsekuent dhe më i shquar i elitës drejtuese shqiptarë që udhëhoqi më vendosmëri frontin e luftës së shqiptarëve kundër pushtuesve osmanë.

Ai realizoi të parin bashkim të shqiptarëve, Lidhjen Shqiptare të Lezhës, e cila hapi rrugën e krijimit të shtetit të pavarur shqiptar, themeluesi i të cilit u bë ai vetë.

Kujdes të veçantë Skënderbeu i kushtoi ruajtjes së burimeve të brendshme ekonomike, tek të cilat u mbështet lufta.
Duke fuqizuar mbrojtjen në brezin kufitar, në lindje e në jug, ai i dha mundësi banorëve të viseve të lira të zhvillonin një veprimtari ekonomike deri diku normale.
Krahas mbrojtjes së vendit, Skënderbeu i kushtoi vëmendje çlirimit të viseve të pushtuara që ndikoi në formimin e mëtejshëm të lidhjeve më banorët e këtyre viseve dhe në forcimin e bashkimin e të gjithë popullit shqiptar.
Aftësitë e Skënderbeut si burrë shteti spikatën edhe në marrëdhëniet me vendet e tjera.
Duke pasur të qartë së rrezikut osman mund t'i bëhej ballë vetëm më sukses vetëm me forca të bashkuara, Skënderbeu kërkoi pareshtur pjesëmarrjen e vendeve evropiane në luftë kundër armikut të përbashkët.
Në kushtet e pabarazisë së theksuar ndërmjet forcave osmane dhe atyre shqiptare, Skënderbeu përpunoi strategjinë dhe taktikën e tij luftarake, në bazë të së cilës qëndronte mendimi se fitorja nuk mund të varej nga numri i ushtarëve.
Ai mbante armikun në alarm të përhershëm, i priste rrugën e fuqizimet dhe, pasi e kishte futur në kurth, e godiste me sulme të fuqishme e të befasishme.

Skënderbeu u shndërrua në simbol të luftës për liri e pavarësi. Ai mbeti një figurë e dashur për shqiptarët edhe pas vdekjes së tij.

Kujtimi i tij mbeti gjithnjë i gjallë nëpër këngët, gojëdhënat e tregimet e shumta popullore që i dhanë atij tiparet e një figure legjendare

Vepra dhe figura e Skënderbeut kishte përmasa dhe rëndësi evropiane.

Ai u vlerësua lart nga personalitetet e shquara evropiane të kohës. Këtë e dëshmon edhe fakti së për Skënderbeun është shkruar një literaturë e shumëllojshme, prej qindra vëllimesh, të botuara në shumë gjuhë, dhe në të katër anët e botës. Ndër autorët shqiptarë janë Marin Barleti, Fan Noli, Sami Frashëri, Sabri Godo, Fatos Daci e shumë të tjerë.

Thuhet se në një rast Ballaban Pasha i dërgoi Skënderbeut një dhuratë: katër kuaj arab së bashku me një pajisje të shkëlqyer për të nderuar Skënderbeut si një komandant, ndërsa Skënderbeu si përgjigje ia kthen me një dhuratë të e përbërë nga një shkop bariu dhe një gunë, duke i dhënë të kuptoj Ballaban Pashës se do të kishte qenë më shumë i nderuar të ishte një bari i thjeshtë në fshatin e tij, sesa të tradhtonte vendin e tij.

Për popullin shqiptar Skënderbeu bënte mrekulli me shpatën e tij. Ishte menduar se duheshin tre burra të

ngrinin shpatën e tij dhe se ai mund të copëtonte shkëmbinj ose shponte male me të.

Në një ngjarje tjetër popullore është thënë gjatë negociatave për paqe se Sulltan Mehmedi i II, që kishte dëgjuar për shpatën e Skënderbeut i kërkoi atë si një nder Skënderbeut.

Skënderbeu pranoi dhe dërgoi shpatën e tij si një dhuratë për sulltanin. Njerëzit e Skënderbeut pas dëgjimit të lajmeve ishin të shqetësuar.

Ata i dolën Skënderbeut në lidhje me frikën e tyre se ai i dorëzoi shpatën e tij legjendare, por Skënderbeu qeshi dhe u përgjigj se ai i dorëzoi shpatën e tij, por jo krahun e tij.

Gjatë një betejë të furishme kundër turqve që zgjati përtej muzgut, Skënderbeu urdhëroi disa nga ushtarët e tij të gjenin një tufë me dhi, e u lidhën pishtarë të ndezur brirëve të tyre dhe dërgohen në drejtim të rreshtave të ushtarëve turq gjatë natës.

Turqit besuan se u sulmuan nga trupa të shumta shqiptare dhe u larguan me mendimin se u mundën që në numër.

Për shërbimin e rëndësishëm të marrë nga ana e këtyre kafshëve, heroin ynë vendosi të përvetësojë imazhin e kafshës si emblemë të tijën, në përkrenaren e tij.

Skënderbeu në shtrat të vdekjes së tij urdhëroi djalin e tij për t'i shpëtuar hakmarrjes turke të largoheshin

për në Itali, tha se sa më shpejt të zbarkojë në ranishte të gjente një pemë ku të lidhë kalin e tij dhe shpatën e tij, dhe sa herë që të frynte era turqit të dëgjonin shpatën e tij në ajër dhe hingëllimën e kalit të tij dhe nga frika se nuk do t'a ndiqnin. Me të përhapur lajmin e vdekjes së Skënderbeut, Turqit vendosën të sulmonin forcat shqiptare sa më shpejt që të përfitonin nga morali i ulët që ngjarja kishte prodhuar.

Komandantët shqiptar vendosën të përdornin një dredhi të pazakontë: morën nga shtrati i vdekjes trupin e pajetë të kreut të tyre dhe e hypën mbi kalin e tij, nxitur në luftë me të gjithë ushtrinë e tij prapa. Turqit, u ndien të mashtruar me lajmin e rremë rreth vdekjes së tij dhe u tërhoqën.

Skënderbeu mblodhi mjaft reputacion një postum në Evropën Perëndimore në shekujt e 16 dhe 17. Me shumë e Ballkanit nën sundimin otoman dhe me turqit në portat e Vjenës në 1683, asgjë nuk mund të ketë lexues të mahnitur në Perëndim më tepër se një përrallë plot aksion e rezistencës heroike të krishterë për të "një luzmë mysliman".

Libra mbi princin shqiptar filluan të shfaqen në Evropën Perëndimore në fillim të shekullit 16. Një nga më të hershme të këtyre historive që kanë qarkulluar në Evropën Perëndimore në lidhje me veprat heroike e Skënderbeut ishte Historia de Vita et

gestis Scanderbegi, Epirotarum Principis (Romë, 1508-1510), botoi në katër dekada vetëm pas vdekjes së Skënderbeut.

Kjo Historia e jetës dhe veprave të Skënderbeut, Princi i Epirote është shkruar nga historiani shqiptar Scodrensis Marinus Barletit, i njohur në gjuhën shqipe si Marin Barleti, të cilët pas përjetuar pushtimin turk të Shkodrës tij të lindjes nga eksperienca personale, u vendos në Padua ku ai u bë rektor i kishës famullitare të Shën Stefan.

Barleti dedikon punën e tij për të Donferrante Kastrioti, (nip i Skënderbeut), dhe të pasardhësve. Libri është botuar së pari në latinisht.

Në shekujt e gjashtëmbëdhjetë dhe të shtatëmbëdhjetë libri Barleti ishte përkthyer në një numër të versioneve të gjuhëve të huaja : në gjuhën gjermane të Johan Pincianus (1533), në italisht nga Pietro Rocca (1554, 1560), në portugalisht nga Francisco D'Andrade (1567), në Polonisht nga Ciprian Bazylik (1569), në frëngjisht nga Jaques De Lavardin, zot feodal Plessis du-Bourrot (frëngjisht: Histoire de Georges Castriot Surnomé Skenderbeu, Roy d'Albanie, 1576), dhe në spanjisht nga Juan Ochoa de la Salde (1582).

Versioni në anglisht ishte një përkthim nga një frëngjisht nga De Lavardin dhe të bëra nga një

Zoterinj Zachary Jones. Ajo është botuar në fund të shekullit 16, nën titullin, Historiku i George Castriot, i mbiquajtur Skenderbej, Mbret i Shqipërisë; përmbajnë Actes famshme të tij, Deedes Fisnik e tij e Armës dhe fitoret paharrueshëm kundër Turkes për Besimi i Krishtit.

Gibbon nuk ishte i pari që e vënë re se Barleti është nganjëherë i pasaktë në favor të heroit të tij, për shembull, Barleti pohon se Sulltani i kishte ngordhur nga sëmundja nën muret e Krujës.

Portreti i Skenderbeut, ca. Biografia e 1648. Kastrioti 's ishte shkruar edhe nga Franciscus Blancus, një peshkop katolik i lindur në Shqipëri. Libri i tij "Georgius Castriotus, Epirensis vulgo Scanderbegh, Epirotarum Princeps Fortissimus" është botuar në latinisht në vitin 1636.

Voltaire nis kapitullin e tij "Marrja e Konstandinopojës" me frazën: "Sikur Perandoret grek ka vepruar si Skenderbeu, Perandoria e Lindjes ende mund të ketë qenë ruajtur."

Skënderbeu është protagonist i tri tragjedive të shekullit XVIII –të britanik, Skenderbeu William Havard-së, një tragjedi (1733), George Lillo's Hero i krishterë (1735), dhe Skënderbeu Thomas Whincop-së, Ose, Dashuria dhe Liberty (1747).

Një numër i poetë dhe kompozitorë gjithashtu kanë tërhequr frymëzim nga karrierën e tij ushtarake.

Frëngjisht poeti i shekullit të 16 Ronsard shkroi një poemë rreth tij, ashtu si edhe të shekullit të 19 poeti amerikan Henry Wadsworth Longfellow.

Për Gibbon, "John Huniades dhe Skënderbeut... janë të dyja të drejtë për njoftim tonë, që nga profesioni i tyre i Osmane armëve vonuar rrënojat e perandorisë greke."

Në 1855, Camille Paganel ka shkruajtur Histoire de Scanderbeg, i frymëzuar nga Krime të Luftës.

...

Shkrimtari dhe filozofi danez Ludvig Holberg, pohoi se Skënderbeu është një nga gjeneralët më të mëdhenjë në histori.

Ndërsa Sir William Temple konsideron se Skënderbeu ishte një nga të shtatë krerët më të njohur sië janë Belisarius, Flavius Aetius, Gjon Huniadi, Gonzalo Fernández de Cordoba, Farnese Aleksandër si dhe William Heshtur.

Kompozitori i njohur italian Antonio Vivaldi shkroi opern e njohur Skënderbeu (e interpetuar për të parën here me 1718).

Operën tjetër për Skendërbeun me titull “Skenderbeu” e shkroi në shekullin 18 kompozitori franqezë François Francœur (që është interpretuar për here të pare në vitin 1763).

Edhe pse shumë studiues nuk kanë qenë shumë të fokusuar në detajet e jetës së Gjergj Kastriotit

Skënderbeut, kjo nuk do të thotë se ata nuk kanë qenë të interesuar, por mbi të gjitha ata e kanë njohur Gjergj Kastriotin si një personalitet të madh, vizionar dhe trim e mbrojtës të civilizimit të përbashkët evropian.

Prandaj, detajet se sa ka qenë i madh, çfarë imazhi apo si ka ngrënë e si është veshur, nuk u kanë interesuar aq shumë autorëve që kanë shkruar për të, se sa vepra dhe gjurmët që ai ka lënë gjatë lidershipit të tij dhe luftës kundër pushtuesit barbar osman.

I vetmi që ka shkruar ka qenë Marin Barleti në veprën e tij me disa detaje, për shkak se ai ishte bashkëkohës, dhe se vetëm bashkëkohësit mund ta dinë se si ishte në tërësi ai personalitet.

Për të parë më mirë imazhin e plotë të këtij personaliteti mbikohor të kombit tonë, do të veçoj këtu fjalët e një nga bashkëkohësit e tij i quajtur Petruzi, nga letra dërguar Senatit Venecian.

Këtu janë përzgjedhur disa nga karakteristikat që i nënvizon mbi Gjergj Kastriotin dhe jetën e tij si më poshtë :

"Një hundë butësisht e lakuar si shqiponjë, një fytyrë të bardhë e përzier me pamje të skuqur dhe të shëndetshme, si rezultat i aktiviteteve te tij në diell, ballë të lartë të gjerë, sy të zi në të kaftë dhe mjekër të stilit të heronjve të vjetër me reputacion…

Kastrioti është i madh më tepër se madhësia e zakonshme e njeriut, i fuqishëm, muskuloz… me dhunti dhe fisnikëri që nga lindja e tij…

Ai ka një trup të fuqishëm dhe të pazakontë fizik dhe unë e kam parë disa herë atë në beteja…

I veshur me të gjelbër me një rrip shumë të mirë në mes… pantallona të gjera me shtrese tek këmbët të çorapeve ne të kuqe dhe çizme te verdha janë stolia e tij e zakonshme…

Natën, shpata e tij gjithmonë duhet të qëndrojë tek shtrati.

Në paqe ai shkon shpesh i veshur, në bazë të veshjes kombëtare (artit të veshjes se vendit)…

Ai është jashtëzakonisht i masës në të ngrënë dhe në të pirë… ndërsa, për nga morali ai mund të shërbejë si shembull (model)…

I pastër, i devotshëm, i butë, orator dhe bujar…

Me pak fjalë, bota është shpirti i tij, nga zemra e tij njihet vetë ai.

Ai zotëron një kujtesë të paimagjinueshme, në mënyrë që ai si Pirro, paraardhësi i tij i madh, emrat e pothuajse të të gjithë luftëtarëve të tij i njeh…

I urtë dhe i kujdesshëm në këshillat e tij, ai i shqyrton planet e sukseseve ose dështimeve të tij, por kur ai i dizajnon planet njëherë, ai i ekzekuton ato me vendosmëri dhe shpejtësi si rrufeja.

Përveç gjuhës së tij amtare, ai flet plotësisht turqishten, tatarishten, sklavonishten, latinishten, persishten dhe Velshisten; po ashtu ai e njeh mirë historinë e lashtë greke dhe romake: librat më të preferuar të tij janë jetëshkrimet e Plutarkut dhe komentaret e Cezarit.
Ai përdori historinë e vjetër të Livit dhe përshkrimet(direksionet)e tij duke i nxjerrë ato si rregulla për qeverinë e tij dhe mënyrën e jetës prej tyre.

"Provokatorët realë të Skënderbeut!"

"Vjet për Kurban Bajram pati një histeri qysh në mëngjes.
E kishin kapur me Skënderbeun. Qysh herët në mëngjes, të njëjtët njerëz që sot kanë vënë kujën për Skënderbeun e "mbuluar", po krenoheshin që gjunjëzuan myslimanët besimtarë të Tiranës, dhe i "detyruan" t'i faleshin Skënderbeut.
E postuan e ripostuan një foto të besimtarëve në gjunjë para kalit të Skënderbeut, ndërkohë që mua nuk më dukej e tillë. Myslimanët falen duke u drejtuar andej nga u thotë feja e tyre, çka koincidon me pozicionin e monumentit të Skënderbeut.
Aq e neveritshme u bë zhurma që "myslimanët ishin gjunjëzuar" para Skënderbeut, që edhe mua që jam

ateist dhe kam një bezdi nga këto ritet fetare kolektive nëpër sheshe, filloi të më vijë keq që ua paskan bërë me hile këtyre myslimanëve dhe i kanë "gjunjëzuar".

Sot në mëngjes që në orën 06:00, ma nxori gjumin një prej këtyre tipave. Kishte pritur se si do t'ua "dhiste" Skënderbeu prapë myslimanëve. Por pa që dhjetë metra para Skënderbeut, tabela elektronike e reklamave pengonte pamjen e Skënderbeut.

Në pozicionet e tjera Skënderbeu dukej normalisht, por me rëndësi ka fotua që nuk duket, e që quhet se është "mbuluar" Skënderbeu. Dhe nisi një histeri e re.

Nga Kosova, një miku më shkruan se i kanë vënë burkë, një tjetër thotë i kanë mbuluar dhe koqet kalit. Në fakt, ato duken po të ulesh poshtë, siç falen ata (me një fjalë, i kanë rrujt koqet, siç thotë populli në këtë rast).

Kjo është një histeri e shëmtuar, nga ato provokacionet e ndyra që duan doemos konflikt mes myslimanëve dhe feve të tjera në Shqipëri.

Nuk e vë në dyshim që dikush është kujdesur për skenografinë që edhe Skënderbeu të mos mbulohej, por dhe të mos shikohej nga të gjithë, duke e penguar skena. Ka aty brenda një zell politiko-fetar kundër tij, duke kujtuar natyrisht dhe "triumfalizmin" e vitit të kaluar, të atyre që i "tallën" se ju gjunjëzuan Skënderbeut. Por këta histerikët që bëjnë si

"gardistë" të Skënderbeut, janë në fakt autorët e vërtetë të kësaj beteje false.

E donin vitin e kaluar, duke "u tallur" me besimtarët se ua kishte futur Erion Veliaj dhe i kishte vënë të faleshin para Skënderbeut dhe po i provokojnë sivjet kur shpikin sikur kanë mbuluar Skënderbeun.

Më e neveritshme është pastaj që gjithë llumi i shoqërisë, ata që duan të bëhen protagonistë, ata që duan të bëhen "pro-perëndimorë" me Skënderbeun, dhe pro turq në grabitje të vendit, vazhdojnë histerinë.

Ky është një rast i mirë për të hartuar një rregullore të përdorimit të sheshit "Skënderbej" për festa fetare, manifestime politike, apo festa kombëtare, dhe këtu merr fund debati.

Skënderbeu nuk ka nevojë as të "gjunjëzojë" besimtarët myslimanë, as të gjunjëzohet prej tyre. Atij i janë gjunjëzuar gjithë shqiptarët duke e pranuar si simbolin unifikues kombëtar dhe jo si drejtues meshash apo Kurban Bajramesh. Ai është aty për të na kujtuar historinë dhe rrënjët e kombit dhe i ka mbyllur betejat me të gjallët më 1468, gati 550 vjet më parë.

Ndaj figurave të tilla të mëdha, do ketë gjithnjë njerëz që do hedhin gurë, apo njerëz që do t'i ngjiten pas bishtit të kalit, që të duken si ai, por kjo nuk e prek atë.

Ata që gëzojnë dhe vajtojnë, duke përmendur emrin e tij, thjesht kanë axhendën e tyre, ku Skënderbeu është i keqpërdoruri i madh.

Nëse i bën keq dikush Skënderbeut në këto kohë, janë pikërisht këta që e duan Skënderbeun, anti-mysliman, katolik apo ortodoks.

Lëreni të qetë majë kalit dhe altarit të kombit shqiptar, se as ata që ulin kokën poshtë tij, e as ata që duan të rrijnë në krah të tij, si “Skënderbej” të rinj, thjesht e bezdisin. Siç bezdisnin në të gjallë mizat kalin e tij, kur i hynin nga poshtë"!

BIOGRAFIA LETRARE DHE ARTISTIKE E SHKRIMTARIT DHE STUDIUESIT FLORI BRUQI

Flori Bruqi ulind më 29 qershor të vitit 1952 në Isniq të Deçanit, Kosovë.

Studimet e Defektologjisë i kreu në Universitetin e Beogradit, ndërsa ato postdiplomike (Magjistraturë) në Universitetin e Prishtinës - në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit (2004).

Bashkëpunoi më shtypin e përditshëm e periodik të vendit dhe të jashtëm që nga viti 1974 e deri me tash ("Bota e re" - Prishtinë, "Rilindja" - Prishtinë, "Danas" - Zagreb, "Dello" - Lubjanë, "Dnevnik" - Lubjanë, "Veqer" - Maribor, "Le Mond", "Corriera della Sera" etj).

Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës (2000).

Është menaxher i kompanisë "Flomed" nga Prishtina dhe menaxher gjeneral për Kosovë në distribucion të preparateve farmaceutike të "Schulke-Mayr-"it të Gjermanisë dhe "Borer Chemie AG" të Zvicres.

Flori Bruqi, mbrojti punimin e magjistraturës më titull "Dallimet në disa ndryshore fiziologjike ndërmjet studentëve sportistë dhe jo sportistë, para dhe pas vrapimit 400 metra para komisionit shkencor - të Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit në Prishtinë, në përbërje - Prof. Dr. sc . Hasim Rushiti, kryetar, Prof. Dr. Hysni Daka, mentor, Prof. Dr. sc. Mustafë Aliu, anëtarë.

Në punimin shkencor të magjistraturës nga lëmia e "Kineziologjisë fiziologjike", Flori Bruqi ka zbatuar një metodologji të avancuar shkencore gjatë këtij hulumtimi të tij në 22 parametra morfologjikë-fiziologjikë duke përdorur kriteret e avancuara të "Programit biologjikë ndërkombëtar" të Weiner-it dhe Louri-esë; "Praktikumin e antropologjisë biologjike" të Buzin-ës më bashkëpunëtorë; "Parktikumin e fiziologjisë sportive", të Heimer-it më bashkëpunëtorë; "Udhëzuesit Kombëtarë të Asociacionit Shëndetësor Amerikan" etj.

Punimi i magjistraturës të Flori Bruqit, është vlerësuar lartë nga komisioni shkencorë dhe i cili ka shfrytëzuar burime më të reja të literaturës (citon 49 referenca librash më të rinj nga kjo lëmi shkencore) si dhe ka përdorur 17 web-adresa portale relevante që merren më këto hulumtime të "Fiziologjisë kineziologjike" botërore.

Flori Bruqi, ka botuar qindra mija punime në shtypin e kohës dhe në internet.

Në vitin 2016 është pranuar si Anëtar i rregullt i Akademisë së shkencave dhe arteve Shqiptaro-Amerikane dhe ka titullin shkencor Prof. Dr. Flori Bruqi, PH.D. Bordi i Akademisë në korrik të vitit të kaluar e ka emruar Drejtor për mardhënie me publikun pranë ASHASHA për Kosovë, Shqipëri, Maqedoni dhe Amerikë.

Deri më tash ka botuar këta libra :

1. Zjarri i diellit, poezi, Prishtinë, 1995.
2. Ndërgjegjja, roman, Prishtinë, 1995.
3. Vrasësit e liridonëve, roman, Prishtinë, Tiranë, 1996.
4. Ringjallja, roman, Tiranë, Prishtinë, 1996.
5. Gjarpërinjtë e pallatit, roman, Tiranë, Prishtinë, 1996.
6. Dorëzeza, roman, Tiranë, Prishtinë, 1997.
7. Tokë e djegur, roman, Shkodër, Tiranë, Prishtinë, 1998.
8. Burri dhe gruaja, libër shkencor, Tiranë, Prishtinë, 2000.
9. Pallati i akereonit, roman, Tiranë, Prishtinë, New York, 2000.
10. Vademecum DDD, libër shkencor, Prishtinë, 2002.
11. Struktura faktoriale e dimensioneve antropometrike dhe fiziologjike, Prishtinë, 2004.
12. Ndikimi i sportit në personalitetin e njeriut, libër shkencor, Prishtinë, 2004.
13. Delinkuenca e të miturve dhe ushtrimet fizike, Prishtinë, 2004.
14. Vademecum për preparate higjenike të “Schulke – Mayr”– it, libër shkencor, Prishtinë, 2004.

15. Dallimet në disa ndryshore fiziologjike ndërmjet studentëve sportistë dhe jo sportistë para dhe pas vrapimit 400 metra (Punim magjistrature, Prishtinë 2005).
16. Antropometri-Jakov Milaj "Raca shqiptare", recension i zgjëruar i botuar në Floart, 2005.
17. Si ta njofim internetin, Flomed, tetor-2005.
18. Sëmundjet infektive seksuale, Floart, tetor-2005.
19. Udhëzues i shkurtër i preparative dezinfektuese, Flomed, 2006.
20. Merruni me sport dhe ushtrime fizike për t'u relaksuar, Floart, janar 2006.
21. Kosova nuk është i berzë e zezë, Floart, dhjetor 2005.
22. Fshehtësitë dhe të vërtetat për virusin avian', Flomed, 2005.
23. THE ECONOMIC ASPECTS OF SPORTS RECREATION AND HEALTH, Sport ritmi-zemrës, janar 2006, etj.
24. DETERMINANTAT SOCIO-PSIKOLOGJIKE TË USHTRIMIT FIZIK (Hulumtim socio-psiko–kineziologjikë më studentët e Universitetit të Prishtinës), Flomed, 2006.
25. Guxim shqiptar, Prishtinë, 2008.
26. 26.Olimpi shqiptar, Rugova-Art, Prishtinë, 2009.
27. Triumfi shqiptar, Rugova-Art, Prishtinë ,2009.
28. Polemika shqip, Rugova-Art, Prishtinë 2009.

29. “Antika greke”- Homeri, Eskili, Sofokliu, Aristofani dhe Aristoteli, Albemigrant, 2009.
30. Nëse kam ditur të guxojë, Rugova-Art, Prishtinë , 2012
31. Delikuenca e të miturve në Kosovë në periudhën 2003-2004, Prishtinë, 2012
32. Vademecum për dezinfektues të “Borer chemie AG”, Prishtinë, 2013.
33. Vademecum për dezinfektues të “Schülke-Mayr”, Prishtinë 2013.
34. Diademë letrare, Rugova-Art, Prishtinë 2013.
35. Diademë letrare II, Tiranë, 2014.
36. Atdheu im s’më vret, poezi, Tiranë, 2015.
37. Diademë letrare III, Tiranë, 2015.
38. Vademecun për dezinfektues 1, Prishtinë, 2016.
39. Vademecum për dezinfektues 2, Prishtinë, 2016
40. Moderniteti në letrat shqipe, Tiranë,2016.
41. Praktikat e pastrimit dhe dezinfektimit të mjediseve spitalore dhe ambulantore në Kosovë, Prishtinë 2017.
42. Dëshmi të krimit të pandeshkuar, Tiranë-Prishtinë, 2017.
43. Shtëpia e verdhë, Tiranë, Prishtinë, 2018.

Ka botuar 21 fejtone publicistiko-shkëncore në gazetën “Rilindja” të Prishtinës, në përiudhën 1974-

1982, si dhe mija punime në shumë web faqe interneti (2003-2016).
Nga viti 2005 është Editor si dhe Kryeredaktor përgjegjës i web faqës elektronike "Agjencioni Floripress".

Flori Bruqi, mban titullin shkencor Prof. Dr. Ph. D dhe është Drejtor për mardhënie me publikun në ASHASHA si dhe anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe Arteve në SH.B.A.

P a s q y r a e l ë n d ë s :

Esat Mekuli - Si ke mundur… / 7

Nobelisti Ivo Andriq si antishqiptar / 9

Pranvera e Kosovës - mars – prill 1981 / 39

Duart e përgjakura të Aleksandër Vuçiçit / 45

Kishat dhe manastiret ortodokse - trashëgimi shqiptare / 53

Dialogu shqiptro-serb në qorrsokak / 93

Shtëpia e verdhë / 101

Dick Marty u “sponsorizua” nga Beogradi / 123

Vetëvrasjet dhe vrasjet në Kosovë / 219

Ramush Haradinaj, dështimi i akuzave serbe / 245

Shqipëria natyrore si realitet / 263

Herojte e Trepces / 297

Akademik prof. Dr. Skender Kodra

Kryetari i Akademisë Shqiptare-Amerikane të Shkencave / 303

Imazhi dhe jeta reale e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut / 323

Biografia letrare e shkrimtarit dhe studiuesit Flori Bruqi / 343

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Bruqi, Flori
Shtëpia e verdhë / Flori Bruqi ; rec. Rexhep Shahu ;
red. Izet Duraku. – Tiranë : Fast print, 2018
350 f. ; 14.5x21 cm.
ISBN 978-9928-271-03-7

1.Çështja e Kosovës 2.Shqiptarë 3.Historia
4.Shkrime, korrespondenca për shtypin 5.Kronika

323.1(=18:497.115) (081
821.18(497.115) -92